

ISSN: 2078-7111



UNIVERSITETI "FAN S. NOLI"  
KORÇË

BULETINI SHKENCOR

SCIENCE BULLETIN

(seria e shkencave shoqërore)  
(social science series)

VITI XVII I BOTIMIT, Nr. 23, 2012

**BULETINI I SHKENCAVE  
SHOQERORE**

**2012**

## KËSHILLI BOTUES I "BULETINIT SHKENCOR"

- Msc Valbona Emini (Redaktore letrare)
- Msc Oljana Papo (Redaktore letrare)
- Monika Thimo (Personi i Kontaktit, Redaktore e gjuhës Angleze)

## KËSHILLI SHKENCOR I "BULETINIT SHKENCOR"

- Prof. As. Dr. Gjergji MERO, Universiteti i Korçës, Shqipëri (Kryetar)
- Prof. Dr. Ion CUCUI, Universiteti i Targovishte, Ruman
- Prof. Dsci. Ivan PETKOV, Universiteti i Sofies, Bullgari
- Prof. Dr. Gjergji PENDAMNJI, Universiteti i Korçës, Shqipëri
- Prof. Dr. Ali JASHARI, Universiteti i Korçës, Shqipëri
- Prof. Dr. Gabriela TEODORESCU, Universiteti i Targovishte, Ruman
- Prof. Dr. Aleko MINGA, Universiteti i Tiranës, Shqipëri
- Prof. Dr. Yllson MANOKU, Universiteti i Korçës, Shqipëri
- Prof. Dr. Kristaq TENEQEXHI, Universiteti i Korçës, Shqipëri
- Ass. Dr. PhD Niko KACIROTI, Universiteti i Michigan, USA
- Prof. As. Dr. Aleksandra PILURI, Universiteti i Korçës, Shqipëri
- Ass. Prof. PhD Gentian KOSTANDINI, Universiteti i Georgia, USA
- Prof. Ass. Dr. Irena KALLCO, Universiteti i Korçës, Shqipëri
- Ass. Prof. PhD Elton MYKEREZI, Universiteti i Minnesota, USA
- Prof. As. Dr. Lorenc EKONOMI, Universiteti i Korçës, Shqipëri
- Dr. Frederik ÇUÇLLARI, Universiteti i Korçës, Shqipëri

PUBLIKUAR NGA  
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" KORÇË  
SHËTITORJA "RILINDASIT"  
KORÇË, SHQIPËRI

## EDITORIAL BOARD OF "SCIENCE BULLETIN"

- Msc Valbona Emini (Editor)
- Msc Oljana Papo (Editor)
- Monika Thimo (Contact person, English - editor)

## SCIENTIFIC BOARD OF "SCIENCE BULLETIN"

- Prof. As. Dr. Gjergji MERO, University of Korça, Albania (Chief)
- Prof. Dr. Ion CUCUI, University of Targovishte, Romania
- Prof. Dsci. Ivan PETKOV, University of Sofia, Bulgaria
- Prof. Dr. Gjergji PENDAMNJI, University of Korça, Albania
- Prof. Dr. Ali JASHARI, University of Korça, Albania
- Prof. Dr. Gabriela TEODORESCU, University of Targovishte, Romania
- Prof. Dr. Aleko MINGA, University of Tirana, Albania
- Prof. Dr. Yllson MANOKU, University of Korça, Albania
- Prof. Dr. Kristaq TENEQEXHI, University of Korça, Albania
- Ass. Dr. PhD Niko KACIROTI, University of Michigan, USA
- Prof. As. Dr. Aleksandra PILURI, University of Korça, Albania
- Ass. Prof. PhD Gentian KOSTANDINI, University of Georgia, USA
- Prof. Ass. Dr. Irena KALLCO, University of Korça, Albania
- Ass. Prof. PhD Elton MYKEREZI, University of Minnesota, USA
- Prof. As. Dr. Lorenc EKONOMI, University of Korça, Albania
- Dr. Frederik ÇUÇLLARI, University of Korça, Albania

PUBLISHED BY  
UNIVERSITY "FAN S. NOLI" KORÇË  
SHËTITORJA "RILINDASIT"  
KORÇA, ALBANIA



Shtëpia Botuese: Promo Print Sh.p.k.

## PËRMBAJTJA

### GJUHËSI

**Dion Tushi**

GRIGOR GJIROKASTRITI DHE GRAMATOLOGJIA SHQIPTARE

**Ediola Nase**

HULUMTIM GJUHËSOR DHE STILISTIK I HUAZIMEVE NGA GREQISHTJA”

**Ervin Hoxhaj**

KULTURA E TË SHKRUARIT ME KOMPJUTER NË GJUHËN E DYTË.

**Jonida Petro**

TEKSTI DHE ANALIZA E TIJ NË FUNKSION TË PËRKTHIMIT PA RISK

**Mihallaq Zilexhiu**

DALLIME DHE TË PËRBASHKËTA MES KOHËVE NË GJUHËN GJERMANE DHE SHQIPE.

**Miranda Ostrosi**

SFIDAT KULTURORE DHE PËRDORIMI I GJUHËS SI MJET KOMUNIKIMI DHE ZGJIDHJE KONFLIKTESH BRENDË NJË MJEDISI PUNE GLOBAL

**Leonard Danglli**

SINONIMIA DHE HUAZIMI LEKSIKOR

### LETËRSI

**Alda Cicko (Jashari)**

“IF”- FILOZOFIA E JETËS (NJË RAST NGA R.KIPLING)

**Dion Tushi**

DY FJALË PËR JORGO SEFERISIN

**Jonela Spaho**

SENTIMENTALIZMI SI DREJTIM I VONUAR LETRAR, NË LETËRSINË SHQIPE, PËRMES PROZËS SË GRAMENOS

**Shpëtim Madani**

QASJA MITIKE DHE IRONIKE NË PROZËN E BERNARD MALAMUDIT

### FILOZOFI

**Irida Laçi (Lika)**

LIRIA SI PARADIGMË E KONSTRUKSIONIT EUROPIAN

**Migena Buka, Theodhori Karaj**

*MOBBING* NË ARSIMIN E LARTË NË SHQIPËRI DHE KARAKTERISTIKAT E PERSONALITETIT

**Robert Stratobërdha**

KONVENTA E KËSHILLIT TË EUROPËS MBI LUFTËN KUNDËR TRAFIKIMIT TË QËNIEVE NJERËZORE

### PSIKOLOGJI, PEDAGOGJI

**Artemisi Shehu (Dono)**

KOMUNIKIMI, INTERNETI DHE TË RINJTË

**Blerta Çani Drenofci**

INFLUENCA E FAKTORËVE DEMOGRAFIKË NË PËRFSHIRJEN NË POLITIKËBËRJE TË INDIVIDËVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA E FAMILJARËVE TË TYRE.

**Doreta Tartari ( Kuçi )**

PUNËSIMI I GRAVE SIPAS KËNDVËSHTRIMIT HISTORIK.

**Narbis Ballhysa**

VLERËSIMI I NEVOJAVE NË TË MËSUAR TË FËMIJËVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA SI FAKTOR KYÇ PËR GJITHËPËRFSHIRJEN E TYRE NË SHKOLLAT E ZAKONSHME

**Silvana Loka**

PSIKOLOGU SHKOLLOR: NJË PROFESIONIST I KUALIFIKUAR PËR TË KUPTUAR BULLIZMIN NË SHKOLLAT SHQIPTARE

**Daniela Tamo**

DETYRA E SHTËPISË – MJET PËR PËRVETËSIMIN E GJUHËS SË HUAJ

**Edlira Xega**

DIMENSIONI NDËRKULTUROR NË MËSIMDHËNIEN E GJUHËS SË HUAJ.

**Pavlo Cicko**

NJË KËNDVËSHTRIM I RI I KORRIGJIMIT ME SHKRIM. ROLI I TIJ PËR NJË PËRVETËSIM MË TË MIRË TË GJUHËS FRËNGE.

## **KUMTESA NGA SESIONI SHKENCOR “MIHAL GRAMENO DHE KONTRIBUTI I TIJ SI NJË NDËR PUBLICISTËT E PARË TË GAZETARISË SHQIPTARE”**

**Dion Tushi**

MIHAL GRAMENO DHE KONTRIBUTI I TIJ, SI NJË NDËR PUBLICISTËT E PARË TË GAZETARISË SHQIPTARE

**Elona (Biba) Çeçe**

VEÇORITË SINTAKSORE TË NDËRTIMEVE GJUHËSORE NË PROZËN E GRAMENOS

**Pavlo Cicko**

FRYMA PATRIOTIKE NË PUBLICISTIKËN E MIHAL GRAMENOS

**Bashkim Jahollari, Aleksandra Piluri**

VEPRIMTARIA PATRIOTIKE E MIHAL GRAMENOS NË VITET 1909-1912

# GJUHËSI



# GRIGOR GJIROKASTRITI DHE GRAMATOLOGJIA SHQIPTARE

**Dion Tushi**

Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë, Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, Universiteti  
“Fan.S.Noli”Korcë

## **Përmbledhje**

Si çdo kulturë gramatologjike edhe gjuha shqipe siç e dimë filloi të hedhë hapat e para dhe të emancipohet më së shumti nga nevoja e njerëzve për të kuptuar dhe njohur Shkrimet e Shenjta. Në këtë kontekst punimi synon të hedhë dritë mbi një figurë të rëndësishme të filologjisë dhe përkthimit, Grigor Gjirokastritin, për të cilin nuk dihet pothuajse asgjë, përveçse emrit të tij. Vepra e tij, përkthimi i Dhiatës së Re në gjuhën shqipe, përbën një ndër monumentët e parë filologjikë dhe religjiozë të plotë të gjuhës shqipe (1824). Në këtë këndvështrim vepra e tij është parë në kontekst me rrethanat historike dhe si produkt i lëvizjes kulturore arsimore të shqipfolësve të Korfuzit dhe ishujve jonikë në përgjithësi në fillim të shek. XIX, numri i të cilëve u rrit me instalimin këtu të shqiptarëve nga Suli dhe Parga. Gjithashtu këtu bëjmë të njohur një figurë të rëndësishme që kontribuoi fuqishëm në këtë përkthim, at Andrea Idromenon, një intelektual shqiptar nga Parga, doktor nderi i Akademisë Jonike dhe anëtar i Shoqërisë Biblike Jonike që mundësoi këtë përkthim. Metoda hulumtuese sjell fakte dhe argumenta nga një bibliografi e hershme, e rrallë dhe e mirëqëmtuar, ku përmendet edhe studiuesi Evlogjio Kurilla si autor i parë i një punimi për të (1933). Punimi hedh dritë mbi vlerat e këtij përkthimi, shtysat që e mundësuan, situatat dhe kushtet historikë, si dhe mbi fakte të reja të jetës dhe aktivitetit të Grigor Gjirokastritit.

## **Fjalët çelës:**

Grigor Gjirokastriti, Dhiata e Re, Shoqëria Biblike Jonike, At Andrea Idromeno, Parga, Suli, Kurilla.

## **Abstract**

As every system of words, the Albanian language is known to have developed and emancipated based on the necessity of people to read and recognize The Holy Writings. In this context, the paper aims to throw light on a distinguished personality of philology and translation, Grigor Gjirokastriti, who is not widely known. His work, translation of The New Testament in Albanian language, is considered to be one of the first most complete philological and religious monuments in Albanian language (1824).

In this aspect, his work is regarded in close context with the historical circumstances and as product of the cultural educational movement of the Albanians living in Corfu and Ionian islands, at the beginning of the XIX century. Their number increased with the settlements of other Albanians from Suli and Parga.

This paper introduces also another personality, who greatly contributed in this translation, Father Andrea Idromenon, an Albanian intellectual from Parga, Doctor of Honor from Ionian Academy and member of Ionian Biblical Association.

The investigative method brings facts and arguments from an early, rare and well-researched bibliography. The researcher, Evlogjio Kurilla, is also mentioned in this



bibliography. He is the first author with a written work on the translation of The New Testament in Albanian language, which dates in 1933. This work enlightens the values of translation, situations and historic circumstances, which resulted in it, as well as numerous new facts from the life and activity of Grigor Gjirokastriti.

**Key words:**

Grigor Gjirokastriti, New Testament, Ionian Biblical Association, Father Andrea Idromenon, Parga, Suli, Kurilla.

**Hyrje**

Në këtë punim bëhet fjalë për të dhëna të rëndësishme në lidhje me një figurë tepër të rëndësishme të gramatologjisë dhe filologjisë shqiptare, Grigor Gjirokastritin, me kontributin e tij në lidhje me botimin e parë të Dhiatës së Re në gjuhën shqipe, me të cilën hidhen themelet e filologjisë shqiptare. Nën dritën e të dhënave të reja që botohen këtu për herë të parë, mësohet më shumë në lidhje me aktivitetin e tij si dhe të bashkëpunorit të tij fare të panjohur për lexuesin shqiptar Andrea Idromenon, shqiptar prej Parge, emri i të cilit lidhet edhe me një lëvizje për emancipim kulturor të arbëreshëve të ishujve të Jonisë, të cilët synonin shkrimin dhe kultivimin e gjuhës shqipe.

**Të dhëna mbi Grigor Gjirokastritin (Argjirokastritin) dhe Aktivitetin e tij.**

**1. Të dhëna mbi veprën dhe studiuesin e parë të Grigor Gjirokastritit.**

Në kuadrin e vlerave të përgjithshme që u krijuan në shekuj, në fushën e gramatologjisë dhe filologjisë shqipe, një vend të rëndësishëm zë edhe Grigor Argjirokastriti, apo Gjirokastriti siç jemi mësuar ta quajmë, me botimin e përkthimit të Vangjel Meksit të Dhiatës së Re në gjuhën shqipe, që për nga rëndësia përbën një ndër monumentët e parë filologjikë dhe religjiozë të plotë të gjuhës shqipe. Dhe kjo për arsyen se përkthimi shqip i Dhiatës së Re, i bërë sipas të gjithave gjasave nga Vangjel Meksi në Stamboll ose në Selanik, ishte një arritje e rëndësishme pas shumë përpjekjesh të mëdha, që e kanë zanafillën nga Anonimi i Elbasanit, Dhaskal Todhri dhe Grigori i Durrësit.

Siç do kulturë gramatologjike edhe gjuha shqipe siç e dimë, filloi të hedhë hapat e para dhe të emancipohet më së shumti nga nevoja e njerëzve për të kuptuar dhe njohur Shkrimet e Shenjta. Kështu përkthimi i tyre në gjuhën e vendit është nisma e parë e kultivimit dhe zhvillimit edhe të gjuhës shqipe, dhe në këtë aspekt prurja dhe kontributi i Grigorit është i madh. Ndërkohë që vepra e tij është e njohur dhe e studiuar nga albanologë dhe gjuhëtarë të ndryshëm, për botuesin e këtij përkthimi në fjalë nuk dihej asgjë përveç emrit të tij dhe mbiemrit që përcaktonte vendin e tij të origjinës. Për herë të parë për të, një studim serioz dhe të plotë ka bërë studiuesi Evlogjio Kurilla i cili i shtyrë prej mikut të tij Mit'hat Frashërit<sup>1</sup>, boton një studim për të në periodikun "Theologjia", në

Athinë në vitin 1933. Mit'hat Frashëri duke njohur kapacitetin e E. Kurillës si studiues dhe dijet e gjera enciklopedike qw dispononte, i lutet atij të shkruajë për të, në mënyrë që të dijet diçka më tepër se emri i Grigor Gjirokastritit\*. Ndërkohë që për publikun shqiptar pothuajse asgjë nuk është thënë për të, për aktivitetin dhe rrethanat në të cilat ai punoi, për të na dhënë botimin e këtij varianti të hershëm dhe korrekt të Shkrimit të Shenjtë në gjuhën shqipe. Megjithatë Evlogjio Kurilla mendonte se këtë vepër e kishte përkthyer tërësisht Grigor Gjirokastriti, ndërsa Vangjel Meksi ka qenë vetëm një redaktues i tij, iniciativa e tij për të sjellë në dritë të dhëna të panjohura për jetën dhe veprimtarinë e Grigor Gjirokastritit, përbën një vlerë të madhe, pasi kontributi i tij qoftë edhe si redaktues, recensues dhe botues i Dhiatës së Re ka qenë i rëndësishëm dhe vendimtar.

Por cili ishte Grigor Gjirokastriti?

## 2. Të dhëna biografike për Grigor Gjirokastritin. Episkop i Paramithisë (1779).

Grigori mendohet të ketë lindur në qytetin e Gjirokastrës, aty nga vitet 40 të shek. XVIII, qytet i cili i në atë kohë i përkiste mitropolisë së Drinopolisit, prej të cilit kanë dalë burra të mëdhenj dhe klerikë të dëgjuar, ku mund të përmendim patrikun e Kostadinopojës Joasafin e Madh (1555 - 1565)<sup>1</sup>, mitropolitin e Tërnovës, Josifin, i cili ndërroi jetë në manastirin e Llavres në Mal të Shenjtë, ku akoma ruhen dorëshkrime të veprave të tij, midis të cilave edhe përkthimi i psalmeve<sup>2</sup>, mitropolitin e Korçës Neofitin (1845 – 1896)<sup>3</sup>, Neofit Derkon, një ndër figurat më të respektuara të Fanarit<sup>4</sup>, mitropolitin e Larisë Neofitin e dytë (1875 – 1896)<sup>5</sup>, mitropolitin e Pogonianisë dhe Delvinës, Vasil Papahriston etj.

---

\*Në prologun e studimit në fjalë ndër të tjera E. Kurilla shkruan: “Penën time për këtë nismë ma vuri në lëvizje miku im z. Mit'hat Frashëri, diplomati i shquar, i njohur në rrethet e Athinës; për arsye se ka qenë ambasadori i parë i Shqipërisë në Athinë (1922 - 1925), i cili pasi i shërbeu në raste të ndryshme atdheut si diplomat, tashmë jeton në Tiranë ku ka filluar botimin e periodikut “Dituria”, një periodik i shkëlqyer filologjik, të cilin e kishte ndërprerë që në vitin 1909. Për hir të tij, pasi disa muaj më parë veç të tjerash më kërkoi të dhëna për kryepiskopin e Evjas Grigorin, përkthyesit të parë të Dhiatës së Re në gjuhën shqipe, vendosa që me të gjetur mundësinë ta shkruaj. Kjo dhe për arsye se nuk është e mundur që këtë lutje të shkëlqesisë së tij ta refuzoj. Me këtë rast dua dhe unë të kontriboj në këtë nismë kaq fisnike për këtë kultivues të gjuhës shqipe. Me të drejtë zoti Mit'hat dhe shqiptarë të tjerë shprehin indinjatën se si nuk ka mundësi që të dinë diçka më tepër se emri i këtij burri, i cili ishte i pari që nxorri në dritë përkthimin e plotë të Dhiatës së Re në gjuhën shqipe. Kjo vepër e cila përbën monumentin e parë religjioz dhe filologjik, ka për shqiptarët një vlerë të pallogaritshme. Nga sa thamë ai me të drejtë mund të konsiderohet si themelues i filologjisë shqiptare. Kështu që shqiptarët e kanë si detyrim kombëtar restaurimin e kujtimit të këtij mirëbërësi të atdheut, i cili me anën e këtij përkthimi ka dashur t’ju përçojë patriotëve të tij doktrinat e hyjshme dhe të mbinatyrshme të Ungjillit. Por këtë borxh këtij kleriku të madh nuk ja kanë vetëm shqiptarët, por edhe bota helene. Grigori dallohet midis klerikëve heronj të 1821, me pjesëmarrje aktive në luftë gjatë kryengritjes së Evjas, ku pësoi shumë. Më pas ai ka qenë edhe mitropolit i Athinës. ...” (E. Kurilla, Grigorios Argjirokastritis, Theologjia, fq 348 – 349, Athinë 1933).

\* Për E. Kurillën, Grigor Gjirokastriti është jo vetëm botuesi por edhe përkthyesi i tekstit të Dhiatës së Re.

<sup>1</sup> Gjedheon, Patriarhiqi Pinakes, fq 510 – 515, Athinai 1967.

<sup>2</sup> Aleks Uavriotu, “Ekl. Alith. Tef. 17, 1887”.

<sup>3</sup> Ismiadiadu A. Koritsa, fq 34, Thessaloniki 1999.

<sup>4</sup> Dhi mandopoulou I dh. Ne ofi tou Dherkon erga ti na, meta tis biogra fias, Athinai 1881.

<sup>5</sup> Gianopoulou N. Epetir. Pam. Fq 280, Athinai 1914,

Bir i kësaj treve ka qenë edhe Grigor Gjirokastriti, i cili në “Katalogun historik të episkopëve të parë dhe të kryepiskopëve dhe mitropolitëve të Athinës”, hartuar nga arkimandriti Panaret Kostandinidhu, më pas mitropolit i Mesinisë, shkruhet: “Burrë i vyrtytshëm, i përkushtuar në besim dhe arsimdashës”<sup>6</sup>. Nga të dhënat që jep ai vetë mësojmë se në atdheun e tij u dorëzua fillimisht si episkop i Paramithisë. Nga të dhëna historike mësojmë se ai gjatë përpjekjeve të përgjakshme të suliotëve kundër Ali Pashës ka luajtur një rol të rëndësishëm, duke shërbyer si shembull i guximit dhe vetsakrifikimit, si dhe iniciatorit të hedhjes poshtë të kushteve që ju propozoi Ali Pashai, luftëtarëve suliotë, nëpërmjet ndërhyrjes së mitropolitit të atëhershëm të Janinës Jerotheut, që të dorëzoheshin dhe ai do të falte pengjet, midis të cilëve ishin edhe të afërmit e tij së bashku me nënën e tij, përndryshe ata do të vriteshin nga Ali Pashai<sup>7</sup>.

Me vdekjen e kryepiskopit të Evjas Jerotheut nga Naksosi, në vend të tij në fund të shekullit XVIII (1799 - 1827) dhe në fillim të shek. XIX vendoset Grigor Gjirokastriti, që siç thamë ishte episkop i Paramithisë, qytet ku një numër të konsiderueshëm zinin në atë kohë shqipfolësit. Pas një periudhe të gjatë pimantike mëse njëzet vjeçare, me fillimin e kryengritjes së 1821, kundër turqve në zonën e Evjas, u përfshi edhe Grigor Gjirokastriti, për kontributin e tij në këtë luftë, si komandant i kryengritjes për pjesën Jugore të Evjas, të dhëna të rëndësishme për të jep një nga kapedanët e kësaj lëvizje Aleks Kryeziu, arbëresh (arvanit). Si rezultat i këtij aktiviteti jeta e tij rrezikohet shumë herë, kapet rob nga Rushit Pasha, lirohet me ndërhyrjen e Aleks Kryeziut dhe rrezikohet të burgoset përsëri, në këto rrethana në Korrik të vitit 1823 Grigori tërhiqet në ishullin e Korfuzit, ku qysh nga viti 1819, kur ky ishull vihet nën zotërimin e Anglisë, atje mbretëronte paqja dhe qetësia. Ambienti tërësisht i ndryshëm nga ai luftarak që lë pas, është mëse i përshtatshëm për misionin e ri në fushën e letrave që do të ndërmarrë ai. Në ishullin e Korfuzit, ai takohet me shumë intelektualë grekë dhe arbëreshë (arvanitë) të vendosur këtu, midis të cilëve përmendim priftin e kulturuar Andrea Idromeno nga Parga dhe të birin e tij Panajot Idromenon, që së bashku me historianin e njohur të Sulit Kristofor Perevos, jepnin mësim këtu në shkollën e parë të hapur që në vitin 1805, rektor i së cilës ishte Joan Kapodhistria.

I ndodhur në këtë ambient mes miqve dhe patriotëve të tij Grigori ndihej mirë, shumë të njohur të tij shqiptarë nga Parga ishin vendosur në Korfuz, gjithashtu, mbas marrjes së Sulit prej Ali Pashës në vitin 1803, një pjesë e madhe e suliotëve u vendosën në Pargë dhe në Korfuz. Kështu në vitin 1803, krijohet regjimenti i njohur i “luftëtarëve shqiptarë” i përbërë kryesisht nga suliotë dhe himariotë, që nën drejtimin e Rusisë ushtronte aktivitetin kryesisht në Eptanisa (ishujt jonianë), kjo trupë luftoi në Napoli, Dalmaci, madje u ftua edhe nga Napoloni i Madh<sup>8</sup> dhe luftoi përkrah tij. Me fillimin e Kryengritjes greke të vitit 1821, 300 luftëtarë shqiptarë nga Parga, shkuan dhe luftuan për çlirimin e Pargës nga turqit, por nuk ja arritën dot, kështu që në fund gjetën strehë dhe u vendosën në Korfuz<sup>9</sup>. Me pak fjalë numri i shqiptarëve apo shqipfolësve në këtë periudhë në Korfuz, ishte rritur së tepërmi.

<sup>6</sup> Periodh. Sotir, Et. A, fq 87.

<sup>7</sup> Pouqueville, Travels in northern Greece, vëll I, fq 513.

<sup>8</sup> Boppe A. Le regiment Albanais 1807 – 1814, Paris 1902.

<sup>9</sup> Aravantinos, Hronologjia tis Ipirou, A, fq 208.

### **3. Kontributi i at Andrea Idromenos nga Parga në përkthimin e Dhiatës së Re.**

Para se të flasim për punën e Grigor Gjirokastritis si botues i Dhiatës së Re, është mirë të ndalemi tek figura tërësisht e panjohur më parë e priftit nga Parga Andrea Idromenos, pasi sipas studiuesit Evlogjio Kurilla nga ai mori shkas përkthimi dhe botimi i Dhiatës së Re në gjuhën shqipe<sup>10</sup> prej Grigor Gjirokastritis. Përsëri nga disa burime historike, mësojmë se ai ishte më i rëndësishmi ndër intelektualët e Pargës dhe figurë simbol për bashkatdhetarët e tij me një aktivitet të madh intelektual dhe patriotik, që pasi ju shkroi mbretërve dhe personaliteteve më të rëndësishëm të Europës për të ndihmuar në çlirimin e atdheut të tij, kur nuk pati më shpresa, braktis Pargën dhe vendoset në vitin 1804 familjarisht në Korfuz. Në vitin 1824 senati i Akademisë së Jonit i themeluar nga lordi Françesk Guilford e shpalli Andrea Idromenon Doktor Nderi në Teologji të kësaj Akademie, duke e emëruar njëkohësisht edhe profesor në këtë Akademi. Studentë të tij kanë qenë shumë figura të rëndësishme të gjeopolitikës dhe kulturës në vende të ndryshme të Ballkanit\*.

### **4. Lëvizja e shqiptarëve për emancipim kulturor në Korfuz dhe ishujt e Jonisë, në fillim të shek. XIX.**

Me Andrea Idromenon, Grigor Gjirokastriti lidhet me një miqësi të sinqertë dhe të dy impenjohen për kultivimin shpirtëror të bashkëpatriotëve të tyre. Në këtë kohë në Korfuz vërehet një lëvizje arsimore dhe kulturore ndër refugjatët shqiptarë të atjeshëm. Për këtë gjë do të thonim se ndihmoi rritja e vetëdijes së tyre kombëtare. Kështu bëmat heroike të suliotëve dhe banorëve të Pargës ishin përhapur në Evropë, që nga viti 1803 deri në vitin 1824, kur botohet pjesa e parë e përkthimit të Dhiatës së Re në fjalë, në Perëndim u botuan shumë libra që trajtonin historinë e shqiptarëve të Sulit dhe Pargës, por që evokonin njëkohësisht edhe periudhën e luftëtarëve të hershëm të Epirit, të pararendësve të tyre. Kështu në vitin 1803 dhe 1815 botohet në Paris dhe në Venetik “Histori e shkurtër e Sulit dhe Pargës” nga Kristo Perevu në dy vëllime. Në këto botime shtohen dhe epigrame, jambe dhe elegji të shkruara nga Andrea Idromeno, ku përjetësohen artistikisht historitë heroike dhe tragjike të maleve të Sulit. Në vitin 1812 nën kujdesin e Evgjenio Vulgarit, një iluministi të shquar grek me origjinë arbëreshe, botohet në Moskë “Historia e Skënderbeut”. Në vitin 1819 Akademia e Vjenës boton veprën “Historia e Epirit të Ri dhe të Vjetër dhe jetën e Pirros të Epirit”, të profesorit të helenistikës në universitetin e Vjenës Athanas Stagjiritit, Në Paris në vitin 1824 nga Miha il Sqina botohet libri “Epitaf për Marko Boçarin” etj.

Një prirje e veçantë për kultivimin edhe të gramatologjisë shqipe, që u vu re në fillimet e shek. XIX, edhe në arbëreshët (arvanitët) e ishujve jonikë, sipas disa studiuesve, u frymëzua më së shumti nga jehona e Revolucionit Frëng dhe impaktit të tij në fushën etnokulturore. Kështu u shkruan fjalorë dhe disa punime të thjeshta filologjike, prej të cilave mund të përmendim ato të Kunduriotit, A. Vretos, G. Rucadhit dhe mbi të gjitha fjalorin e mirënjohur Greqisht – Shqip të Marko Boçarit, të cilin filologu i mirënjohur grek S. Llambru e zbuloi në vitin 1876 në bibliotekën e Parisit në Kodikun Supplement Grec 251, ky fjalor përbëhet prej 244 faqesh dhe në pjesën e dytë të tij, duke filluar nga faqja 136 deri në faqen 244 përfshin një koleksion tematografik grekoshqiptar, si dhe një

<sup>10</sup> Kurilla E. Grigor Argjirokastritis, Theologjia, fq 349 – 363, Athinë 1933.

\* Këtu mund të përmendim vëllezërit Kapodhistria, Brailas etj.

fjalor të shkurtër frankoshqiptar\*. S. Llambru, i cili e studioi dhe foli i pari nëpërmjet botimit të një artikulli studimor, mbi këtë fjalor, mendon se fjalori i Boçarit është shkruar në prag të fillimit të kryengritjes greke të vitit 1821 dhe ka patur si qëllim të ndihmojë në marrëveshjen midis grekëve dhe shqiptarëve kryesisht arvanitë në luftën e përbashkët kundër pushtuesve turq. Në këtë atmosferë pra, fillon edhe përkthimi i këtij monumenti të parë të filologjisë shqiptare prej mjekut labovit Vangjel Meksi, autor edhe i një “Gramatike të Shqipes” në këtë kohë, e cila përmendet më 1819<sup>11</sup>, por që nuk është gjendur deri tani.

## **5. Shoqëria Biblike Jonike, iniciuese e përkthimit të Dhiatës së Re në gjuhën shqipe.**

Një shtysë e rëndësishme në zhvillimin e rilindjes shpirtërore të Eptanisit, në fillimet e shekullit XIX, fillimisht në Korfuz dhe më pas në ishujt e tjerë jonikë ka qenë shoqëria Biblike Jonike, me misionarë anglezë dhe amerikanë, e cila me iniciativën e saj bazuar në kontributet private, kishte si qëllim përhapjen e Shkrimit të Shenjtë, nëpërmjet botimit në gjuhë të ndryshme dhe shpërndarjes falas të Tij<sup>12</sup>. Këtë qëllim dhe inisiativë të Shoqërisë Biblike në fjalë e mbështeti në atë kohë për vetë kushtet dhe rrethanat edhe Kisha Ortodokse, nëpërmjet mbështetjes morale që i dha kësaj shoqërie Patriku Ekumenik Grigori i Pestë, i cili e bekoji themelimin e saj<sup>13</sup>. Nga të dhënat historike mësojmë se presidencën e kësaj shoqërie biblike e mori baroni Emanuel Theotokis, i cili ishte kryetar i Senatit Jonian me katedër në Korfuz. Korfuzi ka qenë një qendër e rëndësishme e intelektualëve në krye të të cilëve, në këtë kohë qëndronte at Andrea Idromeno, i përmendur veçanërisht për kulturën e gjerë, si dhe për krijimtarinë e epigrameve dhe odeve pindarike në greqishten e vjetër. Gjithashtu mësohet se Andrea Idromeno ka qenë anëtar i këshillit drejtues të shoqërisë Biblike Jonike dhe ishte ai që bindi Patrikun, Grigorin e Pestë për të dhënë lejen dhe mbështetjen morale për botimin në gjuhën shqipe të Dhiatës së Re<sup>14</sup>, at Idromenoja ka qenë gjithashtu për një kohë edhe redaktues i librave kishtarë, i caktuar nga Patriarkana e Kostandinopojës<sup>15</sup>, supozojmë se ai mund të ketë qenë recensuesi kryesor mbas Grigori Gjyrokstritit i këtij përkthimi kaq të rëndësishëm si në aspektin shpirtëror religjioz për arvanitët (arbëreshët) e Greqisë, shqiptarët e më gjerë, por edhe në atë kulturor filologjik. Kështu me ndërhyrjen dhe iniciativën e kësaj shoqërie u mundësua përkthimi dhe botimi në gjuhën shqipe i kësaj

---

\* Në pjesën e parë të fjalorit të Boçarit gjendet kyshënim: “Ce lexique est écrit de la main de Marc Botsari a Corfu 1809 devant moi, Pouqueville. Pukëvili në librin e tij “Voyage de la Grèce 1820”, gjithashtu jep edhe këtë informacion: “Kam dorëzuar para pak vjetësh në sallën e dorëshkrimeve të bibliotekës perandorake një fjalor greqishte të thjeshtë – shqip të shkruar nga fillimi në fund nga dora e Marko Boçarit të ri, nën drejtimin e atit dhe xhaxhait (Kristo dhe Noti Boçari) dhe vjerit të tij Kristaqit”. Gjithashtu Mithat Frashëri do ta botojë pjesën e dytë të këtij fjalori në periodikun e tij “Dituria” së bashku me një studim të detajuar në lidhje me të, ku nga 1850 fjalë të këtij fjalori, fokusohet në fjalë të rralla.

<sup>11</sup> Historia e Letërsisë Shqiptare, fq 55, Tiranë 1983.

<sup>12</sup> Att. Imeroll. 1873, fq 229.

<sup>13</sup> Ekk. Ali th. Etos E fq 180.

<sup>14</sup> Kurilla E. Grigor Argji-rokastritis, Theologjia, fq 61, Athinë 1933.

<sup>15</sup> Kurilla E. Grigor Argji-rokastritis, Theologjia, fq 60, Athinë 1933.

vepre nga Grigor Gjirokastriti, me ndihmën dhe mbështetjen e Andrea Idromenos i cili ishte ai që e futi edhe Grigorin në këtë shoqëri.

## **6. Të dhëna mbi tekstin e përkthyer dhe botimin e Dhiatës së Re.**

Kështu episkop Grigor Gjirokastriti boton në Korfuz më 1824 Ungjillin pas Mattheut dhe në vitin 1827 krejt Dhiatën e Re, të përkthyer nën kujdesin e tij. Ky botim pati një përhapje të gjerë në ortodoksët e Shqipërisë dhe në arbëreshët e Greqisë, aq sa më 1858 u ndie nevoja e ribotimit të tij në Athinë<sup>16</sup>. Gjithashtu shtojmë këtu se Vretoja dëshmon se Vangjel Meksi përktheu dhe botoi Ungjillin sipas Mattheut në vitin 1814, por nuk ka asnjë gjurmë apo të dhënë, që ta vërtetojë këtë dëshmi. Gjithashtu nga disa burime të tjera historike mësojmë se Vangjel Meksi e mbaroi së përkthyeri Dhiatën e Re në vitin 1821, mbas 16 muajsh të nënshkrimit të kontratës me Shoqërinë Biblike Britanike. Janë ndoshta këto të dhëna të karakterit kohor disi mospërpëthëse, ato që na shtyjnë të mendojmë se ndoshta kemi të bëjmë me dy përkthime të ndryshme dhe për pasojë me dy përkthyes të ndryshëm, duke marrë në konsideratë edhe hipotezën e hedhur nga studiuesi Evlogjio Kurilla se përkthyesi i Dhiatës së Re në fjalë është Grigor Gjirokastriti dhe jo Vangjel Meksi, gjithsesi ky mbetet akoma një problem i hapur për tu parë nga studiuesit.

Përkthyesi në këtë përkthim, nuk ka përdorur për përkthim tekstin zyrtar të Dhiatës së Vjetër, d.m.th. origjinalin në greqishten e vjetër, por një tekst tjetër në greqishten e re, i quajtur “Maksim”<sup>17</sup>, për shkak të përkthyesit të tij Maksimit të Kalipolit. Ky tekst është në dy gjuhë, në origjinal dhe në përkthimin e greqishtes së re të asaj kohe dhe është shtypur në Gjenevë në vitin 1638.

Pavarësisht faktit se përkthyesi nuk i është referuar origjinalit, dhe kjo vetëkuptohet, për të minimizuar shkallën e vështirësisë, kemi të bëjmë me një përkthim të kujdesshëm në dialektin labërisht të kohës dhe nga pikëpamja e interpretimit ortodoks konsiderohet prej specialistëve mjaft i mirë, gjë që tregon edhe vëmendjen e vetë episkopit dhe at Andrea Idromenos në këtë drejtim dhe përgatitjen e tyre të thellë teologjike. Kështu përfaqësuesi i Shoqërisë Biblike Pinkertoni shkruan se përkthimi u bë nën mbikqyrjen e njërit prej peshkopëve ortodoksë shqiptarë më të ditur e më të respektuar.<sup>18</sup> Në përkthim është përdorur alfabeti grek.

Grigor Gjirokastriti, është episkopi i dytë shqiptar pas Grigor Kostandinidhit ose të quajtur ndryshe Grigori i Durrësit, që pas botimit të Dhiatës së Re në gjuhën shqipe, gradohet nga Patriarkana Ekumenike e Kostandinopojës, ai zgjidhet mitropolit i Athinës<sup>19</sup>.

## **7. Grigor Gjirokastriti për pak kohë, si mitropolit i Athinës.**

Nga Korfuzi Grigori shkoi në qytetin e Athinës. Patriku Ekumenik Agathangjel, që zëvendëson patrikun e mëparshëm, Grigorin e Pestë të përmendur më sipër, të cilin turqit e varën në Kostandinopojë, i propozon Sinodit të Shenjtë, që fronin vakant të mitropolit të Athinës, ta zerë Grigor Gjirokastriti, apo Grigori i Katërt siç do të quhej që

<sup>16</sup> Beduli Dh. Libër i Shërbesave të Shenjta, fq 10, Tiranë 1961.

<sup>17</sup> Kurilla E. Grigor Argjirokastritis, Theologjia, fq 110, Athinë 1933.

<sup>18</sup> Pelushi J. “Një vështrim i shkurtër historik mbi përkthimet fetare...”, Tempulli 2, fq 13, Korçë 2000.

<sup>19</sup> Beduli Dh. Libër i Shërbesave të Shenjta, fq 10, Tiranë 1961.

tani e në vazhdim. Kështu më 16 Shtator të vitit 1827, ai zgjidhet mitropolit i Athinës dhe qëndron në fron deri fund të jetës së tij, në 4 Prill të vitit 1828<sup>20</sup>. Megjithëse qëndroi fare pak muaj si mitropolit i Athinës, kontributi i tij është i madh përse i përket mbledhjes dhe ruajtjes të librave, dorëshkrimeve dhe objekteve të tjera me vlerë materiale dhe shpirtërore të mitropolisë së Athinës, manastireve përreth dhe shkollave të qytetit, mbas largimit nga qyteti të forcave turke, dhe marrjes së tij në dorë nga kryengritësit grekë. Kështu me të drejtë Grigori i Katërt përmendet në analet e historisë greke si ringritësi i bibliotekës së Mitropolisë të Athinës<sup>21</sup>.

Pra nga sa thamë me të drejtë ai është konsideruar jo vetëm si një intelektual i mirëfilltë i kohës së tij por edhe një njohës dhe konservues i vlerave në përgjithësi.

## Referencat

- Gjedheon, Patriarhiqi Pinakes, Athina i, 1967.  
Aleks Llavriotu, "Ekk. Alith". 1887.  
Ismirliadhu A. Koritsa, Thessaloniki, 1999.  
Dhiamandopoulou Idh. Neofitou Dherkon erga tina, meta tis biografias, Athina i, 1881.  
Gianopoulou N. Epetir. Parn. Athina i, 1914.  
Periodh. Sotir, Et. A.  
Pouqueville, Travels in northen Greece, vëll I.  
Boppe A. Le regiment Albanais 1807 – 1814, Paris, 1902.  
Aravantinon, Hronologjia tis Ipirou, A.  
Kurilla E. Grigor Argjirokastritis, Theologjia, Athinë, 1933.  
Att. Imeroll. 1873.  
Ekk. Alith. Etos.  
Ta soz. Ekk. Sugg B.  
Kamburoglou Dhim. Mnimeia tis Istorias ton Athinon, Tom. A, Athina i, 1891.  
Historia e Letërsisë Shqiptare, Tiranë, 1983.  
Beduli Dh. Libër i Shërbesave të Shenjta, Tiranë, 1961.  
Pelushi J. "Një vështrim i shkurtër historik mbi përkthimet fetare...", Tempulli 2, Korçë, 2000.

---

<sup>20</sup> Ta soz. Ekk. Sugg B, fq 25.

<sup>21</sup> Kamburoglou Dhim. Mnimeia tis Istorias ton Athinon, Tom. A, fq 41, Athina i 1891.

# “HULUMTIM GJUHËSOR DHE STILISTIK I HUAZIMEVE NGA GREQISHTJA”

**Ediola Nase**

Departamenti i Edukimit, Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë  
Universiteti “Fan S. Noli”

## **Përmbledhje:**

Cilësimi i një fjale si huazim është një qëndrim etimologjik, për stilistikën kanë vlera shprehëse huazimet, për të cilat bëhet e dukshme që janë diçka e huaj kundrejt brumit të shqipes ose tekstit rrethues shqip. Huazimet i nënshtrohen një vlerësimi shoqëror e kulturor, prej të cilit mbeten ngjyrimet stilistike në leksik dhe rrjedhimisht, mund të shfrytëzohen po për ato synime dhe me po ato përftesa shprehëse.

Shtresimi i fjalëve të huazuara nga greqishtja i ndan fjalët në:

1. Arkaizma dhe historicizma, që janë fjalë të vjetra apo fjalë që janë përdorur në periudha të hershme historike e që s’përdoren më.
2. Fjalë të leksikut aktiv, të cilat janë fjalë që hasen në gjuhën e folur.
3. Leksiku terminologjik që përmbledh ndërkombëtarizma, që janë përgjithësisht terma të fushave shkencore.

**Fjalë kyç:** arkaizma, historicizma, fjalë të leksikut aktiv, leksiku terminologjik, ndërkombëtarizma, çift në mungesë, çift në prani, varg sinonimik i shkallëzuar, funksione stilistike

## **Abstract:**

The qualification of a word as a borrowing is an etymologic evidence; the expressive borrowings are valuable to stylistics. The borrowings are distinguished from the Albanian words or within an Albanian text. Borrowings are evaluated in a social and cultural environment. This phenomenon brings to the lexicon some stylistic features, which can be used as expressive idioms.

The Greek borrowed words are divided into:

1. Archaisms and historicisms: which are words used in early historical periods, not used any more nowadays.
2. Active vocabulary words: which are words encountered in spoken language.
3. Terminological lexicon: which includes international words, which are generally terms of scientific fields.

**Key words:** archaisms, historicisms, active vocabulary, glossary of terminology, internationalisms, couples by default, couples by presence, gradual synonymic series, stylistic functions

## **HYRJE**

Gjatë shekujve të historisë së gjuhës sonë shumë sende janë zhdukur bashkë me sendet a me konceptet e kohës, shumë fjalë të tjera shqipe janë zevendësuar nga fjalë të huazuara prej gjuhësh të tjera ose nga fjalë të reja të krijuara me mjete të tjera. Kjo tregon edhe se zhvillimi i leksikut lidhet ngushtë me historinë e një populli, kështu zhvillimi



shoqëror ekonomik e kulturor sjell ndryshime të drejtpërdrejta në leksik. Po ta shqyrtojmë nga ky këndvështrim leksikun e shqipes do të vemë re se në periudhat më aktive të historisë së popullit tonë janë bërë ndryshime të mëdha dhe në leksikun e shqipes.

Huazimet nga greqishtja kanë pa dyshim arsyet e tyre të ekzistencës dhe vazhdimësisë: Shqiptarët dhe grekët, dy nga popujt më të vjetër të europës, në një vazhdimësi 3000 vjeçare kanë pasur me njëri - tjetrin kontakte të drejtpërdrejta dhe të shumëanshme, kontakte të cilat u shtuan dhe u ndërlikuan sidomos kur para shqiptarëve u shtrua për zgjidhje problemi kombëtar nga mesi i shek. XIX e në vazhdimësi deri në vitin 1912. Si një nga faktorët përcaktues në këtë proces veçojmë praninë e një popullsie minoritare greke në Shqipëri dhe atë të popullsisë shqipfolëse në Greqi. Kontaktet e dyanshme ndërmjet dy popujve kanë çuar, ndër të tjera, në zotërimin e gjuhëve respektive, çka nënkupton minimalisht zotërim të leksikut ndoshta dhe gramatikës së tyre.

### **SHTRESËZIMI I FJALËVE TË HUAZUARA NGA GREQISHTJA**

Për të bërë një shtresëzim të fjalëve të huazuara nga greqishtja, si një mbështetje e mirë shërben “Fjalor fjalësh të huaja në gjuhën shqipe” me autor Mikel Ndreca që ka për bazë lëndën leksikore, të vjelë nga fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe (1954-1980), nga fjalorë e enciklopedi të ndryshme, nga veprat letrare e shkencore, nga tekstet shkollore, nga shtypi i përditshëm e periodik si dhe nga burimet e tjera të informimit publik.

Fjalori përmban rreth 19. 000 fjalë, shprehje e shkurtime, të cilat mund të klasifikohen në:

1. fjalë ndërkombëtare nga të gjithat sferat e veprimtarisë njerëzore e shoqërore që përdoren dendur dhe mund të përdoren në gjuhën shqipe sikundër edhe në çdo gjuhë tjetër.
2. fjalë të vjetra (arkaizma e historicizma) me burim të huaj, që hasen në veprat e shkruara në të kaluarën ose që mund të dëgjohen aty - këtu edhe sot në gjuhën e folur.
3. fjalë të reja me burim të huaj, që kanë hyrë e po hyjnë sidomos në gjuhën e folur.
4. emra të përveçëm njerëzish me burime të huaja, që janë përdorur dhe përdoren ndër shqiptarët.

Mund të vemë në dukje që në fjalor janë paraqitur rreth 2000 të tilla, pra fjalët e huazuara të greqishtes në gjuhën shqipe të këtij fjalori përbëjnë rreth 23% të të gjitha fjalëve të huaja që janë përfshirë aty.

Statusi i sotëm ndërkombëtar i greqishtes dhe ai i shqipes nuk janë të barasvlershëm; ai i greqishtes është mbizotërues së pari sepse greqishtja është gjuhë e një populli dhe e një kulture që kanë përcaktuar rrjedha në zhvillimet europiane dhe së dyti leksikografia greke ka një histori rreth 3000 vjeçare ndërsa leksikografia shqiptare ka një histori vetëm gati 400 vjeçare. Fjalët e burimit grek në shqipe janë huazimet më të hershme. Në përgjithësi fjalët nga greqishtja e vjetër u përkasin fushave shoqërore, të bimësisë, etj., *si fier qersh, pjepër, presh, mokër, lakër* etj. Huazime leksikore nga greqishtja, të kohës bizantine dhe të kohës së re, kanë hyrë sidomos në jetën shoqërore në artizanat, në botën shtëpiake, në kopshtari etj., *si lajm, fis, pronë, flamur, trastë, avlli, oreks, trëndafil, stolis* etj. Ndërkohë që një pjesë e madhe e huazimeve leksikore nga greqishtja kanë mbetur në të folme anësore si krahinorizma. Një pjesë e tyre kanë dalë nga përdorimi dhe po dalin si fjalë të vjetëruara (historicizma). Është vërtetuar gjithashtu

se edhe shqipja ka ndikuar nga ana e saj mbi greqishten; kështu në greqishten e re ka rreth 70 fjalë të burimit shqip. [Thomai J, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, 1999;232]

Shtresimi i hauzimeve nga greqishtja i ndan fjalët në:

### **1.Arkaizma dhe historicizma:**

*ambrozia, angari, barbar, brefotrof, dhaskal, dhiatë, enografi, enologji, falangë, qefali, pezavul, tagar, dhjazzmë, gjeraqinë, katallan, potir, poganik, prikë, enemy, magjiri etj.*

### **2.Fjalë të leksikut aktiv:**

*afendiko, agoni, agora, aguridhe, akoma, alfabet, amfiteatër, amnisti, anonim, antagonist, antipati, aristokraci, ateist, atlet, bibliotekë, ciklike, demokraci, dialog, diasporë, dietë, dinasti, diplomë, dozë, dhisk, dhomë, epokë, etnike, eufori, fantastike, fantazi, fantazmë, fazë, fener, fenomen, filantropi, filarmoni, fizionomi, fobi, fotografi, fron, gargarë, gliko, gjigant, gjini, harmoni, hero, hidraulik, hieroglofe, higjenë, himn, hipokrit, homolog, horizont, ide, idiot, ikonë, jehonë, kalldrëm, kamatë, kanun, karakter, karakteristikë, kartë, kartotekë, katalog, katastrofë, kitarë, klimë, kolos, kremastar, kritikë, krizë, kronikë, kukull, llastik, llogari, magji, melodi, mentor, metodë, mimikë, mister, nostalgji, oreks, organ, orkestër, palestër, panair, panik, panoramë, periferi, protokoll, qendër, rapsod, semafor, simbol, simpati, sindikatë, skelet, skenë, stilograf, strategji, sustë, shkollë, shpellë, taktik, talent, teatër, telegraf, telepati, temë, tip, trapezë, trofe, themel, thesar, zograf, etj.*

### **3.Leksiku terminologjik në fusha të tilla si:**

#### **a) Mjekësi:**

*adeni, adenoktomi, adenologji, aerofagji, aeroterapi, afazi, aglosi, agrafi, alergji, amnezi, anemi, anestezi, anomali, anoreksi, antibiotik, aritmi, asfiksi, autopsy, azotemi, brekopneumoni, citolitë, citolog, dermatolog, dipleji, dozë, faring, fizioterapi, glikemi, idiopati, iktër, iridë, kardiolog, katabolizëm, mani, narkozë, neurolog, neurozë, nevrasteni, oftalmolog, onkolog, onkologji, patolog, pediatër, profilaksi, reumatizëm, semiologji, stomatologji, takikardia, terapi, tiflologjia, traumatizëm, traumatolog, etj*

#### **b) Shkencat e natyrës:**

*aerobalistikë, aerodinamikë, aerofor, aerologji, aeromekanikë, aeronaut, aeropauza, aeroplan, agronom, akromatizëm, akustikë, amebë, amfib, anaerobe, analitike, anatomi, anemografi, asimetri, atmosferë, batisferë, batofobi, biocenozë, biogjenezë, bionomi, biosintezë, botanikë, cefalopodët, cilindër, citogjenetikë, citolitë, citoplazmë, citostomë, dazimetër, deltoid, digonale, eklips, ekzosferë, elipsoid, embrion, energji, entropi, epidermë, fagocite, faring, fizikë, fosforeshente, fotosintezë, galaktikë, gen, grafik, grafit, gjenetike, genotip, halogjeni, hartë, hektolitër, hektometër, helikë, hemisferë, hidrofile, horizont, iridë, izobare, izobate, izohipse, izotermike, izotop, katalizator, kimia, kinetika, klimë, klorofil, kolesterolinë, kozmos, magnet, matematikë, mekanikë, paralele, qendër, romb, saprofitet, simetri, spirale, teleskop, termike, zonë.*

#### **c) Shkencat shoqërore**

##### **• Gjuhësi dhe literaturë:**

*aforizëm, agramatizëm, akatalektike, akronimi, alegori, alofon, aloglot, alomorf, anaforë, analogji, diektike, dialektikë, dialektologji, diatezë, diftong, dramë, epanastrofë, epigrafi, epikë, epilog, epitët, epope, etimologji, filologji, fonemë, fonetikë, frazeologji, gjinia, hiperbolë, homonim, idil, idiolekt, idiomë, ironi, izomorfemë, leksik, leksikologji, lirikë, melodramë, metaforë, metonimi, morfemë, morfofonemë, morfologji, onomastikë,*

*onomatope, ortofoni, ortografi, pantonimë, parabolë, paradigmë, paragraf, parantezë, parodi, paronimi, perifrazë, prolog, sarkazëm, semantikë, semiologji, sinekdotë, sinkretike, sinonim, sintaksë, tragjedi, trilogji, utopi.*

- *Filozofi*

*agnosticizëm, aksiologjike, anakronike, cinizëm, citolog, dogmë, empirike, estetikë, filozofi, gnoseologji, heuristikë, kategori, panteizëm, paradoks, pragmatizëm, profeci, telepati.*

- *Logjikë*

*analizë, aksiomë, alogjizëm, demografi, etiologji, paralogjizëm, silogjizëm, sintezë, tautologji.*

## **VËSHTRIM STILISTIK I HUAZIMEVE NGA GREQISHJTA**

Në studimet e derisotme për huazimet leksikore të shqipes nga greqishtja (greqizmat) shumë pak trajtohet përdorimi stilistik i tyre. Ndërkaq kjo çështje merr rëndësi të veçantë, ngaqë studimi i saj çon në një vlerësim më objektiv të vendit që zënë huazimet në gjuhën marrëse duke iu shmangur kështu “grackave” që fshehin trajtimet statistikore të huazimeve. Del në pah më mirë dinamika e gjuhës dhe procesi i zhvendosjes së huazimeve nga shtresa neutrale e leksikut drejt asaj të ngarkuar stilistikisht.

Në “Parimet themelore për hartimin e Fjalorit të Gjuhës së Sotme Shqipe” (Kostallari 1972), veprës që do të kodifikonte fjalësin e koinesë letrare (1980), shënohet ndër të tjera:

“Në mënyrë të veçantë duhen pasur parasysh ndryshimet stilistikore që kanë ndodhur në shekullin tonë në fushën e turqizmeve e të greqizmeve - pjesa më e madhe e tyre në leksikon e sotëm të shqipes kanë kaluar në kundërvëniet stilistikore, si fjalë të ligjërimit a të gjuhës bisedore, ose, në përgjithësi, si fjalë periferike të leksikut të sotëm letrar me sinonimet e përvetësuara nga gjuhët e tjera nëpërmjet letërsisë si fjalë neutrale librore”.

Duke u nisur nga sa u përmend më lart, dallohen dy aspekte:

- a) huazimi leksikor krijon stil nëpërmjet kundërvënies;
- b) kjo kundërvënie realizohet me ekzistencën e një sinonimi stilistikisht asnjës.

Kështu veçojmë katër tipe të funksionimit stilistik të greqizmeve:

### **1. Çift në mungesë**

Kështu quhet rasti i përdorimit të greqizmeve që janë të “ngjyrosura” stilistikisht, për faktin se ekziston sinonimi asnjëanës i tyre, i cili ndonëse nuk shfaqet në tekst krijon kundërvënien në mungesë. Në shqipen e sotme letrare gjejmë shpesh të tilla çifte, si psh. *afendiko / pronar, punëdhënës; aguridhe / i papjekur; andrallë / shqetësim; dhaskal / mësues, dheks / pranoj etj.*

### **2. Çifti në prani**

Kështu është quajtur rasti i bashkëndodhjes së dy fjalëve sinonime ose pothuaj sinonime, nga të cilët njëra është greqizëm. Këto lloj çiftesh shfaqen më shpesh në letërsinë popullore. të tilla janë: *kocka e kokalla, vrarë e sosur, jetën e zoinë, luftëra e limerë, u pataksën e u çudinë, ner e timi etj.*

### 3. Varg sinonimik i shkallëzuar.

Në këtë rast huazimi nga greqishtja shfaqet njëkohësisht me sinonime të tij në një varg të shkallëzuar: *një ligësi, një kakurgjima; meraket e sèkëllditë etj*

### 4. Alternim dhe larmi sinonimesh

*duhet/ lipset; akoma / ende; letër/ kartë/ gramë; kufi/sinor etj.*

Gjithashtu funksionet stilistike, sipas mënyrës dhe qëllimit të përdorimit mund të jenë:

#### 1. Të tipit intensiv

Funksion intensive kanë fjalët si: *aguridhe, andrallë, gremis, kopanis, lamps, stolis, tromaks, lipsu!gremisu!* etj. Kështu themi *aguridh* për dikë që është tipik i papjekur, *tromaks* kur jemi më shumë se të trembur e kështu me radhë.

#### 2. Me ngarkesë negative:

Fjalë të tilla janë si p. sh: fjala *honeps*; është për t'u theksuar se kjo fjalë pothuaj gjithnjë shoqërohet nga pjesëza mohuese nuk, pra nuk themi zakonisht *honeps* për diçka të pëlqyer por për diçka që nuk pëlqehet, po kështu fjala *pleksje* përdoret zakonisht për diçka që nuk është gërshtuar apo përfutur harmonikisht por për diçka që është ngatërruar negativisht.

#### 3. Me ngarkesë pozitive.

Të tillë ngarkesë kanë fjalët si *feks*, që themi në përgjithësi kur diçka shndrit dhe na fal kënaqësi apo *sihariq* që s'mund të përdoret kurrsesi për një lajm negativ por vetëm për një lajm pozitiv e të gëzueshëm.

Në përfundim të këtij shqyrtimi mund të vemë në dukje përfundimet:

#### Përsa i përket shtresëzimit të huazimeve nga greqishtja, mund të themi se:

- Arkaizmat dhe historicizmat janë fjalë që hasen më shumë në vepra që janë shkruar në të kaluarën apo fjalë që janë përdorur në periudha të veçanta historike e që tani nuk përdoren më, e që thjesht dëshmojnë për lidhjet e hershme mes dy popujve.

- Fjalët e leksikut aktiv vihet re se ato janë fjalë që rrezikojnë varfërinë e gjuhës shqipe e për fat të keq përdoren gjithmonë e më dendur, ndërkohë që për shumicën e tyre ekzistojnë fjalët gjegjëse shqipe të cilat duhet të zëvendësojnë këto huazime të panevojshme që dëmtojnë kryesisht gjuhën e folur.

- Fjalët e leksikut terminologjik janë përgjithësisht ndërkombëtarizma që përdoren dhe në gjuhët e tjera dhe shumë syresh nuk mund të zëvendësohen me fjalë të tjera në gjuhë.

- Këto huazime cilësohen si fjalë me burim të huaj meqenëse gjëlojnë e përdoren edhe në disa gjuhë të popujve të tjerë dhe ruajnë në vete shumë karakteristika morfologjike, fonetike e kuptimore të gjuhës prej së cilës burojnë, prandaj përdorimi i tyre nuk ul aspak vlerën dhe rëndësinë e tyre si pronë e fondit leksikor të shqipes së sotme letrare.

#### Përsa u përket funksioneve stilistike të huazimeve, mund të themi se:

*Së pari*, fjalët nuk e përftojnë nga njëra ditë në tjerën ngarkesën stilistike, kështu në tekste të shekullit të kaluar fjala dhaskal përdoret pa ngjyrimin negativ që mori më pas, kur u

zëvendësua nga fjala mësues. Nuk ka dyshim gjithashtu që ky proces ndikohet prej faktorësh jashtëgjuhësorë.

*Së dyti*, huazimet e “ngjyrosuara” stilistikisht, për shkak të kundërvënies që krijojnë me fjalët e shtresës asnjëanëse, zënë një vend të qëndrueshëm në gjuhë, ndryshe nga huazime të tjera, që shfaqen thjesht si sinonime të fjalëve të shqipes.

### **Referencat**

- A. Kostallari, Parimet themelore për hartimin e “Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe”, 1972
- E. Çabej, Studime etimologjike në fushë të shqipes, 1976
- Dh. Qirjazi, Huazimet greke në shqipen e sotme (Revista ALBANOHELLENICA), 1999
- M. Ndreca, Fjalor fjalësh të huaja në gjuhën shqipe, Tiranë 2007, Botimet Toena
- J. Thomai, Leksikologjia e gjuhës shqipe, 1999, SHBLU

# KULTURA E TË SHKRUARIT ME KOMPJUTER NË GJUHËN E DYTË.

**Ervin Hoxhaj**

Fakulteti i Gjuhëve të huaja, Universiteti i Tiranës

## **Përmbledhje:**

Mjedisi teknologjik ku ndodh procesi i të shkruarit ndikon si në procesin e të shkruarit ashtu dhe në vlerësimin e tij. Sidoqoftë, kjo varet nga caktimi i pajisjeve teknologjike që përdoren në mbështetje të të shkruarit në gjuhën e dytë. Për këtë arsye është shumë e rëndësishme të analizosh efektin që kompjuteri ka, jo vetëm mbi studentët të cilët shkruajnë në gjuhë të dytë, por edhe mbi të gjithë llojet e shkruarve si dhe mbi kulturën e të shkruarit.

Ndikimi është se të shkruarit me kompjutera zakonisht ngjason me të shkruarin i cili është më i thjeshtë por dhe më pak i planifikuar si dhe më pak i përdorshëm. Prandaj strategjitë specifike të cilat mundësojnë që studentët të rregullojnë tekstin e shkruar i ndihmojnë ata, veçanërisht në ndërtimin, shqyrtimin si dhe vlerësimin e tekstit gjatë procesit të të shkruarit në gjuhën e dytë. Duke bashkangjitur metoda dhe strategji të ndryshme në mësimdhënien e të shkruarit në gjuhën e dytë përmes kompjuterit, produkti që ne përfitojmë është më i dobishëm dhe ka rezultate më të mira. Kjo gjithashtu na mundëson të kuptojmë më mirë fushën e të shkruarit në gjuhën e dytë si dhe rëndësinë e kompjuterave në përgjithësi, duke transformuar të shkruarin në gjuhën e dytë në një kulturë të vërtetë e cila meriton një vëmendje të veçantë si nga gjuhëtarët ashtu dhe nga studiues të tjerë.

**Fjalët kyçe;** të shkruarit në gjuhën e dytë, kultura e të shkruarit, ndikimi i kompjuterit në shkrimin në gjuhën e dytë

## **Abstract:**

The technological environment in which the process of writing takes place, affects both the process of writing and its recognition. However, this depends on the design of technological tools that are used to support writing in second language. For this reason it is very important to analyse the effect that the computer has not only toward students that write in second language but also toward all kind of writers and the culture of writing as well.

The effect is that writing with computers, usually tends to lead toward a kind of writing which is simpler but less planned and also less useful. Therefore specific strategies that enable students to regulate the written text attempt to help them especially in the construction, revision and recognition of text in the process of second language writing. By attaching different methods and strategies of teaching writing in second language via computer, the product that we obtain is certainly more effective and obtains better results. It also allows us a better understanding of the field of writing in second language and the importance of computers in general, transforming writing in second language into a real culture that deserves a specific attention from linguistic also from other researches.

**Key Words;** writing in second language, the culture of writing, the influence of computer on second language writing

## Hyrje

Roli dhe rëndësia e shkrimit në jetën tonë ka qënë subjekt studimi dhe interesi i theksuar në literaturën e Robinson<sup>1</sup> i cili thotë se pa shkrimin njerëzimi nuk do të mund të kishte histori. Megjithatë, mijëvjeçari i ri nuk ndryshoi vetëm mënyrën e të jetuarit, por edhe shkrimin si pjesë e rëndësishme e njerëzimit, duke sjellë ndryshime rrënjësore si në formë ashtu edhe funksionet që ka shkrimi<sup>2</sup>. Dëshirat, mesazhet dhe çdo gjë tjetër të cilat më parë dërgoheshin përmes komunikimit oral apo edhe letrave, sot dërgohen përmes shkrimit elektronik.

Edhe në vëndin tonë përdorimi i pajisjeve elektronike të cilat janë në funksion të përmirësimit të komunikimit, shënojnë një rritje të vazhdueshme. Një nga shembujt më tipik të këtij përdorimi është edhe formimi i forumeve të ndryshme në internet, krijimi i faqeve zyrtare të bizneseve apo edhe institucioneve të ndryshme si edhe pajisja e shumë shkollave me laboratorë dhe kompjuter në funksion të përmirësimit të procesit të shkruarit dhe të komunikimit.

Duke qenë se një nga aktivitetet më të përdorura dhe aktet e para që kryhen përmes një kompjuteri lidhen drejtpërdrejt me shkrimin,<sup>3</sup> është shumë e rëndësishme për studiuesit, mësuesit por edhe akademikët të cilët duan të përmirësojnë strategjitë e tyre në mësimdhënien e shkrimit në një gjuhë të huaj, fillimisht të ekzaminojnë gjëndjen dhe veçoritë e gjuhës së shkruar në periudhën e kompjuterizimit.

### - Të kuptojmë kulturën e të shkruajturit

Procesi i të shkruarit dhe kultura e të shkruarit është një fushë që ka ngjallur gjithnjë interes për shumë studiues të gjuhësisë. Nga studimet e kryera, është vënë re se të shkruarit është një mënyrë për të demonstruar gjuhën dhe rëndësinë e gjuhës për qënien njerëzore. Megjithatë, të shkruarit është më shumë se sa një mjet, një vegël që përdorim ne kur duam të shprehim mendimet tona. Sipas Ong (1995) dhe Coulmas (1996), të shkruarit ka një ndikim thelbësor e shumë të rëndësishëm edhe në mënyrën se si ne mendojmë dhe krijojmë perceptimet tona. Në ditët e sotme shumë nga studimet e kryera në lidhje me këtë çështje, kushtëzohen shumë edhe nga përdorimi teknologjisë në procesin e të shkruarit. Me revolucionin “personal” që pësoi përdorimi i kompjuterit gjatë viteve ’80, akademikët dhe studiuesit filluan të kërkonin për më shumë mundësi përdorimi në mënyrë që të kuptonin më mirë të gjitha ndryshimet që sillte përdorimi i tij në mënyrën se si komunikojnë njerëzit mes tyre. Të gjitha studimet që nisën të kryheshin ishin frymëzuar nga shprehja e famshme e McLuhan-it, i cili pohoi se tashmë duhet të fillonim t’i druheshim frikës se mos shoqëria ku ne jetojmë pak nga pak do të transformohej nga një shoqëri bazuar në komunikimin me shkrim në një shoqëri të orientuar në komunikimin oral.

Gjatë këtij kapitulli, do të hedhim dritë në historikun e të shkruarit, në kontekstin e tij kulturor si dhe në efektet që ka përdorimi i mjeteve të ndryshme në procesin e të shkruarit, duke filluar që nga shpikja e alfabetit dhe efektet e tij në shkrim deri tek përfshirja e teknologjisë dhe pajisjeve teknologjike. Pra, në këtë kapitull do të

---

<sup>1</sup> Robinson (1995;7) Story of Writing

<sup>2</sup> Baron, (2001 ) How Written English Evolved and Where it’s Heading

<sup>3</sup> Jones, 1995 Understanding Community in the Information Age “Cybersociety”

mundohemi të përmbledhim konceptin e të shkruarit dhe mënyrën se si ai bashkëpunon me alter-egon e tij, që është komunikimi oral.

### **Shfaqja e kulturës së të shkruarit**

McMurdo<sup>4</sup> sjell në vëmendjen tonë një historik të përmbledhur retrospektiv mbi karakteristikat e komunikimit oral dhe të shkruar, dhe del në përfundimin se këto dy disiplina të komunikimit nuk duhen parë si një trup i vetëm i cili përparon në mënyrë kronologjike, pasi ndryshimet mes tyre janë të mëdha dhe këtë mund ta shikojmë edhe sot, kur pjesa më e madhe e botës moderne është orientuar në komunikimin e printuar, ka ende shoqëri të cilat vazhdojnë e ruajnë traditën e kulturës orale. Në kulturat e vjetra kur shkrimi ishte ende një luks i cili nuk mund të përballohej nga të gjitha shtresat e shoqërisë, nuk kishte asnjë mundësi për të hamendësuar apo studiuar orientimet kulturore, kështu që mitet, legjendat apo edhe çfarëdo historie tjetër e ngjashme me këto, merrej si shembulli më i pastër i kulturës së asaj shoqërie. Në këtë lloj shoqërie, e gjithë dija dhe kultura e një kombi ruhej në një folder të quajtur memoria kombëtare e qytetarëve. Ishin vetë njerëzit ata të cilët kanë zëvendësuar për shekuj me rradhë rolin e shkrimit. Por, zhvillimi që përjetonte kultura rritej gjithnjë e më shumë edhe tani njerëzve u duhej një vënd i sigurtë ku të mund të ruanin gjithë këtë informacion, dhe ky vënd cilëson pikërisht zanafillën e shpikjes së shkrimit.

Megjithatë, edhe pse më shumë se sa një mënyrë, procesi i të shkruarit mbetet një nga mjetet më të arrira për të komunikuar<sup>5</sup>. Por, që të jemi në gjëndje të kuptojmë e të ekzaminojmë më mirë zhvillimin dhe kompleksitetin e të shkruarit si një teknologji komunikimi, duhet ti kthehemi edhe një herë historikut të shkrimit dhe të shohim se si mjete të ndryshme ndikojnë në procesin e të shkruarit.

### **Teoritë e të shkruarit**

Teoritë mbizotëruese të të shkruarit në dy dekadat e fundit kanë krijuar interpretime të ndryshme dhe vlerësimet drejt vetë procesit të të shkruarit dhe teknologjisë kompjuterike. Perspektivat më të mëdha teorike në lidhje me shkrim janë përqendruar në teoritë njohëse dhe teoritë socio-kulturore. Proceset e mëparshme të hartimit të tilla si planifikimi, theksojnë idenë e përshtatjes duke aplikuar përpunimit kompjuterike të gatshme, duke përfshirë fjalë-përpunuesit dhe drejtshkrimin. Në të kundërt, proceset e fundit theksojnë kontekstet dhe qëllimet e të shkruarit, të cilat janë aplikuar kryesisht për të interpretuar përdorimin e kapaciteteve njerëzore të rrjeteve, të tilla si chati dhe e-mail<sup>6</sup>.

### **Të shkruarit si proces njohës**

Njohësit e hulumtimeve shkencore kanë arritur të sigurojnë bazën për dy qasje ku përshkruhet procesi i kompozimit “teoria e strategjive njohëse” dhe “teoria e procesit të të shkruarit”<sup>7</sup>. Të dy qasjet janë identifikuar si një grup i vetëm i procesit të hartimit

---

<sup>4</sup> McMurdo 1995 Changing Context of Communication – Journal of Info Society

<sup>5</sup> Ong, W.J. 1982. Orality and Literacy: The Technologizing of the Word. New York: Methuen.

<sup>6</sup> Daiute 1985:2-5 Writing and Computers

<sup>7</sup> Jones, 1995 Understanding Community in the Information Age “Cybersociety”



universal dhe theksojnë zbulimin në fazat e parashkrimit dhe reflektimin në fazat e parashkrimit. Sipas Daiute<sup>8</sup> dallimet e mëdha mes këtyre dy teorive janë në karakterizimin e shkrimit kryesisht në zgjidhjen e problemeve.

Në të njëjtën kohë, këto dy teori kanë çuar në aplikime të ndryshme të kompjuterëve, si mjete të të shkruarit. Shkrim konceptual është parë edhe si zgjidhja e problemit, i cila ka çuar në zhvillimin e programeve të ndryshme të shkrimit interaktiv. Programet kompjuterike mund të sjellë ndikime të forta tek shkrimtarët duke i bërë të mundur të mendojnë për qëllimet e tyre dhe metodat për arritjen e qëllimeve. Ata gjithashtu mund të ndihmojnë shkrimtarët të bëhen më strategjike në lidhje me procesin e të shkruarit<sup>9</sup>. Në të kundërt, teoria dhe praktika kanë theksuar aspektet krijuese të të shkruarit të cilat kanë qenë të prirur për të minimizuar rolin e teknologjisë, përveçse si një mjet botues.

### **Të shkruarit si një kontekst socio-kulturor**

Të gjitha llojet e bashkëveprimit që lindin mes shkrimit dhe mjeteve të ndryshme që ndihmojnë në procesin e të shkruarit, lidhen ngushtë me kontekstin në të cilin ndodhet një fjalë. Prandaj edhe përdorimi i kompjuterit në procesin e të shkruarit nuk duhet të analizohet kurrë jashtë kontekstit shoqëror në të cilin ndodhet. Në këtë kapitull kontekst do të jetë termi që do të përkufizojë edhe ambjentet nëpër të cilat kryhet ky proces, ku mund të përmendim, klasat e shkollave, zyrat apo edhe programet e ndryshme kompjuterike, pasi ky term përfshin vëndin dhe format në të cilin ndodh shkrimi. (Freire & Ceido, 1987).

Në fakt të shkruarit është në vetvete një fenomen socio-kulturor i cili reflekton vlerat e komunitetit në të cilët studiohet. Sipas Murray (2000), të shkruarit nuk është një set aftësish të cilat në mënyrë automatike me t' i përdorur do të mundësojnë prodhimin e një produkti cilësor dhe të suksesshëm. Pra, me fjalë të tjera të shkruarit nuk ka të bëjë me vlera të shkëputura nga konteksti kulturor, dhe as me aftësi neutrale, por me një set praktikash socio-kulturore. (Reder, 1994).

Vygotsky (1978) pohon se në fakt të gjitha llojet e të mësuarit janë trashëgimi e kulturës. Teoria e tij thekson faktin se procesi i të shkruarit është dhe do të mbetet një nga mjetet më të mira me të cilat mund të ruajmë dhe kultivojmë kulturën e një kombi dhe mbi të gjitha funksionet e gjuhës. Pra shkrimi në vetvete është shumë më shumë sesa riprodhim i lexueshëm i shkronjave.

Procesi i të shkruarit është një praktikë sociale e cila lidhet ngushtë me aktivitetin e të gjithë praktikave sociale më të zhvilluara dhe që përkufizohet në mënyra të ndryshme nga shoqëri të ndryshme. Gjithashtu, shkrimi lidhet ngushtë edhe me përdoruesit e tij, sepse funksioni i shkrimit varet nga shoqëria dhe kultura në të cilën bën pjesë. Veç kësaj, të shkruarit mund të përkufizohet edhe si një proces gjuhësor i cili nuk varet vetëm nga njohuritë gjuhësore si ato që i përkasin fushës së gramatikës apo fjalorit, por edhe tërësisë së dijeve dhe kulturës dhe gjuhës së asaj shoqërie ku bën pjesë.

Sipas teorive socio-kulturore të të shkruarit, të mësosh të shkruash do të thotë të socializohesh me një sërë vlerash, praktikash, sistemesh e simbolesh dhe aktivitetet që përfshihen në krijimin e teksteve janë grupime specifike-kulturore dhe jo praktika

---

<sup>8</sup> Jones, 1995 Understanding Community in the Information Age "Cybersociety"

<sup>9</sup> Cochran-Smith 1991:107-155 Word Processing and Writing in Elementary classroom

universale<sup>10</sup>. Me fokusin e tyre në kontekst dhe tekst teoritë socio-kulturore të komunikimit theksojnë në këtë mënyrë lidhjen e ngushtë mes shkrimit, leximit dhe aktiviteteve bazuar në praktikën e të shkruarit. Edhe pse disa studiues përqëndrohen kryesisht në praktikën e leximit teoria socio-kulturore ka krijuar nocionin e saj të ‘zhanrit’ si forma e tekstit që mban normat kulturore<sup>11</sup>. Kontekste të tilla gjithashtu ngrenë çështje të ndërpersonale dhe ndërgrupore rreth teksteve të veçanta. Vetëm kështu, shpjegimet socio- kulturore mund të zbatohen më lehtë nëse përfshijmë edhe paisjet teknologjike në të shkruar.

### **Referencat**

- Baron, N.S. 2001. Alphabet to Email: How Written English Evolved and Where it's Heading. London: Routledge.
- Robinson, A. 1995. The Story of Writing. London: Thames & Hudson.
- Jones, S.G. 1995. Understanding Community in the Information Age. In Jones, S.G (Ed.), Cybersociety. London: Sage.
- McMurdo, G. 1995. Changing Contexts of Communication. Journal of Information Science, 21(2), 140-146.
- Ong, W.J. 1982. Orality and Literacy: The Technologizing of the Word. New York: Methuen.
- Daiute, C. 1985. Writing and Computers. Reading: Addison-Wesley.
- Cochran-Smith, M. 1991. Word Processing and Writing in Elementary Classrooms: A Critical Review of Related Literature. Review of Educational Research

---

<sup>10</sup> Jones, 1995 Understanding Community in the Information Age “Cybersociety”

<sup>11</sup> Jones, 1995 Understanding Community in the Information Age “Cybersociety”

# TEKSTI DHE ANALIZA E TIJ NË FUNKSION TË PËRKTHIMIT PA RISK

**Jonida Petro**

Departamenti i Gjuhës Angleze, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i  
Tiranës

## **Përmbledhje**

Modeli i mëposhtëm është një model i bazuar në një rast studimor për mënyrën sesi përkthyesit marrin vendime kur përkthejnë. Ideja qendrore është që përkthyesit i ndajnë përpjekjet e tyre sipas risqeve që përfshihen në dhënien e elementëve të ndryshme tekstore. Modeli mund t'i afrohet kështu fushës së analizës së riskut, veçanërisht në lidhje me ekonominë neoklasike dhe psikologjitë e ndryshme të saj. Sidoqoftë në këtë prezantim, çështja kryesore do të ketë të bëjë me mënyrën që analiza e riskut mund të lidhet me analizën e tekstit. Sugjerimi kryesor është që analiza e tekstit është një bazë e papërshtatshme për analizën e riskut. Si rrjedhojë nga perspektiva e këtij modeli, linguistika e tekstit është një bazë e papërshtatshme për analizën e vendimeve të përkthimit. Prezantimi në fjalë do të mbyllet me disa kritika të mundshme të këtij konkluzioni negativ.

## **Abstract**

The following model is based in a case study about the way translators make decisions when translating. The main idea is that translators deliver their efforts according to the risks that are included in elements of different texts. The model can approach the risk analyses, especially in relation to neoclassical economy and its psychologies. In this presentation the main issue deals with the way the risk analyses can be linked with text analyses. As a result, from the perspective of this model, the linguistic text is an appropriate base for the analyses of translation decisions. At the end of the presentation there are some possible critics of this negative conclusion.

## **Natyra e riskut në përkthim**

Le të imagjinojmë se po përkthejmë një certifikatë lindjeje. Certifikata është një dokument relativisht i thjeshtë, me pak pjesë funksionale të rëndësishme. Le ta zëmë që është emëri i personit të lindur, data e lindjes, emrat e prindërve, emri i mamisë dhe emrin i nëpunësit raportues. Nëse do të bëhej një gabim në transkriptimin ose përkthimin e këtyre elementëve, ku mund të bëhej? Nga ana gjuhësore të gjithë këto elemente kanë të njëjtin status; ato janë fraza emërore, thjesht numra dhe emra. Megjithatë nga ana funksionale, një gabim në emrin e personit ose datën e lindjes do të ishte katastrofik. Nga ana tjetër një gabim në emrin e mamisë ose nëpunësit raportues, nuk do të bënte tekstin jofunksional apo të pasuksesshëm në gjuhën marrëse. Megjithëse të gjitha elementet mund të duken të njëjtë si pjesë të ligjëratës, ata në asnjë mënyrë nuk janë të njëjtë për nga funksioni. Ky ndryshim është ajo çka duam të përshkruajmë si risk: disa elemente janë me risk të lartë (në këtë rast emri i personit të lindur dhe data e lindjes), të tjerë janë me risk të ulët (emri i mamisë dhe nëpunësi raportues) dhe pjesa më e madhe e botës reale qëndron në faza të ndryshme ndërmjet këtyre elementeve.

Shembulli ynë nuk është plotësisht i pabazuar. Mayoral (2003) përshkruan certifikatat e lindjes së Pakistanit në të cilat emri i mamisë me sa duket është shpesh i njëjtë ("Dai Bibi"), siç është i njëjtë emri i nëpunësit raportues në spital ("Chaëkidar").

Në dukje e njëjta grua ka sjellë në jetë shumë pakistanezë dhe i njëjti nëpunës ka raportuar të gjithë lindjet e tyre. Një akt me të vërtetë heroik! Sigurisht siç rezulton elementi i parë tekstual nuk është një emër i përveçëm, por emri i përgjithshëm në gjuhën urdu për “mami” ose “grua të martuar”. Elementi i dytë ka kuptim afërsisht si “ndihmës”, të paktën kështu shpjegohet. Nëpunësit që i lëshojnë në Pakistan nuk janë munduar të shkruajnë emra të përveçëm për këto elemente. Përkthyesit (në këtë rast në të gjithë botën) nuk do të mundoheshin të shpjegonin se emrat e paraqitur nuk janë fare emra dhe autoritetet që do të punojnë me këto certifikata pranojnë funksionin e tyre pa u përqëndruar tek hollësitë për shkak të punës. Ose për ta thënë më mirë, autoritetet lëshuese dhe marrëse së bashku me ndërmjetësit e tyre të ndryshëm, pranojnë funksionin operativ, sepse nuk vë në rrezik asgjë. Nuk ka arsye për t’u shqetësuar nga fakti që një “mami gjuhësore” dhe një “nëpunës gjuhësor” kanë marrë pjesë zyrtarisht në mijëra lindje. Po do të ishte shumë shqetësuese, shpresojmë, nëse disa mijëra pakistanezë do të hynin në një shtet të caktuar me të njëjtin emër dhe me të njëjtën datë lindjeje.

Tani mund t’i themi kujtdo që dëshiron të mësojë të përkthejë ose dikujt që dëshiron të bëjë pyetje sesi përkthejnë njerëzit:

- Mësimi një: Disa elemente janë me risk të lartë, disa me risk të ulët, shumica janë në zonën ndërmjet dhe natyra e riskut nuk është domosdoshmërisht e tregueshme nga ana gjuhësore.
- Mësimi dy: Me qëllim që të përcaktohen këto risqe përkatëse, duhet të analizohet funksioni i përkthimit.
- Mësimi tre: gjatë procesit të përkthimit duhet punuar shumë me elementet me risk të lartë dhe mos punoni më pak me elementet me risk të ulët.

Kjo është më e lehtë për t’u thënë sesa për t’u bërë. Sigurisht kushdo që thekson rëndësinë e kontekstit i jep shumë rëndësi edhe përparësisë së funksionit ndaj formës si dhe rolit të qëllimit të përkthimit (Skopos, për disa). Mësimet e mësipërme zbatohen nga të gjithë profesionistët me hamendje ose jo (ky është një supozim që duhet testuar në mënyrë empirike). Po të duhej vetëm kaq nuk do të kishte vend për risi. Megjithatë me sa dihet asnjë nga këto përjasje alternative për përkthimin nuk kanë munduar të analizojnë rolin specifik të riskut në të. Teoritë përkthimore nuk parashikojnë që risku mund të parandalohet me anë të një analize paraprake. Konkretisht kjo është një përpjekje për të identifikuar nëse ky drejtim është i vlefshëm për procesin e përkthimit.

### **Cfarë është risku?**

Le të quhet që risku është një mundësi për mospërmbylljen e qëllimit të përkthimit. Emri i mamisë është një element me risk të ulët, sepse qëllimi i certifikatës së lindjes së përkthyer nuk preket nga identiteti ose jo identiteti i saj. Data e lindjes është risk i lartë, sepse ajo e dallon të sapolindurin ndërmjet njerëzve me të njëjtin emër, përdoret për ta regjistruar në dosje dhe për të nxjerrë informacione që do të përdoren për krahasime me datën e dokumentave të tjerë. Data është fiksuar në mekanizmat e shtetit të cilat identifikojnë dhe kontrollojnë emigrantët dhe shtetasit. Në këtë rast këto mekanizma janë të vetmet që i japin përkthimit një qëllim.

Kur ndjekim këtë lloj arsyetimi, duket se peshku që rrëshqet nuk është vetë risku, por qëllimi që i jep riskut vlerë. Cili është qëllimi i një përkthimi? Në shembullin e

mësipërm qëllimi është mjaft i qartë. Në shumë raste nga bota reale është shumë e vështirë të kuptohet. Funksionet e fshehta zakonisht qëndrojnë nën sipërfaqe.

Këtu lind nevoja për një shembull tjetër, këtë herë nga ora e përkthimit në universitetin e Tiranës, fakultetin e gjuhëve të huaja:

Studentët e huaj kanë nevojë të *convalidate* ose të *bëjnë equivalente* diplomën e tyre të parë.

Detyra ishte të përkthehej fjalia nga anglishtja në shqip sepse ajo do të përfshihej në faqen e internetit të universitetit tonë. Të gjithë e bënë shumë mirë përveç dy termave që kishin lënë në anglisht. Si mund të thuheshin këto fjalë në shqip? Fjalorët japin pesë ose gjashtë terma të mundshëm, por studentët mendohet që janë më të zgjuar, për të arritur rezultate më të mira ata harxhojnë disa sekonda në Google, përcaktojnë disa tekste paralele (në këtë rast faqe interneti përkatëse të disa universiteteve në gjuhën shqipe) dhe dalin me një fjalë të barazvlefshme mjaft bindëse: njëjtësim ose barazvlerësim. Kështu fraza e mësipërme mund të përkthehet.

Studentët e huaj do të kenë nevojë të njëjtësojnë diplomën e tyre të parë.

Fundi i këtij episodi? Ende mund të mbeten disa dyshime. Nëse ka dy terma në anglisht a mund të mbarojmë punë me një në shqip? Ndoshta duhet t'i lëmë termat anglisht pranë të barazvlefshmëve në anglisht? Në këtë rast a jemi të sigurt që dy kulturat mendojnë në të njëjtën mënyrë? Barazvlerësimi zakonisht bëhet për një kurs ose institucion, ndërsa termat anglisht i referohen mënyrave që i japin vlefshmëri diplomës së një studenti.

Këto dyshime janë me vend. Mund të provojmë t'i trajtojmë në mënyra të ndryshme. Për shembull mund të themi që “njëjtësoj” mbase nuk është e përkryer, por të paktën ka disa funksione të ngjashme dhe do ta drejtojë sigurisht lexuesin në shtegun e duhur. Kjo mund të jetë një mundësi e mirë me risk të ulët, aq më shumë kur nevojiten vetëm disa sekonda në Google që të gjendet. Po ashtu nëse shqetësohemi për përqasjet e ndryshme kulturore ndaj çështjes, mund të vendosim t'i lëmë termat anglisht siç janë. Kjo do të ishte një mundësi tjetër me përpjekje të ulët dhe me risk të ulët, duke qenë se nuk po themi ndonjë fjalë të papërdorshme dhe lexuesit janë të lirë të hulumtojnë vetë dhe të zbulojnë kuptimet e fshehta të termave. Çfarë mund të bënim tjetër pa punuar shumë? Heqja është një strategji mjaft e zakonshme, veçanërisht në situata me risk të ulët. Megjithatë mund të japë një përkthim me risk të lartë, veçanërisht nëse ekziston dyshimi se do të vërshonin turma studentësh të huaj pa shkresurinat e nevojshme dhe me përshtypjen e gabuar që rregullat administrative janë të lehta.

Kështu kemi identifikuar tre zgjidhje të mundshme me përpjekje të ulët. Dy prej tyre janë me risk të ulët, njëra me risk të lartë. Logjikisht ose do të ndjekim një nga mundësitë me risk të ulët (ose më mirë, t'i kombinojmë), ose do të vendosim të bëjmë më shumë përpjekje për këtë çështje. Nëse zgjedhim rrugën e fundit, duhet të kërkojmë më shumë informacion për të përmbushur qëllimin e përkthimit. Dhe duhet të dimë për sa risk bëhet fjalë, për të justifikuar përpjekjet e shtuara për kërkimin.

Kaq për modelin

### **Përmirësimi i termave**

Disa shënime kalimthi për termat që po përdorim:

*Probleme përkthimi:* Një element gjuhësor bëhet problem përkthimi kur përkthyesi duhet të vendosë ndërmjet më shumë se një mënyre në përkthimin e tij. Kjo

është diçka e argumentuar para shumë vitesh (Pym 1992) kur bëhej dallimi ndërmjet gabimeve të dyfishta (vetëm dy mundësi: një e saktë, një e gabuar) dhe gabimeve jo të dyfishta (shumë mundësi, disa prej të cilave janë “të sakta, por...” ose “të gabuara, por...”). Atëherë argumentohet që përkthyesit duhet të bëjnë përpjekje për problemet jo të dyfishta dhe trajnimi i përkthyesit në parim duhet t’ia lërë problemet e dyfishta orës së gjuhës. Tani mund të rishikohet ky dallim (që sidoqoftë nuk bëri asgjë më shumë veçse ruajti të gjithë aspektet stilistike dhe pragmatike interesante për orën e përkthimit). Në të vërtetë nuk është kështu sepse një problem i dyfishtë mund të jetë me risk të lartë (p.sh. doza në një etiketë mjekësore) dhe një problem jo i dyfishtë mund të jetë me risk të ulët (përdorimi i përemrit formal dhe jo formal të vetës së dytë njëjës dhe shumës është gjithmonë shumë i ngatërruar, por mund të evitohet me shumë sukses). Në këtë mënyrë çështja e riskut shkon përtej dallimit tonë të ri ndërmjet i dyfishtë dhe jo i dyfishtë. Problemet e përkthimit mund të përshkruhen në vetvete si risk i lartë, risk i ulët ose prapëseprapë diçka ndërmjet tyre.

*Zgjidhje të përkthimit:* Në modelin e lartpërmendur, përkthyesit punojnë për problemet derisa të krijojnë produktin, çka është ajo që vendosin në përkthim. Çfarëdo që vendosin në përkthim mund të shihet si një “zgjidhje”, të paktën në kuptimin që është zgjidhja që propozon secili përkthyes. Disa zgjidhje janë padyshim më mirë ose më keq se të tjerat, por këtu nuk është e nevojshme që të hyjmë në këtë lloj vlerësimi subjektiv të hapur. Në fakt nuk ekziston diçka e tillë siç është zgjidhja e një problemi përkthimi (nga përkufizimi, problemet e përkthimit mund të kenë më shumë se një zgjidhje). Ajo që është me rëndësi ka të bëjë së pari me faktin që disa zgjidhje përmbajnë në vetvete më shumë risqe se të tjerat, dhe së dyti, disa kërkojnë më shumë përpjekje se të tjerat. E mira ose e keqja e një zgjidhjeje është pastaj çështje e mënyrës që risku lidhet me përpjekjen e bërë. Dhe kjo është në të vërtetë një çështje strategjish.

*Strategjitë e përkthimit:* Hapat ose procedurat e ndryshme të përdorura për të zgjidhur një problem përkthimi, mund të analizohen në lidhje me strategjitë si transkriptimi, heqja, perifrazimi, kompensimi, shpjegimet (shënimet në fund të faqes), zgjerimi(shtimi), rimodelimi dhe kështu me radhë (nuk është e nevojshme të krijohet ndonjë lloj tipologjie përfundimtare). Strategjitë e ndryshme të përkthimit mund të përdoren për të reduktuar ose ruajtur nivelet e riskut dhe si rrjedhojë strategjitë mund të përcaktohen se kanë pasoja risku të ulët ose risku të lartë për sa i përket problemit në fjalë. Sidoqoftë do të ishte gabim të mendohej se strategjitë mbartin vlera risku në vetvete. Strategjia e heqjes jep një përkthim me risk të lartë kur aplikohen në problemin tonë të *equivalentim*, por shpesh jep përkthime me risk të ulët kur aplikohet në probleme të tjera (zakonisht heqim reticencën apo informacionet e shtypshkronjës, kur përkthejmë dokumente zyrtare). Transkriptimi mund të jetë me risk të ulët në lidhje me *equivalentim* (siç do të paraqitet më poshtë), por do të ishte me risk të lartë në situata ku lexuesi ndoshta nuk ka njohuri të mira të gjuhës burimore.

*Përpjekjet e përkthimit:* Përkthyesit bëjnë përpjekje kur zgjidhin probleme. Kjo përpjekje merr shumë forma (dokumentim, konsultim, reflektim, rikrijim) dhe mund të matet në shumë mënyra të ndryshme (kohë, mundim, amortizim teknologjie, shkëmbime ndërpersonale). Ajo çka kërkohet këtu është ideja që zgjidhja e një problemi ka nevojë për përpjekje gjithëpërfshirëse (shuma e të gjithë formave të lartpërmendura) dhe përpjekja

do të ndryshojë sipas problemeve të spikatura e strategjitë e zgjedhura. Strategjitë e ndryshme mund të mos i korrespondojnë shkallëve të ndryshme të riskut, por zakonisht ato kanë si pasojë shkallë shumë të ndryshme përpjekjeje. Gjëja e rëndësishme për shkallën e përpjekjes është se në rastin ideal duhet të lidhet me shkallën e riskut që përball përkthyesin. Megjithëse zgjidhjet e përkthimit nuk duhen përcaktuar si të mira ose të këqija në vetvete, mund të parashtrohet që një zgjidhje me përpjekje të ulët ndaj një problemi me risk të lartë është më e leverdishme sesa një zgjidhje me përpjekje të lartë ndaj një problemi me risk të ulët.

Me pak fjalë, problemet janë me risk të lartë ose risk të ulët; zgjidhjet mund të jenë me risk të lartë ose risk të ulët; strategjitë janë mënyra të ndryshme të ezaurimit të përpjekjeve për të trajtuar riskun dhe në rastin ideal përpjekjet e përkthyesit duhet të lidhen me shkallën e riskut.

Kështu deri këtu u përshkruan termat dhe janë prezantuar parimet kryesore. Por ende nuk ka diçka e re në pah me kaq sa është thënë.

### **Risku dhe kushtet e dështimit**

Le t'i kthehemi përsëri problemit tonë me *equivalent*. Pas reflektimit në grup, klasa kërkoi për faqen e internetit ku do të paraqitej përkthimi. Domethënë u analizua vendndodhja e synuar më tepër se tekstet paralele në rastin e parë. Me ndikimin e një mësuesi të rreptë, u arrit në konkluzionin që funksioni i kësaj faqeje të veçantë interneti ishte shumë më kompleks sesa ta kapte syri. Nga njëra anë teksti supozohej të tërhiqte studentë të huaj, duke shpresuar se ishin studentë të mirë. Nga ana tjetër duhet t'u jepte atyre informacionin që u nevojitet për të filluar studimin në universitetin tonë. Mund të thuhet se interesi dhe informimi janë një qëllim mjaft i zakonshëm, në ekuilibër të përsosur, siç është letërsia neoklasike që supozohet se “mëson dhe argëton”. Nëse studentët e mundshëm i informojmë më shumë se ç'duhet (për shembull, duke dhënë të gjithë hollësitë e pakëndshme të burokracisë që duhet të kapërcejnë), ata do të largohen dhe intelektet e tyre do të shkojnë diku tjetër. Nëse teprohet reklama e marketingut, studentët do të vijnë në masë dhe pastaj do të rendin me vrull drejt pengesave burokratike, duke iu shfaqur pakënaqësi gjithë ndërmjetësve që nuk i informuan siç duhet. Strategjitë e përkthimit luajnë një rol kyç për vendosjen e ekuilibrit të kujdesshëm ndërmjet tërheqjes dhe informimit. Peshorja mund të anojë nga secila anë.

Atëherë cilit nga këtyre funksioneve të veçanta i duhet dhënë përparësi? Për të vendosur nuk mjafton thjesht të analizohet teksti burimor sipas termave gjuhësorë. Në fakt, në shumicën e rasteve është përpjekje e kotë që të bëhet analizë teksti e plotë. Christiane Nord (1991) përshkruan 76 pyetje para përkthimit (një për një) që studentët duhet të bëjnë gjatë analizës së tekstit burimor. Sigurisht e gjithë ajo përpjekje do të ishte e tepruar për çdo gjë përveç situatave më elementare pedagogjike? Arsyeimi bazë në këtë rast (së bashku me të gjithë traditën e teorisë *Skopos*) është që i njëjti tekst mund të përfshijë ndarje të ndryshme risku kur përdoret në situata të ndryshme. Një tekst mund të përkthehet në mënyra të ndryshme për të arritur funksione të ndryshme. Faqja e internetit duhet të përkthehet në mënyrë të atillë që të tërheqë dhe asgjë më shumë, ose të informojë dhe asgjë më shumë. Konkretisht në tekstin burimor në fjalë apo në 76 pyetjet, që mund të na thonë se cilin nga këto synime ose ekuilibër synimesh, duhet të përpiqemi të arrijmë.

Kjo pikë është jashtëzakonisht e rëndësishme për qasjen që po trajtohet. Disa herë ajo nënkupton që llojet e risqeve që ndërmerr një analizë gjuhësore nuk janë ato për të cilat përkthyesi duhet të harxhojë kohën e tij. Pjesët e një teksti që janë veçanërisht “të

vështira” ose “të papërkthyeshme”, kanë shpesh rëndësi të vogël për të vendosur suksesin e përkthimit. Përkthyesit zhvillojnë një gamë strategjish shmangëse që thjesht t’i mënjanojnë ato pjesë. Për shembull gjuhëtari antropolog Michael Agar (1994) flet për “pikat e pasura” ku kulturat shpalosin ndryshimet e tyre dhe për to duhet të bëhen përpjekje të mëdha për t’i komunikuar. Për t’iu kthyer shembullit të mëparshëm, ndarjet e ndryshme kulturore ndërmjet përemrave “ti” dhe “ju” (jo formalë dhe formalë) për vetën e dytë kërkojnë mprehtësi dhe eksperiencë në situatat ndërkulturore. Ato janë pika të pasura, në kuptimin që janë të vështira të kodifikohen në lidhje me rregullat e komunikimit paçka se mbartin informacion kulturor. Të kuptosh gabim përemrin mund të sjellë konotacione të paqëllimshme dhe natyrisht ky do të ishte një gabim me risk të lartë. Pritet që përkthyesit me përvojë të jenë jashtëzakonisht të aftë për të gjykuar për përemrin e duhur në situatën e duhur. Ata duhet të jenë përpjekur shumë për të perfeksionuar aftësitë shqyrtuese. Sidoqoftë, në raste dyshimi profesionistët shmangin krejtësisht përemrin e vetës së dytë, duke iu drejtuar emëzimit, foljeve vetvetore ose heqjes. Pikat që janë më të pasura nga perspektiva e krahasimit gjuhësor, ka të ngjarë të mos kenë pasoja të veçanta për funksionin e përkthimit dhe problemet e tyre të vogla mund të zgjidhen me mjaft efikasitet. Domethënë një pikë e pasur gjuhësore nuk është domosdoshmërisht një problem me risk të lartë. Pra, duhet kërkuar informacion përtej tekstit dhe sigurisht përtej gjuhësisë krahasuese.

Çfarë duhet të bëjë dikush me këtë informacion. Nëse ka shumë informacion ose në rastin që informacioni është shumë kontradiktor, do të shterohen përpjekje pa e ditur nëse ia vlen. Megjithatë të menduarit në mënyrë negative mund të ketë efikasitet lidhur me përpjekjen për të përcaktuar jo funksionin ideal të përkthimit, por “kushtet e mundshme të dështimit”, mënyrat në të cilat përkthimi nuk do ta kryente dukshëm punën e tij (këtu e huazojmë nga “etika negative” e Popperit, veçanërisht siç aplikohet në përkthim tek Chesterman 1997). Dështimi mund të përfshijë që autoritetet marrëse të mos pranojnë përkthimin tonë të certifikatës së lindjes. Ka të ngjarë që studentët e huaj të dekurajohen nga çfarë do të lexojnë në faqen e internetit. Kur këto skenare të rastit më të keq të jenë të qarta, suksesi është i thjeshtë pasi shmanget dështimi. Askush nuk krijon dot përkthimin ideal (do të ishte pothuajse e pamundur të arrihej kjo). Ajo që synohet është një përkthim që eviton dështimin. Kjo është çështja kryesore.

Në rastin e faqes sonë të internetit, lidhur me termin *equivalent*, doli në pah se çështja e suksesit ose dështimit varej shumë edhe nga vendndodhja e tekstit. Përkthimi ishte për t’u vendosur në dy vende. Njëri ishte në pjesën sipërfaqësore, atje ku studentët e ardhshëm do të hynin në sit. Në atë pozicion teksti duhet të përkthehej në mënyrë të tillë që më shumë të tërhiqte sesa të informonte: “...kërkon barazvlerësim...” mund të ishte mjaft mirë. Sidoqoftë pozicioni tjetër ishte në brendësi, shumë poshtë ku vetëm studentët e interesuar seriozisht do të klikonin. Në atë pozicion përkthimi duhet të jepte në mënyrë ideale të gjithë informacionet që do t’u nevojiteshin studentëve. Në fakt më vonë versioni i përkthyer i kësaj pjese u vendos të bëhej një faqe e re interneti, që do të paraqesë kushtet (për studentët që kanë interes të vijnë në Shqipëri), përmbledhtazi e lidhjen me faqen e internetit të ministrisë ku do të shpjegohen hollësitë dhe procedurat. Në këtë rast dy strategjitë e përkthimit janë shumë të ndryshme për shkak se dy pozicionet në faqen e internetit ishin shumë të ndryshme.

Që të përcaktohen kushtet e suksesit ose dështimit, kur përkthehet duhet mbledhur më shumë informacion sesa ç’ka në tekst. Rrjedhimisht përkthyesit në të vërtetë



nuk punojnë në tekste; ata punojnë në projekte(drafte), që kuptohen si tekste plus, informacione kontekstuale gjithëpërfshirëse të cilat parshtrihen në vijim.

### **Përshkrimi i punës si reduktues i riskut**

Teoricieni francez i përkthimit Daniel Gouadec (2002) ka përpunuar gjatë një vizion në të cilin problemet e përkthimit zgjidhen duke marrë sa më shumë informacion para se të përkthesh çdo gjë. Gouadec krijon modele shumë të plota për “përshkrimet e punës” për të cilat përkthyesit dhe klientët duhet të bien dakord dhe për analizën para përkthimit ku problemet teknike dhe veçanërisht terminologjike zgjidhen në mënyrë të specializuar. Mesazhi i përgjithshëm i Gouadec është që duhen bërë përpjekje në fazat e ndryshme para përkthimit pasi kjo është mënyra më efikase e menaxhimit të riskut krahasuar me rastin kur dikush përkthen ndryshe dhe përpiqet të zgjidhë problemet kur i dalin. Ky është një mësim që mund të nxirret nga shumica e modeleve të biznesit; është thelbi i “ndërkombëtarizimit” pjesë e teorisë së lokalizimit (cf. Pym 2004). Baza e tij është thjesht që risqet reduktohen nga parashikimi. Planifikimi është parandaluesi më i mirë i dështimeve.

Çfarë mund të ketë një përshkrim pune? Lista e mëposhtme përmbledh të gjitha gjërat që do të duheshin para se të niste të përkthehet një tekst. Kjo listë bazohet në Gouadec:

#### **MATERIALI**

Teksti burimor  
Figura, shtojca të TB etj.  
Glosarë të specializuar  
Tekste paralele  
Përkthime të mëparshme  
Kontakte me ekspertë ose konsulentë.

#### **INFORMACIONE TË FUNKSIONIT**

Funksioni i tekstit (cili do të jetë efekti i përkthimit?)  
Profili i lexuesve (për kë është ai?)  
Cilësia e kërkuar (për informacion?, për publikim?, version i ripunuar?, terminologji?)  
Kush e ripunon?

#### **INFORMACIONE PËR DETYRËN**

Afati (për dorëzim të përkthimit të papunuar?, të përkthimit të ripunuar?)  
Formati i përkthimit (cilat mjete (përkthim i ndihmuar nga kompjuteri)?)  
Baza e kostos (me fjalë, karaktere, faqe, orë, ditë?)  
Kostoja e llogaritur (propozuar nga përkthyesi, rënë dakord nga klienti)  
Kushtet e pagesës (kur do të bëhet pagesa?)  
Kontrata e nënshkruar.

#### **MARRËVESHJE PËR MUNDËSITË E PËRKTHYESIT**

Format e drejtimit  
Drejtshkrimi  
Përshtatja kulturore  
Heqje dhe shtesa të mundshme

Kjo listë nuk ka status të përcaktuar. Janë të mundshme variacione të shumta; mund të shtohet shumë (për shembull 76 pyetjet e Nord) dhe mund të hiqet akoma më shumë. Opinioni i përgjithshëm që jepet përgjithësisht këtu (nga Gouadec dhe të tjerë) është që sa më shumë informacion i tillë është i disponueshëm për përkthyesin në fazën para përkthimit, aq më shumë mund të reduktohen risqet. Megjithatë kjo listë duhet vetëm për rastet kur paraqiten probleme me risk të lartë; kaq shumë informacion shtesë nuk është i nevojshëm për problemet me risk të ulët. Me pak fjalë përkthyesit duhet të sigurohen që të marrin mjaftueshëm informacion për mundësitë me risk të lartë në mënyrë që të eliminojnë sa më shumë supozime negative të jetë mundur.

Lista si ajo më sipër dhe qasja e Gouadec në përgjithësi, sugjerojnë që informacioni nuk është asnjëherë i tepërt. Nëse ka gabime në përkthim, kjo ndodh sepse përkthyesi nuk ishte i informuar siç duhej. Kjo është një situatë shumë e vështirë që i përngjan traditës së plotësimit të formularëve që jo rastësisht është tipike franceze. Sipas këtij këndvështrimi, nëse të gjithë formularët janë plotësuar saktë, ose nuk do të mbetet asnjë risk, ose në rast të ndonjë risku të lartë, përgjegjësia personale e përkthyesit do të jetë eliminuar me efikasitet. Ky është një lloj menaxhimi risku që mund të gjendet vetëm në rregullat e shtrënguara të Shërbimit të Përkthimit të Komisionit Evropian, ku përkthimi i një teksti së pari kërkon krijimin e një teksti tjetër (përshtkrimi i plotë i punës). I gjithë informacioni i grumbulluar do të çojë në një zgjidhje optimale të të gjitha problemeve (Levý 1967) dhe çdo përgjegjësi e mbetur do të jetë thjesht kolektive. Informacioni i tepëruar mbi kontekstin duhet të lerë akoma hapësirë për eksperiencën, pragmatizmin, mospërkthimin e justifikuar, kreativitetin dhe frymëzimin, të cilat që të gjitha mund të reduktojnë përpjekjen. Për më tepër ka shumë raste të problemeve me risk të ulët ku janë të mundshme zgjidhje të shumta mjaft të ndryshme me risk të ulët dhe përkthyesi ka krejtësisht të drejtë të përdorë supozimet (ose ndonjë strategji tjetër me përpjekje të ulët) për të zgjedhur ndërmjet këtyre zgjidhjeve. Në fakt, përkthyesi duhet të bëjë përpjekje të vogla në raste të tilla, duke qenë se kostoja e gjetjes dhe vlerësimit të informacionit do të tejkalonte vlerën e rezultateve të dala.

Sa informacion nevojitet? Fillimisht duhet aq informacion sa për të përcaktuar kushtet e mosdështimit të përkthimit. Në këtë pikë elementet me risk të lartë mund të veçohen dhe mund të kërkohet më tepër informacion për ta. Këta elementë mund të çojnë në rishikim të qëllimit ose në gjëra të tjera që fillimisht e fshihnin riskun e tyre, ose në vendim për të mos kërkuar informacion të mëtejshëm duke qenë se risqet e dukshme janë menaxhuar. Në këtë proces pyetjet dhe përgjigjet, listat si ajo e mësipërme mund ta shpërfaqin dobishmërinë e tyre vetëm pas disa rrjeshtash përkthimi. Ose mund të kërkojnë shtrirje të madhe. Gabimi kryesor do të ishte të besohej se këto instrumente janë gjithmonë të nevojshme ose plotësisht të suksesshme në përcaktimin e riskut.

### **Kritika ndaj kësaj qasjeje**

Lidhur me analizën e riskut dhe se si ajo mund të luajë rol në vendimmarrjen e përkthimit, janë parë disa mënyra. Këto mënyra sigurisht nuk zgjidhin të gjithë problemet me të cilat përballen përkthyesit, por i përkasin shumë aspekteve të botës reale. Për më tepër ato veprojnë në këtë mënyrë ndërkohë shmangin kurthe idealiste si përcjellja e plotë e kuptimit apo korrektesa absolute.

Sidoqoftë kësaj qasjeje mund t'i bëhen disa kritika të mira. Komentet negative që janë marrë gjatë rrugës të paktën shërbejnë për të treguar që po prezantohet diçka më

shumë se një mendim i thjeshtë praktik. Në vijim prezantohen disa nga kritikrat dhe përgjigjet e mundshme ndaj tyre:

*Kritikë 1:* Të gjithë njësitë tekstore janë me risk të lartë, duke qenë se çdo gabim mund të nënkuptojë që përkthyesi humb besimin e klientit dhe besimi është gjithçka në lojën e përkthimit.

Eksperienca e përgjithshme sugjeron që përkthyesit të jenë të hapur ndaj mosbesimit derisa të provohet se meritojnë besimin dhe mosbesimi mund të rritet pas gabimeve në dukje të parëndësishme. Një përkthim kreativ dhe i shkëlqyer për nga aspekti komunikues mund të pritët të dështojë nëse ka gabime drejtshkrimi në termat kryesore. Klientët dhe lexuesit do t'i kapin këto gabime; ata nuk do të jenë në gjendje të gjykojnë meritat e mëdha të veprës; përkthyesi do të humbë besimin; ka gjasa që akti i komunikimit të dështojë. Sidoqoftë a do të thotë kjo që e gjithë qasja në fjalë të mos zbatohet më? A është e sigurt që është treguar qartë se besimi dhe mosbesimi mund të trajtohen lehtë në kuadrin e përgjithshëm të analizës së riskut? Përkthyesit duhet të kuptojnë se natyra tejet e padukshme dhe zakonisht e keqkuptuar e punës së tyre do të thotë që detajet e vogla sipërfaqësore mund të përfshijnë risqe të larta dhe duhet bërë përpjekja përkatëse lidhur me këta të fundit. Akoma më thjeshtë, një nga qëllimet e qarta të të gjitha përkthimeve është të krijojë besim në figurën e përkthyesit. Qasja e prezantuar mund të tregojë pse arritja dhe ruajtja e besimit është kaq e rëndësishme. Pa këtë qasje përkthyesit nuk do të fitonin asnjëherë lirinë e duhur për t'i çuar përpjekjet larg problemeve me risk të ulët.

*Kritikë 2.* Shumica e klientëve nuk janë të informuar për përshkrimet e punës së përkthimit. Ata nuk japin kurrë specifikime për projektet e vogla. Supozojnë që përkthyesit duhet t'i menaxhojnë risqet vetë.

Mjaft e vërtetë, shumë pak projekte përkthimi kanë si fletët e specifikimit që paraqet Gouadec, dhe shumë punë të mëdha nuk i kanë fare. Përgjigja e parë ndaj kësaj situatë është pedagogjike: klientët duhet të mësohen të japin sa më shumë informacion të jetë e mundur dhe përkthyesit duhet të trajnohen t'i mësojnë ata. Përgjigja e dytë, është më realiste: Nëse specifikimet nuk janë dhënë, kjo mund të ndodhë sepse risqet nuk janë mjaft të larta për t'i garantuar ato. Ose më mirë: Klientët që i japin përkthyesve informacionin në lidhje me pikat me risk të lartë duhet të komunikojnë me më efikasitet sesa ata që nuk japin (nëse jo, atëherë jo). Kjo e çon diskutimin drejt hipotezave që mund të eksploroohen në raste studimesh (case studies) dhe të provohen në mënyrë empirike. Ky është rasti ku qasja e propozuar mund të jetë më shumë funksionale.

A po përshkruhet çfarë ndodh gjithmonë në të gjithë përkthimet? Po, pjesërisht, po thuhet që njëfarë analize risku duhet të jetë gjithmonë e pranishme, edhe nëse ka pak rezultat. (Një fillestar kërkon një term dhe sheh se ka tre përkthime të mundshme, dy nga të cilat nuk përshtaten me kontekstin dhe i treti është i panjohur për të; fillestari zgjedh termin e tretë, duke qenë se mund të jetë ende i saktë... Këto gjithsesi janë menaxhime risku me gjithë mënyrën e tyre katastrofike.) Apo ndoshta po përshkruhet ajo që ndodh vetëm në përkthimin e mirë? Po, pjesërisht, marrëdhëniet ndërmjet përpjekjes dhe riskut mund të tregojnë pse disa zgjidhje janë më mirë se të tjerat, kështu që ekziston një mënyrë e përshkrimit të "praktikave më të mira". Apo ndoshta po përshkruajmë vetëm

çfarë duhet të ndodhë në botën ideale kur përkthehet? Po, pjesërisht, modeli ka një potencial normativ. Sidoqoftë kjo bëhet e parashikueshme nëpërmjet testimit të vërtetë në rastet studimore (për kalimin nga përshkruese në të parashikueshme, shih Chesterman 1999). Nuk ka arsye pse një qasje nuk mund të ketë diçka për të thënë për të treja nivelet (ose në më shumë nivele).

*Kritikë 3.* Norma standarde për përkthyesit është të riprodhojë saktësisht tekstin. Kjo është ajo që pritet të bëjnë përkthyesit dhe ajo që duhet të jenë trajnuar të bëjnë. Çdo analizë risku që largohet nga analiza e tekstit ka gjasa të ulë pritshmëritë.

Këtu po perifrazojmë një kritikë të formuluar nga gjuhëtari i tekstit Basil Hatim. Nga ky këndvështrim rastet që kërkojnë analizë risku do të ishin përjashtime, thjesht zbulime që i shtohen strukturës solide të praktikës endemike të përkthimit. Për këtë sigurisht ka shumë justifikime. Nëse klientët nuk japin hollësi, ka të ngjarë ngaqë ata dhe përkthyesit e tyre mbështesin normën që çdo gjë në tekst duhet të përkthehet sa më besnikërisht dhe plotësisht të jetë e mundur. Kjo normë është efiçase (nuk ka nevojë të bëhen përpjekje të mëtejshme për hollësitë) dhe me risk të ulët për përkthyesin (praktikisht çdo zgjidhje mund të justifikohet duke shpjeguar diçka në tekstin burimor). Sidoqoftë koncepti i një norme standarde, nuk mund ta shpjegojë me të vërtetë pse përkthyes të ndryshëm kanë mundësi dhe bëjnë zgjidhje të ndryshme të justifikueshme; kjo normë nuk mund të japë ndonjë bazë të fortë për zgjedhje ndërmjet zgjidhjeve (me përjashtim të iluzionit të kuptimit të qëndrueshëm përjetësisht); sigurisht nuk mund të thuhet pse kjo normë standarde është cituar për të justifikuar strategji përkthimi jashtëzakonisht të ndryshme e me dallime të mëdha gjatë historisë dhe përmes kulturave. Norma standarde ndoshta nuk është aq e rehatshme sa ç'ishte menduar kur u krijua.

Një përgjigje e dytë: Norma standarde tradicionale, e përforduar nga besnikëria dhe ekuivalenca, sfidohet në shumë fusha të përkthimit. Nuk mund të thuhet se zbatohet në të gjithë pjesët e projekteve të lokalizimit, në adaptimin audiovizual, në interpretimin në komunitet, në përkthimin letrar postmodern. Norma është sfiduar dhe analiza e riskut mund të përshkruajë arsyet për sfidat.

*Kritikë 4.* Përkthyesit profesionistë punojnë më me efikasitet kur përkthejnë çfarë është në tekst. Devijimet nga literalizmi u kushtojnë kohë dhe para.

Këtu po perifrazojmë një kritikë të formuluar nga Roberto Mayoral, kryesisht në lidhje me përkthimin e dokumentave zyrtarë. Profesionistët duket se nuk kanë kohë t'i bëjnë vetes pyetje të sofistikuara për analizën e riskut. Ata përkthejnë çfarë është para tyre, duke qenë se kjo është mënyra që fitojnë më shumë para më shpejt. Në rregull: literalizmi i drejtë në këto raste mund të menaxhojë risqet me mjaft efikasitet. Sidoqoftë do të ishte gabim të shtrihej rregulli te të gjithë profesionistët ose te të gjitha llojet e përkthimit. Për këtë përgjigje duhet të jetë e njëjta siç është për argumentin mbi normat standarde. Nuk është e thënë që të gjithë përkthyesit të harxhojnë gjithmonë kohën për të përlllogaritur apo parashikuar risqet.

Teoria e paraqitur këtu gjithashtu mund të pranojë se është efiçase për koston, që në situata më shumë ose më pak të kodifikuara nga normat, të mos humbet kohë duke parë gjëra jashtë tekstit.

*Kritikë 5.* Klienti aktiv është një karakteristikë e tregut perëndimor. Analiza e riskut miraton një formë të imperializmit kulturor duke qenë se orvatet t'ia imponojë modelin e tij të përkthimit të kulturave të tjera.

Kjo është përsëri nga Basil Hatim. Sigurisht që është shumë miklues në supozimin e tij që Perëndimi ka bollëk klientësh aktivë të mirë-informuar. Për fat të keq, as në Perëndim as në Lindje dhe me shumë gjasa asgjëkund tjetër nuk ka një parajsë në lidhje me këtë. Joprofesionalizimi i përkthyesve mund të jetë i kudogjendur dhe disa sektorë europianë faktikisht po i nënshtrohen procesit të deprofesionalizmit (Pym 2000, 2004). Këtu duhet të sqarohet përsëri argumenti i lartpërmendur. Nuk është e thënë që analiza e riskut kërkon pjesëmarrjen aktive të klientëve. Përkundrazi, klientëve mund t'iu duket ekonomike t'i menaxhojnë risqet thjesht duke iu besuar përkthyesve të tyre. Sidoqoftë ajo që sugjeron qasja në fjalë, është që në shumë raste përkthyesit e menaxhojnë riskun më mirë kur u jepet informacion kontekstual dhe në disa raste mund të jetë në përfitim të klientëve të japin këtë informacion, pavarësisht se cilat janë traditat e përkthimit që gjenden pas kësaj praktikë endemike.

*Kritikë 6.* Menaxhimi i riskut nuk është asgjë më shumë se shmangie e vetive krijuese të të marrit përsipër të risqeve. Përkthyesit duhet të jenë të përgatitur të marrin parasysh risqet e përplasjes së kulturave.

Këtu po perifrashojmë një kritikë të zellshme të një afrikano-jugori, për fat të mirë pa emër, në një konferencë në Athinë në 2003. Përgjigja më e lehtë këtu është të deklarojsh fajësinë. Po, e gjithë qasja e këtushme bazohet në supozimin se problemet kryesore të botës së sotme vijnë nga përplasjet ndërmjet kulturave dhe që gjetja e zgjidhjeve për këto probleme rrjedhimisht kërkon bashkëpunim ndërmjet kulturave dhe ekonomia e kooperimit është kuadri më i përshtatshëm për analizën tonë të riskut. Njëfarë seksioni anglez *gaya scienza* mund të vazhdojë të preferojë përplasjet në vend të bashkëpunimit, por kjo sigurisht është çështje që u përket atyre.

Haptazi mund të pranohet se përplasjet mund të jenë kreative, që nga ato mund të rezultojnë përfitime të paparashikuara dhe që disa njerëz duhet të ndërmarrin risqe të skajshme të nevojshme për t'u arritur këto përfitime. Këta njerëz duhen mbajtur më mirë në universitete në departamentet e letërsisë dhe studimeve kulturore. Atje ata nuk bëjnë dëme nëse përlllogaritën dhe gjatë përlllogaritjes së gabuar të risqeve (i njëjti kritik që dha këtë mendim i akuzoi grekët që silleshin si Grekë pasi u shisnin turistëve ikona dhe fajësoi femrat greke se nuk ishin greke pasi të gjitha i kishin flokët të kuqe dhe bjonde ... të zhvillosh studime kulturore është tejet e thjeshtë). Përkthyesit në anën tjetër janë në terren duke mbledhur copëzat kulturore të mbetura. Nëse ata gjykojnë gabim këto pjesëza mund të shkaktojnë dëme se kanë zhvlerësuar risqet që lidhen me kulturën. Masakrat e Ballkanit nuk ishin shumë larg në kohë nga konferenca në fjalë që organizohej në Athinë. Po kështu edhe konfliktet në Afrikën e Jugut. Ata që merren me formimin e përkthyesve duhet të mendojnë më shumë lidhur me konfliktet konkrete ku risqet janë më shumë se figura metaforike.

Përkthyesit mund të japin një kontribut të veçantë në ndërmjetësimin e situatave konfliktuese, lidhur me vendosjen e një bashkëpunimi afatgjatë ndërmjet kulturave. Nëse analiza e riskut mund të na ndihmojë të arrijmë këtë qëllim, atëherë ia vlen që të jemi mirënjohës për analizën e riskut.

## Referencat

- Agar, Michael (1994) *Language shock: Understanding the culture of conversation*. New York: William Morrow.
- Chesterman, Andrew (1997) *Memes of Translation*. Amsterdam and Philadelphia: John Benjamins.
- Chesterman, Andrew (1999) "The Empirical Status of Prescriptivism". *Folia Translatologica* 6. Fq. 9-19.
- Gouadec, Daniel (2002) *Profession: traducteur. Alias Ingénieur en Communication Multilingue (et) Multimedia*. Paris: La Maison du Dictionnaire.
- Levý, Jiří (1967) "Translation as a Decision Process". In *To Honour Roman Jakobson: Essays on the Occasion of His Seventieth Birthday. 11 October 1966*. Věllimi i 2-të. The Hague: Mouton.
- Mayoral, Roberto (2003). *Translating Official Documents*. Manchester: St Jerome.
- Nord, Christiane (1991) *Text Analysis in Translation. Theory, Method, and Didactic Application of a Model for Translation-Oriented Text Analysis*.
- Pym, Anthony (1992) "Translation Error Analysis and the Interface with Language Teaching".
- Cay Dollerup & Anne Loddegaard, eds *The Teaching of Translation*. Amsterdam: John Benjamins. Fq. 279-288.
- Pym, Anthony (2004) *The Moving Text. Localization, Translation, and Distribution*. Amsterdam and Philadelphia: John Benjamins.

# DALLIME DHE TË PËRBASHKËTA MES KOHËVE NË GJUHËN GJERMANE DHE SHQIPE.

**Mihallaq Zilexhiu**

Departamenti i Gjuhës Gjermane, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës

## **Përmbledhje**

Artikulli i mëposhtëm, ashtu sikurse e thotë dhe titulli i tij, merret me vënien në dukje e dallimeve, por dhe elementeve të përbashkët në zgjedhimin e foljes në gjuhën gjermane dhe atë shqipe. Jemi përqëndruar në veçoritë e foljes gjatë zgjedhimit të saj në kohët e ndryshme të mënyrës dëftore, sepse janë pikërisht këto kohë në këtë mënyrë që përdoren kryesisht nga nxënësit në fazat e përvetësimit të gjuhës gjermane në shkollë.

Ky shkrim është pjesë e një studimi krahasues të kohës së foljeve në gjuhën gjermane dhe shqipe me qëllim zbulimin e problematikës së përvetësimit të kohës së foljes në gjuhën gjermane nga nxënësit tanë dhe përfundimet e nxjerra nga krahasimi shpresojmë të jenë një ndihmë e konsiderueshme në punën e mësuesve të gjuhës gjermane në shpjegimin e gramatikës së kësaj gjuhe, në rastin tonë të zgjedhimit të foljes në mënyrën dëftore.

**Fjalët çelës:** kohët e foljes, zgjedhimi i foljes, koha e veprimit, koha e vëzhgimit koha e të folurit, veçoritë e foljes, kohët analitike, sintetike

## **Abstract**

The following article, as the title suggests, tries to deal and bring into evidence some differences, but even common elements in verb conjugation in German and Albanian. The article has mainly been focused on verbs' peculiarities during conjugation in different tenses of indicative mode, as these tenses are the ones which are mainly used by students in different stages of German learning at school.

This article is part of a comparative study about verb tenses in German and Albanian, where we try to find out students' difficulties in mastering different tenses of German language. We hope the conclusions drawn from this comparison would be of considerable help for German language teachers in their daily activity while explaining grammar and especially the conjugation of verbs in indicative mode.

**Key words:** verb tenses, verb conjugation, action tense, tense observation, speaking time, verb peculiarities, analytical, synthetic tense

## **HYRJE**

Më poshtë do të kemi një përshkrim të kohëve të gjuhës gjermane dhe shqipe. Në këtë shkrim përfaqësohet mendimi tradicional sipas të cilit gjermanishtja zotëron gjashtë kohë: *të tashmen, Präteritum-in, të kryerën, më se të kryerën, të ardhmen dhe të ardhmen e përparme*.

Në gjuhën shqipe analizohen kohët duke shprehur mendimin se në gjuhën shqipe janë gjashtë të tilla: e tashmja, e pakryera, e kryera e thjeshtë, e kryera, më se e kryera, e kryera e tejshkuar, e ardhmja, e ardhmja e përparme, e ardhmja e së shkuarës, e ardhmja e përparme e së shkuarës. Edhe në shqipen, kohët janë të ndara në sintetike (e tashmja, e pakryera, e kryera e thjeshtë) dhe në analitike (e kryera, më se e kryera, e kryera e së shkuarës, e ardhmja, e ardhmja e përparme, e ardhmja e së shkuarës, e ardhmja e përparme e së shkuarës).

Megjithë dallimet, kohët në gjuhën gjermane dhe në gjuhën shqipe mund të krahasohen në rrafshin semantik.

Analiza linguistike e kohëve në të dy gjuhët në këtë punim bazohet në dy parime.

I pari nisët nga një analizë semantike dhe dallon për çdo kohë një kuptim kohor bazë. Këtë shpjegim jemi munduar ta bëjmë (për gjermanishten) me ndihmën e tipareve referenciale të kohës: *koha kur flasim, koha aktive dhe koha e vëzhgimit* të cilat i ka përdorur Reichenbach (1947) në analizën e tij të kohëve (*point of speech, point of the event dhe point of reference*) të cilat pastaj janë trajtuar për gjuhën gjermane nga autorë të ndryshëm në mënyrë të ngjashme në punime të tyre mbi kohën. Me këtë terminologji të përdorur kuptojmë: koha kur flasim është koha kur shprehemi, koha e vëzhgimit është koha të cilës i referohemi, dhe koha e veprimit është intervali kohor në të cilin zhvillohet veprimi për të cilin është fjala.

Parimi i dytë mbi të cilin jemi bazuar ka parasysh një mënyrë këndvështrimi kontekstual dhe i përshkruan kohët e veçanta duke pasur parasysh mënyrat e tyre të përdorimit.

Në këtë punim, kohët e gjuhës gjermane dhe të gjuhës shqipe trajtohen në mënyrë të pavarur nga përdorimi aspektor i foljeve.

Ky aspekt nuk trajtohet si një kategori foljore më vete e foljes, por si një pjesë e kuptimit të saj.

Më poshtë do të kemi një përballje të kohëve të gjuhëve gjermane dhe shqipe.

### E tashmja

Gjermanishtja dhe shqipja kanë të njëjtin kuptim bazë për sa i përket kësaj kohe dhe në mënyrat e tyre të ndryshme të përdorimit paraqesin në shumicën e rasteve të njëjtat funksione.

Në shembullin e mëposhtëm:

*Es schneit*

*Bie bore*

shohim të pasqyruar për të dyja gjuhët të njëjtat tipare lidhur me referencat kohore: koha kur flasim dhe koha e vëzhgimit janë identike dhe që të dyja gjenden brenda kufijve të kohës së veprimit.

E tashmja e të dyja gjuhëve nisur nga koha kur flasim, përveç kuptimit bazë, ka edhe kuptim të së ardhmes:

Ich **gehe** morgen abend ins Theater;      nesër në mbrëmje **shkoj** në teatër,

të së shkuarës: (e tashme historike) :

*Gestern **gehe** ich ins kino, da **treffe** ich meinen Freund*



*Dje, që thua ti- **shkoj** në kinema dhe **takoj** një mikun tim;*  
si dhe kuptim jokohor (atemporal,) të gjithëkohshëm:

Jeden Tag **stehe** ich um 7 Uhr auf: Çdo ditë **çohem** në orën 7.

### **Präteritum (e kryer e thjeshtë dhe e pakryer)**

Në kuptimin bazë të saj, Präteritum-i në gjermanisht tregon një veprim që zgjat në të kaluarën. Në shembullin

*Es schneite,*

koha e vëzhgimit (intervali i vëzhguar i veprimit) gjendet brenda intervalit të veprimit dhe që të dy ndodhin para kohës kur flasim.

Präteritum-i mund të shprehë veprim në kohën e tashme:

*wer erhielt das Bier?*

dhe si kohë tregimi i referohet edhe të ardhmes:

*ob er sie fand in diesem Gewimmel?*

Në kushte të caktuara dhe në dialekte rajonale, Präteritum në gjermanisht konkurron me Perfekt-in.

Präteritum në gjuhën shqipe shprehet nëpërmjet dy kohëve: e pakryera dhe e kryera e thjeshtë. Në gjuhën gjermane, për të shprehur kohën e pakryer të gjuhës shqipe përdoret e kryera e thjeshtë:

*“Der Kellner, der uns das Eis brachte, bemerkte offenbar nicht, daß das Titelbild der “Feinschmeckerin” leibhaftig neben mir saß”. Siegfried Lenz Ludmilla*

Një mundësi tjetër është që vazhdimësia e kryerjes së veprimit në të shkuarën të bëhet e qartë përmes kontekstit.

Duhet përmendur gjithashtu se veprime të cilat në gjermanishte shprehen përmes së kryerës, në gjuhën shqipe shprehen përmes së kryerës së thjeshtë:

*Kürzlich **habe** ich aus Neugier Prof. Grönemeyer in Berlin während eines Vortrags an der TU **beobachtet**.*

*Pak kohë më parë, kurioz, unë vura re në Berlin, gjatë një fjalimi pranë TU, prof. Grönemeyer-in.*

Der Spiegel 06.11.06

*Në krijimet popullore të gjuhës shqipe, si kohë tregimtare në dialektin tosk mbizotëruese është e kryera e thjeshtë, në veri e kryera e dëftores1.*

E kryera e thjeshtë e shqipes, dallohet më qartë se e kryera në gjuhën e shkruar. Shqipja dallon nga frëngjishtja, italishtja e ndonjë gjuhë tjetër si gjermanishtja, ku e kryera e thjeshtë përdoret vetëm në libra, kurse në ligjërimin gojor është zëvendësuar ca nga ca nga e kryera (K. Kapllani po aty f. 112).

Po të hedhim një vështrim nga jugu drejt veriut te disa gjuhë indoeuropiane vërejmë se hap pas hapi forma e thjeshtë sa vjen e mënjanohet, ia lë vendin së kryerës: në greqisht e kryera e thjeshtë përdoret më shpesh, po kështu në dialektin tosk të shqipes. Në

dialektin geg, e kryera e thjeshtë përdoret më pak se e kryera. Kjo dukuri theksohet në gjuhën italiane dhe përforcohet më tepër në gjuhën frënge dhe gjermane.

E kryera e thjeshtë ndonjëherë përdoret edhe në ato kushte ku mund të përdorej më se e kryera, kuptimi themelor i të cilës është të tregojë një veprim të përfunduar para një çasti të caktuar të së shkuarës, për shembull:

1. K. Kapllani, *S. Filologjike*, 1984 f. 99.

*Ndërsa bëhej gati për t'u nisur për në Shqipëri, e kishte vrarë mendjen disa herë që të merrte apo jo disa nga femrat e haremit, të tjerët i thanë (=kishin thënë) të kundërtën (I. Kadare, *Këshjella*, f. 8).*

Në varësi nga konteksti dhe situata e ligjërimit, e pakryera në gjuhën shqipe shprehet:

Një veprim të së shkuarës i cili kap një periudhë kohe të pacaktuar duke mos treguar caqet kohore as të fillimit e as të përfundimit të këtij veprimi.

E pakryera përdoret për të treguar veprime të së shkuarës që përsëriten në intervale të caktuara, ashtu si e tashmja, e cila tregon gjithashtu veprime që përsëriten.

Të pakryerën e përdorim edhe kur duam të tregojmë dy a më shumë veprime që kryhen në të njëjtën periudhë kohe të së shkuarës.

### E kryera

E kryera karakterizon një ndodhi si të kryer ose të mbyllur pa përcaktuar ndonjë kohë të caktuar. Duke pasur parasysh përkufizimin e mësipërm, kuptimi bazë i të kryerës në gjermanisht është se koha e veprimit gjendet në të shkuarën bashkë me kohën e vëzhgimit dhe që të dyja ndodhen para kohës kur flasim. Por nga ana tjetër, ndërsa koha e veprimit shihet si e kryer para kohës kur flasim, koha e vëzhgimit mund të arrijë edhe kohën kur flasim.

Përveç kuptimit bazë, e kryera në gjermanisht apo në shqip mund të përdoret me kuptimin e së tashmes :

ich habe endlich verstanden (wie die Sache funktioniert)

si dhe me kuptimin e së ardhmes:

*Stell dir vor was in einem Jahr aus uns geworden ist. Merre me mend si do jemi bërë pas një viti.*

Në gjuhën shqipe, koha e kryer si kohët e tjera të përbëra krijohet me ndihmën e foljes **kam**. Edhe me ndihmën e foljes **jam** formojmë të kryerën, por në rastin e foljeve të diatezës pësore. Është fjala për kohën e kryer, më se të kryer, të kryer të tejshkuar dhe të ardhme të përparme. Në gjuhën gjermane përdoren edhe folja "**kam**" edhe ajo "**jam**".

Një mundësi tjetër është që vazhdimësia e kryerjes së veprimit në të shkuarën të bëhet e qartë përmes kontekstit.

Duhet përmendur gjithashtu se veprime të cilat në gjermanishte shprehen përmes së kryerës, në gjuhën shqipe shprehen përmes së kryerës së thjeshtë:

*Kürzlich **habe** ich aus Neugier Prof. Grönemeyer in Berlin während eines Vortrags an der TU **beobachtet**.*

*Pak kohë më parë, kurioz, unë vëzhgova në Berlin, gjatë një fjalimi pranë TU, prof. Grönemeyer-in.*

Der Spiegel 06.11.06

E kryera e foljes në gjuhën shqipe është formë e përbërë, analitike. Ajo formohet nga e tashmja e foljes ndihmëse dhe pjesorja e foljes që zgjedhohet. Në diatezën veprorë si folje ndihmëse përdoret folja *kam*, në pësoren dhe vetvetoren përdoret folja *jam*.

Në kuptimin e vet themelor, e kryera përdoret për të lidhur një veprim të shkuar me kohën e tanishme.

Kur përdoret për të shprehur veprime tashmë të kryera, koha e kryer mund të jetë e shoqëruar ose e pashoqëruar nga tregues të kohës:

E kryera mund të përdoret dhe me kuptimin e kohës së ardhme, të një futur imediat, atëherë kur folësi mendon se veprimi do të realizohet me siguri menjëherë pas çastit kur flet. Në këtë përdorim hasen zakonisht terminative ose foljet që tregojnë gjendje dhe jo foljet e lëvizjes:

*Kërkomë ç 'të duash, se ta kam dhënë.*

Në të folmet popullore e kryera përdoret më dendur se në gjuhën letrare, dhe brenda dialekteve, në gegërishten më dendur se në toskërishten.

Në gjuhën letrare dhe në atë popullore e kryera përdoret dendur në dialogjet.

Lidhja me të tashmen shërben si pikënisje për të përcaktuar deri në një farë mase edhe sferën e përdorimit stilistik të së kryerës. Ajo përdoret më dendur në ato stile, të cilat nga karakteri i tyre lidhen më tepër me aktualitetin si: p.sh. në hyrje dhe parathënie të librave, në stilin e publicistikës, që ka të bëjë me vlerësime dhe karakteristika të sendeve e dukurive dhe që synon të vendosë një urë midis së shkuarës dhe së tashmes, që i drejtohet të tanishmes.

### **Më se e kryera**

Më se e kryera shpreh një veprim të kryer e të përfunduar para kohës kur flasim. Në fjalitë:

*Es hatte geschneit      kishte rënë dëborë,*

koha e veprimit gjendet para kohës së vëzhgimit dhe që të dyja gjenden para kohës kur flasim.

Në kontekste të veçanta, më se e kryera në gjermanisht mund të zëvendësohet nga e kryera apo Präteritum dhe më se e kryera në shqipen mund të zëvendësohet me të kryerën e tejshkuar .

### **E ardhmja**

Si në gjermanishten, edhe në shqipen, e ardhmja është koha e cila tregon se veprimi i shënuar nga folja do të ndodhë në një moment të caktuar të së ardhmes. Kuptimi bazë i saj në gjermanisht, por edhe në shqip, është përcaktuar si më poshtë: në fjalinë:

*Es wird schneien      Do të bjerë dëborë*

koha e vëzhgimit gjendet brenda kohës së veprimit dhe që të dyja këto kohë janë pas kohës kur flasim.

Përveç kuptimit bazë kohor, në gjermanisht dhe në shqip, e ardhmja (Futur I) shpreh në të dyja gjuhët edhe modalitete të ndryshme:

Në vetën e parë njëjës, kjo kohë mund të tregojë një dëshirë apo një qëllim:

*Ich werde dich nie verlassen - nuk do të braktis kurrë;*

në vetën e dytë tregon një urdhër:

*Du musst deine Aufgaben machen - do t'i bësh patjetër detyrat që të janë ngarkuar.*

E ardhmja mund të lidhet me kohën e tashme nëpërmjet kuptimit të saj modal (hamendje):

*deine Schlüssel werden auf dem Tisch liegen - çelsat do t'i kesh mbi tavolinë.*

### **E ardhmja e përparme**

E ardhmja e përparme, me kuptimin kohor sipas të cilit një ngjarje paraqitet si e kryer pas momentit në të cilin flasim, paraqitet rrallë. Kuptimi bazë i së ardhmes së përparme në gjuhën gjermane është njëlloj si në gjuhën shqipe. Koha e veprimit gjendet para asaj të vëzhgimit dhe që të dyja para momentit të ligjërimit.

Në gjermanisht, e ardhmja e përparme shfaqet kryesisht me kuptim modal. Ajo i referohet së ardhmes :

*der Zug wird wohl in Berlin angekommen sein - Treni do të ketë mbërritur në Berlin*

si dhe të tashmes:

*du wirst dich am Wochenende erkältet haben: - do të jesh ftohur gjatë fundjavës.*

Kohët e analizuara më sipër janë ato më të përdorshmet nga nxënësit në shkollë madje dhe disa prej tyre gjejnë, për arsye të ndryshme, përdorim të rrallë. Kjo është arsyeja për të cilën ne zgjodhëm për të krahasuar pikërisht këto folje.

Disa dallime të dukshme dhe që ndeshen shpesh mes gjermanishtes dhe shqipes në fushë të foljes:

- kohët analitike në gjuhën shqipe i formojmë vetëm me ndihmën e foljes **kam**, ndërsa në gjermanishte përdorim edhe foljen **jam**.

- Në shqip e ardhmja formohet me ndihmën e **do të** plus foljen që zgjedhohet, ndërsa në gjermanishte përdorim foljen **werden**.

- Në shqip njohim **tre tipa zgjedhimi** dhe po aq edhe në gjermanishte. Veçse në gjuhën shqipe ne kemi jashtëzakonisht shumë folje të cilat nuk rreshtohen në sistemin e tipeve të përmendura të zgjedhimit.

- **Pjesorja** e së kryerës në gjuhën shqipe formohet në mënyrë sintetike dhe gjermanishtja është shumë e veçantë në këtë drejtim, çfarë përbën një veçori jo vetëm për nxënësit shqiptarë dhe që përbën shpeshherë vështirësi në përvetësim.

- Një tjetër formë foljore për t'u përmendur është edhe **diateza**, e cila në shqipe formohet në mënyrë sintetike kurse në gjermanishte me ndihmën e foljes ndihmëse "**werden**".

### **Përfundime:**

Gjermanishtja dhe shqipja janë gjuhë indoeuropiane. Që të dyja këto gjuhë kanë një sistem kohor të rregullt.

Sistemi kohor më i përhapur dhe më i njohur i gjermanishtes bën dallime midis gjashtë kohëve gramatikore: *e tashme, e pakryer, e kryer e thjeshtë, e kryer, më se e*

*kryer, e ardhme, e ardhme e përparme.* Paraqitja e këtyre gjashtë kohëve gjendet në të gjitha gramatikat moderne të gjermanishtes. Përveç anëve të njëjta, këto gramatika shfaqin edhe ndryshime në trajtimin e kohëve të foljes.

Në përshkrimin e kohëve të foljes duhen marrë parasysh edhe aspektet e gjuhëve të huaja. Mësimi modern i gjuhës gjermane si gjuhë e huaj njih gjashtë kohët tradicionale duke i përdorur ato në mësim si kategori gramatikore që shprehin marrëdhënie kohore.

Përmes këtij shkrimi ne shpresojmë që të kemi dhënë, përmes përshkrimeve të kohëve në të dyja gjuhët si dhe përmes mendimeve lidhur me dallimet dhe gjërat e përbashkëta mes tyre, një kontribut modest në përjasjen e këtyre dy gjuhëve në këtë fushë.

Nga gjithë përshkrimet e bëra më sipër mund të vihet re se kemi shumë të përbashkëta ashtu sikurse dhe dallime midis gjuhëve shqip dhe gjermanisht. Kjo gjë na çon në përfundimin se të mësosh gjermanishten duhet të marrësh patjetër në konsideratë këtë situatë dhe të vepros në përputhje me të. Fushat e ngjashmërisë midis gjuhëve e lehtësojnë mësimin e tyre nga nxënësi ashtu sikurse dhe dallimet “frenojnë”. Këtë përfundim mund të nxjerrësh lehtë pas leximit të përfundimeve të detyrave të nxënësve të shkollave me nxënësit e të cilave ne punojmë. Këtu duhet t’i ruheni përgjithësisht, ashtu sikurse dhe përfundimeve të gabuara sipas të cilave ndryshimi mes gjuhëve vështirëson punën e përvetësimit të gjuhës së huaj që mësohet. Shumë fenomene të ndryshme të një gjuhe përvetësohen shpeshherë me më pak vështirësi sesa fenomene të ngjashme në këto gjuhë. Vendosja e nyjës, për shembull, para emrave në gjermanisht duket se nuk përbën ndonjë pengesë për nxënësit shqiptarë që nuk e njohin këtë nyje në gjuhën e tyre (megjithatë këtu, vështirësi kemi kryesisht në gjetjen e gjinisë së saktë të emrave).

## **Referencat**

Agalliu F. Rreth problemit të klasifikimit të foljeve në zgjedhime në „Çështje të fonetikës dhe të gramatikës së shqipes së sotme“. Tiranë 1972

Butzkamm, W. 1989 Psycholinguistik des Fremdsprachenunterrichts. – Natuerliche Kuenstlichkeit: Von der Muttersprache zur Fremdsprache. Tuebingen

Dahl E., (1999) Wie lernt man fremde Sprachen? Verlag Freies Geistesleben

Demiraj, Sh., Rreth kategorive gramatikore të mënyrës dhe të kohës në gjuhën shqipe SF. 1977 Nr. 3 Tiranë.

Gramatika e Gjuhës Shqipe , Vëllimi I. Tiranë 2002

Duden(1984). Grammatik der deutschen Gegenwartssprache. Mannheim, Wien, Zuerich: Dudenverlag

Kapllani, K., Mbi kuptimet dhe përdorimet e së kryerës së thjeshtë në gjuhën shqipe SF. 1984 Nr. 2

Wode H., Einfuehrung in der Psycholinguistik – Theorien, Methoden, Ergebnisse. 1988 Ismaning.

Xhuvani A., Pjesorja në shqipet në „Studime Gjuhësore“, Tiranë, 1956

# **CULTURAL CHALLENGES AND USE OF LANGUAGE AS A COMMUNICATION AND CONFLICT RESOLUTION TOOL WITHIN A GLOBAL WORKING ENVIRONMENT**

## **SFIDAT KULTURORE DHE PËRDORIMI I GJUHËS SI MJET KOMUNIKIMI DHE ZGJIDHJE KONFLIKTESH BREND A NJË MJEDISI PUNE GLOBAL**

**Miranda Ostrosi**

Departament i Gjuhës Angleze, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës

### **Përmbledhje**

Qëllimi kryesor i këtij artikulli është të japë një pasqyë të zhvillimeve kryesore dhe problemeve që hasen si rezultat i ndryshimeve globale dhe ndikimeve që ato kanë në komunikimin e natyrshëm midis njerëzve si brenda strukturave të caktuara, organizatave apo kompanive të biznesit, ashtu edhe në marrëdhëniet e tyre me partnerë dhe klientë jashtë organizatës apo kompanisë. Artikulli hedh dritë dhe shtron për diskutim disa alternativa efikase për forcimin dhe përmirësimin e komunikimit duke përdorur gjuhën jo vetëm si mjetin kryesor për të komunikuar por edhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe zbutjen e konflikteve, duke ofruar kështu mundësi për studiuesit dhe ata që interesohen për lehtësimin e komunikimit në një mjedis global biznesi. Alternativat kryesore të përmendura, por pa përjashtuar të tjera që mund të ekzistojnë, i referohen përdorimit të një gjuhe standarde zyrtare, përdorimit të gjuhës së kontaktit, përdorimit të përkthimeve zyrtare si dhe ofrimit të kurseve të gjuhës së huaj për punonjësit apo anëtarët e një organizate.

**Fjalët kyç:** komunikimi i biznesit, gjuhë e huaj, komunikimi ndërkulturor, organizatë ndërkombëtare.

### **Abstract**

The main focus of this article is to give an overview of the main developments coming from the global changes worldwide and the influences they have on the peoples' natural communication within certain structures, businesses or organizations as well as in their relations with external partners or clients. It throws light and discusses some alternatives used to enhance and improve communication by using language not only as a main communication tool but also as a conflict resolution and relations smoothing one, offering opportunities for practitioners and those interested to facilitate communication in a global business environment. The main alternatives mentioned but not excluding others refer to use of a standard official language, use of the contact language, use of translation/interpretation and teaching of foreign language.

**Key Words:** business communication, foreign language, intercultural communication, international organization.

### **1. Introduction**

The growth of interdependence of people and cultures in the global society of the twenty-first century has triggered scholars to pay even more attention to intercultural issues. Borders or distance do not cause any more constraints for collaboration and

working together, thus bringing along with globalization a substantial change in why, where and with who people do business. The development of technology, the constant flow of information and ideas across boundaries, the development of transportation and the progress made in means of communications have affected not only the world economy but also the way people interact with each other and how they behave internally and externally. Cultural diversity and multiculturalism are the realities of working and domestic life everywhere. In the process of migration and general internationalization the idea of a national identity has changed. International alliances and subcultures inside the nations have caused a de-emphasis on the nation-state.

Under the above-mentioned circumstances the study of intercultural issues is by no means an area that more and more attracts attention not only of the anthropologists and business scholars but linguistic as well. People have interacted with others from different cultures throughout our history in wars, religious journeys and exchange of goods. They have also been well aware of the difficulties these encounters may cause. Even though the history of intercultural contact is long, it has never before reached the magnitude of today's world. Earlier it was only people in certain professions or status that had the contact to the foreign cultures. Nowadays even the most isolated and marginal groups of people have the opportunity to interact with people all over the world.

Cultural interaction has become a reality of everyday life for almost everyone. The growth of interdependence of people and cultures in the global society of the twenty-first century has forced us to pay even more attention to intercultural issues. Having said that, it seems right to agree that 'the need for effective and clear intercultural communication is becoming vital in securing success in today's globalized workplace'<sup>12</sup>.

## **2. Features characterizing the peculiarities of cultural challenges in a global business environment.**

### **2.1 Cultural generalizations**

By working on everyday basis and by interacting with people from different educational backgrounds, cultures and sometimes nationalities, we come across several problems related to stereotypes or prejudice about different individuals or groups. In trying to avoid this and while taking into consideration how intercultural communication develops, people who work on every day basis at different agencies and multilateral organizations fall on what is referred to as cultural generalizations. Broad characterizations can be useful as a general guide to anticipating and discussing cultural reactions, attitudes, and behaviours in a neutral way. "While cultural generalizations are helpful in analyzing cultural patterns (e.g., Americans *tend* to be individualistic while Japanese *tend* to be collectivist), it is understood that *no cultural generalization will ever apply to everyone in a culture* (no matter how small or isolated) because individual personalities and backgrounds always play a role in how people think and act.

In intercultural communication, cultural generalizations are used as a shorthand way to make non-judgmental cross-cultural comparisons, not to oversimplify or deny the

---

12 <http://www.kwintessential.co.uk/cultural-services/articles/intercultural-communication-global-workplace.html>

complexity of social interaction."<sup>13</sup> Without any kind of supposition or hypothesis about the cultural difference we may encounter an intercultural situation, we may fall prey to naive individualism, where we assume that every person is acting in some completely unique way or we may rely inordinately on "common sense" to direct our communication behaviour. Common sense is of course, common only to a particular culture. Its application outside of one's own culture is usually ethnocentric.<sup>14</sup> Cultural generalizations can be made while avoiding stereotypes by maintaining the idea or preponderance of belief. Nearly all possible beliefs are represented in all cultural at all times, but each different culture has a preference for some beliefs over others. Of course individuals can be found in any culture that holds beliefs similar to people in a different culture. Generalizing from too small a sample may generate us inductive stereotype. These kinds of assumptions are particularly troublesome, since initial cross-cultural contacts may often be conducted by people who are deviant in their own cultures<sup>15</sup>.

Cultural differences often cause miscommunication and conflict. Conflict is greater when the two cultures are very different than when they are the similar. Technically this difference called "cultural distance". Cultural distance is greater when people speak different languages. Even speaking languages that are related can be a problem, for examples the same word can have different meanings for its users. Cultural distance is also greater when people have different family structures. Simple terms such as "aunt" may convey different meanings when the family structure is different. Religion of course can be a great source of differences in points of view. Even when one knows that the other person believes something different, there is the problem that humans use themselves as the anchors for such judgments. The businessman may not believe that it is possible for the other businessman to have such "outlandish beliefs".

## 2.2 Individual Uniqueness

The English statesman Lord Chesterfield once wrote, "*There never were, since the creation of the world, two cases exactly parallel.*" He also said that there have never been two people exactly alike. The reason is simple: behaviour is shaped by a multitude of sources, and culture is just one of those sources<sup>16</sup>. Put in slightly different terms, we are more than our cultures. Although all cultures offer people a common frame of reference, people are not captives of their culture, nor are they subject to all the lessons of that culture. Instead people are thinking, feeling individuals whose biology and history interact and play crucial roles in their social collective behaviour. Consequently, the values and behaviours of a particular culture may not be the values and behaviours of all the individuals within that culture. Reflect for a moment on all the potential responses that could be generated by the simple phrase *I am going to the racetrack*.

It can elicit of wide variety of responses, depending on the listener's background. One person might believe football match bets are an evil form of gambling, another might

---

13 <http://www2.pacific.edu/ss/culture/File/sec1-1-3h7.htm>

14 [http://www.kuleuven.be/citizenship/\\_data/etho\\_iess.pdf](http://www.kuleuven.be/citizenship/_data/etho_iess.pdf)

15 Carol P. Harvey, Allard M. June, "Understanding and managing diversity: readings, cases, and exercises", Pearson/Prentice Hall, 2005, p.57. as checked in <http://books.google.com/books> on may 10 2012.

16 [http://www.archive.org/stream/letterswrittenby00chesuoft/letterswrittenby00chesuoft\\_djvu.txt](http://www.archive.org/stream/letterswrittenby00chesuoft/letterswrittenby00chesuoft_djvu.txt)



maintain that they are forms different people do business and yet another, regarding the same words, could respond by saying, "I love the football match betting." So in other words, "*Reality is not the same for all people*". One reason it is not the same is that your genetic makeup, your social group experiences, the language you speak, your gender, age, individual and family history, political affiliation, educational level, perceptions of others, and current circumstances, the region or neighbourhood you grow up, your religious experiences and many other factors are at play every moment of your life. All of these factors (along with culture) form your individual personality. What is being stressed is that although all learned behaviour takes place within a cultural setting, every person has a unique personality. Therefore you must be cautious and prudent when making cultural generalizations. Always keep in mind that culture is a powerful force in the shaping of human behaviour, but people are more than their cultures<sup>17</sup>.

### 2.3 Stereotyping

"The concept of the 'stereotype' was borrowed from old raised printing technology, where copies of a composed type were made by using *papier mache* as *molds* for new printing plates, identical to the original. The term stereotype, as allegedly used for the first time by Walter Lippman in 1922, is used today to mean a readily available image of a given social group, usually based on rough, often negative generalizations. Although stereotypes can be positive as well as negative, they are, in everyday usage, most often understood as irrationally based negative attitudes about certain social groups and their members"<sup>18</sup>. Stereotypes are a collection of false assumptions that people in all cultures make about the characteristics of members of various groups. We often see in them what we want to see rather than what is really there<sup>19</sup>. When people say that Muslims do not have time to do anything but pray because they pray five times a day they are engaging in stereotyping. Stereotypes can be attached to any assumed indicator of group membership, such as race, religion, ethnicity, age, or gender, as well as national culture.

The characteristics that are assumedly shared by members of the group may be respected by the observer, in which case it is a positive stereotype. In the more likely case that the characteristics are deprecated, it is a negative stereotype. Stereotypes of both kinds are problematic in intercultural communication for several obvious reasons. One is that they may give us a false sense of understanding our communication partners. Whether the stereotype is positive or negative, it is usually only partially correct. Additionally, stereotypes may become self-fulfilling prophecies, where we observe others in selective ways that confirm our prejudice.

Cultural stereotypes are popular because they are easy to create in every workplace including multilateral organizational or travel agencies. We have all heard foreigners leaving Albania with tales of how hospitable the locals are. Often, these

---

17 Larry A. Samovar, Richard E. Porter, Edwin R. McDaniel, Communication Between Cultures, 7th Edition. ©2010 as checked at

[http://www.cengagebrain.com/content/samovar67442\\_0495567442\\_02.01\\_chapter01.pdf/](http://www.cengagebrain.com/content/samovar67442_0495567442_02.01_chapter01.pdf/)

18 <http://www.jyu.fi/viesti/verkkotuotanto/kp/vf/jaakko.shtml>

19 <http://eycb.coe.int/edupack/09.html>

exclamations characterize, unhesitatingly, an entire nation: "Everyone is sooo hospitable and helpful in Albania". It can be hard to argue against these impressions, particularly since the people who express them are speaking from personal experience. When repeated with custom regularity they become a kind of a shortcut and they are used to present a vast number of different personalities. Stereotyping needs to be studied and examined as an important part of intercultural communication and as a common error made by travel agents<sup>20</sup>.

## 2.4 Intercultural Conflict

Miscommunication and misattributions at workplaces, especially in an intercultural environment often underscore intercultural conflict. Individuals coming from two contrastive cultural communities bring with them different value assumptions, expectations, verbal and nonverbal habits, and interaction scripts that influence the conflict process. A good example are multilateral organizations, mainly the business oriented ones such as is *Vas Tour* with agencies across all the Balkan region where intercultural differences are a problem even though they use a common language when communicating i.e. English as *lingua franca*.

To understand human behaviour it is important to understand the multicultural context in which behaviour is learned and displayed. With our global economy, and increased workplace diversity, we find ourselves in increased contact with people who are culturally different. In this work environment, people bring with them different work habits and cultural practices<sup>21</sup>. More and more executives or other professionals are expected to work internationally, hence business and social contacts between people of various nationalities have increased. As these people come from different cultural backgrounds, geographical barriers give way to commit barriers that lead to tensions and conflicts.

Intercultural clash comes about when the initial stages of wallet members of a multicultural team were not sufficiently or soonest addressed. The reasons to this, for instance can be the reluctance to confront the issue with the other part nipping the problem in the bud soonest possible or by allowing a trivial matter to fester. Also, there are team members who refuse to accept their failings; instead blaming others - and the entire host society for that matter - for their problems. Nevertheless, all culminate to one point where conflict rooting in the intercultural difference prevails. From the majority of research carried out into all types of multilingual companies and organizations it seems clear that communication within tends to be problematic. Irrespective of the structure and efficiency of the internal system, tension and conflict exist, which distort sharing and dissemination of information. Even those organizations or companies which acknowledge that there might be a problem in this regard try to re-organize their structure rather than their means of communication.

---

<sup>20</sup> <http://www.jyu.fi/viesti/verkkotuotanto/kp/vf/jaakko.shtml>

<sup>21</sup> <http://www.upenn.edu/affirm-action/ManagingInterculturalConflict.pdf>

### **3. Language based solutions to minimize and smooth tensions, misunderstanding at the working place in the globalization era**

Language functions as an important tool of thinking and communicating in a certain community has always triggered the interest of scholars and anthropologists. Language in itself is a part of culture and it is closely bound to the principles, rules and values which are formed in the given society. Language is one of the most significant signs of ethnos, has effects on its integration, becomes a symbol of belonging to a different community, consequently it has an ethnically significant function.

Language in itself performs a number of different functions in the given community and ensures communication in various spheres of human activity. According to Mezulánik<sup>22</sup>, its functions are commonly divided into informative, interactive and facilitative ones. Looking at the current situation and global development of business and international relations, it is obvious that the cooperation among different business entities or organisations with mixed cultures as well as those wanting to trade or interact successfully abroad has increased. In such situations, if individuals are unaware of how best to work together and get business done, it most probably can lead to bad performance, misunderstandings and as a worse consequence in lost deals or business failure. The greater the understanding of intercultural communication differences, manners, etiquette, protocol and communication styles, the higher the probability of achieving business goals is.

The employees in a monolingual organization are able to communicate better with their colleagues, because they have mutual knowledge, which reduces occurrence of misinterpretation. Such a fact may prove a disadvantage in external communication of the organization, both in a communication with another organization at the given environment or with organizations outside the national environment. At a fundamental level, sharing the same language reduces the level of potential distortion in translating action into language and language into action<sup>23</sup>. If we accept that a monolingual environment creates risks for a homogenous corporate culture then we tend to believe the opposite when we talk about a multilingual environment and the fact that it might endanger fragmentation of an organization. Scholars provide evidence which suggests that multilingualism can fragment economies: 80 per cent of linguistically heterogeneous countries are also underdeveloped<sup>24</sup>. Although in corporate communication it might be probably true that the language of business dominates any national languages used under the context of natural language, still it is apparent that a multilingual environment can suffer from the existence of various languages. This triggers negative impacts for different businesses or organizations and requires a lot of efforts to minimize. There exist several means how to eliminate the negative impacts of multilingualism on the organization's activities. Czerniawska's work "Corporate Speak"<sup>25</sup> serves as a good basis of the further discussion of different methods of how to minimize the negative effects of

---

22 Mezulánik, J.: The Barriers to Verbal Communication. Acta academica karvinensis. Karviná 1993

23 Allen, T.: Managing the Flow of Technology. Cambridge, Mass.:MIT Press 1977

24 Terpstra, V.: The Cultural Environment of International Business. Cincinnati, Ohio. 1978.

25 Czerniawska, F.: Corporate Speak. The Use of Language in Business. Macmillan, London 1997

multilingualism through using a *standard official language, the contact language, use of translation/interpretation and of foreign language teaching.*

Usage of an official language to minimize the negative effects of communication in a multilingual organization provides for mutual understanding among people working there and whose country of origin and culture is different. Nevertheless, it is worth to be mentioned here that use of an official language in certain cases can have its own negative effects as it can put divisions between those people within the organization who can communicate effectively in the organization's native language, and those who cannot. If we take the case of an International Organization such as United Nations or any of its agencies, it is easier to use the first approach since the language which comes first and used as *lingua franca* is English of course. English language used in such circumstances becomes indispensable and facilitates communication amongst different interlocutors not only within the structures of the organization itself but also when it comes to external communication with other international actors. Another scenario can be envisaged in the case of a European structure and herein we can mention the case of EU and its institutions. The later uses as official language alongside with English, French , Italian, German or any other language of any of its members which in certain situations may become a barrier since not everyone participating in a meeting can understand one or the other language used, thus disrupting the understanding chain.

Another way of tackling the negative impact communication has in multilingual organization is the use of a simplified form of speech that is usually a mixture of two or more languages, so called contact language<sup>26</sup>, kind of a *lingua franca*, which is most frequently a form of English. It is obvious that the use of a contact language is limited to relatively closed communication community or/and very specialized fields of communication. Although the use of business pidgin is more "democratic" than the introduction of the official standard language, both approaches return in fact to a monolingual structure of communication with all their bottlenecks. Examples of a more structured instrument or tool to help better communication, understanding and use of the right terminology and meaning of words in the Albanian current situation can be the "Manual of Utilization of Community Legislation", " Manual for the Translation of Community Legislation" as well as the "Glossary on European Integration"<sup>27</sup>, all publication of the Ministry of Integration. The most recent example in the case of Albania comes again from the Ministry of Integration through the so-called ***ALterm***, a multilingual terminology database developed during the process of translating the EU acquis in the Albanian language serving as an important translation tool. The purpose of this program is to have a unified and consistent terminology base for a range of fields, serving as a reliable source of information and reference for translators, institutions working to harmonise the Albanian legislation with the acquis, universities,

---

26 A simplified form of speech that has a rudimentary grammar and vocabulary, is used for communication between groups speaking different languages, and is not spoken as a first or native language.

27 <http://www.mie.gov.al/>. This glossary is regularly updated and the definitions explain the evolution of specific terms, and if it necessary, they refer to the Treaties. The historical information, the answers to the questions on institutions, the proceedings and the fields that are covered by Community Policies and many others can be found in this glossary.

organizations, as well as the larger public<sup>28</sup>. These can serve as the first steps or the pioneers of such process in the case of Albania.

The third aspect is translation/interpretation to the authentic competence of the recipients. This approach is used especially for official communication. As such in the Albanian reality can be mentioned the use of official language, i.e. Albanian national language, in the external communication of different state institutions and then a so called courtesy translation for all correspondence with external international correspondence as well as in different official events such as conferences, workshops, seminars. Such practice may serve the purpose of archiving and maintaining or preserving the national language, but on the other side may lead to some disadvantages such as a considerable loss of time, high costs and loss/discrepancies of translation (so-called misinterpretation or mistranslation), which may in the end lead to communication barriers. Besides the positive effects, another group argues that sometimes depending on the organizational structures of different businesses or organizations, use of official translation might produce the opposite effects. Michalmann<sup>29</sup> states an example of communication within the European Union, which uses translation for communication between member countries, which might be interpreted as centralized or bureaucratic tendencies in communication of EU countries.

The final method helpful to overcome barriers in a multilingual environment is teaching a foreign language. This approach has been considered the most effective by Fayerweather when he says that "if the businessman wishes effective communication with labors, government officials, customers and others, he must be able to communicate directly with them in their own language"<sup>30</sup>. Most managers or administrators recognize that their companies can be much more successful if they are able to establish effective systems of intercultural communication between employees of different religious, social, and ethnic backgrounds within their company or organisation as well as outside in their relations with partners or clients. This is the reason why they invest in offering language courses (mainly English) to their workers and organisation staffers. In these cases the differences in communication styles can also be found within functional areas of the organisation or business itself and these too need to be addressed to enable the organization operate efficiently. For example, staffers dealing with technical issues (computers, mechanical engineering, etc.) often have educational and work backgrounds that are considerably different from those engaged in other areas of the business (marketing, public relations, etc). This is the reason why when planning on teaching a foreign language to such employees, it needs to be as tailor-made as possible to address and tackle different backgrounds.

## Conclusions

It is important to emphasize that the mentioned problems of relationship between language and intercultural communication in a global business environment represent

---

28 <http://alterm.mie.gov.al/index.php?jezik=angl>

29 Michelmann, H.J.: *Organisational Effectiveness in a Multinational Bureaucracy* (Farnborough: Saxon House, 1978) (also, New York, N.Y.: Praeger, 1978)

30 Fayerweather, J.: *Management of International Operations*. McGraw-Hill, New York 1960.

only a part of the whole process. It is obvious that globalization of communication will take place at different countries, regions, at a different pace and in various forms. In this paper the attention was placed on ways to overcome communication barriers in multilingual structures or environments with respect to their organization structure and through the interaction between language and culture through intercultural communication and the use of English language as *lingua franca* nowadays.

Economic, social and political processes of the individual communities are coming closer, homogenizing but at the same time the basic facilitation tool for communication between the communities – natural languages – remain relatively diversified, they do not “copy” the above-mentioned processes and are in fact the resource of communication barriers. As people are forced to think outside a certain environment, they develop greater interpersonal skills, flex their creative muscle and learn new ways of doing things. As a result, the need for mainstreamed intercultural communication skills combined with interactive language learning is obvious. We are all working in an interconnected global economy and it is important to build good relationships with people from other cultures and backgrounds, thus establishing communication bridges through use of languages primarily but not less important communicating inter-culturally. With this article we do not claim to have answered all questions related to this issue, but hope to have contributed modestly with identifying some of the obstacles and proposing ways out mainly through the use of language not only as a communication tool but also as a conflict resolution one.

### References:

- Allen, T.: Managing the Flow of Technology. Cambridge, Mass: MIT Press 1977.
- Argyle, M.: Social Skills and Work. London 1981.
- Czerniawska, F.: Corporate Speak. The Use of Language in Business. Macmillan, London 1997.
- Cairo M. D'Almeida. *Effects of cultural diversity in the workplace* [electronic resource], published in Ann Arbor, MI: U.M.I.2007.
- Carol P. Harvey, M. June Allard, "*Understanding and managing diversity: readings, cases, and exercises*", Pearson/Prentice Hall, 2005, p.57. as checked in <http://books.google.com/books> on May 10 2012.
- Fayerweather, J.: Management of International Operations. McGraw-Hill, New York 1960.
- Granovetter, M.: Economic Institutions as Social Constructions: A Framework for Analysis. *Acta Sociologica* 35, 1992.
- Hofstede, G.: Culture's consequences: International Differences in work-related values, Beverly Hills, CA, sage 1980
- Kamiš, K.: Code barriers from the psychological point of view and how to overcome them in a multicultural milie. In: Human being and his/her rights. UNESCO. Prague 1995.
- Larry A. Samovar and Richard E. Porter.: Basic Principles of Intercultural Communication. A Reader. Wadsworth, Inc., CA: USA. 1991:
- Larry A. Samovar, Richard E. Porter, Edwin R. McDaniel, Communication between Cultures, 7th Edition. CA:USA.©2010

Monson, M.: Talking to Tech-weenies. Oregon Business. February 1997.

Michelmann, H.J.: Organisational Effectiveness in a Multinational Bureaucracy (Farnborough: Saxon House, 1978) (also, New York, N.Y: Praeger, 1978)

Michelmann, H.J and James Rude, Jack Stabler and Gary Storey. : Globalization and Agricultural Trade Policy, (Boulder: Lynne Rienner Publishers, 2001)

Mezulánik, J.: The Barriers to Verbal Communication. Acta academica karviniensis. Karviná 1993

Taylor, H.M.: English and Japanese in Contrast. U.S: Regents Publishing Company, Inc. 1979

Terpstra, V.: The Cultural Environment of International Business. Cincinnati, Ohio. 1978.

<http://www.mie.gov.al/>.

[http://www.jlonline.co.uk/journal/5\\_1/3LingGao.pdf](http://www.jlonline.co.uk/journal/5_1/3LingGao.pdf)

<http://www.kwintessential.co.uk/cultural-services/articles/intercultural-communication-global-workplace.html>

<http://www2.pacific.edu/sis/culture/File/sec1-1-3h7.htm>

[http://www.kuleuven.be/citizenship/\\_data/etho\\_iess.pdf](http://www.kuleuven.be/citizenship/_data/etho_iess.pdf)

[http://www.archive.org/stream/letterswrittenby00chesuoft/letterswrittenby00chesuoft\\_djvu.txt](http://www.archive.org/stream/letterswrittenby00chesuoft/letterswrittenby00chesuoft_djvu.txt)

[http://www.cengagebrain.com/content/samovar67442\\_0495567442\\_02.01\\_chapter01.pdf/](http://www.cengagebrain.com/content/samovar67442_0495567442_02.01_chapter01.pdf/)

<http://www.jyu.fi/viesti/verkkotuotanto/kp/vf/jaakko.shtml>

<http://eycb.coe.int/edupack/09.html>

<http://www.jyu.fi/viesti/verkkotuotanto/kp/vf/jaakko.shtml>

<http://www.upenn.edu/affirm-action/ManagingInterculturalConflict.pdf>

<http://alterm.mie.gov.al/index.php?jezik=angl>

# SINONIMIA DHE HUAZIMI LEKSIKOR

**Leonard Danglli**

Departamenti i Gjuhës Angleze, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës

## **Përmbledhje**

Ky artikull studion mënyrën se si huazimi leksikor, si në gjuhën angleze ashtu edhe në atë shqipe, shërben si një mjet shumë frytdhënës për vendosjen e marrëdhënieve sinonimike midis fjalëve vendase dhe atyre të ardhura nga gjuhë të ndryshme. Punimi i kushton një rëndësi të veçantë mënyrës se si faktorë historikë dhe shoqërorë ndikojnë në pasurimin e një dukurie gjuhësore siç është sinonimia, pasi ngjarje të tilla si pushtime, kontakte të shumëllojshme midis kombeve, peruidha të ndryshme të zhvillimit të shkencës, letërsisë etj., ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në shtimin e fondit leksikor të një gjuhe me terma që lidhen me këto ngjarje apo epoka. Si rrjedhojë, lindin një numër i madh çiftesh apo grupesh sinonimike, pjesëtarët e të cilave mund t'i nënshtrohen me kalimin e kohës diferencimit të rrafshëve të ndryshme, si atij semantik, stilistikor, apo të përdorimit.

**Fjalë çelës:** *sinonimia, huazimi, diferencimi, faktorë jashtëgjuhësorë.*

## **Abstract**

This paper discusses the way how lexical borrowing, both in English and Albanian, serves as a very productive means of establishing synonymy relations between native words and those borrowed from various languages. This paper pays special attention to the way how historical and social factors influence on enriching a linguistic phenomenon, such as synonymy, because such events as invasions, various contacts between nations, different time periods characterized by development in science, literature, etc. have a direct impact on the enrichment of the vocabulary of a language with words related to these events or epochs. As a result, a great number of synonymous pairs or sets arise, whose members may, with the passing of time, be subject to differentiation in different levels, such as semantic, stylistic or usage ones.

**Key words:** *synonymy, borrowing, differentiation, extra-linguistic factors.*

## **Hyrje**

Sinonimia, kryesisht ajo leksikore, por deri diku edhe ajo gramatikore, kanë qenë dhe ende janë temë diskutimi për një sërë autorësh që merren me çështjet e leksikologjisë, por jo vetëm, sepse sinonimia ka shqetësuar në fakt edhe përfaqësues të fushave të ndryshme si filozofë, psikologë, arsimtarë, shkrimtarë, përkthyes etj. Duke qenë se çështje të përgjithshme teorike në lidhje me këtë dukuri gjuhësore kanë gjetur vend në punimet e disa autorëve të huaj dhe shqiptarë (ndonëse gjuha shqipe ka ende nevojë për studime më të thelluara), ky artikull ka si objektiv trajtimin e një aspekti të sinonimisë, siç është lidhja e saj me huazimin leksikor, si një burim i pashtershëm për vendosjen e marrëdhënieve sinonimike. Fillimisht jepet një pasqyrë e qartë dhe e ilustruar në lidhje me huazimet në gjuhën angleze, të cilat kanë krijuar më pas shtresa të ndryshme fjalësh për të arritur një shprehje sa më të saktë dhe të plotë. Aspektet teorike shoqërohen me



shembuj të larmishëm të marrë nga fjalorë apo botime ndryshme dhe më pas mbahet qëndrim për një sërë çështjesh që shtrohen gjatë punimit. Kjo vazhdon më poshtë edhe me gjuhën shqipe. Punimi vë në dukje se huazimet mund të shërbejnë si pasuri për gjuhën kur ato përdoren me kujdes dhe i nënshtrohen rregullave të gjuhës pritëse. Megjithatë, ato mund të shërbejnë si ngarkesë e panevojshme për gjuhën kur nuk kryejnë asnjë funksion në gjuhë apo kur përdoren pa kriter.

Fjalët e huazuara në gjuhën angleze, por edhe në gjuhën shqipe, janë burim shumë i rëndësishëm për vendosjen e marrëdhënieve sinonimike në këto gjuhë. Shumë autorë pohojnë se gjuha angleze është kaq shumë e pasur me sinonime pasi britaniket, romakët, danezët dhe normanët, të cilët luftuan dhe u vendosën në tokën e ishujve britanikë patën ndikim në gjuhën e njëri-tjetrit. Studiuesit britanikë u morën me studimin e greqishtes dhe latinishtes dhe për shekuj me radhë përdorën latinishten si mjet komunikimi për tema shkencore. Ndërkohë, periudha e Rilindjes shquhet për ringjalljen e interesit tek fjalët latine dhe greke. Në disa periudha të gjuhës angleze udhëtarët dhe tregtarët anglezë “sollën” me vete edhe fjalë nga vendet e Kontinentit. Gjatë zhvillimit të saj, Anglishtja Moderne huazoi fjalë nga më shumë se 50 gjuhë të ndryshme. David Kristëll [3] na jep një pasqyrë të plotë të rrugës që kanë përshkuar huazimet (ndonëse ai vetë nuk është dakort me termin *huazim*, pasi fjala nuk kthehet aty ku u morr) si një burim pasurimi për gjuhën angleze, dhe rrjedhimisht si një burim i rëndësishëm për formimin e marrëdhënieve të shumta të sinonimisë brenda “oqeanit” të leksikut të saj. Kështu, sipas tij “mbi 120 gjuhë janë regjistruar si burime të fjalorit të saj të tanishëm dhe vendet e kontaktit gjenden në të gjithë botën”

Kështu, huazimet filluan menjëherë pasi mbërritën anglo-saksonët. Gjatë kësaj periudhe ka pak huazime kelte por për sa i përket atyre latine, ato janë të shumta, sidomos pas përhapjes së krishtërimit. Mund të përmendim disa fjalë latine që rrjedhin nga kjo periudhë: *priest, school, bishop, church, plant, purple, lobster, giant*. Fjalët latine janë sot pjesë e anglishtes pasi një pjesë prej rreth 140 u futën gjatë periudhës së Anglishtes së Vjetër. Disa nga këto fjalë janë *altar, mass, priest, psalm, temple, kitchen, palm*, dhe *pear*. Ndoshta disa u futën me anë të keltishtes ndërsa të tjera fjalë u sollën në Britani nga pushtuesit gjermanikë, të cilët kishin qenë të njohur me parë me kulturën romake. Megjithatë, pjesa më e madhe e fjalëve latine u futën si pasojë e përhapjes së Krishtërimit. Këto fjalë përfshinin jo vetëm terma fetarë, por edhe shumë të tjerë më pak të specializuar.

Një tjetër fazë e rëndësishme për fjalorin e gjuhës angleze ishin edhe pushtimet e Vikingëve të cilat sollën rreth 2000 fjalë skandinave në gjuhën angleze. Disa nga fjalët e sjella prej tyre në këtë periudhë janë: *window, sky, dirt, egg, kid, leg, skin*.

Faza, e cila pa dyshim mund të quhet më e rëndësishmja, është ajo pas pushtimit norman të vitit 1066, e cila dyfishoi sasinë e leksikut në rreth njëqind mijë njësi, nga europa kontinentale në përgjithësi dhe veçanërisht nga gjuha franceze. Pas ardhjes së tyre, fisnikëria dhe klerikët normanë, ndonëse kishin mësuar gjuhën angleze, futën fjalë franceze që kishin të bënin me qeverisjen, kishën, ushtrinë, artet, mjekësinë, studimin, etj. Pushtimi norman i shtoi fjalorit të gjuhës angleze edhe shumë terma juridike si *sign, agreeing, policy, subject, rules, form, contract*, etj.

Nga fundi i periudhës së Rilindjes, leksiku i gjuhës angleze ishte dyfishuar përsëri, kryesisht nën ndikimin e gjuhës latine, por edhe asaj greke. Sigurisht që këto periudha mund të shihen si më të rëndësishmet gjatë një vështrimi të përgjithshëm të huazimeve në gjuhën angleze, por huazimet vazhduan gjatë shekujve në vazhdim dhe

janë dhe do të jenë një proces natyral i “gjuhëve natyrore” sa kohë që të ketë ndërveprim në aspekte të ndryshme të shoqërisë apo kombeve. Sigurisht që dalja e gjuhës angleze si një “lingua franca” ka sjellë edhe një kontakt intensiv të gjuhës angleze me gjuhë dhe kultura në mbarë botën, duke rritur kështu numrin e huazimeve.

Përveç kësaj, një numër shumë i madh fjalësh të reja janë prodhuar edhe si rrjedhojë e zhvillimeve në fusha të tilla si: produktet industriale, shpikjet, grupet dhe institucionet politike, zbulimet në florën dhe faunën, zhvillimi i industrisë ushqimore etj. Një tjetër faktor i daljes së fjalëve të reja ka qenë edhe rritja e nacionalizimit lokal, ku njerëzit kërkojnë mënyra të reja leksikore për të shfaqur identitetin e tyre brenda sferës së anglishtes standarde ndërkombëtare. Megjithatë jo të gjitha njësitë e reja leksikore do të kuptohen në të njëjtën shkallë. Për shembull, ndonëse pjesa më e madhe sot njohin disa fjalë të viteve 80 si *intifada*, *perestrokia* dhe *glasnost*, gjenden gjithashtu edhe fjalë të tilla si *krai* (rusisht, “ndarje administrative në Rusi”), *visagiste* (frëngjisht, “beautician”) apo *zaitech* (japonisht “spekullim në shkallë të lartë nga një shoqëri financiare”. Të gjitha këto fjalë gjenden në gazetatat angleze të kohës. Sigurisht që fjalë të huazuara nga këto gjuhë janë të shumta. Kështu për shembull, fjalë të huazuara nga gjuha japoneze janë edhe *zazen* (meditimi Zen), *zaikai* (komuniteti i biznesit), *zaibatsu* (një perandori biznesi para luftës së dytë botërore) etj. [5]

Përderisa anglishtja konsiderohet si gjuhë gjermanike nga pikëpamja historike, me variantin anglo-sakson si një fazë e hershme e zhvillimit të saj, fjalët anglo-saksone shpesh konsiderohen si “vendase” ndërsa ato franceze, latine ose greke janë “të huaja”, “të huazuara” nga këto gjuhë. Megjithatë duhet pranuar se termat “vendase” dhe “të huaja” shpesh të ngatërrojnë. Pavarësisht origjinës së tyre, shumica e fjalëve janë një pjesë thelbësore dhe plotësisht e natyrshme e gjuhës angleze; madje, edhe disa prej fjalëve “vendase” mund të jenë “huazuar” nga ndonjë gjuhë tjetër në ndonjë periudhë të caktuar të së shkuarës së largët.

Në anglisht është i dallueshëm kontrasti ndërmjet fjalëve të thjeshta vendase stilistikisht asnjansë dhe shpesh më të shkurtra, fjalëve letrare të huazuara nga frëngjishtja dhe fjalëve shkencore me origjinë greko-latine. Kështu, përftojmë një listë me dy ose tre kolona të kushtëzuar stilistikisht, të cilën mund ta pasqyrojmë si më poshtë:

Tabela 1. Sinonime me etimologji të ndryshme në gjuhën angleze

| <b>Times</b> | <b>Fjalë të huazuara nga frëngjishtja</b> | <b>Fjalë të huazuara nga latinishtja</b> |
|--------------|-------------------------------------------|------------------------------------------|
| Empty        | devoid                                    | vacuous                                  |
| to ask       | to question                               | to interrogate                           |
| Belly        | stomach                                   | abdomen                                  |
| to end       | to finish                                 | to complete                              |
| to rise      | to mount                                  | to ascend                                |
| Teaching     | guidance                                  | instruction                              |
| Kingly       | royal                                     | regal                                    |
| Holy         | sacred                                    | consecrated                              |
| Sweat        | perspire                                  |                                          |
| Clothes      | attire                                    |                                          |
| Happiness    |                                           | felicity                                 |
| Guts         | courage                                   |                                          |
| Wish         | desire                                    |                                          |
| Weariness    |                                           | lassitude                                |

Anglishtja përdor sot shumë çifte sinonimike ku njëra është greke dhe tjetra latine, si për shembull *sympathy - compassion, periphery - circumference, hypothesis - supposition, synthesis - composition*.

Edhe gjuha shqipe, ashtu si gjuha angleze, e ndikuar nga gjuhë të tjera gjatë shekujve, ka sinonime të cilat janë formuar si rrjedhojë e huazimeve të shumta nga gjuhë të ndryshme, kryesisht nga turqishtja, latinishtja, greqishtja: (huazime greke që përdoren kryesisht në të folmet e toskërishtes): *imonik* (shalqi), *mollos* (flas), *psonis* (bëj pazarin), *dhaskal* (mësues), *burazer* (vëlla), gjuhët sllave ballkanike (*memec, grusht, kockë, trup, prag, kyç, strehë, prag, lopatë, kovë, patë, mace, gozhdë, çekiç, pushkë, fllad, plaçkë, dobi, krahinë, padit, porosit, prashit, grabit, gostit, mërzit*), gjuhët neoltaine (italisht dhe frëngjisht) dhe kohët e fundit nga anglishtja. Për shembull, mund të sjellim për ilustrim çiftet e mëposhtme sinonimike, ku pjesëtarit e çifteve sinonimike i përkasin etimologjive të ndryshme:

*gjuhësi - linguistikë; ndikim - influencë ; dritare - penxhere ; kohë - vakt ; zotohem - angazhohem ; përvojë - eksperiencë ; orë (latine.) - sahat (turke.).*[6]

Huazimet nga gjuhët e sipërpërmendura janë të shumta dhe ngërthejnë një sërë faktorësh të sferave të ndryshme. Kështu ndikimet turke ishin pasojë e kontrollit shekullor osman i cili pati ndikim në fusha të ndryshme të jetës, si ushtri, shkollë, besim fetar, administratë, por edhe në aspekte të jetës së përditshme duke pasur parasysh kohën e gjatë të kontaktit ndërmjet dy kombeve. Pas shpalljes së pavarësisë, huazime kryesisht nga frëngjishtja dhe italishtja filluan të hynin në gjuhën shqipe si rrjedhojë e kontakteve politike, kulturore, arsimore etj., me Italinë dhe Francën.

Duhet vënë në dukje fakti se vitet e fundit, sidomos pas hapjes së vendit tonë me botën perëndimore, ka pësuar një rritje shumë të madhe numri i fjalëve të huaja që kanë hyrë në përdorim në Shqipëri, sidomos ato me origjinë angleze. Emigrimi i lartë i njerëzve në vendet ku fliten këto gjuhë, ndikimi i medias së shkruar dhe elektronike, shkalla e lartë e mësimi të këtyre gjuhëve në vendin tonë, janë disa ndër faktorët që kanë rritur përdorimin e fjalëve të huaja, por duke shkaktuar njëkohësisht edhe lindjen e një numri të madh marrëdhëniesh sinonimike. Megjithatë, përdorimi i tyre duket se është më i theksuar nga disa shtresa apo sfera veprimtarie si politikë, media etj. Në disa raste vihet re një teprim i panevojshëm dhe kjo sjell paqartësi në rradhët e bashkëbiseduesve, lexuesve apo dëgjuesve. Duhet theksuar se sinonimet e huazuara, në qoftë se nuk janë të nevojshme për gjuhën, nuk përdoren dhe qëndrojnë jashtë kufijve të gjuhës letrare.

Mund të përmendim këtu disa nga fjalët e huaja që gjejmë sot përdorim në vendin tonë: zgjedhësit – *elektorati*; bashkësi – *komunitet*; keqtrajtoj – *maltretoj*; njoftoj – *anuncoj*; dado – *bebisiter*; truprojë – *bodigard*; vrasës – *killer*; pamje – *luk*; mbikëqyrës – *supervisor*; mirë – *okej*; jetëshkrim (biografi) – *bekgraund*; projekt – *draft*; zbatoj (vë në jetë) – *implementoj*; uikend – fundjavë; shou – shfaqje; *agravohet* – rëndohet; *trapola* – kurth; *inkarnim* – mishërim, si edhe shumë të paasimiluara: *llajv, partajm, fulltajm, non – stop, derbi, pop – korn*, etj. [9]

Vlera e lidhjeve të tilla sinonimike gjykohet në përjasje të standardit me gjuhën shqipe në përgjithësi, si edhe sipas funksioneve në ligjërime e në stile të ndryshme. Mund të përmendim këtu rastin kur formohen lidhje sinonimike ndërmjet fjalëve ekzistuese dhe fjalëve të krijuara rishats, si: vdekje – *mosjetë*; xhamllëk – *qelqanajë*; kioskë – *tregtizë*; arkivol – *arkëmort*; altoparlant – *lartafolës*.

Pasurimin e gjuhës letrare shqipe studiuesi Çeliku e gjen edhe tek një burim tjetër. Bëhet fjalë për “disa fjalë të rralla të gurrës popullore, që në Shqipëri njihen si dialektore (të trevave të Veriut), ose fjalë që nuk gjenden në Shqipëri, fjalë që në Shqipëri njihen, por përdoren mjaft rrallë ose përdoren me një kuptim tjetër, apo edhe fjalë të përfutuara me rrugën e kalkimit sipas hullive fjalëformuese të gjuhës shqipe”[4]. Duke marrë parasysh faktin se ekzistenca e sinonimeve leksikore absolute do të ishte një ngarkesë e panevojshme për gjuhën, ai shprehet se “duhen mbledhur, studiuar dhe ato që nuk formojnë sinonime leksikore absolute duhet të gjejnë vend në fondin leksikor të gjuhës letrare kombëtare shqipe dhe të përdoren më gjerë ashtu siç kanë filluar të përdoren disa prej tyre”. Kështu, gjenden fjalë të tilla si, *shitore* (dyqan), *nënkresë* (jastëk), *rrokaqiell* (grataçielë), *përparësi* (prioritet), *tymtar* (oxhak), *drejtëpeshim* (ekuilibër), *përgojime* (thashetheme), *eptim* (fleksion), *mbulesë* (kopertinë), etj.

Duhet vënë në dukje një tendencë e përdorimit të dy ose më shumë sinonimeve njëri pas tjetrit ose brenda një fjalie. Kjo vihet re kryesisht në gazetari apo tek njerëz të fushave të caktuara si politikë, art etj. Sigurisht që kjo nuk është një tabu pasi shpesh sinonimet edhe mund të përdoren njëri pas tjetrit, por kjo duhet bërë me një qëllim të caktuar stilistikor apo edhe kuptimor. Ky përdorim mund të ketë shpesh funksion përforcues, qartësues apo në disa raste diferencues, siç ndodh shpesh në veprat e Shekspirit i cili përdor dy apo edhe më shumë sinonime njëri pas tjetrit për të krijuar një efekt të caktuar tek lexuesi. Në lidhje me përdorimin e dy ose më shumë sinonimeve pranë njëri tjetrit thjesht për shpejtësi, indiferentizëm gjuhësor, mosnjohje të plotë gjuhësore, apo faktkeqësisht në disa raste edhe për “mburrje pseudo-intelektuale”, çështja bëhet më e ndërlikuar pasi në këtë mënyrë ne i heqim sinonimeve një nga funksionet e tyre themelore, atë të përcaktimit të përpiktë. Sipas Jani Thomait, “rastet kur përdoren njëherazi dy – tri sinonime (*kuvendi/parlamenti*, *fushata elektorale/fushata zgjedhore*) nuk tregojnë një shfrytëzim të vlerave të sinonimisë, por lëkundje të normës ose pasiguri në formimin gjuhësor të autorëve”[9]. Edhe huazimet e reja, si rastet që u përmendën më lart, kryesisht përdoren si njësi që përjashtojnë nga përdorimi fjalët e mëparshme (shpesh të vetë gjuhës shqipe), pra, nuk sjellin pasuri e larmi, por asgjesim të fjalëve shqipe dhe si rrjedhim çngjyrosje të vetë shqipes.

Shpesh, gjatë periudhave të ndryshme, bëhen përpjekje për të hequr nga gjuha ‘elementin’ e huaj. Francezët kanë nxjerrë atë që ata e quajnë ‘Franglais’ (fjalët angleze të cilat përdoren në frëngjishten bisedimore) ndërsa Wellsianët punojnë për të gjetur zëvendësues për fjalët ‘angleze’ në gjuhë, ndonëse mbajnë me kënaqësi fjalët ‘latine’ të cilat hynë në një formë më të hershme të gjuhës në periudhën e Perandorisë Romake. Janë krijuar neologjizma zyrtare nga komisione për terminologjinë, me shpresë për të larguar termat e huaj që kanë depërtuar në gjuhën franceze si në Francë ashtu edhe në vende të tjera frëngjisht-folëse. Kështu për shembull “komisioni terminologjik në Francë krijoi termin *baladeur* për *walkman*, ku të dy termat tregojnë të njëjtin objekt: një kasetofon portabël”[6].

Përpjekje për të pastruar gjuhën e një vendi nga fjalë të huaja që kanë hyrë në periudha të ndryshme gjejmë edhe në gjuhën shqipe. Kështu, këtij veprimi i janë nënshtruar kryesisht fjalët me prejardhje turke, por jo vetëm ato. Duhet theksuar këtu se gjuha shqipe, si pasojë e qëndrimit të vendit tonë për disa shekuj me rradhë nën kontrollin osman, ka huazuar një numër të madh fjalësh nga turqishtja. Duke filluar me rilindasit, me në krye Kristoforidhin, e në vazhdim, herë pas here janë bërë përpjekje që këto fjalë të huaja të zëvendësoheshin me fjalë të tjera.

Përpjekjet për pastrimin e gjuhës shqipe nga huazimet e panevojshme nuk janë drejtuar vetëm kundër fjalëve turke por edhe kundër atyre me origjinë italiane ose franceze, kryesisht pas luftës së dyë botërore. Tani, detyra kryesore është veprimi “për të pastruar shqipen nga fjalët e panevojshme të huazuara kohët e fundit nga anglishtja, duke i zëvendësuar edhe këto me gjegjëset shqipe”[4] dhe kjo nuk duket se është një mision i pamundur pasi “shqipja, me aparatin e pasur gramatikor fjalëformues të saj, ka treguar se është e aftë të zëvendësojë fjalë të huaja, huazuar në kohë dhe nga gjuhë të ndryshme”[4] Kështu, ne sot kemi *denduri* në vend të *frequencë*, *asnjanës* në vend të *neutral*, *trysni* në vend të *presion*, *nen* në vend të *artikull*, *kundërmësymje* në vend të *kundërofensivë*, *teleshikues* në vend të *telespektator*, *ultravjollcë* në vend të *ultraviolet*. Për të krijuar një pasqyrë më të plotë për fjalën e huazur dhe ndërtimin e asaj shqipe po japim tabelën e mëposhtme, ku në kolonën e parë jepet fjala e huazuar e cila është zëvendësuar më pas me fjalën nga brumi i shqipes.

Tabela 2 Fjalë shqipe përballë asaj të huaj

| Fjalë shqipe   | Fjalë e huaj  | Fjalë shqipe         | Fjalë e huaj |
|----------------|---------------|----------------------|--------------|
| nxitje         | stimul        | bimor                | vegetal      |
| Shprehësi      | ekspresivitet | i ngjashëm           | analog       |
| Gojëtar        | elokuencë     | bujqësor             | agrar        |
| Mendësi        | mentalitet    | grumbulloj           | akumuloj     |
| Përparësi      | precedencë    | vë në jetë           | aplikoj      |
| Risi           | novacion      | përvetësoj           | asimiloj     |
| Parimësi       | principlitet  | mbresoj              | impresionoj  |
| vrapore        | pistë         | kujtesoj             | memorizoj    |
| Embëltore      | pastiçeri     | ngastëroj            | parcelizoj   |
| Ngrohtore      | kaldajë       | njëjtësoj            | identifikoj  |
| Gojëtar        | orator        | shoqërizoj           | socializoj   |
| i përshtatshëm | adapt         | rremësi/gënjeshtërsi | falsitet     |
| i skajshëm     | ekstrem       | ndërsjellësi         | reciprocitet |

Duhet vënë në dukje fakti se “neologjizmat, të cilat krijohen kryesisht nga shkrimtarë, gazetarë apo gjuhëtarë, dhe fjalët e huaja gjegjëse bashkëpërdoren në gjuhë si sinonime për njëfarë kohe. Kjo mund të thuhet edhe për fjalët e huaja të zëvendësuara me fjalë jo të reja, por në këtë rast koha e bashkëpërdorimit të tyre është më e shkurtër.”[4]

Pra, kjo sinonimi e përkohshme është një fazë kalimtare e gjuhës pasi njëri nga sinonimet do të mbizotërojë ndaj tjetrit, me shpresë ai nga brumi i shqipes. Megjithatë, edhe nëse kjo përpjekje fisnike për zëvendësimin e fjalëve të huaja me fjalë nga brumi i shqipes nuk do të jetë tërësisht e suksesshme, atëherë ne mund të përftojme një pasuri tjetër, ndoshta edhe më pozitive për një gjuhë, atë të pasurimit dhe ngjyritit të saj me sinonime të cilat kanë dallime të ndryshme ndërmjet tyre, qofshin këto nocionore, stilistike-emocionale, etj.

Me fjalë të tjera, nëse të dyja fjalët sinonime, si ajo e huazuar ashtu edhe ajo nga brumi i shqipes, i rezistojnë kohës dhe përpjekjeve për eliminimin e njërës, atëherë fjalët sinonime mund t’i nënshtrohen procesit të diferencimit, duke na pajisur kështu me dy ose më shumë fjalë të cilat mund t’i shtojnë gjuhës mundësitë e shprehësisë apo përcaktimit të përpiktë. Për shembull, ndonëse fjala *lider* mund të këshillohet që të zëvendësohet me

fjalën *udhëheqës*, tani këto dy fjalë duket se kanë fituar, si pasojë e lidhjes së tyre me faktorë politikë dhe historikë, ngjyime të ndryshme, ndonëse në thelb shprehin të njëjtin gjë, “ai që drejton një vend, një parti, një klasë ose një lëvizje shoqërore” [1]. Megjithatë, fjala *udhëheqës* mund të përdoret më shumë me konotacion që ka të bëjë me një drejtues diktatorial duke qenë se në Shqipëri kjo fjalë na sjell ende ndërmend sistemin e para viteve 90, ndërsa fjala *lider* shpesh përmban ngjyime pozitive të një drejtuesi. Kështu ndonëse *dhaskal* dhe *mësues* mund të kenë bashkëjetuar për një kohë të caktuar, e para sot ka marrë një konotacion tjetër, apo që përdoret kryesisht për efekte stilistike.

Pra mund të thuhet se “burimet e ndryshme të huazimit dhe përpjekjet për pastërtinë e shqipes kanë krijuar shtresa të tëra sinonimesh. Në kohën e fitimit të pavarësisë u ndërtua *nxënës* për të zëvendësuar *student*, mirëpo në ditët tona fjala e dytë mbeti për nxënësit e shkollave të larta.” [7]

Megjithatë, duhet pranuar fakti se një pjesë e mirë e fjalëve shqipe kanë mbizotëruar vërtet ndaj atyre të huaja. Është e natyrshme që ky është një proces dhe kërkon një kohë të caktuar në mënyrë që shtrirja e tyre të jetë më e madhe ndër ata që janë “konsumatorët” e fjalës, përdoruesit e saj. Më poshtë po japim një listë me fjalë shqipe dhe të huaja, ku të parat duket se kanë gjetur një pranim të përgjithshëm nga përdoruesit e gjuhës.

Tabela 3 Fjalë shqipe që kanë mbizotëruar ndaj të huajave [2]

| Fjalë shqipe | Fjalë e huaj | Fjalë shqipe | Fjalë e huaj |
|--------------|--------------|--------------|--------------|
| braktisje    | abandonim    | baraspeshoj  | Balancoj     |
| përshtat     | adaptoj      | pengesë      | Barrierë     |
| afri         | afinitet     | dobësi       | Debulesë     |
| veprimtar    | aktivist     | i kushtoj    | Dedikoj      |
| mjedis       | ambient      | tatëpjetë    | Dekadencë    |
| përforcues   | amplifikator | shpërbëj     | Dekompozoj   |
| zotohem      | angazhohem   | përshkrues   | Deskriptiv   |
| përparoj     | avancoj      | shmang       | Deviyoj      |

### Përfundime

Gjithësesi, duhet theksuar se disa nga fjalët e huaja të dhëna më sipër, por edhe të tjera që nuk janë përfshirë në këtë listë fjalësh, kanë një përdorim të gjerë në disa grupe të caktuara të shoqërisë. Duhet thënë hapur se media luan një rol shumë të madh në përhapjen (apo edhe të kundërtën) e kësaj apo asaj kategorie fjalësh. Teleshikuesi, në rastin e medias elektronike dhe lexuesi, në rastin e medias së shkruar, “bombardohet” çdo ditë me fjalë të cilat duam apo nuk duam do të gjejnë vend në fjalorin aktiv të përdoruesve të gjuhës. Sigurisht, që ka shumë njerëz, qofshin këta studiues, përkthyes, mësimdhënës, por në disa raste edhe gazetarë apo politikanë të cilët me ndërgjegje preferojnë fjalën shqipe e cila mund të zëvendësojë një fjalë të huaj të panevojshme dhe pa asnjë funksion stilistikor apo semantik për gjuhën tonë. Që të arrihet sukses, duhet të ketë një tendencë të përgjithshme, të krijohet një “frymë”, pasi vetëm një institucion si p.sh. Akademia e Shkencave apo një grup personash, nuk do të arrinin dot të lëviznin një “Everest”, siç do ta quante Kristëll fjalorin e një gjuhe.

## **Referencat**

ASHSH, Fjalor i shqipes së sotme, Toena, 2002, fq. 1398.

ASHSH, Për pastërtinë e gjuhës shqipe. Fjalor, Tiranë, 1998.

Crystal, David, The Cambridge Encyclopedia of the English Language, Cambridge University Press, 1995.

Çeliku, Mehmet, Çështje të Shqipes Standarde, ASHSH, Shtypshkronja “Nënë Tereza”, 2006, fq.71.

Evans, M. Toshie, A Dictionary of Japanese loanwords, 1997, fq. 223-224.

Fagyal, Zsuzsanna, Kibbee, Douglas, Jenkins, Fred, French, A Linguistic Introduction, Cambridge University Press, 2006, fq. 146-147.

Lloshi, Xhevat, Stilistika dhe Pragmatika, Toena, 1999, fq. 134.

Thomai, Jani, Leksikologjia e Gjuhës Shqipe, Universiteti i Prishtinës, 1961, fq. 37.

Thomai, Jani, Fjalor Sinonimik i Gjuhës Shqipe, Tiranë, 2005, fq. 11.

# LETËRSI





# **“IF”- FILOZOFIA E JETËS**

(Një rast nga R.Kipling)

**Alda Cicko (Jashari)**

Departamenti i Gjuhëve të huaja, Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë,  
Universiteti Fan S. Noli, Korçë

## **Përmbledhje**

Përkthimi i poezisë është një çështje sa teorike edhe praktike. Thuhet se çdo përpjekje për ta përkthyer poezinë është një përpjekje për ta rishkruar atë. “If” e poetit anglez R. Kipling, na dha një mundësi dhe një rast ndoshta të papërsëritshëm deri më sot për të pohuar se përkthimi i poezisë është më se i mundur e aq më tepër në gjuhën shqipe, përderisa tek ne ka ardhur jo në pak, por në 6 variante, të gjitha me vlera të papërsëritshme, falë cilësive themelore që gjuha shqipe ka, për shkak të bukurisë së fjalës shqip, të mundësive të pafund leksikore dhe stilistikore të saj. Për të gjitha këto vlera “If” flet qartë dhe tingëllon po kaq bukur edhe shqip.

**Fjalë kyçe:** përkthim, filozofi e jetës, analizë, kuptim leksikor, kuptim i përgjithshëm, kuptim i figurshëm, ngjyrim emocionues, stilistik, konotacion, denotacion, fjalë kyçe, variant, metaforë, epitet, përsëritje, simbol, antonimi, sinonimi.

## **Abstract**

Translation is a well-studying area. The poetic translation is a theoretical and a practical matter. It is said that any attempt to translate a poem is also an attempt to rewrite it. This short study had two initial aims to accomplish.

First: to compare the linguistic and stylistic values of an original work with that of another language.

“If” by Kipling was an excellent case which offered us the opportunity to understand that translation is a real attempt, a powerful approach to reveal a new and unknown area, to find out all the chances that a skilful translator offers to the reader.

Second: to show that the translation of poetry is possible even in the Albanian language. The original work is translated in six variants, due to the strong metaphoric ideas of the poetry and the delight of words, fundamental qualities of this poetry, and because the Albanian language has infinite lexical and stylistic possibilities in translating the same strong image of this poetry.

The Albanian language always preserves some hidden possibilities to offer.

In this respect “if” sounds good even in Albanian.

**Key words:** translation, philosophy of life, analyses, lexical meaning, general meaning, figurative meaning, stylistic, connotation, denotation, key word, variation, metaphor, epithet, repetition, symbol, antonym, synonymy

Thuhet se teksa lexon një poezi ke nevojë për një dëshirë që buron brenda teje për ta kuptuar dhe për ta ndierë atë. Në rastin e poezisë “If” të Rodyard Kipling ke nevojë për më shumë se kaq. Teksa e lexon për herë të parë në original të lind menjëherë dëshira për ta lexuar sërish, për të shijuar edhe njëherë bukurinë e gjuhës së zgjedhur mjeshtërisht,

ëmbëlsinë e imazheve dhe tingujve që përdor, fuqinë e emocioneve që i përçon dhe thellësinë e mendimit dhe mesazhit të madh që transmeton.

Duket qartë se ‘If’ është poezia e ndjenjës, sikurse edhe e mendimit të thellë dhe meditimit të fuqishëm, që të frymëzon menjëherë dhe të përfshin plotësisht. Nuk mund të mos ta kuptosh menjëherë se ‘If’ ka në thelb një filozofi të tërë, atë të vetë jetës. Në fakt, duket se e gjithë jeta e njeriut ngrihet, ndërtohet dhe finalizohet në kufijtë e mundësive të tij, nuk ka rëndësi nëse ato gjenden brenda apo jashtë kufijve të “së mundshmes”.

### **1. Roli i fjalëve kyçe në organizimin e gjithë poezisë**

Duke qenë një poezi lirike me elementë narrativë mjaft të dukshëm, ajo që të bie menjëherë në sy është përdorimi i zgjedhur dhe i duhur i fjalëve kyçe, që përbëjnë shtyllën, boshtin mbi të cilin ajo ngrihet, merr jetë dhe fiton dimensionin e duhur.

Natyra poetike e poezisë ‘If’ qëndron së pari te përzgjedhja mjeshtërore e fjalëve kyçe, nga ndërthurja e veçantë dhe mjeshtërore e tyre. Duket se e gjithë filozofia e jetës për Kipling qëndron brenda kuptimit të disa fjalëve kyçe, prandaj dhe çdo fjalë e vetme, çdo ndërthurje brenda vargut ka një kuptim të caktuar, ka një vlerë të veçantë dhe një ndikim të papërsëritshëm brenda kuptimit të gjerë dhe të plotë të të gjithë poezisë.

Përdorimi i një fjale në vend të një tjetre, i një nuance kuptimore në vend të një tjetre apo e një kuptimi të figurshëm në vend të atij të përgjithshëm, e bën më të fuqishëm dhe i jep vlera të mëdha këtij krijimi. Zgjedhja e kujdesshme e fjalëve, sado e ndërlikuar që mund të duket, nxjerr edhe njëherë në pah veçantitë e poezisë dhe thekson më së miri mjeshtërinë e padiskutueshme të autorit.

Në mënyrë që të nxjerrim domethënien e gjithë poezisë, duhet të arrijmë të kuptojmë vlerat e rralla leksikore të çdo fjale kyçe, të cilat, jo rastësisht, na sillen nga Kipling në çifte fjalësh, si: *ëndërr* dhe *mendim*, *triumf* dhe *shkatërrim*, *rrezik* dhe *humbje*, *tokë* dhe *bir*, *besim* dhe *dëshirë*, *krenari* dhe *dashuri*. Çdo përpjekje për të zëvendësuar, hequr a ndryshuar kuptimin leksikor të çdo fjale të vetme, do të dilte i pavlerë, ngaqë madhështia e “Filozofisë” së Kipling qëndron te thjeshtësia e fjalës së tij.

### **2. Vlerat leksikore, kuptimi i përgjithshëm dhe ai i figurshëm (konotacioni dhe denotacioni)**

Poezia është ajo formë e shkrimit, ajo mënyrë e shprehjes së ndjenjës dhe mendimit që, më shumë se çdo formë tjetër, shfrytëzon vlerat individuale të çdo fjale të vetme. Në rastin e poezisë që ne po analizojmë, përveç përzgjedhjes së fjalëve për të cilën thamë e që mbart vlera të pakrahasueshme, një element tjetër për t’u vlerësuar është përdorimi i gjerë i kuptimit të figurshëm të fjalëve, i toneve emocionuese dhe variacionin në mesazhin që ajo përcjell.

Dhe duket qartë se ngjyrat e gjalla dhe nuancat plot dritë të kësaj poezie janë rrjedhojë e përdorimit mjaft të gjerë të kuptimit të figurshëm (konotacionit) të fjalëve. Gjatë një shqyrtimi të kujdesshëm dhe të hollësishëm që ne i bëmë poezisë, duke analizuar kuptime konotative dhe denotative të fjalëve, vihet re se një pjesë e konsiderueshme e fjalëve kyçe ishin përdorur në kuptimin e figurshëm të tyre. Le të analizojmë disa prej tyre: *ëndrra* (dreams)- kuptimi i parë i drejtpërdrejtë leksikor i kësaj fjale është “diçka që na duket se e shohim ose e provojmë në gjumë”, ndërsa në kontekstin e poezisë ‘If’ duket qartë se ëndërr nënkupton shpresë, dëshirë dhe gjithçka tjetër që njeriu dëshiron apo aspiron në jetë; *zotëri/zot / zotërues* (master)- kuptimi i parë denotativ është “ai që zotëron apo ka në pronësi diçka”, kurse në kontekstin e vargut të

Kipling kjo fjalë është përdorur me kuptimin “fuqi e mbinatyrshe që mban të lidhura ëndrrat dhe zotëron dëshirat e njeriut”; *detyro (zembrën) - forcë* (your heart). Kjo është një zgjedhje shumë e veçantë fjalësh. Përgjithësisht kjo fjalë ka kuptimin “shtrëngoje dikë të bëjë diçka pa dëshirë”, ndërsa kuptimi kontekstual i këtij çifti fjalësh shpreh atë luftë të vazhdueshme midis mendjes dhe zemrës, arsyes dhe ndjenjës, që është njëherësh edhe një prej mesazheve që poezia “If” “do të përcjellë; *mjete/vegla* (tools) - edhe zgjedhja e kësaj fjale nuk është e rastësishme. Përdorimi i saj, larg nga kuptimi i parë dhe i drejtpërdrejtë, në poezinë “If” nënkupton sakrificat dhe mundimet e njeriut gjatë jetës.

Gjuha e kësaj poezie dallohet për një bukuri të admirueshme. Çdo fjalë mund t’i duket lexuesit se është familjare dhe shumë e njohur, megjithëse është e skalitur në mënyrë të tillë sa të jetë në të njëjtën kohë aq e thellë, aq e veçantë, aq e largët dhe aq e fuqishme. Fjalët e veshura me nuanca të figurshme dhe vlerat e gjera stilistikore janë veçanërisht të dallueshme te ky krijim. Duket se zhvendosja e kuptimit i jep jetë vargut të Kiplingut dhe është burimi i origjinalitetit të tij.

Thënia e Samuel Coleridge se poezia nënkupton “*fjalët më të mira të vendosura më së miri*” tingëllon e vërtetë dhe natyrale më shumë se kudo tjetër në poezinë “If”.

### 3. Gjuha e figurshme dhe figurat e mendimit

“If” në pamje të parë duket se është e thjeshtë dhe jo e ndërlikuar për sa u përket figurave të fuqishme dhe të stërholluara të mendimit. Siç u tha më lart, duket se Kipling është më shumë i interesuar për t’i zhvendosur fjalët larg kuptimit të përgjithshëm që ato kanë, duke i bërë që të marrin një kuptim të ri më të ndërlikuar dhe me vlera më të mëdha sugjestive. Duke qenë se kujdesi më i madh nga ana e autorit i është kushtuar nxjerrjes në pah të vlerave leksikore dhe stilistikore të fjalëve, sikurse edhe organizimit të brendshëm të vargut, falë të cilit poezia ka vlera të jashtëzakonshme, Kipling duket se nuk e ka parë të nevojshme përdorimin e gjerë të figurave abstrakte të mendimit.

Në fakt e gjithë poezia i ngjan një metafore të fuqishme dhe duket se kaq mjafton për të marrë udhë mendimi dhe për t’u sendërtuar sa më qartë kuptimi. Në rastin e “If”, vlera e poezisë qëndron te fuqia e mesazhit që ajo transmeton.

Sidoqoftë, nuk mund të lihet pa u vënë re dhe pa u vlerësuar përdorimi i disa figurave letrare shumë të gjalla dhe mbresëlënëse, ku mund të përmendim: a) **simboli** është një figurë që mbart vlera të veçanta figurative në këtë poezi. Jo rastësisht Kiplingu ka zgjedhur dy fjalë kyçe për t’i ngritur në nivelin e simbolit: *triumf* dhe *shkatërrim*, dy simbole të fuqishme që ia shtojnë vlerat origjinale poezisë; b. **përsëritja** është mjete artistik më i përdorur nga autori. Përsëritja artistike vihet re në fjalë të veçanta apo dhe në shprehje të plota. Mjafton të përmendim faktin se vetëm lidhëza “if” është përdorur 14 herë dhe kjo nuk është rastësi. Tipar dallues i përsëritjes artistike në rastin e Kiplingut është përsëritja në fillim të fjalisë; c. **epiteti**. Duke bërë së pari një dallim midis epiteteve të mirëfilltë dhe atyre kontekstuale, të parët dalin në formën e mbiemrave të thjeshtë, si: *i mirë, i mençur, i urryer*, ndërkohë që epitetet kontekstuale shfaqen te mbiemrat që mbartin një vlerë metaforike, si: (minutë) *e paharrueshme, të dashur* (miq), (vegla) *të vjetëruara* etj.

### 4. Sfidë e gjuhës shqipe në përkthimin e poezisë angleze

Shpesh thuhet se përkthimi i poezisë është pothuajse i pamundur, se edhe në rastet kur realizohet, ai merret si një sfidë e përkthyesit në raport me autorin dhe veprën origjinale. Në rastin e gjuhës shqipe kjo sfidë është e hapur, tërheqëse dhe

gjithëpërfshirëse, është një sfidë që buron prej faktit se gjuhët korresponduese duket të mos jenë aspak të përafërta, në mos tejet të largëta me njëra-tjetrën, për faktin e thjeshtë se kemi të bëjmë me dy gjuhë me trashëgimi gjuhësore dhe kulturore shumë të ndryshme, me origjinë të faktuar në periudha mjaft të largëta dhe me shtrirje e përhapje të dallueshme.

Gjithsesi, shqipja ka mjete të pafundme dhe mundësi të pashtershme, ajo na sjell jo pak vlera jo vetëm në krijimet origjinale të saj, por edhe në përkthime gati “të pamundura” si në rastin e poezisë “If” në anglisht. Siç do ta shohim më poshtë, këto mjete të fuqishme na kanë përcjellë jo pak, por gjashtë variante për një origjinal të vetëm, gjashtë variante jo vetëm të dallueshme njëra nga tjetra, por që kanë sjellë të njëjtën vlerë, të njëjtin mesazh dhe të njëjtin përjetim të origjinalit, çka ka bërë të mundur që lexuesi shqiptar ta perceptojë edhe ta ndiejë poezinë po aq sa dhe një lexues anglez. Gjatë përkthimit të poezisë “If” krijimi origjinal nuk ka humbur asnjë vlerë, në mos tjetër, ka fituar më shumë në shqip, falë mundësive të paarritshme leksiko-semantike e stilistike të kësaj gjuhe.

Çfarë humbet dhe çfarë zëvendësohet gjatë përkthimit? Krijimi origjinal përbëhet nga 4 strofa, 42 rreshta dhe 282 fjalë. Kjo strukturë në gjuhën shqipe ruhet vetëm për sa u përket strofave. Duke analizuar ndarjen në vargje apo numrin e fjalëve, të gjitha variantet<sup>31</sup> e shqipes paraqesin ndryshueshmëri dhe origjinalitet. Numri i fjalëve të përdorura në variantet e sjella në shqip shkon nga 148 (varianti i dytë) apo me 313 (varianti i katërt) e më pas 260 (varianti i tretë) dhe 310 (varianti i gjashtë). Duke bërë krahasimin me origjinalin apo dhe me variantet e shqipes, në mes tyre ky ndryshim është mjaft i dukshëm, çka përbën një problem mjaft të diskutuar në teorinë e sotme të përkthimit, se çfarë ruhet dhe çfarë humbet gjatë përkthimit, a ndikon ky fakt në cilësinë e përkthimit dhe a cenohet në këtë rast vepra origjinale?

Në fakt, parimi themelor se nuk mund të ketë një ngjashmëri të plotë midis dy gjuhëve, në fushën e përkthimit është më se i vërtetë. Në rastin e shqipes mund të shprehemi me bindje se ajo çka mund të ketë “humbur” nga pikëpamja statistikore gjatë përkthimit nuk ndikon aspak në kuptimin e përgjithshëm dhe mesazhin që poezia ka dashur të transmetojë e aq më pak në vlerat shprehëse poetike të krijimit.

Shumë fjalë nuk do të thotë domosdoshmërisht shumë ide. Një fjalë e vetme mund të përçojë kuptimin e disa fjalëve bashkë dhe në rastin e shqipes kjo dukuri vihet re shumë shpesh për shkak të identitetit dhe origjinatit të vetë kjo gjuhë ka. Për më tepër, ajo që mund të quhet si “humbje” në kontekstin e gjuhës origjinale, zëvendësohet fare mirë në kontekstin e gjuhës së përkthyer. Ndërkohë që dukuria e shtimit të fjalëve, e cila është mjaft e qartë në variantet 4 dhe 6, shpjegohet me zgjedhjen e lirë të përkthyesit për të mos i qëndruar tërësisht besnik origjinalit, por pa cenuar në asnjë rast kuptimin apo vlerat e origjinalit.

Duke analizuar të gjitha variantet e përkthyer në shqip, del se një karakteristikë e veçantë dhe mjaft e dukshme është ajo e origjinalitetit dhe e veçantisë në çdo varg, në çdo fjalë dhe në çdo sintagmë, fakt që shpjegon edhe njëherë tiparet semantike dhe leksikore të gjuhës shqipe. Këtë tipar shumë të qartë të shqipes mund ta argumentojmë me disa shembuj konkretë të sinonimisë dhe antonimisë:

---

<sup>31</sup> Shih shtojcën në fund të artikullit.

a) duke filluar që nga titulli i poezisë, një fjalë e vetme, siç është lidhëza “if”, është përkthyer me 6 variante të ndryshme lidhëzash apo shprehje lidhëzore përkatësisht: *në munç, në, në mundsh; sikur, në qofte se, nëse; “keep your head”,* sipas përqasjes që është bërë midis fjalorëve idiomatike të gjuhëve përkatëse përkthimi duhet të ishte: 1. “ruaj gjakftohtësinë” dhe 2. “nuk e humb toruan”. Asnjëri prej përkthyesve, me përjashtim të variantit të dytë, nuk e ka përdorur shpjegimin e dhënë në fjalor. Në të gjitha rastet shprehja me vlerë idiomatike në anglisht është përkthyer me një togfjalësh *folje + emër* me vlerë foljore. Elementët emërorë i përkasin së njëjtës fushe leksikore, duke qenë në këtë aspekt sinonime kontekstuale, ndërkohë që elementët foljore janë sinonime të plota nëse krahasohen: *-të mbash (terezinë); -të ruash (arsyen); -të mos humbasesh (toruan); -të ruash (mendjen); -të ruash (gjykimin); all (të gjithë)*, edhe në këtë rast variantet e ardhura në shqip janë origjinale. Në krijimin original *all* (të gjithë), përemër i pacaktuar, është një fjalë me kuptim neutral, e zhveshur nga çdo nuancë kuptimore e ngjyrim emocionues, ndërkohë që ekuivalentet e saj në shqip janë shumë më interesante. Në variantin e parë kjo fjalë është përkthyer “shokët”, fjalë e cila shpreh një marrëdhënie të ngushtë apo afërsi. Variantet 3, 4 dhe 5 të përkthimit në shqip janë shumë origjinale: “*bota*” – fjalë në të cilën kuptimi i brendshëm emocionues dhe vlera stilistike e fjalës është zgjeruar mjaft, veçanërisht kur kjo fjalë shoqërohet me epitete, si “e marrë” apo “e çmendur”; *to blame* (të hedhësh përgjegjësinë mbi një person) në shqip kjo folje është përkthyer me disa leksema me kuptim neutral, si për shembull: *i hedh fajin* (varianti 3), *ke faj* (varianti 2), ndërkohë që në rastet e tjera ky kuptim neutral i fjalës është zëvendësuar me një kuptim të figurshëm të një stili informal: *-fajin kopil ta lë pas dere; -në shpijfe e llum të ndot etj.*

b) antonimia është mjeti më i përdorur leksikor që mbart dhe vlera poetike, mënyrë e realizimit të kuptimit me shumë vlerë, sepse e gjithë poezia është ndërtuar mbi bazën e saj. Të njëjtën ide krijojmë edhe në variantet e realizuara në shqip ku kjo metodë është realizuar pothuajse njëlloj. Disa prej shembujve që na jep shqipja janë: *Të ruash terezinë- të çmendesh; Të ruash arsyen- të humbasesh fillin; Të gënjesht- të mos të të gënjejnë; Të humbasesht- të fitosh.*

Një analizë më e detajuar është e nevojshme për të kuptuar në mënyrë sa më të plotë dhe sa më konkrete ndryshimet që u vunë re në të gjitha variantet e përkthyer në shqip, si dhe për të dëshmuar origjinalitetin, tiparet dhe vlerat e veçanta të tyre. Për qëllime praktike është zgjedhur një varg nga strofa e fundit:

*If you can talk with crowds and keep your virtue*

*Në munç të zbreç në turm e të mbash nderin (variant 1)*

*Në folç me turmën dhe të ruash nderin (variant 2)*

*Në mund të flasësh me masakrenj por nderin tënd ta ruash (variant 3)*

*Sikur të rrosh me qenin pa mësuar të lehësh flliqshëm (variant 4)*

*Nëse do të rriësh me popull e të mbetësh i virtytshëm (variant 5)*

*Sikur me qen të rroje pa lehur ndyrë si qeni (variant 6)*

Në këtë varg analizën do ta fillojmë me dy njësi leksikore që i përkasin kategorisë gramatikore të emrit: *virtut* dhe *turmë* (virtue and crowd). Në anglisht *virtue*-moral excellence, goodness; në shqip *virtut* – cilësi e lartë morale, prirje për të bërë punë të mira; në anglisht *crowd*- a large number of people gathered closely together ; në shqip-*turmë* – grumbull i madh i paorganizuar njerëzish.

Siç mund të vihet re nga shpjegimet e dhëna në fjalor kuptimi leksikor i të dy emrave në të dyja gjuhët është pothuajse i njëjtë. Në këtë aspekt fjalët e përzgjedhura në variant 1 dhe 2 të përkthimit janë të njëjta me origjinalin. Një ndryshim rrënjësor i kuptimit ndodh në variantin 3 ku fjala *turmë* është përkthyer “maskarenj”, një fjalë me ngjyrim negativ me nuancë të theksuar stilitikore. Në variantin 5 fjala “turmë” është zëvendësuar me *popull* një fjalë me kuptim më konkret, krahasuar me atë kuptim neutral dhe të papërcaktuar që fjala ka në original.

Mjaft e veçantë është përzgjedhja e njëjtë e fjalës *qen* në variantet 4 dhe 6, ku është përdorur me ngjyrim negativ.

Fjala tjetër kyçe e këtij vargu është *virtyt*. Megjithëse ekziston një fjalë ekuivalente me fjalën e origjinalit në shqip, dy përkthyesit e parë kanë parapëlqyer një fjalë me një kuptim paksa të ndryshëm *nder* -tërësia e vetive morale që çmohen nga shoqëria.

Një element i veçantë na paraqitet në variantin 5. Në vend të emrit *virtyt* përkthyesi ka zgjedhur mbiemrin e prejardhur nga ky emër *i virtutshëm*, i cili, krahasuar me emrin, mbart një cilësi më të qëndrueshme dhe më të pranishme. Në variantet 4 dhe 5 pjesa e dytë e vargut nuk përkon aspak me origjinalin, fakt që përforcon edhe njëherë idenë se përkthyesi është i lirë të ndryshojë strukturën e vargut, të përdorë mjete që ai i quan të përshtatshme për të përçuar kuptimin dhe vlerat e poezisë.

Mund të thuhet me bindje të plotë se të gjitha variantet e sjella në shqip kanë arritur të përcjellin të njëjtën ndjesi, të njëjtën gjallëri, të njëjtën nuancë shumëngjyreshe të veprës origjinale për shkak të ngjyritimit stilistik-emocionues që ato sjellin. Dhe merita e plotë për gjithë këto vlera të përkthimeve në shqip i ka përdorimi i gjerë i kuptimeve të figurshme dhe ngjyimeve emocionuese, që fusha e gjerë leksikore dhe semantike e gjuhës shqipe ofron.

Rastet e sjella në gjuhën shqipe kundërshtojnë plotësisht dhe sfidojnë hapur thënien se “përkthimi i kuptimeve të figurshme të fjalëve është i pamundur”. Në disa raste kuptimi i figurshëm i një fjale në anglisht është dhënë me më shumë se një variant në shqip, çka dëshmon edhe një herë se konotacioni është një nga tiparet semantike më të gjallë e më të larmishëm të shqipes. Vërejmë se e njëjta fjalë me kuptim të figurshëm në anglisht, si *impostor*, në shqip na vjen me variantet “kallpazane (varianti 1), “mashtues” (varianti 2), “gënjeshtar” (varianti 5); *knaves* është përkthyer në shqip “dreq” (varianti 1), “horr” (varianti 2), “kopuk” (variantet 3 dhe 6); *fools* është përkthyer “sylesh” (varianti 1), “teveqel” (varianti 2), “trutharë” (varianti 3), “budallë” (varianti 6) etj.

Gjuha e figurshme e të gjithë varianteve shqip për shkak të përzgjedhjes mjeshtërore të figurave të mendimit dhe gjuhës poetike është thellësisht vetjake dhe simbolike. Imazhet e përcjella të përfshijnë menjëherë, të bëjnë për vete dhe të ngjallin emocione dhe ndjenja të forta.

Figura letrare më e përdorur në të gjitha variantet në shqip është metafora, e cila në origjinal është përdorur më rrallë. Megjithatë, duket se të gjithë përkthyesit kanë kërkuar imazhe të veçanta dhe origjinale. Ja disa shembuj tipikë të një gjuhe figurative shumë të kuar dhe të stërholluar që dëshmojnë, veç mjeshtërisë së pamohueshme të përkthyesve, edhe vlerat e mëdha të një gjuhe siç është shqipja: *Kalanë e jetës rrëzuar (1); E vërteta ndrydhet (2); Mbush minutën që s’ të fal kurrë (2); Fitoret t’i flijosh (3); T’i mbushësh minutat aq të rënda (3); T’prehesh si yll në krahët e punës tënde (4); T’ia marrësh minutës shpirtin (6); Dhëmbët ngul urrejti (6).*

Duket qartë se metafora dhe shprehjet metaforike janë të gjalla dhe tërheqëse, gjuha është e prekshme dhe energjike, teknika e shkrimit është e përsosur dhe mendimi krijues i bën të gjitha variantet njëloj të arrira.

Si përfundim, mund të themi se analiza që bëmë në këtë artikull përmes përqasjes dhe krahasimit nga pikëpamja gjuhësore dhe stilistikore, dëshmon më së miri atë çka shprehëm edhe më lart, se “Filozofia e jetës” e Kiplingut në anglisht është po aq e arrirë sa edhe në shqip.

## **Referencat**

- P.H. Matheus, *Oxford Dictionary of Linguistics*, Oxford University Press, 1997
- Seidl/Mc Mordie, *English Idioms* (and how to use them), Oxford University Press, 1998
- E.Douba Kabitoglou, *Logomachia* (forms of opposition in English, Language, Literature), Thesaloniki, 1994
- Oxford Dictionary of Current English*, Oxford University Press, 1998
- E.Mc Mahan, S.Day, R.Funk, *Literature and the writing process*, New York, 1989
- J.H.Pickering, J.D.Hoeper, *Literature*, New York, 1986
- I.Stefanllari-V.Dheri, *A Phraseological English-Albanian Dictionary*, Tiranë, 1981
- Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe*, 1980
- J.Thomai, *Fjalor Frazeologjik i Gjuhës Shqipe*, 1999
- David Crystal, *Enclopedic of the English Language*, Cambridge, 1995
- The Cambridge English Dictionary*, London, 1980
- Webster's Encyclopedic Unabridged Dictionary of English Language*, New Jersey, 1996
- Kuintz and Hoycraft, *20-th century authors*, New York, 1996
- Holman and Harman, *A handbook of Literature*, 1986
- Merh Licht*, Tiranë, maj 1998
- Catwona Picken, *The translator's Handbook*, 1989
- Roman Jacobson, *On Linguistics Aspects of Translation*, Oxford University Press, 1966



## Shtojca

IF

If you can keep your head when all about you  
Are losing theirs and blaming it on you  
If you can trust yourself when all men doubt you  
But make allowance for their doubting too  
If you can wait and not be tired by waiting  
Or being lied about, don't deal in lies  
Or being hated don't give way to hating  
And yet don't look too good, nor talk too wise.

If you can dream-and not make dreams your master  
If you can think-and don't make thoughts your aim  
If you can meet with Triumph and Disaster  
And treat those impostors just the same  
If you can bear to hear the truth you've spoken  
Twisted by knaves to make a trap for fools  
Or watch the things you gave your life to, broken  
And stop and build' em with worn-out tools

If you can make one heap of all your winnings  
And risk it on one turn of pitch-and-toss  
And lose and start again at your beginnings  
And never breathe a word about your loss  
If you can force your heart and nerve and sinew  
To serve your turn long after they are gone  
And so hold on when there is nothing in you  
Except the Will which says to them: "Hold on!"

If you can talk with crowds and keep your virtues  
Or walk with Kings-nor lose the common touch  
If neither foes nor loving friends can hurt you  
If all men count with you, but none too much  
If you can fill the unforgiving minute  
With sixty seconds' worth of distance run  
Yours is the Earth and everything that's in it  
And-which is more-you'll be a Man, my son!

by RUDYARD KIPLING

*Variant i parë i përkthimit*

## NË MUNÇ

Në munç të mbash në kokë terezinë  
Kur shokët çmenden dhe fajtor të nxijnë  
Në munç të kesh besim, kur të dyshon  
Kushdo, dhe s'ka njeri që të beson  
Në munç të preç, dhe pritjen s'e kursen  
Në të gënjejshin, ti nuk i gënjen  
Në të urrefshin, ti s'i çan me brirë  
Dhe s'hiqesh as m'i mënçëm, as më i mirë

Në munç të çndërrosh e të mejtos  
Dhe nga këto më mos u robërofsh  
Në munç të preç Triumfin dhe Hatanë  
Dhe t'i shkelmosh të dy dhe si kallpazanë  
Në munç të mbahesh, kur një dreq ta dredh  
Të drejtën dhe në lak syleshin heth  
Kur sheh kalan' e jetës të rrëzuar  
Dhe prap e ngre me veglën e çkallmuar

Në munç të vish mi grumbull çdo thesar  
Edhe t'i loç të gjitha me një zar  
T'i humpç edhe të nisësh përsëri  
Pa thën' asgjë për këtë batërdis  
Në munç të kesh një zemër, trup e kokë  
Që të shërbejnë sat ë bëhen trokë  
Dhe të vazhdosh i djegur shkrimp në furrë  
Dhe të thërret vullneti: "Mbahu, or burrë"

Në munç të zbreç në turm'e të mbash nderin  
Të hash me mbretin, të pish me neferin  
Në mos të ngaftë dot as mik as hasmë  
N'i daç të gjithë, po asnjë për dasmë  
Në munç për çdo minute të përpjetë  
Të renç tamam sekunda gjashtëdhjetë  
Zaptove dhenë me çdo mall dhe hir  
Dhe ca më mire, qenke trim, or bir!

## **Përkthyer nga FAN. S. NOLI**

*Marrë nga Merh Licht, Tiranë, 1998*

*Varianti i dytë i përkthimit*

## NË

Në s'humbsh toruan kur të gjithë rreth teje  
Humbur e kanë dhe thonë se ti ke faj  
Në paç besim tek vetja kur të tjerët s'kanë  
Tek ty edhe dyshimin'e tyre ti ua fal

Në prish edhe nga pritja të mos lodhesh  
Në të gënjejshin, ti mos i gënjesh  
Në të urrefshin, ti mos i urresh  
I urtë shumë, as shumë i mirë s'tregohesh

Në ëndërrofsh, por zot s'ke ëndërrimin  
Mendove dhe mendimet s'i ke si qëllim  
Në e takofsh Triumfin dhe Rënimin  
Të dy mashtruesve u jep të njëjtin çmim  
Duron kur e vërteta jote ndrydhet  
Nga horrat edhe lak bëhet për teveqelë  
Në pafsh atë ç'ke stisur që të thyhet  
Prap të ndërtosh me veglat bërë fertile

Në bëfsh një piring me çka ti ke fituar  
Dhe me rrezik t'i hedhësh çift a tek  
Dhe të humbaç dhe prap duke filluar  
Gojën ta qepësh përpara kur s'ke shtek  
Zemrën ti gur n'e bëfsh dhe nervat hekur  
Të të shërbejn' dhe kur të thonë: Jo!  
Dhe të qëndrosh asgjë kur s'të ka mbetur  
Përveç vullnetit që të thot': "Qëndro!"  
Në folç me turmën dhe të ruash nderin  
Me mbret të rrish, por cakun mos kalosh  
Kur as armiq, as miq s'ta duan sherrin  
Të gjithë kur ti do, por kurrë mos ta teprosh  
Në e mbuç minutën që nuk ta fal kurrë  
Me gjashtëdhjetë sekonda në vrapim  
I tokës zot je ti, çdo gjë atje është e jotja  
Dhe sidomos Njeri do jesh, o biri im!

### **Përkthyer nga VEDAT KOKONA**

*Marrë nga Merh Licht, Tiranë, 1998*

*Varianti i tretë i përkthimit*

### **NË MUND SH...**

Në mundsh ta ruash arsyen, kur bota humbet fillin  
E fajin ty ta hedh-dhe vetes t'i besosh  
Sa here tek ti dyshojnë e s'të përfillin  
Por edhe dyshimet drejt t'i gjykosh...  
Në mundsh të rrish në pritje, nga pritja pa u lodhur  
E kur t'urrejnë, urrejtje mos t'ushqesh  
Madje, ndaj shpifjeve të rrish pa folur  
Me thjeshtësi, me to pa rënë ndesh...

Në mundsh t'mendosh, por jo gjer në shkatërrim

Të ëndërrosh, por jo si rob ëndërrimesh  
Dhe t'i trajtosh njëlloj e pa dallim  
Ngadhënjim e shpartallim-burim mashtrimesh  
Në durofsh dot që thëniet e tua të drejta  
Në kurthe për truthtarët, kopukët të t'i kthejnë  
T'i shohësh gjërat më të shtrenjta  
E prapë t'i ndërtosh me vegla që nuk vlejnë...  
Në mundsh fitoret që ke korrur' t'i flijosh  
Si në kumar, në një të vetme lojë  
Të rrezikosh, të humbsh e prapë t'ia fillosh  
Dhe humbjen kurrë të mos e zësh në gojë...  
Në i detyrosh dot muskul, nerv e zemër  
Të të shërbejnë edhe kur gjithçka duket e kotë  
E të qëndrosh kur s'ke asgjë më veç vullnetit  
Që vetëm fjalën "Qëndro!" gjithmonë të thotë...

Në mundsh të flasësh me maskarenj, por nderin tënd ta ruash  
E të ecësh përkrah mbretit pa krenari që të verbon...  
Nëse armiku apo miku s'të bëjnë dot të vuash  
Dhe gjithkënd e çmon, por veç sa meriton...  
Në mundsh t'i mbushësh ti minutat aq të rënda  
Me vepra që peshojnë  
Dije dhe mos ki asnjë dyshim  
Se jotja do të jetë Bota, me ç'ka brenda  
Dhe Burrë do të jesh, o biri im!

### **Përkthyer nga ROBERT SHVARC**

*Marrë nga Merh Licht, Tiranë, 1988*

*Variant i katërt i përkthimit*

### **SIKUR**

Sikur t'mundsh ta ruash mendjen nga dergja dhe atëherë  
Kur krejt bota e çmendur fajin kopil ta lë pas dere  
Sikur t'mundsh t'i besosh vetes se ende ke burri e nder  
Kur krejt bota e flliqur hedh mbi ty rrena, bajga e vrer  
Sikur t'mundësh pritjen duke u mbajtur te shpresa  
A kur t'hedhin hi syve, t'hakmerresh duke shkrepur dita  
A kur t'kafshon urrejtja ta mëkosh dashurinë pa thersa  
E prap t'mos dukesh fort fisnik pleqnar i kamur n'urtina.

Sikur t' mundsh t'ngarkohesh deri n' qiell me flori dhe lavdi  
E për dy pika lot t'i humbasësh a t'ua vesh flakën  
T'mbetesh pa rrasë në diell, nga fillimi t'ia nisësh përsëri  
Pa t'shkuar ndërmend me than një gjysmë fjale për mandatën  
Sikur t'mund t'prehesh si yll n'krahët e punës sate për jetë  
Anipse t'u ka tha syri, dora, këmba, zemra, mendja

E pa u rrzuar t'ecësh buzë greminës ditën e terrtë  
T'i biesh lik përmyet tmerit pa u trembur hiç nga vdekja.

Sikur t'mund t'ëndërrosh pa u mbytur në gjumë edhe në ëndrra  
Sikur t'mund t'mendosh pa t'u robnuar truri edhe gjuha  
Sikur t'mund t'lundrosh mespërmes detit me gaz edhe brenga  
Pa t'u dehur shpirti e pa ta futur frigamën tuta  
Sikur t'mund ta kqyrësh t'vërtetën që the të shfityruar  
Kthyer në kurthe ku bataçiu kap me lak të marrët  
A t'përballosh rrënimin e veprës sate t'pruar  
E prap t'ngrihesh dhe pa barna t'ia mbyllësh mundit plagët.

Sikur t'mund t'rrosh me qenin pa mësuar të lehësh fliqimën  
Apo t'jetosh me luanin pa t'ardhur era egërsinë  
Sikur t'mund t'qeshësh faqe miqsh e armiqsh njëloj hijshëm  
Sikur t'mund t'i duash krejt njerëzit pa dreqni e pa tepri  
Sikur t'mund t'ia marrësh me vrap e djerse minutës shpirtin  
E sekondat e saj t'i kthesh në djepe punësh t'arrira  
Toka do t'jepet para teje e ka me ta dhanë gjirin  
Do të jesh NJERI, biri im, dhe kjo na qenka më e mira!

### **Përkthyer nga UKZENEL BUÇPAPAJ**

*Marrë nga Merh Licht, Tiranë, 1998*

*Variant i pestë i përkthimit*

#### **NË QOFTË SE**

Nëse do të ruash gjykimin kur të gjithë të tjerët e kanë humbur  
Dhe fajin për këtë ua hedhim juve  
Nëse do të mund të besosh kur gjithë dyshojnë në ju  
Bile t'u japësh edhe shkas dyshimi gjithashtu  
Nëse mund të presësh pa u lodhur nga pritja  
Apo të gënjesh pa gënjyer asnjë fjalë  
Ose të ndihesh i urryer ti vetë  
E megjithatë të mos dukesh as shumë i mirë, as shumë i zgjuar

Nëse do të mund të ëndërrosh pa e lënë ëndrrën të bëhet zot  
Nëse mund të mendosh, pa i bërë mendimet e tua qëllim  
Nëse mund të takosh triumfin pas disfatës  
E t'i presësh këto dy gënjeshtare me të njëjtën fytyrë  
Nëse do të dëgjosh të vërtetën e thënë prej teje  
Të shtrembëruar ligsht, sa bëhet lak për të marrët  
Ose të shohësh gjëra për të cilat jep jetën, të prishet para syve tu  
E me durim mund t'i riparosh ato.

Nëse do të humbasësh me një goditje  
Fitoren e 100 ndeshjeve

E pa bërë zë për humbjen, t'ia nisësh nga fillimi  
 Pa bërë asnjë gjest e asnjë psherëtimë  
 Nëse mund t'i detyrosh zemrën dhe nervat  
 Të të shërbejnë edhe kur ato kanë mabruar  
 Dhe të qëndrosh kur asgjë s'ka mbetur tek ju  
 Veç vullnetit që të thotë: "Mbahu!"  
 Nëse do të rrih me popull e të mbetesh i virtytshëm  
 Apo të këshillosh mbretërit e të mbetesh popull  
 Nëse as armiq të as miq të dashur s'ia dalin të prishin zemrën tuaj  
 Nëse do t'i duash të gjithë si vëllezër pa qenë asnjëri gjithçka për ty  
 Nëse do të shfrytëzosh minutën e rreptë  
 Me përkushtim të denjë-të artë  
 Atëherë mbretërit, fati dhe fitorja do të jenë skllëvërit e tu  
 Dhe ajo që vlen më tepër se mbretërit dhe lavdia ti do të jesh NJERI, o biri im.

### **Përkthyer nga DINO DINO**

*Marrë nga Merh Licht, Tiranë, 1988*

*Variant i gjashtë i përkthimit*

#### **NËSE**

Nëse ke forcë, gjykimin ta mbrojë pa cenim  
 Edhe kur bota e marrë të vesh me faje plot,  
 Që t'i zësh besë vetvetes se je fisnik e trim  
 Kur botë e tërë, e ndyra, me shpifje e llum të ndot!  
 Nëse do mposhtje pritjen, në shpresë mbështetur gjinë,  
 Hirit që të venë syve, dritën t'u vesh hakmarrje,  
 Kur dhëmbët ngul urrejtja, të ushqesh ti dashurinë,  
 Fisnik në urtësinë e moshës, prapë ti në mes të të parëve...

Me ar e me lavdi po të të veshte e mbara,  
 Pastaj t'i humbje krejt për një pikë lot viktime...  
 Të kthehesh lakuriq, t'ia nisësh nga e para  
 Pa patur kohë, që fatit t'i ngresh zë ulërime  
 Në gji të veprës tënde të prehesh si yll ari  
 Edhe kur mendja e zemra, tërë shqisat të jenë tharë,  
 Të çash te buzë e honit, sado në tmerr llahtari  
 Pa frikë se vdes, greminën ta çash si një i marrë!  
 Të thurrje ëndërrime, pa u mbytur në ëndrra gjumi,  
 Ta modulosh logjikën, pa u bërë rob i saj  
 Ngarkuar gaz e derte, dhe detit t'i gjesht fundin  
 E shpirti të rrijë shpirt dhe frika larg pastaj!  
 Ta shije të vërtetën që e shfaqje të përthyer  
 Një kurth, ku një kopuk buda llët kap në lak  
 A t'i shoq rënien veprës, që e ngrite të shkëlqyer  
 Dhe plagët, pa ilaç, ti vetë t'i shërosh prapë  
 Sikur me qen të rroje, pa lehur ndyrë si qeni

Të rroje me luanin pa pasur erë bishe;  
Qeshjen ndër miq e armiq si mjahtë njëlloj të keni  
Njerëzit njëlloj t' i donit, pa vese e pa qejfprishje!  
Ta shtrydhje fort minutën sa shpirti t' i këputej  
T' ia ktheje vepër arti sekondat që ajo ka-  
Globi në gjuhë do t' i ulej- pi gjirin tim, do lutej!  
O bir, qenke Njeri me gërma të mëdha.

**Përkthyer nga AGIM SHEHU**

*Marrë nga vëllimi "Brilantë të shekujve", Tiranë, 1997*

# DY FJALË PËR JORGOS SEFERISIN

Dion Tushi

Departamenti i gjuhës dhe letërsisë shqipe, Fakulteti i Mësuesisë dhe Filologjisë  
Universiteti “Fan S. Noli” Korçë

## Përmbledhje

Jorgos Seferis u lind në Izmir të Azisë së Vogël, në vitin 1900. Ai ndoqi studimet elementare në Izmir, ndërsa ato të mesme i përfundoi në Athinë. Kur familja e tij u zhvendos në Paris në vitin 1918, Seferis studioi për jurisprudencë në Universitetin e Parisit, por ndërkohë tregoi interes edhe për letërsinë. Kthehet në Athinë në vitin 1925 dhe pranohet në Ministrinë Mbretërore Greke të Punëve të Jashtme në po këtë vit. Ky ishte fillimi i një karriere të gjatë dhe të suksesshme diplomatike, gjatë së cilës ai mbajti poste në Angli (1931-1934) dhe në Shqipëri në Korçë (1936-1938). Vëllimi i tij i parë poetik titullohet “Kthesa”, botuar në vitin 1931, ku ndihet ndikimi i simbolizmit, për të vazhduar më pas me vëllimin poetik “Sterna” (Çisterna), botuar në vitin 1932, ku përcjell imazhin e njeriut të shpërfillur nga shoqëria, i cili injorohet nga bota e përditshme. Poezia e tij më cilësore fillon me vëllimin poetik “Mythistorima” (Përralla), botuar në vitin 1935, e cila përbëhet prej një seri prej njëzetekatër poezish të shkurtra me temë mitologjike, të cilat janë një idiomë e njeriut modern. Më pas ai nxjerr vëllimet e tij poetike në “Tetradio Gymnasmaton” (Libri i Ushtrimeve) 1940, “Eimerologio Katastromatos” (Ditar Udhëtimi I) 1940, “Eimerologio Katastromatos B” (Ditar Udhëtimi II) 1944, dhe “Eimerologio Katastromatos C” (Ditar Udhëtimi III) 1955. Seferisi në këto vëllime poetike përdor gjerësisht simbolikën mitologjike dhe sidomos figurën e Odisesë së Homerit. “Ditar udhëtimi”, konsiderohet nga shumë kritikë si vëllimi i tij më i mirë poetik. Libri i fundit poetik i tij është vëllimi poetik, “Tria Krypha Poimata” (Tri Ppoezi Sekrete) 1966, e cila përmbledh njëzetetete copa lirike të shkurtra, ku ai paraqitet si poet surrealist.

Gjithashtu Seferisi ka botuar një libër me ese të titulluar “Sprova”. Në vitin 1962, përkthen në greqisht Tomas Eliotin, si dhe një koleksion nga poetët më të mirë amerikanë, anglezë dhe francezë, në një antologji poetike të titulluar “Kopime”

**Fjalë Çelës:** Jorgos Seferisi, diplomat, poet, Korçë, mitologji.

## Abstract

**Giorgos Seferis** was born in Smyrna, Asia Minor, in 1900. He attended school in Smyrna and finished his studies at the Gymnasium in Athens. When his family moved to Paris in 1918, Seferis studied law at the University of Paris and became interested in literature. He returned to Athens in 1925 and was admitted to the Royal Greek Ministry of Foreign Affairs in the following year. This was the beginning of a long and successful diplomatic career, during which he held posts in England (1931-1934) and Albania, Korçë (1936-1938).

His wide travels provided the backdrop and colour for much of Seferis's writings, which are filled with the themes of alienation, wandering, and death. Seferis's early poetry consists of *Strophe* (Turning Point), 1931, a group of rhymed Lyrics strongly influenced by the Symbolists, and *E Sterna* (The Cistern), 1932, conveying an image of man's most deeply felt being which lies hidden from, and ignored by, the everyday world.



His mature poetry, in which one senses the awareness of the presence of the past and particularly of Greece's great past as related to her present, begins with *Mythistorema* (Mythistorema), 1935, a series of twenty-four short poems which translate the Odyssean myths into modern idiom. In *Tetradio Gymnasmaton* (Book of Exercises), 1940, *Emerologio Katastromatos* (Logbook I), 1940, *Emerologio Katastromatos B* (Logbook II), 1944, *Kihle* (Thrush), 1947, and *Emerologio Katastromatos C* (Logbook III), 1955, Seferis is preoccupied with the themes he developed in *Mythistorema*, using Homer's Odyssey as his symbolic source. The recent book of poetry, *Tria Krypha Poimata* (Three Secret Poems), 1966, consists of twenty-eight short lyric pieces verging on the surrealist.

In addition to poetry, Seferis has published a book of essays, *Dokimes* (Essays), 1962, translations of works by Tomas Eliot and a collection of translations from American, English, and French poets entitled *Antigrafes* (Copies), 1965.

**Key words:** George Seferis, diplomat, poet, Korçë, mythology.

**Hyrje:** Në këtë punim synohet që të krijohet një ikonë sa më e plotë e veprës poetike të poetit të madh nobelist grek Jorgos Seferis. Përveç të dhënave biografike të cilat na ndihmojnë në një perceptim më të plotë të mendimit të tij poetik, në këtë punim renditim vëllimet e tij poetike me të dhëna përkatëse për secilën prej tyre. Gjithashtu, vihet në dukje kontributi i Seferisit si përkthyes, por edhe si diplomat, ku jepen mbresa dhe perceptime të tij në lidhje me Korçën dhe me qëndrimin e tij në këtë qytet.

### **Dy fjalë për Jorgo Seferisin**

Jorgos Seferiadhis, apo Jorgos Seferis siç do të njihet më vonë poeti i shquar nobelist grek, lindi në Urla, pranë Izmirit, në vitin 1900. Në vitin 1914, familja e tij vendoset në Athinë. I ati i tij Stelios Seferiadhis, ishte një ndër profesorët e dëgjuar të së Drejtës Ndërkombëtare të Fakultetit Juridik në Universitetin e Athinës. Jorgos Seferisi në vitin 1918 shkon në Paris, ku studion për Drejtësi në Universitetin e Sorbonës. Në vitin 1925, fillon punë si diplomat në Ministrinë Mbretërore të Punëve të Jashtme të Greqisë. Para luftës së Dytë Botërore, ai dërgohet nga Ministria e Jashtme Greke në Angli dhe Shqipëri, si konsull i përgjithshëm në Konsullatën e Korçës. Gjatë luftës shkon me Qeverinë e Lirë Greke, në Egjipt, në Afrikën e Jugut dhe në Itali. Mbas luftës, shërben me detyrën e diplomatit, në Londër, Liban dhe Siri. Megjithëse ka qenë një diplomat i shquar kariere, ai njihet si një ndër poetët më të mëdhenj të Greqisë dhe botës. Vargjet e tij filluan të njihen dhe të vlerësohen jashtë Greqisë qysh herët, ndërsa mbas marrjes së çmimit "Nobel" në Letërsi, në vitin 1963, me motivacionin...*për shkrimet e tij të shquara lirike, të frymëzuara nga një ndjenjë e thellë për botën helenike të kulturës...*, atë e njeh e gjithë bota. Kritika greke dhe ajo botërore kanë shkruar mjaft për të. Përkthyesit Edmund Keely dhe Philip Sherrar, në një botim të përbashkët, në parathënien e një vëllimi të plotë poetik me poemat e Jorgos Seferis, të përkthyer në gjuhën angleze dhe botuar në vitin 1955, e karakterizuan atë: "si gjenin e aftë për të shndërruar një politikë lokale, një histori personale, apo mitologjike në një deklamacion artistik, apo në një metaforë"<sup>32</sup>.

---

<sup>32</sup> Keely E. & Sherrar Ph. Collected Poems, 1955.

Në formimin e tij letrar një rol të rëndësishëm luajti poezia moderne frënge e fillimit të shek. XX, me të cilën ai u njoh gjatë kohës së studimeve të tij në Paris. Kështu në vëllimin e tij të parë poetik “Στροφή”<sup>33</sup> (Kthesa), botuar në vitin 1931, ndihet ndikimi i simbolizmit frëng, sidomos, ai i poetëve Mellarme, Rembo, dhe Huysman. Poeti i madh klasik grek Kostis Pallamas, mbas botimit të këtij vëllimi, e quan Seferisin si një shpresë të vërtetë të poezisë dhe botimin e tij e cilëson si një kthesë në poezinë greke. Në vitin 1932, J. Seferis boton poemën e tij alegorike (Στέρνα)<sup>34</sup> (Çisterna), frymëzimin për këtë poemë, të cilën ia kushton mikut të tij Jorgos Apostolodhis, ja jep njohja me koleksionin e veprave të piktorit të famshëm grek Domenikos Theotokopoulos, i njohur me emrin El Greko. Kjo poemë dallohet për frymën e saj të veçantë, që buron prej humanizmit ekzistencial, ndoshta këtu duhet kërkuar shpjegimi i simbolikës së kësaj poeme, që karakterizohet si një produkt gjenial i vetvetishëm, ku pasqyrohet përvoja e një jete konkrete. Në këtë poemë të Seferisit bëhet fjalë për botën e brendshme të njeriut, që jeton i fshehur, i braktisur dhe i shpërfillur nga shoqëria, këtu poeti aludon për peshën e boshllëkut, motiv i cili trajtohet në mënyrë të veçantë në vitet 40 të shekullit XX. Edhe nga shkrimtarët ekzistencialistë frëngë si Sartri, Zhide dhe Kamy<sup>35</sup>. Kritikët dhe studiuesit që janë marrë në mënyrë të vazhdueshme me poezinë e J. Seferisit, janë të mendimit se poezia e tij më cilësore fillon me vëllimin poetik “Μυθιστόρημα”<sup>36</sup> (Përrallë), botuar në vitin 1935, ky vëllim përbledh 24 poema të vogla, të cilat kanë për bazë dhe për subjekt Mitin e Odisesë, por që janë në vetvete një alegori dhe një idiomë bashkëkohore. Në vitin 1940 botohet vëllimi poetik i tij “Το Τετράδιο των Γυμνασμάτων”<sup>37</sup> (Fletorja e Ushtrimeve), ndërsa më pas në harkun kohor 1940 – 1955 boton, “Ημερολόγιο Καταστροφάτος, Α, Β, Γ.”, vëllimet poetike, 3 Ditaret e Bordit I, II, III., prej të cilëve, ai i pari “Ημερολόγιο Καταστροφάτος Α”<sup>38</sup>, konsiderohet prej kritikës si vepra e tij më e mirë poetike.

Mbas vitit 1955, Seferisi lëvront poezinë me temë mitologjike, duke përdorur kryesisht Odisenë e Homerit si burim të simbolizmit të tij. Në vitin 1966, ai boton veprën tjetër poetike të tij “Τα Τρία Μυστικά Ποιήματα”<sup>39</sup> (Tri Poemat e Fshehta), e cila përbëhet prej 28 poemash të vogla, dhe që e tregojnë Seferisin si një poet te sukseshëm surrealist.

Seferisi konsiderohet një poet modern që me vargun e tij emancipoi poezinë greke bashkëkohore, vargu i tij pavarësisht toneve dramatike dhe pesimiste, mbart në vetvete potencialin e besimit tek jeta, kjo gjë i jep në tërësi veprës së tij një frymë të veçantë humaniste. Vetë poeti në fjalën e tij të mbajtur para Bashkisë së Stokholmit, si laureat i çmimit “Nobel” për Letërsinë, në vitin 1963, e pohon këtë, kur midis të tjerash, duke shprehur kredon e vet poetike thotë: “Në botën tonë gjithnjë më të ngushtë, secili ka nevojë për të gjithë të tjerët. Ne duhet që ta kërkojmë njeriun kudo që mund ta gjejmë. Kur gjatë rrugës për në Tebë, Edipi takon Sfinksin, përgjigjia e tij për enigmën e Sfinksit

<sup>33</sup> Σεφέρης Γ. «Στροφή», Αθήνα 1931.

<sup>34</sup> Σεφέρης Γ. «Στέρνα», Αθήνα 1932.

<sup>35</sup> Tushi D. Letërsia e Huaj e Shekullit të XX, fq. 45. Korçë 2012.

<sup>36</sup> Σεφέρης Γ. «Μυθιστόρημα», Αθήνα 1935.

<sup>37</sup> Σεφέρης Γ. “Το Τετράδιο των Γυμνασμάτων”, Αθήνα 1940.

<sup>38</sup> Σεφέρης Γ. “Ημερολόγιο Καταστροφάτος Α”, Αθήνα 1953.

<sup>39</sup> Σεφέρης Γ. “Τα Τρία Μυστικά Ποιήματα”, Αθήνα 1966.

ishte: “Njeriu”. Kjo fjalë e thjeshtë shkatërroi përbindëshin. Sot kemi shumë përbindësja për të shkatërruar. Të mendojmë për përgjigjen e Edipit.”<sup>40</sup>

Të bën përshtypje se mitologjia, ashtu siç e thamë, zë një vend të rëndësishëm në krijimtarinë e tij, dhe kjo për arsye se Seferisi ishte i mendimit se poezia popullore pra dhe mitologjia si forma më e hershme e saj, ka qenë ajo që ka ringjallur në momentet kapërcyell poezinë greke të kultivuar, në çdo periudhë të historisë së zhvillimit të saj, pasi, sipas tij, vetëm tek tradita orale ruhet në formën më autentike shpirti i ripërtëritjes i popullit grek, larg purizmit, kultivimit dhe intelektualizmit, me pak fjalë, “majaja” e krijimtarisë së vërtetë. Sipas tij, krijimtaria popullore, ka qenë një traditë e pandërprerë gojore që është mbartur në shekuj dhe i është dhënë më pas pararendësve të letërsisë greke moderne, si Dionisis Solomos, Kostis Pallamas etj., të cilët pasi kanë krijuar me “majanë” e marrë prej saj, kanë ditur ta përçojnë atë në poetët bashkëkohorë, grekë, me të cilët ata kanë ngjizuar letërsinë bashkëkohore greke, një përfaqësues i shquar i të cilëve ka qenë edhe vetë poeti.

Përveç poemave, Seferisi ka botuar në vitin 1962 edhe një libër me ese, të titulluar “Δοκίμια”<sup>41</sup> (Sprova). Gjithashtu përveç poezive të poetit francez Valery, ai ka përkthyer në gjuhën greke edhe poezitë e Tomas S. Eliotit, poetit të tij më të dashur. Sipas shkrimtarit Dritëro Agolli<sup>42</sup>, Tomoas S. Elioti ka qenë ndër poetët që ka ndikuar më tepër tek Seferisi, prej të cilit ai, (Seferisi) mori, asimiloi dhe bëri të tijat dy gjëra kryesore, vargun e lirë biblik dhe konceptimin e botës si një tërësi në një vazhdimësi të pandërprerë. Gjithashtu Seferisi ka përkthyer në gjuhën greke, një koleksion të pasur nga poezia më e mirë amerikane, angleze dhe franceze, të botuar në vitin 1965 me titullin “Αντίγραφα” (Kopje).

Jorgos Seferis u nderua dhe u vlerësua prej shumë institucioneve prestigjioze ndërkombëtare, qysh kur ishte gjallë, kështu ai u zgjodh anëtar nderi i Akademisë Amerikane të Arteve dhe Shkencave, si dhe anëtar nderi i Shoqatës së Gjuhës Modrene. Ai u nderua me titullin doktor nderi (Honoris Causa), nga Universiteti i Kembrixhit (1960), nga Universiteti i Oksfordit (1964), nga ai i Selanikut (1964), si dhe nga Universiteti Princeton (1965). Vdes në 20 Shtator të vitit 1971.

Një poet si ai, së bashku me poetët e njohur grekë, Kavafis, Ricos, Sarandaris, Baras, Kavadhias, Elitis etj., përbën një dëshmi të pakontestueshme se Greqia vazhdon të mbetet si edhe në lashtësi, vendi më i madh poetik. Ndoshta këtë gjë ka patur parasysh edhe sekretari i atëhershëm i Akademisë Suedeze, Andres Osterling, kur mbasi deklaroi vendimin e 18 anëtarëve të Akademisë, që çmimi Nobel për Letërsinë ti jepej poetit grek Jorgos Seferis, shtoi se: “Letërsia e Greqisë moderne, e ka pritur mbase prej shumë kohësh kurorën e dafinave”<sup>43</sup>.

Në Shqipëri vendi që lidhet më tepër me emrin e Jorgos Seferisit është pa dyshim qyteti i Korçës, ku për një interval kohor prej mëse një viti, poeti nobelist i mëvonshëm ka jetuar me idiomën e diplomatit. Pa dyshim që qëndrimi i tij këtu la gjurmë në jetën dhe krijimtarinë e tij, kjo edhe për faktin se kjo periudhë është një periudhë vuajtjesh të brendshme dhe përsiatjesh për të, pasi lidhet me largimin e detyruar të tij prej Maros,

<sup>40</sup> Spahiu A. Nobelistët e Letërsisë, fq. 529, Universiteti i Tetovës 2007.

<sup>41</sup> Σεφέρης, Γ. «Δοκίμια», Αθήναι 1962.

<sup>42</sup> Jorgoni N. Seferis, fq 7, Albin 1996.

<sup>43</sup> Κόντη Σ. «Οι σοκολάτες του Σεφέρη», fq. 188, Θεσσαλονίκη 2011.

gruas që aq shumë shënoi dhe tronditi botën e tij si njeri dhe poet. Ndoshta dhe ky largim nga Athina në postin e konsullit në Korçë, i dedikohej përpjekjeve të atit të tij për ta detyruar atë që të heqë dorë prej kësaj gruaje të ndarë me dy fëmijë, por kaq të rëndësishme për të. Në këto rrethana aspak optimiste, ai largohet nga Athina natën e 15 Nëntorit të vitit 1935, dhe të nesërmen nëpërmjet rrugës hekurudhore Athinë – Follorinë dhe më pas që andej nëpërmjet rrugës automobilistike mbërrin në qytetin e Korçës. Veçanërisht e pasur është në këtë kohë korrespondenca e tij me dashurinë e tij të jetës Maron, së cilës i shkruan në mënyrë të vazhdueshme për ekskursionet që ai zhvillon në fshatrat përreth Korçës, sidomos në Drenovë dhe Mborje, për vizitat në shtëpitë e miqve të rinj që bën etj. Ndërkohë ai vazhdon të shkruajë, në ditarin e tij personal, bile bën edhe poezi.

Kështu ai shkruan në varg të lirë: Το ζεστό νερό μου θυμίζει κάθε πρωί/ πως δεν έχω τίποτε ζωντανό κοντά μου. Uji i nxehtë çdo mëngjes më kujton/ Se as ndonjë të gjallë afër meje nuk kam. Këto vargje i shënojmë jo aq për të evidentuar vetminë që ai ndiente larg atdheut dhe të dashurës së tij, por për të treguar se si një traditë e hershme e këtij qyteti, sipas së cilës për të shprehur dashurinë për të vdekurit, të afërmit duhet që të ujitnin çdo mëngjes varrin e tyre me ujë të ngrohtë, bëhet objekt i poezisë së tij, duke hyrë në fondin poetik të nobelistit. Seferisit i bëjnë përshtypje malet që e rrethojnë qytetin dhe ndërkohë ato ja shtojnë melankolinë. Mendojmë, se ndoshta ai ka parasysh pozicionin gjeografik të Korçës, kur shkruan në një poezi të tij: Ο τόπος μας είναι κλειστός, ολο βουνά/ που έχουν σκεπή τον γαλανό ουρανόέρα γιαέρα. Vendi ynë është i mbyllur, tërë male/ që qiellin e kaltër tej për tej kanë për strehë. Pothuajse përnatë ai i shkruan Maros për impresionet dhe aktivitetin e tij. Kështu, njëherë i përshkruan përshtypjet e tij për liqenin e Poradecit, mbas një ekskursioni atje, ku uji i liqenit dhe një varkë e vetmuar në sipërfaqe i ngjasojnë atij me Detin e Vdekur. Një herë tjetër i flet asaj për dimrin e Korçës, për dëborën e bardhë si dhe për gratë dhe vajzat e veshura shik me palltot dhe pelicet e tyre. Në këtë periudhë Korça ka tre konsullata, përveç asaj greke, ka një konsullatë italiane dhe një jugosllave. Nga shënimet e Seferit, del se të tre konsujt së bashku me disa profesorë të Liceut Frances të qytetit, mbledheshin herë pas here për ti kaluar mbrëmjet në shoqërinë e njëri - tjerit. Ndërsa Seferisi shkruan për ta në ditarin e tij: “Τάλλοι καθηγητές του Λυκείου, λες πως τους έστειλαν εδώ για να τους ξεφορτωθούν, ώσπου να τους φορτωθούν οι Αρβανίτες που τους κατηγορούν ότι φτιάχνουν κομμουνιστές.”<sup>44</sup> (Profesorët francezë të Liceut, thua se i kanë dërguar këtu për ti hequr qafe, derisa ti heqin qafe Arvanitët (shqiptarët), që i akuzojnë se krijojnë komunistë).

Konsulli i përgjithshëm Jorgos Seferiadhis, qëndroi në Korçë një vit, deri në fund të vitit 1937. Ky vit ishte tepër produktiv për të, qoftë në punën e përkushtuar të tij si diplomat, qoftë edhe në përjetime dhe shkrime, kështu në 22 Nëntor të këtij viti ai shkruan në ditarin e vet: “Εμειναν και τούτα από τις Κορυτσίες προσπάθειές μου. Για καλό ή κακό δεν το ξέρω. Ωστόσο τώρα που προετοιμάζομαι για μια καινούργια στροφή, λυπούμε που και τούτη η δουλειά κόπηκε στα μισά. Η Κορυτσα με πότισε πίκρες και φαρμάκια, άλλα μου πρόσφερε και λίγες ήσυχες ώρες. Ας είναι.”<sup>45</sup> (Mbetën dhe këto (nënkupton shkrimet e tij dhe poezitë) nga përpjekjet e mija në Korçë. Për mirë apo për keq nuk e di. Ndërkaq tani që po parapërgatitem për një kthesë të re, më vjen keq që kjo

<sup>44</sup> Κόντη Σ. Οι σοκολάτες του Σεφέρη, σελ. 87, Θεσσαλονίκη 2012.

<sup>45</sup> Σεφέρης Γ. « Το ημερολόγιο του Σεφέρη », fq 78. Αθήνα 1992.

punë mbeti në mes. Korça më ujiti me hidhërime dhe helme, por më ofroi dhe pak momente të qeta. Kështu). Nga poezitë e bëra në Korçë, përmendim poemën “Dy fjalë për verën”, të botuar në përbledhjen poetike “Fletorja e Ushtrimeve” dhe poemën “Mathios Paskalis në mes të trëndafilave”, botuar në vëllimin poetik “Ditari i Bordit I”. Poezi që karakterizohen nga doza të forta melankolie, trishimi dhe vetmie.

Ky poet i madh është bërë i njohur gjatë gjysmës së dytë të shekullit XX, edhe për lexuesin shqiptar, poezi të tij janë përkthyer dhe janë futur në antologji, si dhe janë botuar në gazetën “Drita”, nga poetë në zë dhe përkthyes, një koleksion më i plotë i poezive të tij është dhënë në shqip nga përkthyesi Perikli Jorgoni 1996, janë përkthyer vjersha të tij nga Niko Kacalidha 2012<sup>46</sup>, si dhe nga përkthyes të tjerë.

Gjithsesi poezia e Seferisit, lloji i vargut, elementi simbolik, karakteri surrealist që shoqërohet shpesh nga një frymë e lehtë hermetike e bëjnë disi të vështirë për t’u dhënë pa shumë firo në një gjuhë tjetër, kështu që edhe në gjuhën shqipe ndoshta do të ketë edhe variante të tjera përkthimore, nëpërmjet të cilave lexuesit do të mundën t’i afrohen akoma më tepër poezisë së Seferisit.

## Referencat

- Σεφέρης Γ. «Στροφή», Αθήνα, 1931.  
Σεφέρης Γ. «Στέρνα», Αθήναι, 1932.  
Σεφέρης Γ. «Μυθιστόρημα», Αθήναι, 1935.  
Σεφέρης Γ. “Το Τετράδιο των Γυμνασμάτων”, Αθήναι, 1940.  
Σεφέρης Γ. “Ημερολόγιο Καταστήματος Α”, Αθήναι, 1953.  
Σεφέρης Γ. “Τα Τρία Μυστικά Ποιήματα”, Αθήναι, 1966.  
Σεφέρης Γ. «Δοκίμια», Αθήναι, 1962.  
Σεφέρης Γ. «Το ημερολόγιο του Σεφέρη », fq 78. Αθήνα, 1992.  
Κόντη Σ. Οι σοκολάτες του Σεφέρη, σελ. 87, Θεσσαλονίκη, 2012.  
Keely E. & Sherrar Ph. Collected Poems, 1955.  
Jorgoni N. Seferis, fq 7, Albin, 1996.  
Kacalidha N. Legjendë, Tiranë, 2012.  
Tushi D. Letërsia e Huaj e Shekullit XX, fq. 45. Korçë, 2012.  
Spahiu A. Nobelistët e Letërsisë, fq. 529, Universiteti i Tetovës, 2007.

---

<sup>46</sup> Kacalidha N. Legjendë, Tiranë 2012.

# SENTIMENTALIZMI SI DREJTIM I VONUAR LETRAR, NË LETËRSINË SHQIPE, PËRMES PROZËS SË GRAMENOS

**Jonela Spaho**

Departamenti i gjuhës dhe letërsisë shqipe, Fakulteti i Mësuesisë dhe Filologjisë  
Universiteti “Fan S. Noli” Korçë

## **Përmbledhje**

Siç dihet prej historisë së letërsisë shqiptare, fillimet e prozës së gjatë shqipe janë të vona. Gjithashtu, është pranuar prej studiuesve të letërsisë shqipe se fillimet e kësaj proze, tek ne, janë të natyrës sentimentaliste. Tiparet sentimentaliste në prozën e viteve të fundit të shek. XIX, dhe në dy dekadat e para të shek. XX, ishin sunduese. Ardhja e vonuar e sentimentalimit në letrat shqipe nuk është paradoks, por një fenomen që vërteton se proceset letrare shfaqen vetëm kur bëhen të domosdoshme nga zhvillimet sociale. Proza jonë e sapolindur, nuk mund të fitonte menjëherë tipare realiste, që kërkonin nivel dhe botëkuptim të lartë artistik, për atë kohë. Në mungesë të një tradite, prozës sonë të parë i vinin më për shtat tiparet sentimentaliste. Prozatorët tanë sentimentalistë, e mes tyre dhe Gramenoja, do të shpreheshin në veprat e tyre për një mohim të moralit regresiv dhe do të shprehnin konceptet e para, ende të pakonturuara mirë, të një mënyrë të re të organizimit të shoqërisë shqiptare, që sapo kishte shpëtuar nga një prej robërive më të gjata dhe më famëkeqe në botë. Në novelat e Gramenos vëmë re, dukshëm, përkime me kërkesat estetike të programit të sentimentalistëve si: kulti i ndjenjës (rreth ndjenjës së dashurisë janë të organizuara të gjitha subjektet e novelave të Gramenos), lotët të cilët janë reagim i drejtpërdrejtë i personazheve për të shprehur botën e tyre shpirtërore, vdekja si element që shfaqet shpesh në novelat e tij, shprehja e mendësisë së shtresës së tretë dhe simpatisë për të, pasi pjesa më e madhe e personazheve të Gramenos vijnë prej kësaj shtrese, etj. Është e natyrshme që në novelat e Gramenos të ketë dhe shmangie nga sentimentalizmi, sepse në ato vite proza jonë filloi të shfaqte edhe tipare realiste, por ne e vlerësojmë këtë autor sepse në mënyrë të dukshme transmetoi, në mënyrë origjinale, drejtimin e vonuar letrar të sentimentalizmit në rrjedhat e letërsisë shqipe.

**Fjalët kyçe:** prozë e gjatë, sentimentalizëm, romantizëm, realizëm, kulti i ndjenjës, psikologjizëm, mendësi.

## **Abstract**

As it is known from the history of the Albanian literature, the beginnings of the Albanian prose are very late. At the same time, it is accepted by the Albanian scholars that the beginnings of this kind of prose, are of the sentimentalist nature. The sentimentalist features are to be found in the prose of the last years of the XIX-th century, and during the two first decades of the XX-th century. The arrival of the sentimentalism in the Albanian literature is not a paradox, but a phenomenon which acknowledges that the literary processes come out only at the time when they become a necessity of social developments.

The newly born Albanian prose, could not gain realistic features immediately, which required high artistic level and view point. Having a lack of such tradition, our long

prose at the beginning, needed and suited much better the sentimentalist features. The long novel writers, and among them, M. Grameno as well, would point out in his works a deny of the regressive moral and would show the first concepts, yet, not well defined, of a new way of managing the Albanian society, which had just escaped from one of the longest and wrecked robbery in the world.

We can easily notice in Grameno's novels, lots of similarity to the esthetic requirements of the sentimentalists such as: the sentimentalist feeling (especially that of love are well organized), the tears that are to be found everywhere are the straightforward rejection of the characters that they tried to express and their inner spiritual world, death as an element which appears very often in his novels; his expression of sympathizing the third category of the society, as the majority of his characters in his works come out of this sort of social class. It is natural the fact that in his novels Grameno has very often deviate from sentimentalism because in those years our prose began to show even some realistic features, however we do appreciate this author because very obviously transmitted, in his original way, the late literal direction of sentimentalism in the Albanian literature.

**Key words:** Long prose, sentimentalism, romantism, realism, the inner feeling, psychology, new thinking.

## **Hyrje**

Në këtë punim do të trajtohet një aspekt i veçantë, ai i ndikimeve sentimentaliste në letërsinë shqipe përmes prozës së gjatë të Mihal Gramenos. Studiuesit e letërsisë shqipe janë të mendimit se fillimet e prozës së gjatë shqipe janë të natyrës sentimentaliste dhe kjo vërehet qartë te disa autorë të saj, e veçanërisht te proza e gjatë e Gramenos. Duke marrë në konsideratë novelat e Gramenos dhe duke i krahasuar me programin estetik dhe artistik të sentimentalistëve, kemi evidentuar disa pika takimi si: kulti i ndjenjës, reagimi i personazheve nëpërmjet lotëve, për të shprehur dëshpërimin, vdekja, shprehja e mendësisë së shtresës së tretë etj. Në këtë mënyrë Gramenoja cilësohet si një autor që solli përmes novelave të tij drejtimin e vonuar letrar të sentimentalizmit në letërsinë shqipe.

### **1. Pse sentimentalizmi ishte një drejtim letrar i vonuar në letërsinë shqipe?**

Vitet 1903-1909 nuk janë vetëm harku kohor që shënon kohën kur Gramenoja do të shkruante rrëfimet e veta artistike, të cilat ai, çuditërisht, i quante romane dramatike, por njehohësisht, kjo përkon dhe me fillimet e prozës artistike shqiptare. Gjithçka trashëguan letrat shqipe deri atëherë, në fushën e rrëfimit, nuk ishin gjë tjetër veçse sprova rrëfimtare, të cilat përshfaqnin një prozë të brishtë, të thjeshtë deri në naivitet, me temat e njohura ku gërshetoheshin dy dashuritë: ajo për njeriun dhe ajo për atdheun, një prozë kjo, që po formësohej dalëngadalë me rrënjët e saj, që ushqeheshin prej tokës ku u mbështet letërsia e Rilindjes Kombëtare.

Është pranuar, përgjithësisht, prej studiuesve se fillimet e prozës shqipe ishin të natyrës sentimentaliste. Sentimentalizmi, sigurisht, që nuk erdhi i formësuar si drejtim, me një platformë të përpunuar estetike, artistike dhe filozofike, siç ndodhi në letërsitë europiane. Ndryshe nga këto letërsi, ku drejtimi letrar i sentimentalizmit përgatiti romantizmin, në letrat shqipe ndodh e kundërta: zhvillohet romantizmi dhe pas tij shfaqen tipare të theksuar të sentimentalimit në prozë. Pse ndodh kjo thyerje e proceseve letrare?

Natyrisht mund të sillen shumë argumente kulturore, kontekstuale dhe letrare, por më kryesorja është se proza jonë, në fëmijërinë e saj nuk mund të ishte ndryshe, veçse e natyrës sentimentaliste. Për të sqaruar më mirë këtë argument, përmbledhtazi duhet të ndalemi në një përcaktim historik, kulturor dhe letrar të sentimentalizmit, si drejtim që lindi për herë të parë në gjysmën e parë të shekullit të 18-të, në Angli. I njohur dhe si pararomantizëm, ai u quajt kështu pas botimit të romanit të Lorenc Stërnit: "Një udhëtim sentimental nëpër "Francë dhe Itali". Jo thjesht nga titulli i librit, por dhe në përmbajtje, emërtimi sentimentalizëm i përshtatet plotësisht drejtimit letrar të kësaj kohe, përfaqësuesit e të cilit, shpallën që në fillim kultin e ndjenjës, si kundërpeshë me neoklasizmin dhe prirjet realiste të iluminizmit. Duke patur për bazë idealizmin subjektiv të Berklit dhe Hjumit, ai erdhi si pasojë e acarimit të kontradiktave në shoqërinë borgjeze të kohës pas revolucionit, prandaj pesimizmi, dëshpërimi, prirja për t'i kundërvënë idesë utopike të ndërtimit racional të botës, kultin e ndjenjës, u bënë fryma zotëruese e tyre. Ai ndikoi në zhvillimin e romanit dhe forcoi më tej disa elemente realiste, përsosi mjete e analizës psikologjike të personazhit duke i përgatitur kështu rrugën romantizmit.

Ndërsa tek ne, romantizmi ishte drejtimi i vetëm që arriti të formësohej dhe zhvillohej plotësisht, në të njëjtën kohë kur ai lindi dhe u zhvillua edhe në letërsitë europiane, por, natyrisht, me origjinalitetin e vet që varej, më së shumti, nga pritshmëritë e periudhës historike nëpër të cilën po kalonte Shqipëria aso kohe. Tiparet sentimentaliste në prozën e viteve të fundit të shek. XIX, e në dy dekadat e para të shek. XX, ishin sunduese. Ardhja e vonuar e sentimentalimit në letrat shqipe nuk është paradoks, por një fenomen që vërteton se, proceset letrare shfaqen vetëm kur bëhen të domosdoshme nga zhvillimet sociale. Proza jonë, e sapolindur, nuk mund të fitonte menjëherë tipare realiste, që kërkonin nivel dhe botëkuptim të lartë artistik, për atë kohë.

Në mungesë të një tradite, prozës sonë të parë i vinin më për shtat tiparet sentimentaliste. Për mendësinë botëkuptimore të asaj kohe, shkrimtarët që do të shkruanin në prozë, kundërvënien ndaj shoqërisë së prapambetur feudale do ta shprehnin përmes patosit dhe ndjenjave të fuqishme e të pastra, që më së shumti gjendeshin tek njerëzit e thjeshtë, si bartës të virtyteve. Prozatorët tanë sentimentalistë, e mes tyre dhe Grameno, do të shpreheshin në veprat e tyre për një mohim të moralit regresiv dhe do të shprehnin konceptet e para, ende të pakonturuara mirë, për një mënyrë të re të organizimit të shoqërisë shqiptare, që sapo kishte shpëtuar nga një prej robërive më të gjata dhe më famëkeqe në botë. Siç shprehet dhe studiuesi Ali Xhiku: "Një prozë që e kishte mjaft të hapur intonacionalitetin e saj që kërkonte të ndikonte sadopak në "zbutjen e jetesës së ashpër" të shqiptarëve, që donte t'i përgatiste ata për kohërat që do të vinin". Prandaj, prozatorët tanë të parë, e midis tyre, veçanërisht, Grameno, që përgjithësisht vinin prej radhëve të mikroborgjezisë, por jo të një mikroborgjezie pasi ka fituar revolucionin, por të një mikroborgjezie para se revolucioni të ishte një problem i shtruar për zgjidhje, me të drejtë preokupoheshin për të ardhmen e shoqërisë shqiptare. Dhe për të shprehur këto mendime atyre nuk ju nevojitej më romantizmi, i tejkaluar tashmë dhe i përmbushur në misionin e tij, por as nuk ishin në gjendje të rroknin tiparet realiste, që kërkonin depërtim më të thellë në problemet sociale dhe pjekuri më të madhe artistike. Për këtë arsye, sentimentalizmi iu nevojiti në atë moment letërsisë shqiptare, veçanërisht prozës së saj, për të shprehur idetë dhe pikpamjet e autorëve të saj. Por çfarë e shtyu Gramenon t'i drejtohej prozës e të shkruante romanet e tij dramtike (siç i quan vetë) "Oxhaku", "E puthura", "Varri i pagëzimit"?



Mendohet që gjatë formimit të tij të ketë njohur letërsinë europiane, sidomos atë rumune të shekullit të 19-të, gjë që i dha mundësinë të përvetësonte mirë gjëra që i përgjigjeshin ideve të tij krijuese e që përputheshin me pikëpamjet e tij për jetën. Ai nuk ra në pozita imitimi, por në përputhje me pikëpamjet e tij estetike, filozofike e politike, solli në letërsinë tonë karaktere shoqërore të marra nga bota shqiptare. Ai e ndiente se, trajtimi i temave morale etike në letërsi, do të arrihej, më mirë, përmes prozës së gjatë, e cila trajtonte njeriun përballë fatit, jetës dhe shoqërisë. Kjo mendohet të ketë qenë shtysa që ai iu drejtua prozës së gjatë, e cila s'mund të ishte atëherë veçse sentimentaliste: "Gramenoja mendonte të ishte rrëfimtari që thurte një histori dashurie me shumë të papritura, rastësi e fjalë të dhëna, që i nënshtroheshin vetëm zemrës, problem që sillnin vetëm triumfin e së drejtës, duke synuar t'i nixte lexuesit të ngashëreheshin, pra për pasojë, të mendoheshin. A nuk porosiste perëndia që vetëm të vuajturit mund të ishin të vërtetshëm? A nuk iu vlente të kaloje përkohësinë e kësaj bote me një jetë që do të linte kur të sosej, kujtimin e një shembulli fisnikëruesi?" (A.Xhiku,"Letërsia shqiptare si polifoni")

Duke u nisur nga sa thamë më sipër, nuk është e vështirë që duke lexuar këto sprovat letrare, të vërejmë pikëtakimet e tyre me prozën sentimentaliste. Natyrisht, nuk mund të mohojmë në prozën e Gramenos, por dhe të të prozatorëve të tjerë të kohës gërshtime dhe ndërthurje drejtimesh, si fjala vjen mpleksje romantike, sentimentaliste, realiste dhe ndonjëherë dhe klasiciste madje, por këto janë shumë të vakëta.

## **2. Kulti i ndjenjës në novelat e Gramenos dhe besimi tek providenca**

Përmendëm pak më sipër se sentimentalistët shpallën kultin e ndjenjës, si kundërvënie ndaj kultit të arsyes të klasicizmit dhe rreth ndjenjës së dashurisë ata organizuan të gjithë subjektet e veprave të tyre. Tri subjektet e sprovave rrëfimtare të Gramenos, gjithashtu, organizohen vetëm rreth një dashurie e cila, më së shumti, sjell fatkeqësi, vuajtje, mundim dhe tragjizëm të skajshëm. Psikologjia e personazheve të tij dominohet nga ndjenja dhe ata nuk mund të flasin,veprojnë apo rebelohen jashtë këtij konteksti psikologjik. Heronjtë e Gramenos janë pjesë e një mjedisi shoqëror, në një kohë dhe në një vend të caktuar dhe ndjenja e tyre duhet të kalojë nëpër shumë filtra apo pengesa, të cilat janë të natyrës sociale, fetare apo zakonore. Ndalimi dhe mohimi i ndjenjës është shpesh pika kyçe e konfliktit që sjell rrjedhën e veprimit dramatik, me plot të papritura dhe mistere. Kaq të dhënë janë pas ndjenjës këto personazhe, sa kur humbin dashurinë edhe vdekjen e shikojnë si fundin logjik ku i çoi humbja e të vetmes përmbajtje që ata i kishin dhënë jetës. Kështu, vdes Marga dhe Miti tek novela "E puthura", ndërsa Thana, kur i shuhet Afërdita dhe familja, arratiset nëpër male, duke u shndërruar në eremit. Ndjenja në këto novela, si në gjithë veprat sentimentaliste, është shpërthyes, dominante, e pamposhtur, aq sa emocionet vërshojnë furishëm duke zëvendësuar analizat psikologjike të procesit të formimit të saj. Te "Varri i pagëzimit", kur Thana takohet me Afërditën ndjenja shprehet kështu: "Kjo zali nuk ishte prej helmit po prej gazit të madh që të jep lumturinë e qiellit dhe të dheut", ndërsa te "Oxhaku": "Por ishte vonë, se shkëndija në një sekondë ishte rrënjosur kaq shumë, sa zjarri i përvëlonte zemrën. Po dashuria e zemrës e bëka njeriun të harrojë detyrën ndaj "Oxhakut", prindërve, si prej çfardo tjetër dashurie. Se në jetë nuk paska brengë më të madhe se dashuria, që të tret më këmbë edhe të thëthin gjakun si gjarpër". Por kjo fuqi e përjetimit të ndjenjës, sipas botëkuptimit sentimentalist, e pra dhe të autorit të këtyre prozave, duket se i bën këta personazhe thellësisht njerëzorë dhe të mirë deri në altruizëm, prandaj midis fjalës ndjenjë dhe vërtet,

autori vë shpesh shenjën e barazimit. Nëpërmjet ndjenjës heronjtë janë të pastër moralisht, sepse nga qenia e tyre rrjedh veç dashuri, dhembshuri dhe sacrificë, jo vetëm për objektin e dashurisë, por për gjithë njerëzimin, sepse një njeri që ndjen thellë nuk mund të jetë kurrë i keq. Edhe nëse, ndonjëherë, humbja e ndjenjës nuk i çon drejt vdekjes, së paku ata kthehen në njerëz që i shërbejnë komunitetit siç ndodh me Malon dhe Thanën. Në këto vepra ka prirje për të krijuar një moral të ri, të ngritur mbi ndjeshmërinë që siguron mirësinë. Ai beson në mirësinë e njeriut, e cila siç pohohej dhe nga Rusoi ishte e mundimshme të ruhej e pacënuar. Në këtë aspekt, besimi tek zoti është faktor vendimtar i fateve të heronjve të Gramenos e që kultivon përsosjen morale të tyre. Virtyti i kërkuar dhe i mbrojtur prej sentimentalistëve shkon bashkë me ndjenjën e thellë dhe bukurinë e shpirtit, që mbështetet fuqishëm te besimi në drejtësinë e zotit. Thana kthehet në oshënar që përpiket, sa herë i jepet rasti, të mbjellë të mirën dhe të bukurën në shpirtin e njerëzve, Miti i lutet zotit, duke u larguar, te kisha e “Shën Ilias” që ta falë dhe ta bëjë Margën të lumtur, Rushan beu bën mirësi për t’i shpëtuar peshës së mëkateve të dikurshme sepse: ”Kudo shihte veçse eshtra të djegura dhe të zhuritura dhe thoshte: ja një e mirë që mund të bëj sot për të shpëtuar nga mëkati. Ky i fundit ngjason shumë me personazhin e çifligarit B, te romani ”Pamela ose ”Virtyti i shpërblyer” i Riçardsonit, i cili pëson shndërrim determinante nën efektin “ndjenjë”. Iluzioni se, njeriu përmes vuajtjesh, nën ndikimin e veprave të virtytshme, pendohet për gjithçka të keqe dhe kalon nga errësira në dritë, është fryt i kuptimit idealist të shoqërisë njerëzore që çonte në paqe sociale. Ky iluzion i sentimentalistëve përshkon si rrymë e nëndheshme edhe prozën e Gramenos.

## **2. Lotët si shprehje e dëshpërimit të personazheve dhe prania e vdekjes**

Ajo që të bie dukshëm në sy është se, ashtu si në krijimtarinë sentimentaliste dhe në prozën e Gramenos, lotët janë mënyra direkte, më e drejtpërdrejtë, më e thjeshtë dhe më e menjëhershme e personazheve të tij, për të shprehur dëshpërimin. Nga kjo zë fill te sentimentalistët i ashtuquajtur ”pikëllim botëror”, që u pasua nga trishtimi egocentrik i romantikëve. Të gjithë personazhet e Gramenos mbyten në lotë: ”Kishte qarë e gjora Margë se një brengë e madhe fshiheshe në zemrën e saj”, ”lotët i derdheshin çurg si lumi”, ”me të hyrë Miti në shtëpi u shtri në minder, duke qarë me blegërimë e duke mallkuar veten e tij për të gjitha të ligat që i kishte bërë Margës”, ”duke qarë pështolli fytyrën me duar dhe ra përdhe”, ”E lotë iu derdhën çurk si breshëri”, ”Vahideja zuri vajë e blegërima se një gjamë i tregoheshe” etj. Pse ndodh kjo më së shpeshti? Sepse dashuritë e tyre janë të destinuara të dështojnë dhe ata sa janë të apasionuar, aq dhe janë të trishtuar. Shprehja e Riçardsonit: ”Një shpirt i ndjeshëm është një e mirë që i kushton shumë atij që e ka”, iu përshtatet më së miri dhe personazheve të Gramenos. Pikërisht se janë shpirtndjeshëm pa vetëvriten, izolohe, sakrifikohen. Thana shndërrohet në asket, duke braktisur jetën, Maloja, gjithashtu, shndërrohet nga fisnik në komit, Marga e gatuar prej pasionit sakrifikon vetveten, njëlloj si Julia D’Etanzh e Rusoit që i bindet vullnetit të prindërve, por jo atij të zemrës. Aq e madhe është kjo humnerë sa Grameno e përshkuan kështu: ”Vërtet ishte një lule, por një lule brenda e fishkur dhe dy zhubra poshtë syve dëftenin sa kishte vuar në këtë botë”. Duke qenë, përgjithësisht, episode të tilla, të cilat vetë Grameno do t’i quante “dramë kaq e tmerruar”, ishte e pritur që personazhet të reagonin në këtë mënyrë e komunikimi midis tyre të ishte vetëm gjuha emotive” (A. Xhiku, Nga romantizmi rrjedhave të realizmit)

Vdekja është një element i shpeshtë te veprat e Gramenos, ashtu si te të gjithë shkrimtarët sentimentalistë. Në fakt, vdekja te heronjtë e Gramenos nuk është rezultat i ndonjë qëndrimi filozofik. Qëllimi i saj është moral në prozën e tij, ndryshe nga veprat e sentimentalistëve që parapëlqenin mistikën e vdekjes, por në ndonjë rast e shohim të përshfaqet dobët dhe kjo prirje në prozën e tij si p.sh. Thana te “Varri pagëzimit”, që mediton për jetën e përtejme, duke e parë si shpëtim prej vuajtjeve të botës: “Jeta ime përmbi dhe është një vdekje e pambaruar” - thoshte ai. Disa elementë të tjerë të mistikes, si preferencë e sentimentalistëve ngrenë tek - tuk krye dhe përmes rreshtave të Gramenos si: ëndrra e kumbares që e shikon Thanën të rinuar dhe të vendosur në një kopsht të mrekullueshëm, parandjenja e Vahidesë për kobin që do ndodhë, shfaqja e Mitit ditën që Marga po martohej, gjëmimi i këmbanave, thirrjet e Thanës natën, mbi “Varrin e pagëzimit”, djegia e shtëpisë mistike, fanitja e Mitit që shikon Margën të tretur si qiri, parandjenja e Afërditës ditën e dasmës etj.

#### **4. Shprehja e mendësisë së shtresës së tretë në novelat e Gramenos, dhe shmangiet nga sentimentalimi .**

Letërsia sentimentaliste ishte një protestë e pasojave të revolucionit industrial në Angli tek masat e thjeshta, prandaj është quajtur edhe si një letërsi e shprehjes së mendësisë së “shtresës së tretë”. Edhe te Grameno shihet të vlerësohen njëlloj si njerëzit e thjeshtë, ashtu dhe të pasurit, zotërinjtë, për cilësitë njerëzore apo antinjerëzore. Nëpërmjet personazheve të Mitit, Thanës, Vahidesë, Rustemit, etj., ai zbuloi madhështinë e shpirtit të mrekullueshëm të këtyre njerëzve, të cilët ditën të ndjenin të vuanin dhe të sakrifikoheshin me dinjitet. Vahideja e ndjeshme përngjan me Klarisën apo Pamelën e Riçardsonit, që ruan të paprekur bardhësinë morale. Por, duke sendërtuar në iluzionet e tyre një shoqëri të ardhshme për shtetin e ri shqiptar, Grameno dhe të tjerë si ai, krijuan në vetvete një ide utopike të “paqëimit” në rrafshin shtresor. Sentimentalistët, kundërvënien ndaj jetës e shprehnin nëpërmjet ekzaltimit të ndjenjës e virtytit të heronjve të thjeshtë. Te Grameno, reagimi ndaj të këqijave shprehet nëpërmjet lotëve, vuajtjeve, robinsoniadeve dhe vdekjes, dhe këtu do kërkuar thelbi sentimentalist i qëndrimit të tij, pas zgjidhjesh që kërkonin virtytin jashtë kushtëzimit social, në dashurinë pannjerëzore.

Duke folur për pikëtakimet sentimentaliste te proza e Gramenos, nuk mund të mos përmendim dhe disa shmangie. Analiza psikologjike e personazheve, aq e pëlqyer prej sentimentalistëve, pothuaj mungon te Grameno. Sentimentalistët, siç thotë sër Uolltër Skot:” si askush tjetër më parë, hulumtuan brenda zemrës njerëzore”. Ndërsa Grameno i kushton vëmendje ndjenjës, pa mundur të hyjë në analizat e brendshme të saj. Gjithashtu, gjuha e këtyre novelave, ku sundon folja dhe mbiemri që luan rolin e epitetit të zakonshëm, figurat monotone, gjuha e papërpunuar, subjektet me kthesa të papritura, mungesa e monologut dhe plasticitetit të përshkrimit, janë shmangie apo shkëputje e kësaj proze prej sentimentalizmit. Megjithatë, ne e vlerësojmë prozën rrëfimtare të Gramenos, jo vetëm se ajo plotësoi një nevojë shpirtërore e kulturore të kohës, jo vetëm se inicioi zhvillimin e prozës së gjatë tek ne, por edhe sepse transmetoi, në mënyrë origjinale, drejtimin e vonuar letrar të sentimentalizmit në rrjedhat e letërsisë shqipe.

## **Referencat**

*Historia e letërsisë shqiptare*, Tiranë, 1983.

*Letërsia si e tillë*, Tiranë, 1996.

*Letërsi botërore e shek. XVII-XVIII.*, Tiranë, 2000.

Elsie R., *Historia e letërsisë shqiptare*, Tirane -Pejë, 1997.

Grameno G., *Vepra letrare*, Prishtinë, 1988.

Gjika Th., *Mihal Grameno, jeta dhe vepra*, Tiranë, 2012.

Jorgaqi N., *Poetika e dokumentit*, Tiranë, 1987.

Jorgaqi N., *Antologji e mendimit estetik shqiptar*, Tiranë, 1979.

Petrota G., *Popolo lingua e letteratura albanese*, Palermo, 1931.

Postoli F., *Vepra letrare 1*, Tiranë, 1991.

Stërmilli H., *Vepra letrare 1*, Tiranë, 1983.

Xhiku A., *Nga romantizmi rrjedhave të realizmit*, Tiranë, 1989.

Xhiku A., *Letërsia shqiptare si polifoni*, Tiranë, 2004.

# **QASJA MITIKE DHE IRONIKE NË PROZËN E BERNARD MALAMUDIT**

**Shpëtim Madani**

Fakultetit të Gjuhëve të Huaaja, Universiteti i Tiranës

## **Përmbledhje**

Punimi ndalet në qasjen mitike dhe ironike në prozën e Bernard Malamudit (1914-1986), një nga shkrimtarët më të njohur hebreo-amerikanë të shekullit të kaluar. Lidhur me mitin, do të trajtohet ‘miti i shkretëtirës’ dhe përpjekjet e heroit për ta bërë pjellore atë. Për sa i përket ironisë, tek Malamudi, ajo krijon efekte që luhaten nga shfryrja komike tek denoncimi i hidhur, por në mënyrë karakteristike qasja e tij ironike shpreh kompleksitetin dhe ambiguitetin – ankthin ekzistencial – e jetës. Po ashtu, ai shkrin ironinë me botëkuptimin humanist për të paraqitur një kontrast të fortë ndërmjet situatave që janë brutale, barbare dhe çnjerëzore, dhe idealeve që janë fisnike, të arsyeshme dhe humane. Tek Malamudi, ndeshet edhe përdorimi i ironisë me ngjyrim hebraik që lidhet me rrethanat historike të popullit hebre në të shkuarën. Si përfundim, miti dhe ironia shërbejnë si mjete të përshtatshme artistike për të shpalosur dimensione të ndryshme të jetës njerëzore.

**Fjalët çelës:** Miti, miti i shkretëtirës, ironia, kontrasti

## **Abstract**

The paper focuses on the mythic and ironic approach in the prose of Bernard Malamud (1914-1986), one of the major Jewish American writers of the last century. Concerning myth, we will concentrate on ‘the desert myth’, and the hero’s efforts to make it fertile. Regarding irony, it creates effects ranging from comic deflation to bitter denunciation but characteristically, his ironic approach points out the complexity and ambiguity – the existential anguish – of life. Likewise, he blends irony with a humanistic outlook to show an intense contrast among situations being brutal, barbarous, and inhumane, and ideals being noble, reasonable, and humane. Malamud also employs Jewish irony resulting from the historical circumstances of the Jewish people in the past. In conclusion, myth and irony serve as effective artistic means to unfold various dimensions of human life.

**Key words:** Myth, desert myth, irony, contrast

## **1. Hyrje**

Qëllimi i këtij punimi është të hedhë dritë mbi qasjen mitike dhe atë ironike në prozën e Bernard Malamudit, si teknika mjaft të rëndësishme artistike për perceptimin dhe interpretimin e realitetit. Arsyeja kryesore e ndërmarrjes së këtij studimi është theksimi i rëndësisë që ka përdorimi i mitit dhe i ironisë në një vepër letrare. Në mënyrë të veçantë, tek Malamudi ato marrin ngjyime të dukshme humaniste dhe moraliste, duke iu referuar edhe historisë dhe kulturës hebraike në prozën e tij, çka përbën dhe risinë kryesore të këtij punimi në aspektin artistik dhe tematik.

Artikulli në fjalë i analizon mitin dhe ironinë veçmas, duke filluar me rolin dhe rëndësinë që ka secila teknikë, si dhe duke përfshirë disa pikëpamje kritikësh dhe shkrimtarësh lidhur me to. Trajtimi i mitit dhe ironisë realizohet duke u ndalur në romanet kryesore të shkrimtarit.

## 2. Miti

Miti është produkt i imagjinatës njerëzore, pjellë e fantazisë dhe ëndrrës. Çdo kulturë dhe shoqëri ka mitet e veta, të cilat jetojnë në fantazinë dhe kujtesën e njerëzve. Por ka dhe mite kolektive apo universale që kanë kaluar kufijtë e një kulture të caktuar, si për shembull, miti i Sizifit, Prometeut etj.

Ernst Kasire e sheh prirjen për të menduar dhe shprehur përmes mitit si tendencë konservatore, e cila kërkon ruajtjen e traditës. Sipas kritikut Ernst Cassirer (Ernst Kasire) “Miti nuk ka asnjë mënyrë për të kuptuar, shpjeguar dhe interpretuar jetën aktuale njerëzore, përveçse duke e reduktuar këtë të fundit në të shkuarën e largët.” [224] Shkrimtarët që aplikojnë qasjen mitike, ndoshta jo se u mungojnë rrugët e tjera për të shpjeguar kohën e tashme, u duket kjo qasje e përshtatshme për të theksuar nevojën për ruajtjen e vlerave tradicionale. Tomas Elioti shprehej se qasja mitike ishte “thjesht një mënyrë për të kontrolluar, rregulluar, për t’i dhënë formë dhe kuptim panoramës së pafundme të kotësisë dhe anarkisë që karakterizon historinë e sotme.” [Cit. në Ducharme 6] Kjo tendencë konservatore është e dukshme në veprën e Malamudit, ku shpeshherë heroi hedh poshtë vlerat e dyshimta të shoqërisë moderne për të përqafuar ato të botës së vjetër. Vetë autori është shprehur se, sipas tij, detyra e shkrimtarit në shoqërinë moderne është “të mbrojë qytetërimin nga vetëshkatërrimi.” [Cit. në Lasher 7] Krijimet e Malamudit i drejtohen mitit për të realizuar këtë qëllim. Në romanet e trajtuara më poshtë do të hedhim dritë mbi arketipin mitik të shkretëtirës që i bashkon ato, si dhe përpjekjet e heronjve për ta bërë pjellore atë.

Romani i parë “I Talentuar” (1952), është një histori beisbolli, por në brendësi është tregim mitik për krenarinë, impulsivitetin, fajin, vetëshkatërrimin dhe mungesën e vetëkontrollit. Në mënyrë specifike, romani ka ndërthurur mitet e Kalorësit të Gralit dhe të Fishër Kingut me mistikën e sotme kombëtare të beisbollit profesionist. Duke shkrirë kërkimin arturian me një histori beisbolli, Malamudi e shtrin kërkimin përtej kohës, duke e shndërruar karrierën e beisbollit të heroit në simbolikë të psikologjikë dhe moralit njerëzor. Tregimi malamudian është mitik në sensin që bën një renditje simbolike të përvojave, shpreh dhe kodifikon besime të caktuara, përmban modele të sjelljes morale, si dhe paraqet një këndvështrim të botës.

Në vepër heroi Roi Hobs krahasohet me kalorësin Persival, ndërsa Pop Fishëri me Fishër Kingun, i cili, si Perëndia e Pjellorisë, është i lidhur ngushtë me tokën. Kur Fishër Kingu është i sëmurë, toka është e shkretë. Ky është kërkimi që Përsivali duhet të realizojë: ai duhet të gjejë një mënyrë për të shëruar Fishër Kingun që vuan nga ‘këmba e atletit’ në duar dhe, në këtë mënyrë, t’i kthejë pjellorinë tokës.

Kjo vepër ka paralele edhe me “Tokën e Shkretë” të Eliotit, por poema e Eliotit lë të nënkuptohet se toka e shkretë e qytetërimit modern nuk ka Fishër King për t’u shëruar; nuk ka as hero që t’i sjellë pjellorinë tokës së shkretë. Duket se në një përfundim të ngjashëm arrin dhe Malamudi, pasi romani mbyllet me dështimin e heroit dhe mospërmbushjen e misionit të ndërmarrë prej tij.

Roi është një lojtar i lindur beisbolli që luan si pritës i majtë për skuadrën e famshme New York Nights (Nju Jork Naits). I pajisur me shkopin e tij ‘magjik’ që e quan

“Djali Çudibërës” – të cilin e ka prerë nga një pemë të goditur nga rrufeja – Roi arrin suksese të njëpasnjëshme, duke u shndërruar në një hero të vërtetë dhe duke i ‘kthyer’ shiun e shumëpritur ekipit të menaxherit Pop Fisher, të cilin e ka ‘kapluar’ thatësira. “Djali çudibërës shndërrimi në diell. Kapi sferën në pjesën më të madhe. Një zhurmë si ajo e nderimit me njëzet e një të shtëna buçiti në qiell. U dëgjua një tingull i tendosur i këputur, si dhe disa pika shiu që ranë në tokë.” [70] Tre ditë të tjera pasojnë plot shi. Roi arrin suksese të njëpasnjëshme me skuadrën e tij, duke u bërë pretendentë kryesorë të finales së sezonit. Por, ashtu si heroit mitik Persivali, Roi dështon në kërkimin e gralit, sepse nuk arrin të ruajë virtytet që i kërkohen kërkuesit të suksesshëm. Roi i ngjan një tjetër heroit mitik, Akilit, sepse të dy vuajnë nga krenaria dhe epshi. Fitorja e finales kryesore – sigurimi i gralit – do t’i sillte shërimin e plotë menaxherit Fisher, por një gjë e tillë kthehet në mision të pamundur, pasi sukseset e arritura i errësojnë sytë Roit, e bëjnë gjithnjë e më egoist, duke mos vlerësuar siç duhet talentin dhe rolin e tij në shoqëri. Kërkon gjithçka dhe vetëm për veten. Kur Heriet Bërdi – gruaja famëkeqe që është e fiksuar të vrasë sportistë të famshëm – e pyet:

“Çfarë shpreson të arrish, Roi?”

Ai i kishte thënë njëherë, por pa asnjë minute ia ktheu, “Nganjëherë kur të eci rrugës jam i bindur se njerëzit do thonë ja po kalon Roi Hobs, lojtari më i mirë i të gjitha kohërave.”

Ajo e shikoi me sy të prekur e të trazuar. “Kjo është e gjitha?”

Ai u përpoq ta kuptonte plotësisht pyetjen e saj. Dy herë i ishte përgjigjur, por ajo akoma ishte e pakënaqur. Nuk ishte i sigurtë se ç’priste që t’i thonte. “Kjo është e gjitha?” tha ai përsëri.

“A nuk e di?”....

“A nuk ekziston diçka përtej gjërave tokësore – që jeta dhe veprimet e njeriut të kenë një kuptim më të lavdishëm?” [26-27]

Roi, në fakt, nuk e kupton domethënien e fjalëve të saj, sepse e sheh veten si perëndi të shkëputur plotësisht nga realiteti. Jeton në mitin e heroit të beizbollit, suksesi i të cilit nuk duhet të ndahet me të tjerët. Si pasojë, Roi plagoset nga Heriet.

Ajo çfarë Roi nuk ka mësuar akoma është se dashuria dhe përkushtimi ndaj nevojave të grupit më të gjerë – familja, ekipi, njerëzimi – janë grali i vërtetë dhe jo fama, pasuria dhe bukuria që ndjek në ndjek në mënyrë vetëshkatërrimtare, duke u lidhur me femrën e paraqitshme por materialiste dhe të paskrupullt Memo, e cila e shtyn Roin të shitet tek pronari i ekipit, gjyqtari Benër, i cili është në beisboll vetëm për të nxjerrë përfitime të majme personale.

Ndërsa Memo e çon Roin drejt shkatërrimit duke ia shteruar energjitë, Iris Lemon është forca jetëdhënëse për të. Emri i saj evokon qënien e saj si perëndëshë e pjellorisë dhe burim i energjisë. Duke e mbështetur e qëndruar afër, ajo arrin t’ia ripërtërijë energjitë Roit. Irisi ka kaq shumë jetë dhe fertilitet brenda saj, sa që në moshën 33 vjeçare është bërë gjyshe. Por ajo është akoma e re. Fati tragjik i Roit është se nuk arrin të bëjë zgjedhjen e duhur duke u lidhur me këtë femër, në mënyrë që të shpëtojë karrierën në beisboll dhe, kështu, të shfrytëzojë talentin e tij të lindur.

Ndryshe nga Persivali që më në fund e shëron Fishër Kingun dhe tokën e shkretë, Roi nuk ia arrin qëllimit. Duke mos fituar ndeshjen kryesore të sezonit, ai lë përfundimisht pa shëruar menaxherin Fishër. Roi ia përplas në fytyrë lekët e ryshfetit Benërit, por është tepër vonë. Tashmë, është zëvendësuar nga një lojtar i ri i talentuar dhe

lajmi i korruptimit ka marrë dhenë. Përfundimisht, i duhet të shkëputet nga bota mitike që i jepet kuptim jetës së tij për t'u përballur me realitetin e hidhur:

“Kur doli në rrugë, ishte i sfilitur. Nuk ishte rruar dhe një mjekër e zezë i kaplonte fytyrën. Ndihej i plakur dhe i poshtëruar. Ua nguli sytë njerëzve që kalonin nëpër rrugë, por askush nuk e njohu.

“Mund të kishte qenë mbret”, një grua i tha një burri.”[217]

Roit i duhet të paguajë për gabimet e tij, nga të cilat duket se nuk mëson kurrë. “...Nuk mësova asgjë nga e kaluara ime, tani do më duhet të vuaj përsëri” [217] - thotë ai.

Romani “Shitësi” (1957) hapet në një shkretëtirë urbane në muajin nëntor. Moris Boberi, një burrë i moshuar në një muaj të thatë, i mbërthyer nga era e ftohtë e krizës ekonomike po përjeton në ushqimorën e tij një shkretim që reflektohet në terrenin urban, ndërsa dimri i zymtë afrohet. Edhe Helena – e bija – “vajtonte kohën e gjatë derisa të vinte pranvera dhe i druhej vetmisë në dimër” [16] Pastaj, në skenë shfaqet Frenk Elpajni, një jetim që ka ardhur në Nju Jork nga Perëndimi për të kërkuar një jetë të re. Dy skena të rëndësishme në roman ndodhin në ditët që në mënyrë interesante i përziejnë stinët. Konkretisht, në një ditë të ngrohtë shkurti Frenku e dhunon Helenën në park. Është ditë me borë në prill, kur Morisi del jashtë për të hequr borën nga rruga, çka i shkakton ftohje dhe vdekjen më vonë.

Frenku fillimisht futet në ushqimorën e Morisit si grabitës, bashkë me shokun e tij, Uord Minogun. Grabitja ndodh pikërisht kur biznesi i bakallit është në pikën më të ulët. Ida, gruaja e Morisit, i krahason raftet me “kockat e ndukura të zogjve të ngordhur.” [45] Por, gjërat marrin për mirë kur Frenku merret në punë si ndihmës – është kthyer kryesisht për të larë fajin e pjesëmarrjes në grabitje – dhe Morisi “ia atribuoi suksesin kryesisht shitësit.” [83] Rruga e Frenkut drejt reformimit është e vështirë. Ai fillon të vjedhë nga arka, duke e justifikuar me faktin se ka ndikuar në përmirësimin e biznesit. Po ashtu, shoqërohet fshehurazi me vajzën e bakallit – Helenën. Kapet duke marrë para nga arka dhe si pasojë dëbohet. Morisi ndihet veçanërisht i zhgënjyer, sepse kishte filluar ta shihte Frenkun si zëvendësues të djalit të vdekur.

Në pranverë, Morisi vdes në spital, pas qëndrimit jashtë për të hequr borën që ka penguar kalimin në një ditë të pazakontë fillimprilli. Frenku, ndërkohë, është kthyer prapë për t'i kthyer jetën dyqanit dhe për të mbajtur Idën dhe Helenën.

Transformimi i Frenkut, në të vërtetë është meritë e Morisit, i cili shihet si modeli i njeriut moral që sakrifikon për të tjerët. Pavarësisht se nuk arrin t'u sigurojë jetesën gruas dhe së bijës, ai u jep veresie njerëzve të varfër në lagje, megjithëse e di se nuk do të paguajnë ndonjëherë. Po ashtu, ngrihet çdo ditë në pikë të mëngjesit për t'i shitur simiten 3-centëshe një gruaje të moshuar polake antisemite. Morisi imigrant hebre në lagjen johebraike kthehet në një figurë mitike që paralelizohet me Krishtin. Ashtu si Krishti, edhe Morisi, edhe pse është vetë me një këmbë në varr, ka aftësinë të ngrejë të tjerët nga varri duke e marrë Frenkun nga bodrumi i dyqanit ku është fshehur, për t'i dhënë bukë dhe punë pastaj. Duket sikur Frenku e kupton këtë rol si atë të Krishtit, teksa ha në një simite me fara që i ka dhënë Morisi. “O Jezus, kjo qenka bukë e mirë.” [29] Funkcioni i Morisit në lagje është që të jetojë për të tjerët, ashtu si Krishti, i cili është quajtur nga teologët modernë “njeriu për të tjerët” [Cit. Në Ducharme 15]



Ndonëse Morisi është hebre (siç qe edhe Krishti) veprimet dhe fjalët e tij mëshirojnë atë që njihet si etika kristiane – ose e dashurisë. Kur Frenku e pyet Morisin se ç'do të thotë të jesh hebre, bakalli i përgjigjet:

“... të jesh i drejtë, i ndershëm, i mirë me të tjerët. Jeta e jonë është mjaft e vështirë. Pse u dashka të lëndojmë dikë tjetër? Sepse çdonjëri duhet të përpiqet për t'u bërë sa më i mirë, jo vetëm për ty ose mua. Ne s'jemi kafshë. Ja pse na duhet Ligji. Pikërisht në këtë të fundit beson hebreu.” [150] Ndërkohë, Frenku vëren se “edhe fetë e tjera predikojnë të njëjtën gjë.” [150]

Pas elozhesë që i bëhet Morisit në funeral, Helena shprehet se “ai e shndërroi veten në viktimë.” [181] Megjithëse ajo me fjalën “viktimë” nënkupton pamundësinë e Morisit për të mbijetuar, është pikërisht kjo sakrificë e Morisit që e shndërron në një model të mirëfilltë kristian. Ai bëri mirë dhe e dha jetën që të tjerët të jetojnë.

Të njëjtën rrugë do ndjekë dhe Frenku pas vdekjes së Morisit duke u bërë pasuesi i tij moral. Konvertimi i tij në fenë judaiste ka një domethënie simbolike që kapërcen aktin social e të shkuarit në sinagoga, sepse përmes kësaj zgjedhjeje Frenku ka konfirmuar përqafimin e një sërë qëndrimesh morale. Romani mbyllet me Frenkun që bëhet synet, që pranon rolin e Morisit si njeriu që vuan për të tjerët, si dhe etikës së tij të dashurisë dhe sakrifikimit për të tjerët, çka i jep jetës një tjetër dimension.

“Një Jetë e Re” (1961), romani i tretë i Malamudit, përshkruan peripecitë e Seimor Levinit, hebre nga Nju Jorku, që ka ardhur në Perëndim për të dhënë anglisht në Kolegjin shtetëror të Kaskadias. Përfshihet në një marrëdhënie seksuale me Paulinën, gruan e kolegut Xherald Xhilli, si dhe kandidon në zgjedhje për të zëvendësuar Ferçailldin, shefin në prag pensioni të departamentit. Kundërshtari i tij në zgjedhje është Xhilli, i cili e shfrytëzon provën e tradhtisë së Paulinës me Levinin për ta kthyer stafin kundër tij. Xhilli i fiton zgjedhjet, por e humbet Paulinën tek Levini.

Edhe këtu zë vend miti i shkretëtirës dhe përpjekjet e heroit për t'i kthyer pjellorinë. Së pari, kemi përpjekjet e Levinit për t'i dhënë jetë mjedisit shterp universitar dhe së dyti, falë tij, Paulina pret një fëmijë, çka nuk kishte mundur ta bënte prej vitesh me Xhillin steril.

Fill pas ardhjes në fakultet, Levini gjen shumë gjëra për të kritikuar në departamentin e anglishtes. Në veçanti, tmerrohet nga mungesa e shkencave humane në Godinën e Shkencave Shoqërore. Në departament, letërsia anashkalohet për mësimin e gramatikës, e cila zhvillohet me tekstin e Ferçailldit, *Elementët e Gramatikës* (tashmë në botimin e tij të trembëdhjetë). Kolegët e tij nuk janë veçse një grup pedagogësh mediokër, të cilët kundërshtojnë çdo lloj ndryshimi. Në vend që të nxitet mendimi i lirë dhe zhvillimi i intelektit, ai zbulon se kolegët e tij u mësojnë studentëve aq sa për të marrë testin e caktuar të gramatikës, se ata pranojnë jo vetën tekstin e vjetruar të shefit, por edhe pikëpamjet e tij të mykura politike. Gjithkund, Levini përballlet me frikë, ndërkohë që priste guxim. Megjithëse disa prej kolegëve të departamentit janë peshkatarë të apasionuar, ata e shohin universitetin e tyre si një të tillë që do t'u mësojë njerëzve si të presin pemët, t'u vënë pendë lumenjve, si dhe të ndërtojnë autostrada nëpër male. Arti nuk ka asnjë vlerë, sepse nuk ka funksion praktik për krijimin e një shoqërie të suksesshme në të mirat materiale. Ferçailldi deklaron: “Neve na duhen pylltarë, fermerë, inxhinierë, agronomë, njerëz që merren me peshq dhe shpesë të egër, si dhe të çdo profesioni tjetër të ngjashëm. Na duhen të tillë njerëz – të jemi të singertë – më

shumë sesa kemi nevojë për të diplomuar në anglisht. Nuk mund të rrëzohet pema, të ndërtohet autostrada me katër korsi nëpër mal apo të ngritet diga me poezi.”[34]

Kolegji i Kaskadias është shkretëtira intelektuale ndaj së cilës Levini realizon një fitore të pjesshme. Kjo sepse nuk arrin t’i fitojë zgjedhjet në departament. Megjithatë, janë ndërmarrë disa ndryshime pas përjashtimit të tij. Levini bën të mundur që gramatika e Ferçailldit të hiqet pas tridhjetë vjetësh, si dhe Xhilli po mendon që t’u ofrojë lëndën e letërsisë disa instruktorëve që merren me studentë pasuniversitarë.

Paralel me mitin e mësipërm ecën edhe miti i Perëndimit si Eden, por që nga ana tjetër ka shkaktuar shkretimin shpirtëror. Ashtu si paraardhësit e tij që kishin ‘marshuar’ drejt perëndimit drejt një jete më të mirë, edhe Levini mbërrin në Isçestër (Easchester), qyteti ku ndodhet Kaskadia, duke mbartur me vete perceptimin për Perëndimin si vendi ideal për njeriun. “O Zot, Perëndimi, mendoi Levini. Solli ndërmend pionerët me karroca të mbuluara, teksa futeshin në këtë luginë për herë të parë, dhe u mallëngjye. Megjithëse kishte jetuar pak në natyrë, Levinin i kishte pëlqyer gjithnjë, dhe fakti që ishte larguar nga Nju Jorku, i dukej më se i drejtë. Rrënoqetëj me fatin e tij të mirë.”[2]

Topografia fizike e këtij komuniteti perëndimor, e karakterizuar nga bollëku, pjelloria, natyra e paprekur, gjallëria, përshkruhet zakonisht me terma edenikë ose shpëtues. Fabrikanti, “liberal” i vetëshpallur i departamentit të anglishtes, shprehet me ironi të panënkuptuar që theksohet ndërsa shpalosen ngjarjet: “Shpesh kam menduar se kombi ynë do të kishte një mendje shumë më të shëndoshë, nëse kryeqyteti i Shteteve të Bashkuara do të ndodhej këtu.”[95] Kaskadia quhet shprehimisht parajsë. “Ka njerëz këtu, që janë me origjinë nga shtetet e Pleins apo Miduesti, të cilët betohen se Isçestëri është parajsë. Xheraldi është një prej tyre. Kudoqë që shkon dëshiron të kthehet prapë këtu”[15], i shpjegon Paulina për bashkëshortin e saj dhe, përgjithësisht, për tërë banorët e Isçestërit.

Është Paulina, më shumë se çdokush tjetër, që përpiket t’i ‘ndreqë’ perceptimin për Perëndimin Levinin naiv dhe romantik. Ajo duket se njeh vështirësitë që ka parajsa dhe përpiket t’ia vërë në dukje që natën e parë karakterin e ngushtë dhe hermetik të qytetit.

“Shpresoj se nuk do të zhgënjehesh tek ne, Z.Levin. Në kolegji dhe qytet. Isçestëri mund t’u shkaktojë vetmi beqarëve – nuk e kam fjalën për studentët në kolegji; bota e tyre nuk është reale. Ndokush që vjen nga një qytet i madh mund të zhgënjehet këtu. S’e ke idenë sa të rrethuar, sa të bllokuar dhe pa shije që jemi...Na mungojnë shumë gjëra, ngaqë askush nuk e ka fajin, në veçanti. Është mëkati i përbashkët i neglizhencës.”[14-15]

Si përçuese simbolike e njohurisë, ajo duhet t’i tregojë Levinin edhe për një të metë që prish bukurinë e natyrës në këtë territor ideal – shiu, ndoshta një inversion përqeshës i “Tokës së Shkretë”. “A nuk të shkruajti Xheraldi për shiun?...Duhej të kishte shkruar për të. Bie shi, për shembull, gjithë vjeshtën dhe dimrin, si dhe në një pjesë të mirë të pranverës. Është një qiell sfungjeror që do kesh mbi kokë.”[15] Paulina është Eva emblematike, e pakuptueshme dhe komplekse në këtë Eden amerikan, që tundon jo një, por dy Adamë drejt njohjes së nevojshme, ndonëse jo gjithmonë të mirëpritur, të jetës: Xherëlld Xhillin, bashkëshortin që bën rezistencë, duke ruajtur naivitetin e mundimshëm e të dëmshëm, çka i sjell humbjen e saj; si dhe Levinin, i cili mëson nga ajo se të jetosh në Eden do të thotë të heqësh dorë nga humanizmi.

Por Xheraldit i duhet Paulina për të ruajtur fasadën se çdo gjë shkon për bukuri: martesë e lumtur, fëmijë të këndshëm, stabiliteti, qetësia – virtytet e nevojshme familjare sipas qytetit të vogël. Të tjerët, duke qenë se janë të kënaqur, ia kanë frikën Paulinës në të qenët e ndryshme nga ta, sepse u kujton sesa ekuivok mund të jetë vizioni parajsor. Megjithatë ka vite të tëra që jeton aty, ajo është e padëshiruar, e shkatërruar nga mungesa e kënaqësisë dhe lumturisë. Ekzistenca e saj në këtë mjedis shërben si një koment ironik për papërsosmërinë e Edenit.

Duke parë vazhdimësinë e lidhjes së Paulinës me Levinit dhe duke mos dashur që të përsëritet Rënia e Adamit Amerikan, Ferçailldi ia bën të qartë Levinit se nëse dëshiron të rrijë në parajsë, atëherë duhet të:

“tregosh respektin e duhur për mendimet e të tjerëve....Si dhe të këshilloj....që të mos merresh më me gratë e kolegëve të tu. Ato janë gra të martuara....Të kam paralajmëruar shumë qartë për një gjë të tillë dhe po ta përsëris. Po tregohem tolerant vetëm se më vjen keq që të shkatërrosh karrierën pa e filluar akoma mirë. Që të frenosh pasionin tënd për të ndërhyrë tek punët e të tjerëve, si dhe të kritikosh çdo gjë që shihet, do ishte mirë të filloje reformimin e vetvetes për të cilin ke shumë nevojë....Tregohu i përgjigjur. Duhet të jemi të gjithë, sidomos ata që u japin mësim të tjerëve....Sillu mirë –.” [266-267]

Që të mos përdoret më si vegël, Paulina e kupton se duhet të largohet nga ky utopik. Kjo Evë duhet të largohet me dëshirë nga Edeni me një Adam që ka të njëjtat pikëpamje për jetën reale. Nga ana tjetër, Levini është përjashtuar nga puna dhe i bëhet shantazh nga Xhilli që të heqë dorë nga mësimdhënia, në qoftë se ai dhe Paulina dëshirojnë t'i mbajnë fëmijët. Por tregimit biblik i jepet një fund amerikan: Edeni mbetet i pacënuar; janë Adami naiv i dikurshëm, i shndërruar tashmë në Gjarpër, dhe Eva që dëbohen. Ajo çfarë nënkuptohet këtu është se miti i Perëndimit si parajsë edhe mund të ekzistojë, por duke ofruar sigurinë dhe perfeksionin me çmimin e individualitetit dhe mundësisë.

Në romanin “Riparuesi” (1966), ngjarjet vendosen në Rusinë pararevolucionare, e cila është kthyer në një shkretëtirë social – politike dhe ligjore, si pasojë e masave represive të shtetit ndaj individit. Fabula ka në qendër hebreun 33 – vjeçar Jakov Boku, i cili lë shtetlin ukrainas ku jeton për të kërkuar një jetë më të mirë në Kiev. Pas disa muajsh qëndrimi aty nën emër të rremë, akuzohet dhe burgoset me të padrejtë për vrasjen e një fëmije 12-vjeçar rus. Me provën kryesore e “të qenët hebre”, Jakovi lihet për më shumë se 2 vjet në burg, me shpresën se do pranonte “krimin” e tij ose do kryente vetëvrasje; apo do komprometonte hebrenjtë e tjerë, apo do të pranonte të lirohej si kriminel i falur. Ai nuk pranon të bëjë asnjërin prej tyre, duke i shpëtuar, në këtë mënyrë, hebrenjtë rusë nga një tjetër fushatë spastrimi e qeverisë. Romani mbyllet me vrasjen – në mënyrë simbolike dhe në ëndërr – të carit nga Jakovi, dhe organizimin e një gjyqi publik, i cili është dhe shpresa e vetme e Bokut dhe e gjithë njerëzve.

Në dialogun e fundit imagjinar, Jakovi i thotë carit: “Rusia është shteti më i varfër dhe reaksionar në Evropë. Me fjalë të tjera, ju e keni shndërruar këtë vend në një luginë të mbushur me eshtra.”[298] Pas vrasjes simbolike të carit dhe nisjes për në gjyq, riparuesi shprehet: “Një gjë kam mësuar...se nuk ka gjë më të keqe se një njeri apolitik, sidomos një hebre. Të dyja janë të pandashme, kjo është e dukshme. Nuk mund të bësh sehir dhe të shohësh veten duke marrë fund... Nëse shteti sillet në mënyrë çnjerëzore me natyrën njerëzore, e keqja më e vogël është shkatërrimi i tij.” [299] Nga një njeri apolitik

në fillim të romanit, Jakov Boku kthehet në revolucionar dhe shpëtimtar duke asgjësuar dhunuesin e racës së vet në veçanti, por edhe të rusëve në përgjithësi.

### 3. Ironia

Një tjetër element i rëndësishëm që zë vend në prozën e Malamudit është edhe ironia, e cila është mjeti për të shprehur kontrastet dhe përmbysjet, të kundërtat dhe të papriturat. Si teknikë për krijimin e efekteve tragjike dhe gjykimeve morale, ironia ka një histori të gjatë që shkon deri tek letërsia antike greke. Në shek. XIX, ironia u bë më shumë sesa një teknikë për paraqitjen e qëndrimeve dhe gjykimeve – për shumë shkrimtarë filloi të mëshironte një mënyrë vështrimi të botës, përfundimin e natyrshëm të konfliktit ndërmjet imperfeksionit njerëzor dhe moralit universal. Për shkrimtarët ekzistencialë, ironia bëhet më e paqëndrueshme, duke nënkuptuar se shkrimtari nuk shpreh haptas asnjë qëndrim apo botëkuptim. Ai gjithmonë përfshin një vetëdije ironike të qëndrimeve të kundërta dhe plotësuese. Për shembull, një ironi ambivalente haset tek Sartri në pikëpamjen se njeriu është një krijesë “e dënuar” për të qenë e lirë.

Përdorimi i ironisë ka avantazhe të shumta për autorin. Xhejms Xhojsi e konsideronte ironinë si mjetin përmes të cilit shkrimtari arrinte njëfarë distancimi nga materialet e tij. Ironia i jep mundësinë autorit që të merret me materialet e tij letrare në mënyrë objektive. Ajo ka të njëjtat avantazhe edhe për lexuesin. Sipas Harold Kaplanit, “Ironia kap qartas disproporcionet dhe mospërputhjet ndërmjet domethënies dhe ngjarjeve, veprimeve dhe vlerave, motiveve dhe rezultateve.” [27] Nëse Geza Roheim shprehet se miti është një përpjekje për të “lidhur fantazinë dhe realitetin” [273] nuk është e çuditshme që një autor i cili ka përdorur mitin si mjet strukturor bazë të gjeje të përshtatshëm llojin e ironisë të arritur duke treguar hendekun ndërmjet ëndrrës dhe realitetit.

Në romanin “I Talentuari”, krahasimi i Roit me Përsivalin është ironik, për vetë faktin se Roi është një njeri naiv që gënjehet lehtë. Ai shfrytëzohet nga Memo, e cila në vend të dashurisë apo seksit e dend vetëm me ushqim. Manipulohet lehtësisht nga gjykatësi Benër dhe pranon të shitet. Ironia kryesore qëndron në faktin se Roi e ka humbur perceptimin e realitetit dhe preferon të izolohet në mitin e heroit që ka krijuar për veten, duke mos e kuptuar se heroit i vërtetë bëhet shembull i mirë për të tjerët. Mundësia për të perceptuar siç duhet realitetin, por edhe për të ruajtur të paprekur mitin e heroit, i jepet pikërisht përmes njohjes me Irisin, e cila është mjaft e rrahur me jetën.

Në romanin “Shitësi” ironia shërben për të shprehur atmosferën mbytëse dhe kontrastin ndërmjet shpresave, ëndrrave dhe aspiratave të personazheve në vepër dhe realitetit të tmerrshëm që nuk e favorizon përmbushjen e ëndrrave, por krijon një patos kaplues.

Kështu, Moris Boberi ka më shumë se 20 vjet që ka ardhur në Amerikë nga Rusia për t’i ikur regjimit të egër carist, por ndërkohë ka gjetur izolimin total në një ushqimore që më tepër i ngjan një burgu “...në Amerikë, ai rrallë e kishte parë qiellin.” [4] Nuk mban dot familjen, ndërkohë që vazhdon të japë veresie. Karpi – shitësi i pasur hebre i pijeve alkoolike – i thotë Morisit të telefonojë policinë – vetë Karpi s’ka vënë akoma telefon në dyqan – se dyshon që po e grabisin, ndërkohë që gabimisht grabitet dhe goditet Morisi i varfër. “Dy burra po qëndronin në anën tjetër të banakut, fytyrat e mbuluara me shami. Njëri e kishte ngjyrë të verdhë e me njolla, e tjetrit ishte e bardhë. Ai me të bardhë

filloi t'i këpuste dritat e dyqanit. Iu desh bakallit një gjysmë minute për të kuptuar se viktima ishte vetë ai dhe jo Karpi.”[27]

Mirësia e Morisit i shërben vetëm Frenkut, por nuk vlerësohet nga të tjerët dhe nuk i sjell asgjë familjes së tij. Vetë Morisi është i vetëdijshëm për këtë ironi fati, pasi i duket se sa më shumë rropatej aq më shumë varfërohej. Vajton se s'mund të ushqejë familjen e vet për shkak të fatit të keq, ndërkohë që për tjerët bëhet e qartë se nuk është kjo arsyeja kryesore. Ironia në personazhin e Morisit përfshin si tragjikën ashtu edhe komikën, sepse ai nuk mëson nga e kaluara dhe beson se njerëzit janë të mirë në shpirt, pavarësisht nga veprimet e tyre. Tek Frenku, shpreson të zëvendësojë djalin e vdekur, por zhgënjehet se e kap duke vjedhur nga arka, ndërkohë Karpi e konsideron të pranueshëm faktin që i biri e vjedh, sepse nuk i jep lek sa duhet. Edhe atëherë kur i jepet mundësia për ta shitur dyqanin, Morisi vendos të tregohet i sigurtë me blerësin e mundshëm teksa i tregon për fitimin e paktë që del. Vdes me fjalët “E flaka jetën time për asgjë. Ishte një e vërtetë e llahtarshme.” [273] Sidoqoftë, në mënyrë mjaft ironike dhe paradoksale, dështimi i tij është gjithashtu suksesi i tij.

Edhe Frenku mendon se jeta e tij është një ironi e mirëfilltë. "Mos më pyet se pse, por herët a vonë çdo gjë që mendoj se ia vlen ta kesh më shpëton nga duart në një mënyrë apo tjetër. Punoj si kalë për të arritur atë që dua dhe, kur duket se e kam siguruar, bëj ndonjë lëvizje të pamenduar dhe e katranos fare.”[40] Po ashtu, që të bëhet njeri i mirë dhe i moralshëm atij i duhet të zgjedhë midis dy formave të 'burgimit' që i ofron dyqani. Më në fund zgjedh lirinë shpirtërore duke e paguar me atë fizike. Pra, fitorja e tij është, në një farë mënyre, si e Pirros. Helena, nga ana tjetër, e shkatërron dashurinë e saj duke iu dhënë menjëherë Netit – studentit të drejtësisë – dhe, më pas, duke i rezistuar Frenkut më tepër se ç'duhet.

Lidhur me këtë, Frenku e shpëton nga tentativa për përdhunim e Uord Minogut – bashkëgrabitësi i Morisit – por del vetë jashtë kontrolli dhe i bën të njëjtën gjë. Frenku s'mund të rezistojë më, duke menduar që nuk do ta shohë më Helenën pas dëbimit nga Morisi. Për ironi, ky i fundit e kap Frenkun duke marrë një dollar nga lekët e vjedhur që kishte filluar t'i kthente pak e nga pak.

Helena shpreson që Frenku të bëhet më i mirë se ç'është kur e takon. Kështu që, i jep libra për të lexuar. Por, siç vëren Frenku, “Ato librat që m'i pate dhënë njëherë për t'i lexuar, ti vetë i kuptoj?” [282] Është e qartë se Helena nuk ka nxjerrë mësim për jetën nga leximi i saj. Ajo i jep Frenkut *Krim e Ndëshkim* për të lexuar, por nga romani i Dostojevskit ajo nuk ka mësuar as për dhembshurinë, as faljen dhe siç duket nuk e kupton fare konceptin e shpëtimit të vuajtjes nga dashuria. Ndryshe nga Frenku që e merr jetën si të vijnë, Helena nuk arrin dot të jetojë siç duhet të tashmen, sepse ndodhet e ‘kapur’ ndërmjet gabimeve të së shkuarës dhe shpresës për t'u bërë dikushi në të ardhmen.

Në romanin "Riparuesi", ironia lidhet ngushtë me humorin hebraik. Nga shkrimtarët evropiano-lindorë të traditës popullore jidishe Malamudi përshtati në krijimtarinë e tij humorin e fortë hebraik (nganjëherë i quajtur ironia hebraike). Humori hebraik nuk vjen nga feja e hebrenjve - Dhjata e Vjetër dhe Talmudi karakterizohen nga mungesa e humorit. Humori hebraik lidhet në fakt me gjendjen shoqërore të hebrenjve evropiano-lindorë që mbijetonin me vështirësi si minoritetet brenda kulturës dominuese kristiane. Ndonëse krenarë, këta hebrenj ishin më se të vetëdijshëm për statusin e tyre të ulët. Ata ishin Populli i Zgjedhur i Zotit, por edhe populli i shtypur në fshatin polak apo rus. Humori filloi të shihej si mënyrë për të ngushtuar hendekin ndërmjet aspiratave

shpirtërore dhe situatës së tyre reale. Ndërsa zbehej besimi në Judaizëm dhe shtohet skepticizmi, u bë gjithnjë e më ironik kontrasti ndërmjet shpresës dhe realitetit. Ky bashkim i padëshiruar i rrethanave me besimin çoi në lindjen e figurës së shlemilit, budallaut zemërmirë dhe në dukje komik që vazhdimisht e gjen belaja. Marifeti në veprimet e tij komike synon të na bindë se pafuqia e tij është në të vërtetë fuqi. Si teknikë ironike, humori hebraik krijon njëfarë vizioni të dyfishtë që shkrin në një shpresën dhe dëshpërimin.

Ironia lidhet me dy aspekte kryesore. Së pari, kemi përpjekjet e Jakovit për të hedhur pas krahëve jetën në shtetl dhe së dyti, përpjekjet e tij për të mohuar identitetin hebraik. Jakovi, i turpëruar nga e shoqja shterpë, vendos të largohet nga shtetli, por edhe në burg i vjen në mendje ajo dhe e gjithë jeta me të. “Vë në lëvizje kujtesën. Mendoj për Raislin. Jam në burg, kështu që ç’rëndësi ka? Herën e parë që e pashë...” [189]. Në fund nuk nguron ta mallkojë edhe njëherë për shterpësinë e saj. Por, më vonë, ajo vjen në burg pikërisht për t’iu lutur Jakovit që të pranojë atësinë e fëmijës së saj me një tjetër. Jakovit i duhet të gëzojë në letër atë që s’mundi ta bënte në realitet.

Elementi i dytë i ironisë është se heroi dënohet pikërisht për identitetin hebraik të cilin fillimisht e ka fshehur duke rruar mjekrën, ndryshuar pjesërisht emrin, etj. Nga ana tjetër, burgoset si i akuzuar për vrasje rituale dhe praktikim të fesë, edhe pse Jakovi i është shmangur gjithnjë asaj. Duke u akuzuar thjesht për identitetin e tij, ai atëherë kalon në kundërsulm duke mbrojtur pa asnjë kompromis fenë e tij dhe të qenët hebre.

Ironia merr përmasa të mëdha në momentin që i gjithë aparati shtypës shtetëror, përfshirë dhe carin, mobilizohet kundër një njeriu të thjeshtë e të pafajshëm, të cilin e shikojnë si element të rrezikshëm për shtetin, si revolucionar... Jakovi, ndërkohë, mbrohet duke thënë “ Nuk jam revolucionar. Jam një njeri i parrahur me jetën. Jam riparues.” [205] Ndërkohë, vjen një moment kur rolet ndërrohen dhe viktimja bëhet më e fortë se viktimizuesi. Prokurori famëkeq Grubeshovi i lutet Jakovit të nënshkruajë një letër ku të rrëfejë krimin e kryer në këmbim të lirisë së tij dhe mundësisë së ofruar nga autoritetet për t’u arratisur jashtë shtetit me pasaportë të rregullt. Jakovi, natyrisht, refuzon, pasi është i vendosur në kërkesën e tij për gjyq të ndershëm dhe drejtësi për vete dhe të tjerët. Dhe kjo vendosmëri i buron tashmë nga njohja me historinë dhe fenë e origjinës së tij, të cilën ai e kishte mohuar për shumë kohë. Si rezultat, ekzistenca e Jakovit sillet brenda një rrethi vicioz dhe është e karakterizuar nga një atmosferë ironike, e cila e përshkon tërë veprën në fjalë.

#### **4. Konkluzion**

Miti dhe ironia, siç u ilustrua dhe më sipër, gjejnë një vend shumë të rëndësishëm në prozën e Malamudit. Ato ridimensionojnë lidhjet e heroit me të shkuarën, të tashmen dhe të ardhmen; përceptimin e tij mbi ëndrrat dhe realitetin, si dhe nevojën për të gjetur ekuilibrin e duhur. Pra, si miti, ashtu edhe ironia, bëhen përçuese të filozofisë së jetës, me të papriturat dhe kontrastet e forta të saj, si dhe përpjekjet e njeriut për të jetuar me dinjitet dhe përgjegjësi.

#### **Referencat**

Cassirer, Ernst (1994) *An Essay on Man: An Introduction to A Philosophy of Human Culture*, New Haven, Yale University Press.

Ducharme, Robert (1974) *Art and Idea in the Novels of Bernard Malamud*, The Hague, Mouton & Co.N.V, Publishers.

Kaplan, Harold (1966) *The Passive Voice: An Approach in Modern Fiction*, Athens, Ohio.

Lasher, Lawrence M.,ed. (1991) *Conversations with Bernard Malamud*, New York, Jackson and London: University Press of Mississippi.

Malamud, Bernard (1966), *The Fixer* (Riparuesi), New York, Penguin.

(1961) *A New Life* (Një Jetë e Re), New York, Avon Books.

(1957) *The Assistant* (Shitësi), New York, Avon Books.

(1952) *The Natural* (I Talentuari), New York, Avon Books.

Roheim, Geza. (1941) *Myth and Folktale*, Baltimore, Johns Hopkins University Press.

# FILOZOFI





# LIRIA SI PARADIGMË E KONSTRUKSIONIT EUROPIAN

Irida Laçi (Lika)

Ministria e Punëve të Jashtme

## Permbledhje

Ky punim ka për qëllim të marrë në analizë gjenezën e “paradigmës së lirisë”, në Europë, duke nisur që nga *polis-i* grek. Nëpërmjet një metodologjie analitike dhe argumentuese do të përshkruhet evoluimi i përkufizimit të konceptit të lirisë, e cila nis fillimisht si vlerë e përjetuar brenda një komuniteti. Më pas, dashuria shumë e madhe dhe mbivlerësimi ndaj ndjenjës së lirisë gjeneron një ndjenjë superioriteti deri në despotizëm të europianit ndaj jo-europianit. Kjo ndjenjë çon në krijimin e një seti dikotomish antagoniste, si Perëndim – Lindje, ne – ata, civilizim - barbari, të cilat kanë karakterizuar kontinentin tonë. Punimi synon ndërgjegjësimin ndaj faktit se diferencat ndërmjet këtyre “të kundërtave” nuk janë dhe aq të pakapërcyeshme, madje në shumë aspekte konsiderohen artificiale. Mjaft interesant në këtë drejtim është dhe fakti se brenda mendimit të autorëve të botës klasike, të marrë në studim si: Esiodi, Hipokrati, Aristoteli e Platoni ekzistojnë këndvështrime të ndryshme të konceptit të paradigmës së lirisë në Evropë.

**Fjalët kyç:** liri, paradigmë, tirani, dikotomi, ndërgjegje europiane.

## Abstract

This article aims to analyse the genesis of the “paradigm of freedom” in Europe, starting from the Greek – polis. Through an analytical as well as an argumentative methodology it describes the definition of the concept of freedom, which originally started as an experienced value within a community. Later on, this great love and overestimating sense towards freedom generated the feeling of superiority that led to the despotism of Europeans towards non-Europeans. This very feeling of superiority gave life to a set of antagonistic dichotomies, such as West versus East, We versus Them, Civilizations versus Barbarisms, which have characterized our continent throughout its history. This paper aims at raising awareness of the fact that the very differences between these "opposites" are not so insurmountable, even in many respects they could be considered artificial. Different perspectives on the concept of the “paradigm of freedom” in Europe, are given through the considerations of various classical authors taken into analysis in this paper, such as Hesiod, Hippocrates, Aristotle and Plato.

**Key words:** freedom, paradigm, tyranny, dichotomy, European consciousness.

## Hyrje

Nuk është e lehtë të trajtohet temën e paradigmës së konceptit të lirisë në Europë për arsye të thjeshtë se vetë termit “liri”, “paradigmë” dhe “Europë” paraqesin një kompleksitet aspektesh dhe refleksionesh filozofike, si dhe një shtrirje kohore që ndërthur reflektime e studime letrare, etike, filozofike, juridike e politike e madje edhe gjeopolitike në një evolucion të vazhdueshëm. Për këtë arsye, qëllimi i këtij prezantimi është thjesht hapja e një dritareje të vogël nga ku do të tentohet të përkufizohet paradigma e lirisë në

gjenezën e saj në botën antike greke, me gjithë shumëllojshmërinë e interpretimeve që mbart.

Sipas fjalorit *Oxford English Dictionary* [9] paradigma “është një formë, një model apo një ekzemplar”. Ndërsa, vlerësohet se sociologu Thomas Kuhn i dha paradigmës kuptimin e saj më bashkëkohor, në veprën *Struktura e Revolucionit Shkencor* [3] e përkufizon paradigmën si “një set arritjesh shkencore të njohura universalisht, të cilat, për një periudhë kohore ofrojnë modele problematikash dhe zgjidhjesh për një komunitet kërkuesish”. Nga përkufizimet e mësipërme rezulton se paradigma është më e gjerë se një teori, ajo është një vizion i botës, një dritare mendore, një rrjetë leximi që paraprin elaborimin teorik. Nisur nga ky përkufizim, rrënjët e paradigmës së lirisë në Europë do të na duhet t’i kërkojmë që nga gjeneza, nga etimologjia e fjalës EUROPË. Për herë të parë e gjejmë në mitologjinë antike kreteze [12] – EUROPA – ajo që ka fytyrë të gjerë dhe të bardhë si Hëna, vajza ose gruaja e Feniksit nga Azia (prej nga merr emrin Fenicia) rrëmbëhet nga Zeusi, nën pamjen e një demi (simbol i diellit) dhe çohet në Kretë.

Sipas një tjetër etimologjie antike, fjala EUROPE rrjedh nga rrënja semite “erebu” = perëndim dielli, ndërsa ASIA nga rrënja semite “asu” = lindje dielli [8]. Pra, nga pikëpamja etimologjike Azia personifikonte “tokën e lindjes së diellit”, ndërsa Europa “tokën e perëndimit të tij”. Në këtë paradigmë të parahistorisë shohim se si në perëndim të historisë së Europës shtrihej bota e njohur e lindjes dhe bota e panjohur e perëndimit, e cila pritej ende të zbulohej. Kjo çoi në krijimin e një qytetërimi të ri, i cili do të mbante emrin e vajzës aziatike dhe do të përhapej në të gjithë gadishullin europian, në një përzjerje gjaku egjiptian, fenikas, grek dhe aziatik [11].

### **Europa dhe jo-Europa**

Fillimisht, vepër e mendimit grek ishte të tregonte se çfarë është Europa, duke e dalluar atë nga Azia dhe nga kontinentet e tjera. Karakteristikë e kësaj periudhe është se Europa nuk përcaktohet asnjëherë nga vetvetja, por në raport me diçka tjetër. Kështu Esiodi (770 p.e.s.), në veprën e tij *Teogonia* e përshkruan Europën si “motrën e Azisë”, ndërsa Ovidi tek *Metamorfozat* [5] si “mbesën e Libisë”. Nga kjo përballje fizike filluan diskutimet mbi pozicionin gjeografik, si dhe mbi ndryshimet kulturore, morale dhe politike ndërmjet Europës dhe jo-Europës.

Pozicioni gjeografik i europës ndikoi edhe në formimin e moralit, karakterit, deri në stilin e jetës së europianëve, duke influencuar kështu në krijimin e konceptit të “lirisë”. Ndërmjet shekullit të V dhe të IV para Krishtit lindi një ndërgjegje “Europiane” (ose Perëndimore) kundrejt një ndërgjegjeje “Aziatike” (ose Lindore), e cila fillimisht kishte karakter “mbrojtës” dhe më pas mori karakter “ofendues” dhe ekspansionist [10].

Kështu për shembull në shekullin e V p.K., në traktatin e Hipokratit, babait të teorisë së ambientit, të titulluar “Për ajrin, ujrat dhe vendet” gjejmë të përmendur tezën e tij, sipas së cilës “aziatikët janë inferiorë, si nga pikëpamja morale ashtu edhe nga ajo fizike, krahasuar me barbarët europianë, të cilët kanë, ashtu si edhe grekët, ndjesinë e lirisë [7]”. Në librin e IV, kapitulli i V i “Politikës” së Aristotelit [1] rimerret dhe saktësohet ideja se nëse grekët do të ishin të bashkuar në një shtet të vetëm do të zotëronin perandorinë e botës. Sipas tij, europianët duke qenë kurajozë dhe inteligjentë jetojnë në liri, janë të pavarur, drejtohen sipas ligjeve. Edhe nga pikëpamja ushtarake europianët janë luftëtarë më të mirë, më me shpirt, pikërisht sepse luftojnë për veten dhe jo për një padron.

## Vlera politike e lirisë

Nga sa thamë më sipër, del qartë se fillimisht koncepti i “paradigmës së lirisë”, si një moment aspak teogonik, por si një eksperiencë e përjetuar dhe më pas e transformuar në reflektim filozofik, mendohet t’i ketë rrënjët në kulturën greke të antikitetit. Fjala LIRI me origjinë nga greqishtja “eleutheria” përkufizon grekët, të cilët pasi luftuan armikun e brendshëm (tiranin) dhe atë të jashtëm (perandorinë persiane), “shpikën” politikën, pra krijuan një hapësirë të përbashkët, në të cilën vend qendror zë dialogu dhe jo dhuna dhe ku vendimet merren nga komuniteti. Në këtë fitore të dyfishtë, të brendshme dhe të jashtme, që rrjedh nga refuzimi i ndërgjegjshëm për t’ju nënshtruar një autoriteti superior rrjedh **vlera politike e lirisë**. Fitorja e Helenëve ndaj Medëve është fitorja e lirisë mbi skllavërinë; liri që nënkupton barazinë e pushtetit politik, një fitore triumfuese mbi një ushtri shumë më të madhe, por të përbërë nga skllavër. Liria nga rreziqet e jashtme, nga tirania, konsiderohet një nga përkufizimet më të rëndësishme kur i referohemi polis, duke përbërë ideologjinë kryesore të Athinës së shekullit të V-të, e reflektuar kjo në veprat e historianëve, filozofëve dhe tragjedianëve, (përtej faktit se kjo ishte një eksperiencë e jetuar nga qytetarët). Liria bëhet kështu vlera që përmbledh qënien politike të Athinasve, një motiv për fitore, krejt e kundërta e botës barbare. Këtë e gjejmë deri diku tek Platoni, por kryesisht tek Aristoteli. Sikurse përmendëm dhe më lart, ky i fundit dënon skllavërinë dhe tiraninë, si dhe kontrastin ndaj gjendjes servile të persianëve. Për Aristotelin liria është ajo çka dallon popullin e tij helen nga popujt lindorë. Sipas tij skllavi është “një instrument i pa shpirt [1]”, një njeri që nuk i përket vetvetes, por një tjetri. Kjo domethënie politike e fjalës liri rrjedh nga koncepti praktik i POLIS. Aristoteli na kujton se të qenit të lirë është një gjendje juridike e atij që gëzon të gjitha të drejtat civile. **Liria përkon me Logos-in, pra me arsyen.**

Eksperienca e lirisë greke është një nga vlerat më të rëndësishme të grupeve sociale e popujve, e cila përmban në vetvete dy aspekte të rëndësishme: nga njëra anë thjeshton aftësinë e autodeterminizmit [4]/vetëpërcaktimit, duke krijuar ligje dhe duke drejtuar një politikë të jashtme (autonomi) dhe nga ana tjetër ofron mundësi pjesëmarrjeje të barabarta në proceset vendimmarrëse, nëpërmjet ndërhyrjes në punët e Asamblesë. Liria, pra është pushtet i cili i lejon qytetarëve të njëjtat të drejta politike. Në këtë mënyrë ajo konsiderohet si **sinonim i barazisë**.

Nga pikëpamja filozofike, **liria është e lidhur me njohjen/njohurinë**, që i ofron motivin, arsyen dhe drejton zgjedhjen. Megjithatë, aspekt i rëndësishëm i kësaj paradigme është fakti se bëhet fjalë për një **liri në kuptimin e një konteksti politik, jo personal**. Liria që do të fitohet apo mbrohet nuk është liri e individit, por e komunitetit politik. E parë nga brenda liria ekziston aty ku ka qytetarë të barabartë, që diskutojnë gjërat në publik nga një pozicion i barabartë. Në një plan të jashtëm, një komunitet politik është i lirë kur ka ligjet e veta dhe i zgjedh vetë miqtë apo armiqtë e tij.

Në botën greke liria mbetet një vlerë e jetuar dhe e vlerësuar. Studiuesi Hegel në veprën e tij *Filozofia e Historisë* [2] e vendos lirinë në një raport historik me lindjen e lirisë në POLIS-in grek dhe më pas me krishtërimin. Sipas tij, historia e lirisë nis me POLIS-in, në të cilin nënkupton një komunitet qytetarësh të lirë, të cilët kishin pranë tyre skllavërinë. Më pas me krishtërimin afirmohet parimi se të gjithë njerëzit janë të lirë, që nënkupton se njeriu është i lirë pasi pikësëpari është njeri.

## **Liria si Tirani**

Por le të rikthehemi edhe një herë tek **Platoni** [6]. Për këtë mendimtar të shquar, liria nuk ka një rol themelor në vizionin e tij politik. Në sytë e tij ekzistonte rreziku se **një dashuri shumë e madhe për lirinë mund të sillte të kundërtën, tiraninë**. Në këtë kontekst një tjetër aspekt i paradigmës së lirisë është fakti se mbivlerësimi për veten ka gjeneruar një sjellje konservatore, vetëmbrojtëse por edhe ekspansioniste, nga ana e individëve apo nga ana e një shoqërie.

Bindja se mendimi filozofik ishte një pushtim filozofik tipik perëndimor ka përforcuar paradigmën “eurocentriste” duke vendosur hierarki ndërmjet kategorive sociale dhe kulturore me qëllimin e vetëm që t’i sigurojë europës një lloj supremacie të mendimit filozofik. Në këtë mënyrë europa konsiderohet si në rolin e legjislatorit global, me një “mision qytetërimi”. Hegjemonia e europës nën formën e një paradigme dominuese në relacionin me tjetrin, ka penguar shkëmbimet me traditat e tjera intelektuale.

Lindja paraqitej si pasqyra negative e Perëndimit, si mungesa e karakteristikave të Perëndimit. Orientit i mohohet një ekzistencë e pavarur prej Perëndimit, ndonëse ka qenë aty për të kënaqur nevojat e europianit për tregje, lëndë të parë, aventurë dhe për idenë e madhështisë apo të racës së zgjedhur. Lindja kthehet në një objekt pasiv, për të cilin perëndimi është njëherazi vepruesi, spektatori dhe gjykatësi. Kur kategoritë “lindor” dhe “perëndimor” përdoren si vendndisje dhe vendmbërritje e analizës, atëherë përfundimi që përftohet është skajëzimi i mëtejshëm i dallimeve midis këtyre dy pjesëve të përfytyruara të botës. Në këtë mënyrë, “lindori” bëhet më “lindor” dhe “perëndimori” bëhet më “perëndimor” dhe kufizimi në qasjen njerëzore midis kulturave, traditave dhe shoqërive të ndryshme thellohet.

## **Përfundime**

Analiza përshkruese e këtij punimi na çon në përfundimin se gjeneza e paradigmës së lirisë i ka rrënjët në Polis-in grek, aty ku liria mbetej një vlerë e jetuar dhe e vlerësuar në komunitet. Ajo përkon me logos-in, barazinë dhe njohurinë. Kjo paradigmë ka shërbyer si pikë e rëndësishme orientimi për evoluimin e këtij koncepti nga liria në grup në liri individuale, çka nënkupton një lëvizje universale që shkon nga liria e disave tek liria e të gjithëve. Ky studim kishte për qëllim evidentimin e gjenezës së paradigmës së lirisë. Ndërkohë evoluimi, drejt lirisë së lidhur me të drejtën dhe politikën mbetet objekt i diskutimeve të mëtejshme, pasi e gjithë historia e filozofisë perëndimore mund të përshkruhet si një “pasardhje” e filozofive të lirisë apo si një “metamorfozë” e idesë së lirisë.

Paradigma liri – despotizëm ka gjeneruar kategori të tjera dikotomish, si p.sh. Perëndim - Lindje, ne – ata, civilizim dhe barbari, të cilat kanë karakterizuar historinë e europës nga origjinat më të largëta të saj deri në ditët e sotme. Ndonëse hendeuku midis tyre sot nuk është aq i theksuar sa në të kaluarën, përsëri ka ende rrugë për të bërë deri në ndërgjegjësimin e plotë të shteteve anëtare apo jo të BE-së se kundërvënia ndërmjet këtyre kategorive është ndryshim dhe jo përplasje.

## Referencat

Aristotele, (2007) *Politica*, Edizione 10, Laterza.

Hegel G W F (1956) *Lectures on the Philosophy of History*, trans. J. Sibree New York: Dover.

Kuhn Th.S (1962) *The Structure of Scientific Revolution*, 3<sup>rd</sup> edition, University of Chicago Press,

Linguiti A (2009) *Scielta e liberta' nel pensiero antico, Scelta dei Atti del convegno nazionale* 29/30 gennaio, Collana Symbolon.

Ovidio P N (2005) *Metamofosi, Classici Latini*, Torino, UTET. Second book.

Platone (2007) *La Repubblica*, Libro VIII, Laterza,

Reynold de G (1957) *Le toit chre'tien* , vol. VII nga *La formation de l'Europe*, Plon, Paris.

Romoli R, (1991) *FIORI DI CARDO*, Nardini Editore, Firenze

Simpson John, Weiner E (1989) *Oxford English Dictionary*, Second Edition, Volume I, Oxford University Press.

Sinani Gj (2008) "Leksionet mbi Historinë e idesë së Europës"

Turroni F, (2005) *Kumtesë me temë "Il vagare di Cadmo"*, *Universiteti i Bolonjës*.

World Book Encyclopedia, (1992 – 1993) World Book Inc., New York , Vol. 6

# **MOBBING NË ARSIMIN E LARTË NË SHQIPËRI DHE KARAKTERISTIKAT E PERSONALITETIT**

**Migena Buka, Theodhori Karaj**

Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës

## **Përmbledhje**

*Mobbing* në vendin e punës është një koncept i ri që ka filluar të studiohet në fillim të viteve '90, e megjithatë ai ka ekzistuar që më parë. Për shkak të kompleksitetit të *mobbing* për tu vëzhguar apo për tu gjetur në arkivat e kompanisë, si dhe bazuar në studimet e ndryshme të bëra në Europë dhe më tej, mënyra që u zgjodh për ta studiuar ishte pyetsori vetëraportues. Përveç prevalencës së *mobbing*, pyetsori përfshinte edhe shkallën e vetvlerësimit të Rosenberg si dhe informacion demografik. U shpërndanë 300 pyetsorë tek pedagogët e universiteteve publike. Instrumenti që u përdor për të matur *mobbing* në vendin e punës ishte Pyetsori i Veprimeve Negative. Të dhënat u analizuan sipas përkufizimit operacional të Leymann (1990) për *mobbing* (të paktën një herë në javë, për të paktën 6 muaj rresht). U përllogarit prevalenca e fenomenit *mobbing* në universitetet publike si dhe lidhja korelacionale që kishte me shkallën e vetvlerësimit dhe gjininë. Në fund paraqiten konkluzionet bazuar në gjetjet e këtij studimi.

**Fjalët kyçe:** *mobbing* në vendin e punës, institucionet e arsimit të lartë, vetvlerësimi

## **Abstract**

*Mobbing* in the workplace is a very new concept studied in the organizations at the beginnings of '90s, yet it is believed to have existed long before they gave it a name. Due to the complexity of the phenomenon to be observed or documented in the companies' archives as well as based on the other researchers' experiences, the best way to establish the prevalence was thought to be the self report questionnaires. 300 questionnaires were distributed to full time lecturers in the public universities around Albania. The survey include the Negative Act Questionnaire - to measure *mobbing*; Rosenberg self esteem scale as well as some demographic information questions. The percentages were calculated based on Leymann's (1990) operational definition about *mobbing* in the workplace (at least once a week, for six months or more). The prevalence of *mobbing* was calculated, as well as its correlation with self esteem scale and gender. In the end, based on the findings of the study, the respective conclusions are drawn.

**Keywords:** *mobbing* in the workplace, higher education institution, self esteem

## **Hyrje**

Në këtë artikull do të paraqiten disa të dhëna nga studimi që është bërë për *mobbing* në vendin e punës, në universitetet publike në Shqipëri. Punonjësit në sektorin publik janë ata që njihen si një nga sektorët me nivele më të larta të *mobbing* (Einarsen & Skogstad, 1996). Në Mbretërinë e Bashkuar 70% e personave të punësuar në edukim dhe 20% të të punësuarve në shëndetësi, janë viktimat të *mobbing*. *Mobbing* është më i

përhapur në sektorin e burgjeve, shëndetësisë, dhe edukimit si dhe tek punonjësit e postë-telekomunikacionit (cituar në Cartwright & Cooper, 2007). Mobbing në vendin e punës duket se ka prevalencë më të lartë në sektorin e shërbimeve – si edukimi, dhe shëndetësia ku puna është komplekse, qëllimet nuk janë gjithnjë shumë të qarta, praktikat më të mira janë të debatueshme dhe disiplina është shumë larg (Westhues, 2002). Ka studime të cilat sugjerojnë se mobbing në vendin e punës ndikon 2-5% të të gjithë punonjësve, por numri më i madh i këtyre praktikave është në institucionet akademike (Leymann & Gustafsson, 1996). Janë të tilla gjetjet në literaturën ndërkombëtare që u bënë shtysë për ndërmarrjen e këtij studimi në Shqipëri. Mobbing në vendin e punës u shqyrtua në lidhje me vetvlerësimin dhe u gjet se rreth 8% e pedagogëve në universitetet publike janë viktimat e mobbing, dhe ata kanë vetvlerësim më të ulët krahasuar me kolegët e tyre, që nuk janë viktimat të mobbing. Diskutimet dhe implikimet që mund të sjellë këto gjetje janë diskutuar më hollësisht në seksionin e diskutimeve.

*Mobbing* vjen nga fjala “to mob” në anglisht që do të thotë: të mblidhesh përreth dhe të bezdisesh, sidomos kur je i inatosur, ose të mblidhesh dhe të sulmosh kur je në numër të madh dhe të fitosh.

Për herë të parë, fjala *mobbing* është përdorur nga një etnolog, Konrad Lorenz i cili përshkruan një sjellje në grup të kafshëve. Sipas Lorenz (cituar në Leymann, 1996) sulmi i një grupi kafshësh të vogla kundër një kafshe të madhe të vetme quhet *mobbing*. Ky term u huazua nga një doktor suedez Heinemann i cili ishte i interesuar të gjente çfarë mund të bënin fëmijët kundër njëri-tjetrit gjatë orës së pushimit. Ky studiues e përdori termin *mobbing*: sjellje shkatërruese i një grupi të vogël fëmijësh kundër (shpeshherë) një fëmije të vetëm (cituar në Leymann, 1996).

Në vitet e mëvonshme, Leymann huazoi këtë term pasi gjeti një sjellje të ngjashme në vendin e punës. Megjithatë Leymann (1996) nuk u fokusua tek ngacmimet fizike si ndodh *mobbing* në botën e kafshëve, por tek ngacmimet emocionale. Pas vitesh të tëra studimi, artikujsh të botuara nga ky studiues *mobbing* fitoi të drejtën për t’u trajtuar si një koncept dhe fenomen i veçantë.

## ***Mobbing* dhe Fenomene të Ngjashme**

### **Mobbing dhe bullizmi**

Fillimisht këto dy terma kishin disa ndryshime të caktuara. Bullizmi është një term i cili ka një histori pak më të gjatë se *mobbing* dhe ka shumë studiues të cilët i përdorin këto dy koncepte në vend të njëri-tjetrit (Namie, 2003). Megjithatë gjatë shqyrtimit të literaturës do t’i citoj këta autorë, mbetem e mendimit se *mobbing* përfaqëson një fenomen që ka pika të përbashkëta por është krejtësisht i veçantë nga bullizmi.

Së pari, bullizmi tipikisht i referohet sjelljes së nxënësve në shkollë (Westhues, 2002). Gjithashtu bullizmi ka një konotacion të agresivitetit fizik dhe kërcënimit, ndërsa *mobbing* është një mënyrë më e sofistikuar e sjelljes, dhe thuhet se asnjëherë nuk përfshin sulme fizike. Konfrontimi fizik është një ngjarje që haset kryesisht tek moshat shkollore, por rrallë mund të dëgjohet për të tilla ngjarje ndërmjet kolegëve në punë. Punonjësit zgjedhin mënyra të rafinuara për të bërë dikë të ndjehet keq, si për shembull: nëpërmjet izolimit social, thashethemeve të ndryshme, ose thjesht duke ndërprerë një bisedë në



momentin kur personi i “padëshiruar” afrohet. Në raste të tilla, në pamje të parë as nuk mund të akuzosh askënd për *mobbing*.

### **Mobbing jo konflikt**

Një mënyrë për ta parë *mobbing* në vendin e punës është “konflikt i ekzgjeruar”. *Mobbing* zhvillohet si pasojë e një konflikti pas një kohe të caktuar, ndonjëherë shumë shpejt, ndonjëherë pas javësh ose muajsh. Konflikti në tërësinë e tij nuk është gjithnjë shkatërrues dhe mund të lindë, të zhvillohet dhe të zgjidhet brenda një kohe të caktuar. Për më tepër një konflikt mund të zgjidhet dhe të ketë pasoja pozitive të gjitha palët e përfshira në të. *Mobbing* nga ana tjetër ka gjithnjë konotacion negativ, zhvillohet me dijeninë e plotë të personave që e ushtrojnë atë, si për procesin ashtu edhe për pasojat. *Mobbing* nuk është një konflikt i fuqishëm një herë, por një seri ngjarjesh që vazhdojnë në kohë dhe që çojnë në shqetësime të ndryshme fiziologjike dhe psikologjike (Leymann, 1996). Për më tepër që *mobbing* kurrë nuk ka pasoja pozitive për personin që është viktimë e fenomenit.

### **Ngacmuesit dhe viktimat**

Është sugjeruar disa herë se ka disa karakteristika personaliteti që dallojnë ngacmuesit dhe viktimat. Disa nga gjetjet në literaturë sugjerojnë se viktimat janë persona që besojnë, bashkëpunues, të ndërgjegjshëm, punonjës me performancë të lartë, dhe shpesh besnikë ndaj kompanisë (Davenport, 2002; Leymann, 1996). Këto rezultate bien në kundërshtim me gjetjet nga studime të tjera të cilat tregojnë se ka karakteristika të personalitetit që i bëjnë punonjësit të jenë ngacmues apo viktima (Zapf & Einarsen, 2001). Në këto studime, ngacmuesit perceptohen si autoritarë, manipulues, të pandjeshëm, “djallëzorë”, sadistë (Davenport, 2002), ndërsa viktimat perceptohen si “të dobët” dhe “të pashpresë”. Megjithatë, studiues të tjerë kanë gjetur se është pozicioni i punës ai që sulmohet dhe jo individi që e zë atë vend pune (Leymann & Gustafsson, 1996).

Karakteristikat e personalitetit dominues dhe dëshirës së ulët sociale janë lidhur me *mobbing* (Parkins, Ritchey, & Fishbein, 2006). Studimet kanë treguar se kërcënimet ndaj vetvlerësimit siç është ndryshimi organizativ i cili kërcënon ekspertizën e konsoliduar dhe marrëdhëniet në fuqi, rezultojnë në agresion (cituar në Akar, Anafarta, & Sarvan, 2011). Akar et.al (2011) studiuuan statusin sociometrik të viktimave dhe të agresorëve, dhe ndryshe nga ç’pritej viktimat ishin “yjet” dhe jo “të përjashtuarit”.

Leymann (1996) ishte i qartë në idetë e tij për të konsideruar karakteristikat e personalitetit në studimin e *mobbing*. Ai gjykoi se “pohimet për problemet e karakterit të një individi të vetëm, logjikisht janë të gabuara”. Leymann thotë se personaliteti nuk është faktor që duhet marrë në konsideratë. Sipas tij, vendi i punës nuk duhet ngatërruar me situata të tjera në jetë, sepse vendi i punës është ambient ku sjellja e duhur bëhet e ditur që në fillim. Konfliktet në punë duhet të kontrollohen dhe të rregullohen nga eprori, dhe kur konfliktet arrijnë fazën e sjelljeve të *mobbing*, sipas Leymann “është e pavend t’ia vësh fajin personalitetit të dikujt”.

### **Mobbing në Arsimin e Lartë**

Shumë studiues që kanë studiuar fenomenin e *mobbing* janë fokusuar në dy sektorë kyçë në ekonominë e çdo vendi: në arsimin e lartë dhe në shëndetësi. Duket se në këto sektorë *mobbing* gjendet më shumë se në çdo sektor tjetër. Kjo lidhet veçanërisht

me konkurrencën e lartë dhe me mungesën e qartësisë në përcaktimin e detyrave të punonjësve. Lewis në studimin e tij flet për një evidencë të qartë të fenomenit të *mobbing* në universitete dhe institucione të arsimit të lartë (Lewis, 2004). Ai përmend raste të ndryshme të këtyre pedagogëve të cilët kanë qenë viktimë të fenomenit *mobbing* për mesatarisht tre vjet, dhe pasojat pas kësaj eksperience vazhdonin të ishin aty (Lewis, 2004).

Një nga kontribuesit më të mëdhenj në fushën e *mobbing* është Kenneth Westhues. Ai është fokusuar ekskluzivisht në *mobbing* në arsimin e lartë. Bazuar në studime të ndryshme, ai ka përcaktuar edhe një profil për viktimën më të mundshme të *mobbing*. Sipas tij, viktimë është një pedagog me 10–20 vjet punë; shumë i/e suksesshëm/e në profilin tij/saj; shumë i respektuar nga studentët dhe i vlerësuar nga eprorët. Goditjet e *mobbing* kryesisht përgatiten dhe vijnë nga kolegë, zakonisht për motive smire dhe lakmie (Westhues, 2005). Sipas Thomas (2005) 45% e punonjësve në arsimin e lartë kanë pasur eksperiencën *mobbing* të paktën një herë në vitin e shkuar, dhe tek këta persona shqetësimet më të dukshme fizike ishin: dhimbje koke, të përziera, shtrëngime në stomak, djersë të ftohta etj (Thomas, 2005).

### **Qëllimi i studimit**

Qëllimi i këtij studimi është të ofrojë një tablo të gjerë mbi fenomenin *mobbing* në Shqipëri, të japë statistika mbi prevalencën e fenomenit, nëse ka lidhje me pozicionin e punës, etj. Gjithashtu në këtë studim është studiuar marrëdhënia që ka vetëvlerësimi i individit me të qenit ose jo vikimë e *mobbing* tek pedagogët e arsimit të lartë.

### **METODA**

#### **Pjesëmarrësit**

U shpërndanë 300 pyetsorë tek pedagogët e universiteteve publike: Universiteti i Tiranës; “Aleksandër Moisiu”, Durrës; “Ismail Qemali”, Vlorë; “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan; “Luigj Gurakuqi”, Shkodër; “Eqerem Çabej”, Gjirokastrë dhe “Fan Noli” Korçë. Përqindja e përgjigjeve ishte 56.7%, me 169 pyetsorë të kthyer dhe të plotësuar. Moshë mesatare e pedagogëve ishte 36.3 vjeç dhe varionte nga 22–64 vjeç. Nga pjesëmarrësit, 124 ishin femra (73.4%) ndërsa 45 ishin meshkuj (26.6%).

#### **Instrumentet**

Instrumenti kryesor në këtë studim ishte Pyetsori i Veprimeve Negative në vendin e punës, i rishikuar (NAQ-R, Einarsen, Hoel, & Notelaars, 2009). Instrumenti përmban 22 pohime të cilat kërkojnë informacion mbi veprimet e ndryshme negative në vendin e punës. Pyetsori u përkthye nga anglishtja në shqip, dhe pastaj sërish nga shqipja në anglisht nga ekspertë të gjuhës angleze dhe ekspertë në fushën e psikologjisë. U pilotua në 50 pedagogë, të cilët nuk u përfshinë në kampionin final. Pyetsori tregoi se kishte një besueshmëri të mirë të brendshme me Alfën e Chronbach’ut 0.94.

Përveç pyetsorit të veprimeve negative u përfshinë pyetje demografike si dhe shkalla e vetëvlerësimit të Rosenberg’ut.

#### **Hipotezat dhe analiza e të dhënave**

Analizat për këto të dhëna kaluan në disa faza. Fillimisht u përllogaritën statistikat përshkruese për prevalencën e *mobbing* në sektorin e arsimit të lartë në Shqipëri. U përllogaritën frekuencat, mesataret dhe devijimi standart për fenomenin

*mobbing*, të dhënat demografike dhe vetëvlerësimin e pjesëmarrësve (i lartë; mesatar; i ulët).

Në këtë studim u hodhën dy hipoteza:

1. Pedagogët që janë viktimë të *mobbing* (bazuar në përkufizimin e Leymann, 1996) shfaqin më shumë vetëvlerësim të ulët sesa ata që nuk janë viktimë të *mobbing*. Kjo hipotezë u testua nëpërmjet analizës së variancës (ANOVA).

2. Viktimë të *mobbing* janë më shumë femrat sesa meshkujt. Kjo hipotezë u testua nëpërmjet korelacionit chi-square ( $\chi^2$ ).

## REZULTATET

Nga 169 pjesëmarrësit në këtë studim u morën të dhënat demografike mbi gjininë, vitet në punë, moshën, niveli i *mobbing* ndaj të cilit janë ekspozuar, si dhe vetëvlerësimi që kanë për veten. Mesataret, përqindjet dhe devijimin standart për këto ndryshore janë paraqitur në Tabelën 1.

|                | Kategoritë  | Mesatare | Devijimi standard | Përqindje (%) |
|----------------|-------------|----------|-------------------|---------------|
| Gjinia         | Femër       |          |                   | 73.4          |
|                | Mashkull    |          |                   | 26.6          |
| Mosha          |             | 36.4     | 10                |               |
| Vite në punë   |             | 13.2     | 10                |               |
|                | Nën 10 vjet |          |                   | 55.1          |
|                | Mbi 10 vjet |          |                   | 44.9          |
| <i>Mobbing</i> |             | 33.97    | 7.96              |               |
|                | Viktimë     |          |                   | 8.2           |
|                | Jo viktimë  |          |                   | 91.8          |
| Vetëvlerësim   |             |          |                   |               |
|                | Ulët        |          |                   | 21.3          |
|                | Lartë       |          |                   | 78.7          |

**Tabela 1.** Mesataret, përqindjet dhe devijimet standarte të disa ndryshoreve demografike

Nga kampioni, 41.9% e pedagogëve ishin 25-35 vjeç; 51.6% ishin nga 36-50 vjeç dhe 6.5% ishin mbi 50 vjeç; 9.8% e pjesëmarrësve mbanin edhe pozicione drejtuese (shef departamenti, zëvendësdekan, dekan), ndërsa 90.2% ishin pedagogë me kohë të plotë, pa ndonjë pozitë administrative në universitetin respektiv. Sipas shkallës së veprimeve negative në punë, 8.2% e pedagogëve ishin viktimë të *mobbing*, por pyetjes së

drejtpërdrejtë nëse kishin qenë viktimat të *mobbing*, 15.4% u përgjigjën se e konsideronin veten viktimë të fenomenit.

Pyetjes se kush ishte personi (personat) që kishin shkaktuar këtë situatë, 64.7% u përgjigjën për kolegët e tyre, 29.4% për eprorët, ndërsa 5.9% thanë se ata që i kishin ngacmuar ishin vartës të tyre.

Në lidhje me vetëvlerësimin, rezultoi se nga 169 pedagogët që u përgjigjën 36 prej tyre (21.3%) ishin me vetëvlerësim të ulët, të matur sipas shkallës së Rosenberg, ndërsa 78.7% rezultojnë me vetëvlerësim të lartë. Me anë të analizës së variancës u gjet se kishte një ndryshim statistikisht të rëndësishëm ndërmjet viktimave të *mobbing*, dhe jo-viktimave ( $F=4.07$ ,  $p<0.05$ ), në lidhje me vetëvlerësimin e tyre. Me fjalë të tjera, personat me vetëvlerësim të ulët kishin më shumë gjasa të ishin viktimat të *mobbing* sesa personat me vetëvlerësim të lartë. Nëse është vetëvlerësimi i ulët që bën që personat të kthehen në viktimat të *mobbing*, apo është fakti se janë viktimat e *mobbing* që u ulët vetëvlerësimi për veten, kjo është një çështje që duhet studiuar në studimet e mëvonshme.

Përsa i përket hipotezës së dytë, ku pritej që viktimat e *mobbing* të jenë më shumë femrat sesa meshkujt u përdor koeficienti i korelacionit  $\chi^2$  (chi-square). Megjithatë në frekuencat bruto, rezultoi se viktimat e *mobbing* janë më shumë femrat se meshkujt (respektivisht: 9 dhe 2), koeficienti i korelacionit rezultoi jo statistikisht i rëndësishëm. Kjo sepse edhe përqindja femra/meshkuj në universitet publike në këtë kampion është në favor të femrave (124 ishin femra - 73.4% ndërsa 45 ishin meshkuj - 26.6%). Pas analizave statistikore, përfundimi është se të jesh viktimë e *mobbing* nuk ka ndonjë lidhje me të qenit mashkull apo femër ( $r=-0.05$ ,  $p>0.05$ ), por është një fenomen që mund të prekë këdo pavarësisht nga gjinia.

## Diskutimi

Në vitet e fundit, *mobbing* ka fituar një vëmendje të konsiderueshme nga studiuesit e shkencave sociale. Pas vitit (1990), vit kur Leymann i vuri një emër këtij fenomeni, ka pasur jo vetëm studime dhe instrumenta për të matur *mobbing* (WAMI, NAQ-R) por edhe themelime të instituteve të ndryshme (Workplace Bullying Institute, Bergen Bullying Research Group etj.) pranë universiteteve apo qendra për të ofruar mbështetje për viktimat e *mobbing*.

Në dijeninë e studiueses nuk ka ndonjë studim të ngjashëm që përpiket të përcaktojë prevalencën e këtij fenomeni në sektorin e edukimit të lartë në Shqipëri. Për të konsideruar një sjellje si *mobbing*, duhet të ndodhë të paktën një herë në javë, për një periudhë të paktën 6 muaj (Leymann, 1996). Një ngjarje e vetme nuk konsiderohet *mobbing*, dhe nuk konsiderohet *mobbing* as kur të dyja palët janë të barabarta në një konflikt të fortë ndërmjet tyre (Zapf, Knorz, & Kulla, 1996). Gjithashtu, në një zyrë, jo të gjithë kolegët e zyrës janë viktimat të *mobbing*; zgjidhet një ose dy viktimat dhe të gjitha sjelljet drejtohen drejt viktimës me synimin për të poshtëruar, vënë në siklet dhe me kalimin e kohës për ta përzënë nga puna (Efe & Ayaz, 2010). *Mobbing*, gjithashtu, nuk ndodh kur punonjësi mund të gjejë lehtësisht një vend tjetër pune (Duffy & Sperry, 2007).

Studimi aktual synon të përcaktojë një prevalencë të fenomenit *mobbing* në sektorin e arsimit të lartë publik në Shqipëri. Sipas shkallës së Veprimeve Negative në Punë 8.2% e pedagogëve pjesëmarrës në studim rezultuan të ishin viktimat të *mobbing*,

por pyetjes së drejtpërdrejtë nëse ishin viktimë të *mobbing* u përgjigjën pozitivisht 15.6% e pjesëmarrësve. Sipas një raporti në Organizatës Ndërkombëtare të Punës (Hoel, Sparks, & Cooper, 2002), 80% e punonjësve janë viktimë të *mobbing* të paktën një herë në jetë e tyre profesionale, por kjo përqindje bie në 8-9% në një pikë të caktuar në kohë. 15.4% është një shifër e lartë duke pasur parasysh se institucionet ku është zhvilluar studimi konsiderohen elitare. Megjithatë, një arsye për këtë përqindje të lartë të vetëraportimit të *mobbing* në vendin e punës mund të lidhet me faktin se *mobbing* mund të jetë perceptuar si një lloj konflikti (të paktën një herë) ndërmjet kolegësh apo vartës-eprorë, më shumë sesa një fenomen që zgjat në kohë.

Në këtë studim u gjet se *mobbing* në vendin e punës shoqërohej me vetëvlerësim më të ulët për personat që ishin viktimë të *mobbing*, sesa ata që nuk ishin. Kjo gjetje është e njëjtë me literaturën botërore ku ndër pasojat e *mobbing* përmenden: ulje e moralit dhe e vetëvlerësimit, largim nga puna (Lybecker & Sofield, 2000); simptoma të stresit post-traumatik (Leymann & Gustafsson, 1996; Matthiesen & Einarsen, 2007); reagime të larta frike, çrregullime gastrointestinale, shqetësime të gjumit, depresion dhe ankth (Schat & Kelloway, 2003); e madje disa gjetje kanë sugjeruar se *mobbing* çon deri në vetvrasje si një tentativë për të gjetur paqe ndaj braktisjes që i është bërë viktimës (Namie & Namie, 2003). Mbetet ende për t'u studiuar dhe për të gjetur një përgjigje ndaj pyetjes: është *mobbing* në vendin e punës që çon në një vetëvlerësim më të ulët, apo duke qenë një person me vetëvlerësim të ulët, ka më shumë predispozitë për të qenë pre e *mobbing*?

Hipoteza tjetër ku pritej që femrat të ishin më shumë viktimë të *mobbing* sesa meshkujt nuk u mbështet nga gjetjet e këtij studimi. Ka shumë studiues që kanë vënë re ndryshime të gjinisë në lidhje me *mobbing* në vendin e punës. Gratë mund të manipulojnë më tepër dhe burrat po përshtaten ta mësojnë këtë stil, sepse funksionon (Bjorkqvist, Osterman, & Lagerspetz, 1994). Sipas Bjorkqvist et. al (1994) gratë janë më të predispozuara të përdorin agresionin indirekt dhe të fshehur, dhe kjo mënyrë të sjelluri është më e pranueshme në punë. Einarsen & Skogstad (1996) raportuan se ka më shumë gra që janë viktimë të *mobbing* sesa burra. Megjithatë, një rezultat i tillë mund të mbështetet nga fakti që *mobbing* në vendin e punës nuk zgjedh, por mund të bëjë viktimë këdo që është aty.

### **Konkluzione**

Një konkluzion i rëndësishëm për t'u nxjerrë nga ky studim është se *mobbing* në vendin e punës haset dendur, por në shumicën e kohës është një fenomen që anashkalohet në organizatë dhe nuk është pjesë e identifikimit si problem, dhe aq më pak i trajtimit të tij. Pedagogët në këtë studim raportuan që ishin të ekspozuar ndaj *mobbing* dhe kjo vinte kryesisht nga kolegët, dhe më pak nga eprorët. Kjo situatë redukton vetëvlerësimin i cili më pas mund të lidhet me shumë pasoja të tjera. Sugjerohet që fenomeni *mobbing* të studiohet më në detaje për të kuptuar më qartë shkaqet dhe pasojat e tij, sepse me këto të dhëna që kanë dalë nga ky studim mund të aludohet që *mobbing* në vendin e punës është një nga faktorët më të rëndësishëm që ndikon në jetën e punonjësve. Pasi të hidhet dritë mbi faktorët dhe pasojat, mund të mendohet për një projekt më afatgjatë dhe një strategji gjithëpërfshirëse mbi këtë fenomen.

## Referencat

- Akar, N. Y., Anafarta, N., & Sarvan, F. (2011). Causes, Dimensions and Organizational Consequences of Mobbing: An Empirical Study. *Ege Akademik Review*, 11(1), 1467-1479.
- Davenport, N. (2002). *When conflict escalates to emotional abuse*. Retrieved June 2010, from <http://www.mediate.com/articles/davenport.cfm>
- Duffy, M., & Sperry, L. (2007). Workplace Mobbing: Individual and Family Health Consequences. *The Family Journal*, 15(4), 398-404.
- Efe, S. Y., & Ayaz, S. (2010). Mobbing against nurses in the workplace in Turkey. *International Nursing Review*(57), 328-334.
- Einarsen, S., & Skogstad, A. (1996). Bullying at Work: Epidemiological Findings in Public and Private Organizations. *European Journal of Work and Organizational Psychology*, 5(2), 185-201.
- Hoel, H., Sparks, K., & Cooper, C. L. (2002). *The Cost of Violence/Stress at Work and the Benefits of a Violence/Stress-Free Working Environment*. Geneva: International Labour Organization.
- Lewis, D. (2004). Bullying at work: the impact of shame among university and college lecturers. *British Journal of Guidance & Counselling*, 32(3).
- Leymann, H. (1990). Mobbing and Psychological Terror at Workplaces. *Violence and Victims*, 5, 119-126.
- Leymann, H. (1996). The Content and Development of Mobbing at Work. *The Journal of Work and Organizational Psychology*, 5(2), 165-184.
- Leymann, H., & Gustafsson, A. (1996). Mobbing at Work and the Development of Post-traumatic Stress Disorders. *European Journal of Work and Organizational Psychology*, 5(2), 251-275.
- Namie, G. (2003). Workplace bullying: Escalated incivility. *Ivey Business Journal*, 68(2), 1-6.
- Parkins, I. S., Ritchey, P. N., & Fishbein, H. D. (2006). The Influence of Personality on Workplace Bullying and Discrimination. *Journal of Applied Social Psychology*, 36(10), 2554-2577.
- Schat, A. C., & Kelloway, E. K. (2003). Reducing the Adverse Consequences of Workplace Aggression and Violence: The Buffering Effects of Organizational Support. *Journal of Occupational Health Psychology*, 8(2), 110-122.
- Thomas, M. (2005). Bullying among support staff in a higher education institution. *Health Education*, 105(4), 273-288.
- Westhues, K. (2002). At the mercy of the mob. *Canada's Occupational Health and Safety Magazine*, 18(8), 30-36.
- Zapf, D., & Einarsen, S. (2001). Bullying in the workplace: Recent trends in research and practice - an introduction. *European Journal of Work and Organizational Psychology*, 10(4), 369-373.

Zapf, D., Knorz, C., & Kulla, M. (1996). On the Relationship Between Mobbing Factors and Job Content, Social Work Environment, and Health Outcomes. *European Journal of Work and Organizational Psychology*, 5(2), 215-237.

# KONVENTA E KËSHILLIT TË EUROPËS MBI LUFTËN KUNDËR TRAFIKIMIT TË QËNIEVE NJERËZORE

**Robert Stratobërdha**

Departamenti i Gjuhëve të Huaja, Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë,  
Universiteti “Fan S. NOLI” Korçë.

## **Përmbledhje**

Në këtë artikull parashtrohen çështjet themelore që kanë të bëjnë me dispozitat e Konventës së Këshillit të Europës mbi luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore e njëkohësisht procedurat e zbatimit të saj nga shtetet që e kanë nënshkruar atë. Konventa fokusohet në tre akse kryesore : parandalim, mbrojtje e viktimave dhe dënim i trafikantëve. Ajo afirmon se trafikimi dhunon të drejtat e njeriut dhe prek vlerat mbi të cilat është themeluar Këshilli i Europës dhe vendos theksin kryesor në mbrojtjen e të gjitha viktimave të trafikimit. Artikulli përshkruan gjithashtu formimin dhe funksionimin e mekanizmit të monitorimit që ka për qëllim të kryejë vlerësimin e zbatimit të Konventës nga të gjitha palët nënshkruese.

**Flalë kyç:** Këshilli i Europës; Konventa; mbrojtje e viktimave; GRETA; monitorim i zbatimit të Konventës.

## **Abstract**

This article sets out the main issues concerning the dispositions of European Union Council Convent on the war against the human trafficking and at the same time its implementation by the states that have signed it. The Convent is focused on three main acts: prevention, support of victims and the punishment of the traffickers. It affirms that the trafficking violent the human right and affects the values on which the European Council is founded and emphasizes the protection of all victims of trafficking. The article describes the creation and function of monitoring mechanisms which aims to evaluate the implementation of the Convent by undersigning partners.

**Key words:** European Union, Convent, victim protection, GRETA, monitoring of convent implementation.

## **Këshilli i Europës**

- Këshilli i Europës është një organizatë politike ndërqeveritare rajonale, një nga organizatat ndërkombëtare më të vjetra që i dedikohen promovimit të bashkëpunimit europian. I themeluar në 5 maj të vitit 1949 nga Traktati i Londrës, ky institucion u krijua nga një grup qeverish të disa shteteve të vendosura për të evituar përsëritjen e tmerreve dhe vuajtjeve të shkaktuara nga dy lufrat botërore të shekullit të XX. Që nga ajo kohë, 10 shteteve themeluese (Belgjika, Danimarka, Franca, Irlanda, Italia, Luksemburgu, Holanda, Norvegjia, Suedia, Mbretëria e Bashkuar) u janë bashkuar pothuajse të gjitha vendet e kontinentit europian, gjë që e shpie në 47 numrin e shteteve aktualisht anëtare të Organizatës. Selia e Këshillit të Europës ndodhet në Strasburg (Francë).
- Shtetet anëtare të Këshillit të Europës janë:



Shqipëria, Gjermania, Andora, Armenia, Austria, Azerbajxhani, Belgjika, Bosnjë-Herzegovina, Bullgaria, Qipro, Kroacia, Danimarka, Spanja, Estonia, Finlanda, Franca, Gjeorgjia, Greqia, Hungaria, Irlanda, Islanda, Italia, Letonia, ish- Republika jugosllave e Maqedonisë, Lihtenshteini, Lituania, Luksemburgu, Malta, Moldova, Monako, Mali i Zi, Norvegjia, Hollanda, Polonia, Portugalia, Republika çeke, Rumania, Mbretëria e Bashkuar, Federata Ruse, San Marino, Serbia, Sllovakia, Sllovenia, Suedia, Zvicra, Turqia, Ukraina.

- Qëllimi parësor i Këshillit të Europës është të realizojë një bashkim më të ngushtë midis 47 shteteve anëtare të saj me qëllim që të mbrojë dhe promovojë në të gjithë kontinentin europian të drejtat e njeriut, demokracinë pluraliste dhe shtetin e së drejtës. Me rënien e murit të Berlinit në vitin 1998 dhe shtrirjen e vlerave demokratike në mbarë Europen, Organizata ka marrë një dimension të ri politik. Sot, Këshilli i Europës mishëron angazhimin e përbashkët të thuhet 800 milion Europeanëve në shërbim të të drejtave të njeriut, të demokracisë dhe Shtetit të së drejtës. Asnjë vend nuk është bërë pjesë e Bashkimit Europian pa qenë më parë anëtar i Këshillit të Europës.

- Që nga krijimi i tij, Këshilli i Europës ka bërë hapa të rëndësishëm drejt realizimit të objektivave të tij. Ai ka evidentuar sfidat më të mëdha aktuale që lidhen me situatën politike dhe sociale të Europës dhe nuk ka munguar të reagojë përballë emergjencave dhe rreziqeve të reja që kërcënojnë të drejtat e njeriut të popullit europian. Këshilli i Europës ka qenë një nga institucionet e para që u hapi portën vendeve të Europës qendrore dhe lindore mbas rënies së murit të Berlinit; ai adoptoi gjithashtu traktate të reja për t'i bërë ballë problemeve të kohës si siberkriminaliteti, kriminaliteti në fushën e shëndetit, terrorizmi ndërkombëtar dhe trafikimi i qënieve njerëzore.

### **Përmasat e trafikimit të qënieve njerëzore**

- Sipas Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO), numri minimum i personave të shfrytëzuar si pasojë e trafikimit në një moment të caktuar ishte 2, 45 milion (maj 2005)
- Shumica e këtyre njerëzve bëhen objekt trafikimi për qëllime shfrytëzimi seksual (43%) por të shumtë janë ata që bëhen objekt trafikimi për qëllime shfrytëzimi ekonomik (32%). Të tjerët bëhen objekt trafikimi për shfrytëzim seksual dhe ekonomik njëkohësisht ose edhe për arsye të tjera (25%)
- Trafikimi i qënieve njerëzore është aktiviteti i 3-të kriminal më fitimprurës në botë pas atij të drogës dhe të armëve
- Përfitimet ilegale të krijuara në vit llogariten në rreth 33 miliard \$

### **Veprimet e ndërmara**

Që në fund të viteve 80, Këshilli i Europës ka ndërmarë iniciativë të ndryshme:

- Studime dhe kërkime
- Aktivitete sensibilizuese
- Aktivit
- ete bashkëpunimi në nivel kombëtar dhe rajonal

Këshilli i Europës ka hartuar gjithashtu dokumenta në lidhje me trafikimin e qënieve njerëzore, veçanërisht: *Rekomandimin n° R (2000)11 të Komitetit të Ministrave të Shteteve anëtare mbi luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore për qëllime shfrytëzimi seksual*

### **Instrumentat kryesorë ndërkombëtarë**

- Protokolli shtesë i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar transnacional i cili synon parandalimin, shtypjen dhe dënimin e trafikimit të qënieve njerëzore veçanërisht trafikimin e grave dhe fëmijëve (Protokolli i Palermos)
- Direktiva e BE e 29 prillit 2004 në lidhje me lejën e qëndrimit lëshuar për shtetas të huaj të një vendi tjetër të cilët janë viktimë të trafikimit ose janë bërë objekt i një imigracioni klandestin dhe që bashkëpunojnë me autoritetet kompetente
- Vendimi Kuadër i Këshillit të BE i 19 korrikut 2002 në lidhje me luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore
- Plani i veprimit të OSBE-së për luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore

### **Përse duhej një traktat i ri?**

- Vlera e shtuar që sjell Konventa e Këshillit të Europës është:
  - **së pari**, të afirmojë se trafikimi dhunon të drejtat e njeriut dhe prek vlerat mbi të cilat është themeluar Këshilli i Europës, për pasojë, është e nevojshme të forcohet shkalla e mbrojtjes së të gjitha viktimave të trafikimit.
  - **së dyti**, fusha e veprimit të Konventës mbulon të gjitha format e trafikimit.
  - **së treti**, Konventa krijon një mekanizëm monitorimi me qëllim që të sigurojë një zbatim efektiv të dispozitave të saj nga çdo shtet.
- Shtirja gjeografike e Këshillit të Europës u mundëson vendeve të origjinës, të tranzitit dhe të destinacionit të bien dakord për një politikë të përbashkët e të fortë kundër trafikimit.
- Tekstet ndërkombëtare ekzistuese ose i kundërvihen në mënyrë të pamjaftueshme ose trajtojnë vetëm “një aspekt” të problemit.

### **Qëllimi i Konventës së Këshillit të Europës**

Konventa e Këshillit të Europës është një traktat global që synon 3 P (3 akse) kryesore:

- Parandalim të trafikimit
- Proteksion (mbrojtje) të të drejtave njerëzore të viktimave të trafikimit
- Përndjekje dhe dënim të trafikantëve

Konventa përbëhet nga një hyrje, 10 kapituj dhe 47 nene. Që në fillim përmendet nevoja për të hartuar një instrument politik ndërkombëtar global i cili fokusohet mbi të drejtat njerëzore të viktimave të trafikimit dhe krijimin e një mekanizmi monitorimi specifik. Konventa shoqërohet edhe nga një raport shpjegues i detajuar.

### **Fusha e zbatimit të Konventës**

Konventa zbatohet për:

- Të gjitha format e trafikimit: qofshin ato kombëtare apo transnacionale, të lidhura ose jo me krimin e organizuar
- Cilëdo qofshin viktimat : gratë, burrat apo fëmijët
- Cilatdo qofshin format e shfrytëzimit: shfrytëzim seksual, nëpërmjet punës apo shërbime të detyruara etj.

### **Perkufizimi i trafikimit të qënieve njerëzore përbehet nga 3 elementë:**

❖ **Veprimi** nënkupton: « rekrutimin, transportimin, strehimin ose pritjen e personave »

❖ **Nëpërmjet:** « kërcënimit apo përdorimit të forcës ose formave të tjera detyruese, nëpërmjet rëmbimit, mashtrimit, zhgënjimit, abuzimit me autoritetin apo me një situatë vulnerabiliteti, ose nëpërmjet dhurimit apo pranimi të pagesave apo avantazheve për të marrë pëlqimin e një personi që ka autoritet mbi një person tjetër»

❖ **Qëllimi** është shfrytëzimi. «Shfrytëzimi nënkupton minimum, shfrytëzimin e prostitucionit të një tjetri ose forma të tjera të shfrytëzimit seksual, shfrytëzimin e punës apo shërbimeve të detyruara, skllavërinë apo praktika analoge me skllavërinë, robërinë apo marrjen e organeve»

### **Trafiku i migrantëve**

• Nëse qëllimi i trafikut të paligjshëm të migrantëve është transportimi përtej kufijve për të nxjerrë përfitime financiare apo përfitime të tjera materiale, direkt apo indirekt, qëllimi i trafikimit të qenieve njerëzore është shfrytëzimi. Përveç kësaj, trafikimi i qenieve njerëzore nuk përfshin domosdoshmërisht aspektin transnacional; ai mund të ekzistojë në nivel thjesht kombëtar. (trafikimi i brendshëm)

### **Format e shfrytëzimit**

Format e shfrytëzimit që mbulon Konventa nuk kufizohen vetëm në shfrytëzimin seksual. Ajo mbulon gjithashtu :

- punën dhe shërbimet e detyruara
- skllavërinë ose praktikatat e ngjashme me skllavërinë
- robërinë
- marrjen (heqjen) e organeve.

### **Viktimat e trafikimit**

• Asnjë dokument tjetër ndërkombëtar nuk përkufizon viktimat duke ia lënë secilit shtet të përcaktojë se kush quhet viktimë dhe për pasojë ka të drejtë për masa mbrojtëse dhe asistencë.

• Termi « **viktimë** » përcakton çdo person fizik që i është nënshtruar trafikimit të qenieve njerëzore ashtu si përkufizohet në Konventë.

• Të pranuarit nga viktimat i shfrytëzimit nuk merret në konsideratë kur është përdorur një nga cilatdo mjete të përmendura në përkufizim (detyrimi, dredhija, mashtrimi, etj. )

## **Masat e parashikuara nga Konventa e Këshillit të Europës**

### **I. Parandalimi**

### **II. Masa që synojnë mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të viktimës**

### **III. E drejta penale dhe procedurale**

### **IV. Bashkëpunimi**

### **V. Mekanizmi i monitorimit**

### **I. Parandalimi**

- Për të qenë efikas dhe duke patur parasysh natyrën e këtij fenomeni, veprimet parandaluese kundër trafikimit duhet të jenë të koordinuara.

- Parandalimi i trafikimit të qënieve njerëzore nëpërmjet masave të tilla si fushata informuese, sensibilizuese dhe edukuese për persona vulnerabël që mund të bëhen preh e trafikimit.
- Aktivitete që kanë për qëllim të dekurajojnë “konsumatorët” e këtyre shërbimeve.
- Masa në kufi për të diktuar e identifikuar trafikimin e qënieve njerëzore dhe masa që bëjnë të sigurt vlefshmërinë e dokumentave të udhëtimit apo të identitetit.
- Shoqëria civile ka një rol të rëndësishëm në parandalimin e trafikimit dhe mbrojtjen e viktimave. Për rrjedhojë, Konventa e Këshillit të Europës inkurajon bashkëpunimin midis institucioneve shtetërore, organizatave joqeveritare dhe anëtarëve të shoqërisë civile.

•

## **II. Masa që synojnë mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të viktimës**

- a. Procesi i identifikimit
- b. Për çfarë lloj asistence kanë të drejtë viktimat?
- c. Periudha e rehabilitimit dhe afati kohor për të reflektuar
- d. Leja e qëndrimit
- e. Dëmshpërblimi dhe ndihma
- f. Riatdhesimi
- g. Barazia midis femrave e meshkujve duke evituar diskriminimin

## **II. a. Procedurat e identifikimit**

- Personeli që merret me identifikimin e viktimave dhe lëshimin e lejes së qëndrimit duhet të jetë i formuar dhe i kualifikuar.
- Gjatë procesit të identifikimit, personi nuk dëbohet nga territori i vendit dhe përfiton disa masa asistence.
- Në rastin e fëmijëve viktimë, përdoren dispozita të veçanta në favor të tyre (psh. përfaqësim i fëmijës, përcaktim i moshës dhe kombësisë, kërkim i familjes kur kjo është në interesin më të lartë të fëmijës).

•

## **II. b. Tipi i asistencës**

- Viktimat **duhet** të mbështeten për rehabilitimin e tyre fizik, psikologjik dhe social; Një asistencë e tillë përmbleddh:
  - Kushte jetese korrekte për të jetuar duke marrë masa për një strehë të përshtatshme dhe të sigurt, asistencë psikologjike dhe material;
  - Akses në shërbimin mjekësor për nevoja emergjente;
  - Një ndihmë në komunikim nëpërmjet përkthimit ;
  - Këshilla dhe informacione në lidhje me të drejtat që u njeh ligji dhe shërbimet që mund të marrin;
  - Fëmijëve iu mundësohet ndjekja e shkollës;
  - Asistencë gjatë procedurës penale (avokat);

## **II. c. Periudha e rehabilitimit dhe afati kohor për të reflektuar**

- Çdo shtet parashikon në ligjet e vendit një afat kohor të paktën 30 ditë si periudhë rehabilitimi dhe refleksioni kur ka motive të arsyeshme të besohet se personi në fjalë është viktimë. Kjo periudhë shërben që personi të rehabilitohet dhe të mund të shkëputet nga influenca e trafikantëve si dhe të marrë një vendim për të bashkëpunuar me autoritetet kompetente.

- Gjatë kësaj periudhe, personi nuk dëbohet nga territori i vendit dhe përfiton disa masa asistence.

## **II. d. Leja e qëndrimit**

- Çështja kryesore është: a duhet lidhur leja e qëndrimit me bashkëpunimin e viktimës me autoritetet represive (polici, prokurori)?
- Konventa e Këshillit të Europës i le të dyja mundësitë të hapura: shtetet mund të japin lejë qëndrimi :
  - nëse viktima bashkëpunon me autoritetet represive apo;
  - kur kjo është e nevojshme, duke patur parasysh gjendjen e viktimës;

## **II. e. Dëmshpërblimi dhe ndihma**

- E drejta për asistencë nga një avokat mbrojtës dhe e drejta për asistencë juridike falas për viktimat.
- E drejta e viktimave për dëmshpërblim, e cila duhet të garantohet p. sh. nga fondi i dëmshpërblimit që çdo shtet krijon.

## **II. f. Riatdhesimi**

- Vendi nga vjen viktima ose vendi ku ajo kishte të drejtën e qëndrimit të përhershëm, duhet të pranojë kthimin e këtij personi duke mbajtur parasysh të drejtat e tij, sigurinë dhe dinjitetin e tij.
- Kur një shtet kthen (riatdheson) një person në një shtet tjetër, ky kthim sigurohet duke mbajtur parasysh të drejtat, sigurinë dhe dinjitetin e personit.
- Çdo shtet merr masa ligjore për të vënë në zbatim programe riatdhesimi në bashkëpunim me OJF-të. Këto programe synojnë të evitojnë riviktimizimin.
- Fëmijët nuk riatdhesohen nëse duket se kthimi nuk është në interesin më të lartë të tyre.

## **II. g. Barazia midis gruas e burrit (femrave dhe meshkujve)**

Kur shtetet zbatojnë masat e asistencës të parashikuara nga Konventa, ata synojnë të promovojnë barazinë midis gruas dhe burrit dhe përdorin programin e integruar në zhvillimin, zbatimin dhe vlerësimin e këtyre masave duke evituar diskriminimin gjinor.

## **III. E drejta penale dhe procedurale**

Çdo shtet adopton masa ligjore në lidhje me :

- Inkriminim dhe dënimin e fenomenit të trafikimit të qenieve njerëzore.
- Mundësinë e inkriminimit dhe dënitit të përdoruesve të shërbimeve të viktimave të trafikimit.
- Inkriminimin dhe dënimin e fabrikimit të një dokumenti udhëtimi apo identiteti të falsifikuar, përdorimin ose pajisjen me një dokument të tillë, mbajtjen, vjedhjen, ndryshimin, dëmtimin apo prishjen e dokumentit të udhëtimit apo të identitetit të një personi tjetër.

- Inkriminimin dhe dënimin e bashkëpunëtorëve dhe çdo përpjekje që favorizon trafikimin e qënieve njerëzore.
- Përgjegjësitë penale, civile apo administrative të personave moralë (p. sh. agjensi transporti, turistike etj).
- Ndëshkimet dhe masat penale ose jo penale.
- Rrethanat rënduese në përcaktimin e sanksioneve (p. sh. vënia në rrezik e jetës së viktimës, viktimë është e mitur, faji është kryer nga një punonjës publik, implikimi i një organizate kriminale).
- Mundësinë e mosndëshkimit të viktimave për pjesëmarrje në aktivitete të paligjshme kur ato kanë qenë të detyruara ta bëjnë këtë.
- Ankimin *ex-parte* dhe *ex-officio* (neni 27 u lejon autoriteteve publike të ndjekin shkeljen e ligjit pa qenë i domosdoshëm ankimi i viktimës. Kjo për të mbrojtur viktimën nga presioni dhe kërcënimet e trafikantëve për të mos u ankuar).
- Mbrojtjen e viktimave, dëshmitarëve dhe personave që bashkëpunojnë me autoritetet gjyqësore (këtu parashikohet dhe mundësia e ndihmës dhe mbështetjes së viktimës gjatë procesit penal nga OJF apo shoqata që synojnë luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore).
- Përshtatjen e procedurave gjyqësore për të mbrojtur jetën private dhe sigurinë e viktimave (nëse duhet, mospërballja direkt me trafikantët, videodëshmi etj. ).

Çdo shtet merr masat e nevojshme për të patur personel dhe autoritete të specializuara në luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave.

#### **IV. Bashkëpunimi**

- Bashkëpunimi ndërkombëtar është një detyrim për shtetet sipas dispozitave të Konventës. Ky bashkëpunim duhet të jetë sa më i gjerë që të jetë e mundur për të:
  - parandaluar dhe luftuar trafikimin e qënieve njerëzore;
  - mbrojtur dhe asistuar viktimat e trafikimit;
  - kryer hetime apo procedura që lidhen me shkeljet penale;
- OJF-të punojnë me viktimat, njohin nevojat dhe problemet me të cilat ato përballen. Konventa inkurajon bashkëpunimin me shoqërinë civile.

#### **V. Mekanizmi i monitorimit**

- Efektiviteti i çdo traktati varet nga efikasiteti i mekanizmit të tij të monitorimit.
- Ky mekanizëm monitorimi ngarkohet të bëjë vlerësimin e zbatimit të Konventës nga shtetet që e kanë nënshkruar atë. Ai përbëhet nga një grup ekspertësh të pavarur dhe të paanshëm (15 vetë gjithsej) i quajtur « GRETA ». Përbërja e GRETA-s mban parasysh një pjesëmarrje të ekuilibruar femra meshkuj, shtrirje gjeografike të ekuilibruar si dhe një ekspertizë multidisiplinare të anëtarëve. Procedura e zgjedhjes së anëtarëve të GRETA-s është përcaktuar nga Komiteti i Ministrave. Përzgjedhja e kandidaturave të paraqitura bëhet nga Komiteti i Shteteve pjesëtare të Konventës për një mandat katërvjeçar të rinovueshëm vetëm njëherë.
- Komiteti i Shteteve pjesëtare të Konventës është një instancë politike.
- Të gjitha shtetet pjesëtare të Konventës do t'i nënështrohen të njëjtit mekanizëm monitorimi në mënyrë të barabartë. Procedura e vlerësimit ndahet në cikle dhe

kohëzgjatja e cikleve caktohet nga GRETA. Në fillim të çdo cikli, GRETA përzgjedh dispozitat mbi të cilat do të bëhet procedura e vlerësimit. Ai harton një pyetsor për secilin nga ciklet dhe ia dërgon të gjitha shteteve të cilët i përgjigjen këtij pyetsori si dhe çdo kërkesë tjetër për informacion nga ana e GRETA-s. GRETA mund të kërkojë informacion edhe pranë shoqërisë civile dhe të kryejë vizitë në vendet përkatëse. Mbi bazën e informacionit të mbledhur dhe vizitës në vend, GRETA harton një projekt- raport që përmban analiza në lidhje me zbatimin e dispozitave të Konventës si dhe sugjerime e propozime sesi shteti përkatës mund të trajtojë problemet e identifikuar. Projekt- raporti i dërgohet shtetit përkatës për të bërë komentet e tij të cilat merren në konsideratë nga GRETA. Mbi këtë bazë, GRETA adopton raportin final dhe konkluzionet e tij në lidhje me masat e marra nga shteti përkatës për zbatimin e dispozitave të Konventës. Ky raport dhe këto konkluzione i dërgohen shtetit përkatës dhe Komitetit të Shteteve anëtare. Raporti dhe konkluzionet e GRETA-s bëhen publike menjëherë pas adoptimit së bashku me komentet e mundshme të shtetit përkatës.

Në bazë të raportit dhe konkluzioneve të GRETA-s, Komiteti i Shteteve anëtare mund të japë rekomandime për shtetin përkatës në lidhje me masat që duhet të ndërmarë për të zbatuar konkluzionet e GRETA-s duke vendosur edhe afate.

#### **Lidhjet me instrumenta të tjerë**

- Konventa e Këshillit të Europës nuk bie ndesh me të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga dispozitat e Protokollit të Palermos të Kombeve të Bashkuara dhe ka për qëllim të forcojë mbrojtjen e vendosur nga ky Protokoll dhe të zhvillojë normat që ai përmend.
- Të qenët viktimë e trafikimit të qënieve njerëzore nuk mund të pengojë të drejtën për të kërkuar dhe për të përfutur azil.

#### **Referencat**

- Convention du Conseil de l'Europe sur la lutte contre la traite des êtres humains et son rapport explicatif. (nr. 197) Varsovie, 16. V. 2005
- Le Conseil de l'Europe sur la scène internationale
- Le Conseil de l'Europe : tour d'horizon
- Le Conseil de l'Europe. *800 millions d'Européens*

# PSIKOLOGJI, PEDAGOGJI





# KOMUNIKIMI, INTERNETI DHE TË RINJTË

**Artemisi Shehu (Dono)**

Departamenti Pedagogji-Psikologji, Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës

## **Përmbledhje**

Interneti ka filluar të bëhet mjeti më i përdorur i komunikimit, ndërkohë që studiuesit shqetësohen se kjo mund të sjellë një degradim të përgjithshëm të komunikimit sidomos në terma jo-verbale.

Për këtë arsye u krye një studim me një fokus grup dhe anketim të vetëhartuar, për të vëzhguar nëse komunikimi në internet mund të jetë më pak efektiv se komunikimi ballë – për – ballë. Hipoteza e ngritur në studim është: Mungesa e feedback-ut vizual dhe keqkuptimet kanë korrelacion negativ midis tyre. Për këtë arsye, u përzgjedh një kampion i kufizuar (42 studentë) në mënyrë rastësore të shtresëzuar nga Fakulteti i Shkencave Sociale, Tiranë, dega Psikologji, për të grumbulluar fakte që do mbështesin ose jo hipotezën.

Nga analiza e të dhënave doli se mungesa e komunikimit jo-verbal ka lidhje me keqkuptimet që lindin gjatë komunikimit në chat dhe se ky korrelacion është negativ. Ky vërtetim ngre shqetësim të bazuar se komunikimi, ku si kanal përdoret interneti, nuk është aq efektiv sa komunikimi ballë – për – ballë dhe se pasojat do të vihen re ndjeshëm me shtimin e përdoruesve të internetit si qëllim për të komunikuar me një palë të dytë përmes chat-it.

**Fjalët kyçe:** internet, chat, komunikim, joverbalitet, feedback vizual.

## **Abstract**

Internet has started to become the most used means of communication, while researchers worry that this may bring a general degradation in terms of communication, especially non-verbal.

For this reason a study was conducted with a focus group and self-created survey has been used, to observe, whether online communication may be less effective than face - to - face communication. Hypotheses raised in the study: Lack of visual feedback and misunderstandings have negative correlation between them. For this reason, a limited sample (42 students) in the stratified random manner was selected from the Faculty of Social Sciences, Tirana, Department Psychology, to gather evidence that would support the hypothesis or not. From data analysis it turned out that the lack of non-verbal communication related to the misunderstandings that arise when communicating in chat and that this correlation is negative. This evidence-based raises concern that communication, where both use the Internet channel is not as effective as face - to - face communication and the consequences will be observed with increasing significantly intended users of internet to communicate with a second pair thought chat.

**Key words:** internet, chat, communication, non-verbal communication, visual feedback.

## Hyrje

Kanalet, nëpërmjet të cilëve mundësohet komunikimi, sa vjen e po shumëfishohen në mënyrë të pallogaritshme nga dita ditës. Një nga këto kanale është edhe kompjuteri, ose më saktë rrjeti i gjerë i kompjuterëve, i cili ka fituar shumë terren kohët e fundit dhe përdoret në mënyrë masive nga kushdo. Tashmë mund të thuhet se, ka filluar një epokë e re e komunikimit, dhe si rrjedhojë edhe shoqëria ka ndryshuar në mënyrë thelbësore. Kudo mund të shohësh njerëz duke komunikuar me të tjerët me kompjuter të lëvizshëm në mënyrë të sinkronizuar, ose ndryshe “*për së gjalli*”, në kohë reale e si rezultat lindja e një mori termash të reja që janë shpikur për të shpjeguar fenomenin e komunikimit të ndërmjetësuar nga kompjuteri. Megjithatë, sa më shumë shtohet numri i qendrave të internetit dhe sa më shumë rriten përdoruesit e internetit, aq më shumë rritet shqetësimi i psikologëve dhe sociologëve. Është bërë shqetësim edhe në shoqërinë tonë një lloj komunikimi i tillë. Takimet tashmë lihen me email, elektronikisht, dhe të rinjtë sot po i dëgjojnë gjithnjë e më pak zërin njëri-tjetrit e parë më pak tjetrin. Ky shqetësim lidhet pikërisht me idenë se komunikimi në rrjet mund të mos jetë aq efikas sa komunikimi *klasik* ballë për ballë. Kjo është edhe arsyeja që shtyu iniciimin e zhvillimin e këtij studimi. Duke theksuar edhe qëllimet e këtij studimi mund të renditim këto:

- Paraqitja e një panorame të studimeve të fundit mbi komunikimin elektronik në përgjithësi, dhe të komunikimit në chat në veçanti.
- Ofrimi i një panorame të arsyeve se pse lindin keqkuptime në një komunikim në chat, bazuar mbi studimet e mëparshme dhe studimit në fjalë.
- Hetimi i mënyrës së komunikimit me qëllim gjetjen e të dhënave të tjera të vlefshme për studime të tjera të mëvonshme.

Ky studim është kryer si një studim pilot për të parë si mund të procedonte në një studim më përfaqësues. Për këtë arsye ky studim është i përbërë nga një subjekt, që nuk lejon përgjithësimin e rezultateve në një kontekst më të gjerë. Gjithashtu, një kufizim i dytë i këtij studimi ka të bëjë me instrumentin metodologjik të pyetësorit të përdorur në këtë studim.

Por ky studim nga ana tjetër do i shërbejë të gjithë përdoruesve të internetit, sidomos atyre që përdorin chat-in si mjet për të komunikuar me një palë tjetër, që të ndërgjegjësohen mbi disavantazhet që shfaq ky lloj komunikimi. Ky është një ndër studimet e para në këtë fushë në Shqipëri, gjë që mund të nxisë studiues të tjerë të kryejnë studime të mëtejshme.

Ka një sërë arsyesh që bëjnë psikologët të mendojnë në këtë mënyrë (O'Neill & Martin, 2003):

Së pari, një arsye e fortë mund të jetë mundësia e lartë e shfaqjes së keqkuptimeve mes ndërfolësve.

Së dyti, është mungesa e feedback-ut vizual/komunikimit jo-verbal, si mjaft e rëndësishme për komunikimin.

Së treti, shtohet sipas këtyre autorëve jo-koherenca e mendimeve, zhurmat e brendshme ose ndryshe mendimet.

Së katërti, janë marrëdhëniet mes bashkëbiseduesve, pra fakti sesa njihen ata me njëri-tjetrin. Dhe së fundi, lloji i bisedave që bisedojnë njerëzit me njëri-tjetrin (sa të përgjithshme apo specifike ato janë).

Këto janë elementë, të cilët sa më shumë të mungojnë në një komunikim, aq më efektiv e bëjnë këtë të fundit (Bolanle, A. 2010).

Komunikimi i ndërmjetësuar nga kompjuteri ka qenë një nga fenomenet më të hasura në dy dhjetëvjeçarët e fundit dhe si rrjedhojë studimet në shkencat sociale e kanë studiuar mjaft atë. Pjesa më e madhe e studimeve janë dhënë si kontribut nga psikologët dhe inxhinierët e telekomunikacionit. Shkencat sociale janë gjithmonë e më të interesuara në të kuptuarit të karakteristikave të Komunikimit të Ndërmjetësuar nga Kompjuteri (KNK) dhe efekteve të tij në njerëz, grupe dhe organizata (Riva & Galimberti, 1997). Ajo që vihet re si një ngatërresë që bëhet shpesh në specifikimin e termit KNK, është se shpesh njerëzit mendojnë se ky komunikim ka të bëjë me format: njeri-kompjuter apo kompjuter-kompjuter, ndërkohë që këto të fundit nuk bëjnë pjesë në KNK. Kompjuteri në këtë lloj komunikimi është një *ndërmjetës*, ç'ka do të thotë që vetë kompjuteri nuk merr pjesë në komunikim, por është kanali, nëpër të cilin kalojnë informacionet që shkëmbehen mes njerëzve. Siç tregojnë edhe eksperimentet e kryera nga Nass dhe Stewer (1993), proceset psikologjike tipike të KNK "... kanë më shumë të përbashkëta me ndërveprimin ndërpersonal sesa me procedurat teknologjike të cilat nuk janë në gjendje të riprodhojnë marrëdhënien person-person, kur kompjuteri përdoret si makinë llogaritëse, për shembull" (fq. 522).

### **Përkufizimi i feedback-ut vizual**

Feedback-u vizual shpesh nënkuptohet me term fizik, në të folurin e përditshëm, i cili në përgjithësi ka të bëjë me aspektin optik të reagueshmërisë. Ndërkohë studiesit e shkencave sociale e kanë përdorur këtë term në një kuptim më të gjerë, ku shpesh është parë si sinonim i termit komunikim jo-verbal (Riva, G. & Galimberti, C., 2001). Nga studiues të tjerë kjo nuk duhet pranuar plotësisht, pavarësisht se ky term është shumë i ngjashëm me komunikimin jo-verbal, vazhdon të ketë gjithsesi një përplasje midis kuptimit të të dy termave, për vetë faktin se feedback-u vizual merret në një kontekst shumë të përgjithshëm, ndërsa komunikimi jo-verbal edhe pse është një term i përgjithshëm, mbetet gjithsesi më specifik se feedback-u vizual.

### **Komunikimi jo-verbal - KJV**

Në përgjithësi, komunikimi jo-verbal shihet si një komunikim, në të cilin mund të përdoret çfarëdolloj kanali, përveç kanalit të gjuhës së folur e të shkruar (Andersen, 2007). Ky komunikim mund të jetë disa formash (Knapp & Hall, 2002):

- Me gjeste dhe prekje
- Gjuha e trupit ose postura
- Shprehjet e fytyrës
- Kontakti me sy etj

KJV mund të shprehet nëpërmjet mënyrës së të veshurit, mbajtjes së flokëve, ose edhe arkitekturës dhe simboleve. Gjithashtu këtu bëjnë pjesë edhe elemente paragjuhësore si cilësia e zërit, emocioni, stili i të folurit, gjithashtu edhe elemente si ritmi, intonacioni dhe theksi. Të kërcyerit, gjithashtu, merret si mënyrë shprehjeje, po ashtu edhe gjuha e shkruar ka elemente jo verbale, si shkrimi i dorës, rregullimi hapësinor i fjalëve dhe përdorimi i emoticons. KJV është studiuar shumë herë në korrelacion me *kuptueshmërinë*, dhe është gjetur gjithmonë një korrelacion shumë i lartë pozitiv mes dy koncepteve, çka përbën edhe një bazë të fortë për të mbështetur hipotezën e këtij studimi.

## Emoticons

Emoticons, ose ndryshe emotional icons, janë simbole, shpesh imitime të fytyrave njerëzore, që shprehin një lloj emocioni të caktuar (Derks, Bos & Grumkoë, 2004). Njerëzit i përdorin ato për të shprehur gjendjen emocionale, por pjesa më e madhe e studiuesve nuk bien dakord me këtë ide. Ata mendojnë se këto simbole janë tepër të varfra për të shprehur një gjendje emocionale, qoftë momentale e të përkohshme.

## Keqkuptimet në KNK

*Çfarë e bën KNK të ketë mundësi të lartë keqkuptimi?* Siç u përmend dhe më lart, KJV ndikon shumë në kuptueshmërinë e informacionit të shkëmbyer nga 2 bashkëfolës. Ndërkohë, shohim se, duke mos pasur feedback vizual në KNK, mundësia që kuptueshmëria të jetë e dobët është shumë e lartë. Moskuptimi lidhet drejtpërsëdrejti me keqkuptimin, i cili është një keqinterpretim i një informacioni të shkëmbyer. Në këtë mënyrë, sipas këtij rrjedhimi logjik, vihet re se duhet të ketë një korrelacion negativ mes feedback-ut vizual dhe keqkuptimeve. (Megjithatë, këtu futet edhe aftësia perceptivë e njeriut për të kuptuar apo jo një informacion).

## METODOLOGJIA

Detyra shkencore e këtij studimi është hulumtimi i mënyrës së komunikimit në chat me qëllim që të përcaktohet natyra e korrelacionit mes feedback-ut vizual dhe keqkuptimeve. Për këtë arsye edhe hipoteza e studimit do të jetë: Mungesa e feedback-ut vizual dhe keqkuptimeve që lindin në një komunikim në chat kanë midis tyre korrelacion negativ.

*Çështë komunikimi në chat?* Ky lloj komunikimi është një komunikim i sinkronizuar, i ndërmjetësuar nga 2 ose më shumë kompjutera të vendosur në një rrjet të brendshëm. Ky lloj komunikimi karakterizohet nga disa elemente kyçe: feedback-u vizual dhe mundësia e lartë për të keqkuptuar informacione të ndryshme që shkëmbehen. Disa studime pohojnë se ka një lidhje korrelacionale të fortë midis tyre, me koeficient korrelacioni 0,845 (Bordia, P. 1999).

Për të mbledhur të dhënat e nevojshme për studimin u përdorën dy metoda cilësore: Fokus Grupi dhe Anketimi. Në studim u përzgjedhën 42 subjekte në Kursin I (viti i parë i studimeve) të degës së Psikologjisë të FShS të Universitetit të Tiranës. Nga këto subjekte 8 u përzgjedhën për të zbatuar metodën e Fokus Grupit dhe 34 u përzgjedhën për metodën e Anketimit. Kjo zgjedhje e subjekteve u bë në bazë të rishikimit të literaturës ku sipas statistikave mbi moshën e përdoruesve të chat-it (Starfire, 2006), mosha më e predispozuar ndaj këtij kanali komunikimi është ajo nga 16-20 vjeç, në të cilën studentët e Kursit I-re bëjnë pjesë më së miri.

Në Kursin I të Psikologjisë u përzgjedhën në mënyrë rastësore të shtresëzuar 42 subjekte. Përzgjedhja u krye prej secilit grup seminaresh, në të cilat ndahet kursi në fjalë. Më poshtë vijon tabela e përzgjedhjes së subjekteve sipas grupeve përkatës:


*Tabela 1. Numri i subjekteve të përzgjedhur bazuar në grupin dhe metodën e studimit ku bëjnë pjesë*

| Metodat e studimit | Grupet e Kursit I |         |         |
|--------------------|-------------------|---------|---------|
|                    | Grupi A           | Grupi B | Grupi C |
| Fokus Grup         | 2                 | 3       | 3       |
| Anketim            | 11                | 12      | 11      |

Përzgjedhja e kryer në këtë mënyrë siguron që të ketë një shpërndarje sa më përfaqësuese të studentëve të studimit në mënyrë që të shmanget diskriminimi i mundshëm. Kjo përzgjedhje mbulon, përafërsisht, 33% të studentëve për secilin grup. Procedura e përzgjedhjes u krye duke shkruar numra në copa letre, të cilat tërhiqeshin në mënyrë rastësore nga një enë dhe, më pas, gjendej në regjistrin e kursit emri përkatës i studentit, të cilit i korrespondonte numri i përzgjedhur. U përzgjedhën, në këtë mënyrë, më shumë numra sesa do të duheshin studentë për testimin. Nëse ndonjë prej të përzgjedhurve refuzonte të kryente testimin, ose nuk ndodhej në klasë në momentin kur u krye testimi, ai zëvendësohej me numrin që vinte në radhë sipas përzgjedhjes së kryer.

## 2.2. Shpërndarja femra / meshkuj

**Grafiku 1:** Shpërndarja Femra / Meshkuj (në %).



Grafiku tregon se numri i femrave është më i madh krahasuar me meshkujt, një fenomen ky që mund të përgjithësohet për gjithë Fakultetin e Shkencave Sociale, por veçanërisht për degën e Psikologjisë.

Për të mbledhur të dhënat e këtij studimi u përdorën dy instrumente metodologjike:

1.një intervistë në grup e cila synonte të mblidhte të dhëna të përgjithshme mbi popullatën e studentëve të Psikologjisë dhe që u përdor si fazë pilotimi për të testuar kuptueshmërinë e pyetjeve dhe

1.një pyetësor i cili synonte të maste llojin e korrelacionit midis feedback-ut vizual dhe keqkuptimeve.

### Fokus-Grupi

Instrumenti metodologjik pilot për këtë studim konsiston në një takëm pyetjesh interviste që u paraqitën subjekteve në një fokus grup, të cilat kishin për qëllim:

- Të grumbullonin të dhëna paraprake ndihmuese për popullatën e marrë në studim

- Të shërbente si fazë pilotimi për një pjesë të madhe të pyetjeve të instrumentit të pyetësorit

Pyetjet e intervistës u hartuan nga vetë studiuesit, bazuar në rishikimin e literaturës.

*Pjesët e intervistës:* Intervista përbëhet nga 3 pjesë, të dallueshme nga njëra-tjetra, ku secila pjesë synon të mbledhë një lloj të caktuar të dhënash.

- Pjesa I: Pyetjet 1, 2 dhe 3 janë pyetje hyrëse të cilat synojnë të kuptojnë sa të “familjarizuar” janë subjektet me komunikimin në internet dhe chat.

- Pjesa II: Pyetjet 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9 janë pyetje që synojnë të marrin përgjigje nga subjektet për një krahasim mes 3 lloje komunikimesh: komunikim me chat, komunikim me mikrofon e webcam dhe komunikimi ballë për ballë.

- Pjesa III: Pyetjet 10, 11 dhe 12 janë pyetje përmbyllëse që kërkojnë të kuptojnë, nëse hipoteza e studimit është faktike apo mund të rrëzohet.

Para se të përmbyllet fokus-grupi, subjekteve iu bënë pyetje që synonin të merrnin feedback nga ata për kuptueshmërinë e pyetjeve dhe sugjerim për korrigjime të aplikueshme në pyetjet e instrumentit të pyetësorit.

### **Pyetësori**

Instrumenti metodologjik kryesor mbi të cilin bazohet studimi konsiston në një pyetësor të tipit laps-letër, në të cilin parashtroheshin pyetje të lidhura me qëllimin e studimit, pyetje të cilat janë hartuar me ndihmën e metodës së mësipërme.

*Pjesët e pyetësorit:* Intervista përbëhet nga 3 pjesë, të dallueshme nga njëra-tjetra, ku secila pjesë synon të mbledhë një lloj të caktuar të dhënash.

- Pjesa I: Pyetjet 1, 2 dhe 3 janë pyetje hyrëse të cilat synojnë të kuptojnë sa të “familjarizuar” janë subjektet me komunikimin në internet dhe chat.

- Pjesa II: Pyetjet 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9 janë pyetje që synojnë të marrin përgjigje nga subjektet për një krahasim mes 3 lloje komunikimesh: komunikim me chat, komunikim me mikrofon e webcam dhe komunikimi ballë për ballë.

- Pjesa III: Pyetjet 10, 11 dhe 12 janë pyetje përmbyllëse që kërkojnë të kuptojnë nëse hipoteza e studimit është faktike apo mund të rrëzohet.

*Llojet e pyetjeve:* Pyetësori përmban 12 pyetje të mbyllura nga të cilat:

- 2 pyetje me përzgjedhje me shkallë
- 10 pyetje me përzgjedhje alternativash

### **Procedura**

*Fokus-Grupi* u realizua brenda një dite, ku 8 studentë u morën nga orët e mësimi me leje largimi të pedagogëve të orëve përkatëse. Në fillim subjekteve iu paraqitën disa instruksione dhe një prezantim i shkurtër i temës së studimit dhe më pas iu mor leje për filmuar fokus- grupin me kamera. Subjektet pranuan që t’iu regjistrohej vetëm zëri, kështu që kamera u vendos në mënyrë të tillë që të mos dukej fytyra e pjesëmarrësve. Fokus-grupi zgjati pothuajse aq sa ishte parashikuar paraprakisht, 58 minuta.

*Anketimi* u realizua po ashtu brenda një dite (ditën pasardhëse), ku 34 studentë morën pjesë. Gjatë një ore pushim subjektet e përzgjedhura u mbledhën në një klasë dhe iu shpërndanë pyetësorët e fotokopjuar, për t’u plotësuar. Gjithashtu, edhe në këtë procedurë iu dhanë udhëzime studentëve për plotësimin si dhe iu lejua bërja e pyetjeve në rast paqartësish të mundshme. Koha mesatare e plotësimit të pyetësorit ishte 8 minuta.

### **Përpunimi i të dhënave të grumbulluara**

Përpunimi i të dhënave të pyetësorit u krye me metoda sasiore e cilësore. Gjatë kësaj faze është përdorur programi Microsoft Excel 2010 për llogaritje të ndryshme dhe ndërtimin e tabelave dhe grafikëve të nevojshëm për këtë studim.

Nga përpunimi i të dhënave doli në pah fakti se sa më shumë të mungojë feedback-u vizual, aq më shumë tendencë ka të lindin keqkuptime në një komunikim. Gjithashtu, doli përfundimi se pavarësisht se komunikimi në chat është më i përdoruri, subjektet do preferonin të komunikonin me mjete si kufje me mikrofoni dhe webcam për të minimizuar disavantazhet e këtij lloji komunikimi, por përdorin komunikimin në chat për shkak të komoditetit që ai ofron (shpejtësisë së tejçimit të informacionit, mos dalja nga shtëpia, çmimit/kostos etj.)

Përpunimi me metoda sasiore ka të bëjë me numërimin e subjekteve, për të evidentuar cila nga alternativat ishte zgjedhur më shpesh si përgjigje.

## REZULTATET E TË DHËNAVE

Një total prej 42 subjektësh morën pjesë në këtë studim. Të gjithë vazhdojnë studimet universitare në degën e psikologjisë në Fakultetin e Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës. Të gjithë ishin në vitin e parë të studimeve. Katër prej të testuarve (9.5 %) ishin meshkuj dhe 38 (90.5 %) ishin femra.

### Përpunimi i të dhënave dhe rezultatet e intervistës në grup

Kjo metodë është metodë sekondare ose ndihmuese e instrumentit metodologjik të pyetësorit dhe shërbeu si një fazë pilotimi, për këtë arsye, rezultatet e kësaj metode nuk do të merren parasysh në këtë studim.

**Tabela 1**

Sa e përdorni internetin në një shkallë nga 1 në 5?

| 1  | 2   | 3   | 4   | 5   |
|----|-----|-----|-----|-----|
| 3% | 15% | 35% | 23% | 24% |

**Tabela 2**

Sa pjesë të kohës që kaloni në internet e përdorni për të folur me të tjerët?

| Gjithë kohën | Pjesën më të madhe të kohës | Gjysmën e kohës | Një pjesë të vogël të kohës | Thuajse aspak |
|--------------|-----------------------------|-----------------|-----------------------------|---------------|
| 0%           | 29%                         | 41%             | 15%                         | 15%           |

**Tabela 3**

Cili është programi/faqja e internetit që përdorni më shumë për të komunikuar?

| Facebook | Windows Messenger | Skype | Chat rooms | Tjetër program |
|----------|-------------------|-------|------------|----------------|
| 64%      | 15%               | 6%    | 0%         | 15%            |

**Tabela 4**

Cilat nga këto elemente përdorni për ta mundur komunikimin me të tjerët?

| Chat (komunikoni me shkrim dhe simbole) | Kufje me mikrofoni (me zë) | Webcam/kamera | Webcamera dhe kufje me mikrofoni |
|-----------------------------------------|----------------------------|---------------|----------------------------------|
| 71%                                     | 6%                         | 0%            | 14%                              |



**Tabela 5**

Për cilat çështje bisedoni zakonisht në internet?

| <b>Çështje të gjata e të përgjithshme</b> | <b>Çështje të shkurtra e specifike</b> |
|-------------------------------------------|----------------------------------------|
| <b>71%</b>                                | <b>29%</b>                             |

**Tabela 6**

Në cilat nga çështjet e mësipërme ju kanë lindur më shumë keqkuptime?

| <b>Çështje të gjata e të përgjithshme</b> | <b>Çështje të shkurtra e specifike</b> |
|-------------------------------------------|----------------------------------------|
| <b>60%</b>                                | <b>40%</b>                             |

**Tabela 7**

A përbën problem për ju që nuk mund ta shihni fytyrën e personit me të cilin komunikoni në internet?

| <b>Po</b>  | <b>Jo</b>  |
|------------|------------|
| <b>60%</b> | <b>40%</b> |

**Tabela 8**

Mendoni se përdorimi i buzëqeshjeve shton mundësitë e keqkuptimeve në komunikimin në chat?

| <b>Po</b>  | <b>Jo</b>  |
|------------|------------|
| <b>50%</b> | <b>50%</b> |

**Tabela 9**

Sa shpesh ju lindin keqkuptime të çdolloji në komunikimin në chat nga 1 në 5?

| <b>1</b>  | <b>2</b>  | <b>3</b>   | <b>4</b>   | <b>5</b>   |
|-----------|-----------|------------|------------|------------|
| <b>9%</b> | <b>3%</b> | <b>18%</b> | <b>47%</b> | <b>23%</b> |

**Tabela 10**

Zakonisht, keqkuptimet kanë më shumë të ngjarë të lindin gjatë një bisede në chat apo ballë për ballë?

| <b>Bisedë chat</b> | <b>Bisedë ballë për ballë</b> |
|--------------------|-------------------------------|
| <b>91%</b>         | <b>9%</b>                     |

**Tabela 11**

Nëse do të kishit mundësi t'i takonit njerëzit më shpesh, do të zgjidhnit të komunikoni me to ballë për ballë apo komunikimi me chat?

| <b>Bisedë chat</b> | <b>Bisedë ballë për ballë</b> |
|--------------------|-------------------------------|
| <b>6%</b>          | <b>94%</b>                    |

**Tabela 12**

A mendoni se komunikimi ballë për ballë ndihmon në shmangien e keqkuptimeve?

| Po  | Jo  |
|-----|-----|
| 90% | 10% |

### DISKUTIMI I TË DHËNAVE

Diskutimi i të dhënave bazuar në hipotezën e studimit: *Mungesa e feedback-ut vizual dhe keqkuptimet gjatë komunikimit në chat kanë korrelacion negativ.*

Anketimi i kryer nxori në pah faktin se (të paktën për kamponin e studimit) në një komunikim ku mungon feedback-ut vizual ka më shumë të ngjarë të lindin keqkuptime. Nëse u referohemi shifrave konkrete, vihet re se 91% e subjekteve raportojnë se keqkuptimet kanë tendencën të shfaqen më shumë në një komunikim në chat ku feedback-u vizual mungon sesa në një komunikim ballë – për – ballë, ku feedback-u vizual është i pranishëm.

Nga ana tjetër, vihet re se gjatë një bisedimi rreth çështjeve të gjata e të përgjithshme ka më shumë mundësi të shfaqen keqkuptime sesa gjatë një bisede rreth një çështjeje të shkurtër e specifike. Ky pohim verifikohet edhe një herë nga shifrat, ku 60% e subjekteve të cilët e raportojnë këtë përgjigje në pyetjen 7 në pyetësorin e studimit.

Të dhënat e sipërpërmendura tregojnë qartë se prania e feedback-u vizual dhe bisedat e shkurtra dhe specifike, kontribuojnë në një komunikim më efektiv sesa një komunikim ku dy elementet e mësipërme nuk janë të pranishëm.

Fakti shqetësues vjen edhe njëherë nga shifrat e analizës së të dhënave ku vihet re se 77% e subjekteve raportuan se kanali kryesor i komunikimit në një bisedë në rrjet është chat-i, i cili sipas shifrave të mësipërme është kanali ku ka më shumë të ngjarë të shfaqen keqkuptime gjatë bisedës, të cilat janë elemente, që një komunikim efektiv nuk duhet t'i ketë. Megjithatë, shifra tregon qartë se të paktën pjesa më e madhe e subjekteve të anketuar përballet shpesh me këtë problem në bisedat e tyre në internet dhe kjo mund të sjellë Kačmárová (2006) një “degradim të përgjithshëm të komunikimit të përdoruesve të internetit, gjë që mund të shfaqet edhe në një komunikim jo domosdoshmërisht në rrjet më vonë.”

Duke patur parasysh rezultatet, mund të arrihet në konkluzionin se komunikimi në internet me chat është më pak efektiv, sesa një komunikim ballë – për – ballë. Kjo do të thotë se përdoruesit e chat-it si mjet komunikimi do ndeshin më shumë keqkuptime në bisedat e tyre si pasojë e mungesës së komunikimit jo-verbal.

Për këtë arsye del si nevojshëm i pasja parasysh e disa rekomandimeve:

- Mundohuni të mos e përdorni shumë chat-in. Vërtet ai mund të jetë një mjet i përshtatshëm komunikimi, por rreziqet për një komunikim jo efektiv janë shumë të larta në krahasim me një komunikim ballë për ballë.
- Dilni më shpesh në kohën tuaj të lirë, duke pasur më shumë kontakte sociale të drejtpërdrejta se jo të drejtpërdrejta. Gjithashtu, me mjaft rëndësi është edhe fakti i diskutimit të çështjeve të rëndësishme në një komunikim të drejtpërdrejtë më tepër se virtual.
- Nëse keni mundësi, përdorni pajisje si kufje me mikrofon, apo webcam për të patur një komunikim sa më efektiv.

- Rritja e ndërgjegjësimit të prindërve për mënyrën e edukimit të komunikimit të fëmijëve të tyre që herët në jetë. Kjo mund të ndodhë përmes workshopeve efektive që prindërit mund të marrin pjesë ose organizojnë.

Sigurisht, studime të mëtejshme nevojiten të ndërmerren me qëllim rritjen e besueshmërisë së studimit edhe në target grupe të tjera të ngjashme.

## Referencat

Bargh, John A. 2002. "Beyond Simple Truths: The Human-Internet Interaction." In: *Journal of Social Issues*, Vol. 58/fq. 1, 1-8.

Bolanle A. Olaniran, (2010) "Group communication and conflict management in an electronic medium", *International Journal of Conflict Management*, Vol. 21 Iss: 1, fq. 44 – 69

Derks D., Bos A.E.R., Grumbkow J.v. Emoticons and social interaction on the Internet: the importance of social context (2007) *Computers in Human Behavior*, 23 (1), fq. 842-849.

Douglas, Karen M. and McGarty, Craig. 2001. "Identifiability and self-presentation: Computer-mediated communication and intergroup interaction." *British Journal of Social Psychology* 40, fq. 399-416.

Dresner, E. and Herring, S. C. (2010), Functions of the Nonverbal in CMC: Emoticons and Illocutionary Force. *Communication Theory*, 20: 249–268. doi: 10.1111/j.1468-2885.2010.01362.x

Herring, S. 1999. Interactional Coherence in CMC. E gjendshme tek: <http://jcmc.indiana.edu/vol4/issue4/herring.html>

J. B. Walther, "Computer-Mediated Communication: Impersonal, Interpersonal and Hyperpersonal Interaction", *Communication Research* 23(1), 1996, fq. 3-43.

J. C. McCarthy, V.C. Miles, A.F. Monk, M.D. Harrison, A.J. Dix, and P.C. Wright, "Text-based On-line Conferencing: A Conceptual and Empirical Analysis Using a Minimal Prototype", *Human-Computer Interaction* 8, 1993, pp. 147-183.

Kačmárova, A. 2005. "Internet Chatting Inside Out" E gjendshme në adresën e internetit: <http://www.skase.sk/Volumes/JTL02/kacmarova.pdf>

Kiesler, S., Siegel, J., & McGuire, T. W. (1984). Social psychological aspects of computer-mediated communication. *American Psychologist*, fq. 39, 1123-1134.

Krajčovičová, Slávka. 1999. "Functioning of a Visual Mode in Individual Interaction Types in Television News Discourse." E gjendshme në librin: M. Ferenčík, M. Prčíková, and S. Krajčovičová *Comparative Studies in English and Slovak Massmedia and School Communication*.

M. L. Markus, "Finding a Happy Medium: Explaining the Negative Effects of Electronic Communication on Social Life at Work", *ACM Transactions on Information Systems* 12(2), 1994, 119-149.

Noblia, Maria V. 1998. "The Computer-Mediated Communication, A New Way of Understanding the Language." E gjendshme në adresën e internetit: <http://www.sosig.ac.uk/iriss/papers/paper22.htm>

Poole , B. J., Axmann, M., Calongne, C. M., & Cox, D. (2003, April). To chat or to chatter: Making online sense of the chat room environment. E gjendshme tek adresa e internetit: <http://makahiki.kc.hawaii.edu/tc/2003/conference/>

Riva, G., Galimberti, C. 1998. "Genetic, Social and General Psychology Monographs", fq. 124, 434-464

S. Turkle, *Life on the Screen: Identity in the Age of the Internet*, Simon & Schuster, New York, 1995.

Starfire, V. (2003, September). Free online voice chat programs. TESL-EJ, 7(2). E gjendshme tek adresa e internetit: <http://tesl-ej.org/ej26/m4.html>

Vronay, D. Smith, M. Drucker, S. 1999. "Alternative interfaces for chat" UIST '99 Proceedings of the 12th annual ACM symposium on User interface softëare and technology

Wiest, B. 1999, Implementing non-verbal cues in cmcenvironments. e gjendshme tek: <http://www.teleinstitut.de/journal/Nonverbal/cues/in/enviroment.pdf>

# **INFLUENCA E FAKTORËVE DEMOGRAFIKË NË PËRFSHIRJEN NË POLITIKËBËRJE TË INDIVIDËVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA E FAMILJARËVE TË TYRE.**

**Blerta Çani Drenofci**

Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (FSHDPK).

## **Përmbledhje**

Artikulli njeh lexuesin me rezultatet e një studimi të kryer së fundmi në Shqipëri, me synim eksplorimin e përfshirjes në politikëbërje të personave me aftësi të kufizuara dhe familjarëve të tyre. Artikulli i përgjigjet pyetjes se si ndikojnë faktoret demografike si gjinia, kategoria e aftësisë së kufizuar, vendbanimi dhe të qenit individ me aftësi të kufizuar apo familjar i tij, në procesin e përfshirjes në politikëbërje të personave me aftësi të kufizuara.

Kuadri ligjor i periudhës post-komuniste krijon premiset bazë për të mundësuar përfshirjen në politikëbërje të individëve me aftësi të kufizuar dhe organizatave përfaqësuese të tyre në nivel kombëtar dhe lokal. Artikulli pasqyron një përmbledhje të kuadrit ligjor në këtë drejtim si edhe studime në Shqipëri të lidhura me përfshirjen në politikëbërje të grupeve të interesit.

Me pas, artikulli përshkruan metodologjinë e ndjekur për realizimin e studimit. Të dhënat u mbledhën përmes një pyetësoi disa seksionësh në gjashtë rajone të vendit: Elbasan, Durrës, Korçë dhe Tiranë etj. Pjesëmarrësit ishin 477 persona me aftësi të kufizuara dhe 397 antarë të familjeve të tyre. Rezultatet tregojnë përfshirje të ulët në proces dhe një sërë barrierash: burrat me aftësi të kufizuara janë më shumë të përfshirë në proceset politikëbërëse në krahasim me gratë me aftësi të kufizuara; personat me aftësi të kufizuara mendore dhe autizëm janë më pak të përfshirë në krahasim me grupimet e tjera të aftësisë së kufizuar; individët me aftësi të kufizuara që banojnë në zonat rurale apo periferike nuk konsiderohen të jenë pjesë e hartimit të politikave që ndikojnë në jetën e tyre.

**Fjalë Çelës:** politikëbërje, pjesëmarrje dhe qeverisje e mirë, aftësi e kufizuar

## **Abstract**

The paper describes the results of a recent study conducted in Albania on the pattern of engagement in the process of policy-making of people with disabilities and their family members. The paper will explore how demographic factors like gender, disability category, residence and being individual with disability or family member, influence the engagement in the policy making process.

Post-communist Albanian legislation (1995-2010) provides the preliminary context for the creation of enabling social niches for the engagement of people with disabilities and the organizations representing them in the policy-making processes both at the national and local levels. The paper provides a brief description of the Albanian legislation as well as research studies that have measured its effectiveness.

Then, the paper describes the methods of the study. In brief, data were collected through a cross-sectional survey in six regions of the country, Elbasan, Fier, Durres,

Shkoder, Korce and Tirane. Participants were 477 people with disabilities and 397 family members.

The results indicate an unsatisfactory engagement pattern of the policy making process and various barriers: men with disabilities are more involved in the policy making processes than women with disabilities; people with mental disability and autism and their family members are less involved in the policy making process if we compare with other disability groups; people with disabilities from rural and periphery areas are not considered to be part of the process of policy making.

## HYRJE

Vitet e fundit po flitet për 'pjesëmarrje aktive të qytetarëve' edhe në Shqipëri. Studimet tregojnë se qytetarët shqiptarë janë pak të përfshirë drejtpërsëdrejti në procese politikëbërëse, të cilat mund të kenë ndikim në jetën e tyre. Studimet tregojnë gjithashtu për nivelin e ulët të përfshirjes së qytetarëve shqiptarë në organizata si antarë apo vullnetarë, çka tregon mbi indiferentizmin e tyre për përfshirjen në përgjithësi, por edhe ndaj shoqërisë civile në veçanti (IDM& CIVICUS 2010).

Megjithatë, janë bërë përpjekje për të targetuar demokratizimin dhe qeverisjen e mirë nga aktorët e shoqërisë civile. Në studimet e viteve të fundit evidentohet se është rritur tendenca e bashkëpunimit të qeverisë me shoqërinë civile në hartimin e ligjeve (Euclid Network & HDPC 2009). Megjithëse nuk ka mekanizma formalë për përfshirjen në procese politikëbërëse, shoqëria civile në Shqipëri ka qenë pjesë e konsultimeve për një sërë ligjesh të rëndësishme dhe ka mundur të përfshijë interesat e sektorit në to. Përveç kësaj, ajo ka qenë edhe iniciuese e nismave ligjore, të propozuara, të diskutuara me bazë të gjerë dhe të miratuara më pas nga Qeveria Shqiptare.

Pavarësisht arritjeve të shoqërisë civile të ndikojë në bërjen e politikave të vendit, studimi i Euclid Network & HDPC (2009), tregoi se organizatat e shoqërisë civile janë në një periudhë 'përgjumjeje' në tre apo katër vitet e fundit. Në të njëjtën linjë, indeksi i qëndrueshmërisë së OJFve (USAID 2009) tregon për një periudhë 'stacionare' të sektorit në tre vite e fundit, pasi ka një rënie të aktiviteteve avokuese, zvogëlim të impaktit në politikat e qeverisë, rënie të rrjetëzimeve dhe pjesëmarrjes në organizata me anëtarësi. Komisioni Europian në "Raportin e Progresit për Shqipërinë 2009" ritheksoi mungesën e efektivitetit të pjesëmarrjes së shoqërisë civile në procese politikëbërëse.

Kuadri ligjor, në nxitje të përfshirjes në politikëbërje të grupeve të interesit dhe të organizatave të shoqërisë civile në Shqipëri, nuk është frenues, megjithatë mungesa e instrumentave formalë (Komisioni Europian 2009), ndikon që përfshirja të mbetet në dëshirën e politikëbërësve, të cilët shpeshherë nuk e kuptojnë rëndësinë e saj e për rrjedhojë, e neglizhojnë atë.

Studime të kryera në vend, në fushën e aftësisë së kufizuar, tregojnë se personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre ende i përkasin pjesës më të marginalizuar të shoqërisë shqiptare. Ata janë të varfër dhe ndihen të izoluar në një shoqëri, të cilës ende i duhet të zhdukë një sërë barrierash arkitektonike dhe shoqërore (Flagler 2009). Shërbimet sociale, shëndetësore, arsimore dhe ato të punësimit janë të një cilësie të dobët (Drenofci 2010, FSHDPAK 2010). Sistemi i vlerësimit është i orientuar drejt modelit mjekësor të aftësisë së kufizuar (FSHDPAK 2008a) dhe kuadri ligjor, megjithë përmirësimet e pesë viteve të fundit, nuk mbron njëlloj të gjithë personat me aftësi të kufizuara (FSHDPAK 2006).

Kuadri ligjor shqiptar i periudhës post-komuniste (FSHDPK 2008b; FSHDPK 2009a), mundëson kontekstin bazë për krijimin e pozicionit social të përfshirjes së njerëzve me aftësi të kufizuara dhe organizatave përfaqësuese të tyre në proceset politikëbërëse si në nivel qendror, ashtu edhe atë lokal. Ligje si "Statusi i të Verbërit" (Ligj Nr. 8098, datë 8.3.1996), "Statusi i Invalidëve të Punës" (Ligj Nr. 7889, datë 14.12.1994), "Ligji i Shëndetit Mendor" (Ligj Nr. 8092, datë 21.3.1996), "Ligji për Ndihmën Ekonomike dhe Përkujdesin Social" (Ligj Nr. 9935, datë 10.3.2005) si edhe Vendime të Këshillit të Ministrave, përmendur "Strategjia Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara" (VKM Nr. 8, datë 7.1.2007), "Aprovimi i Standarteve të Përkujdesit Social për Personat me Aftësi të Kufizuara në Qendrat Ditore e Rezidenciale të Shërbimeve" (VKM, Nr.822, datë 6.12.2006) , përmbajnë nene specifike, përmes të cilave kërkohet pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuara dhe përfaqësuesve të tyre në të gjitha hallkat e procesit të bërjes së politikave.

Megjithatë, studime tregojnë se përfshirja e tyre nuk ka qenë efektive. Një studim i realizuar në vitin 2009 me 1041 persona me aftësi të kufizuara dhe familjarë të tyre, tregoi se një në tre pjesëmarrës (35.3%) nuk e ndiente të konsiderohej si partner në procese politikëbërëse në nivel lokal dhe qendror (Flagler 2009).

Organizatat e fushës së aftësisë së kufizuar kanë luajtur rol në hartimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor të fushës së aftësisë së kufizuar. Ato nxitën hartimin e ligjeve specifike të grupimeve të ndryshme të aftësisë së kufizuar në vitet e para të procesit të tranzicionit në Shqipëri (1994-2000). Më pas, në periudhën 2002-2005, u përfshinë në një proces bashkëpunimi, konsultimi e partneriteti me qeverinë në hartimin e dokumentit të parë në vend, përmes të cilit aftësia e kufizuar trajtohej si një çështje shumësektoriale dhe shumë dimensionale (Strategjia Kombëtare për Aftësinë e Kufizuar), për të vazhduar më tej në inisiativat për të nxitur problematikën e aftësisë së kufizuar në ligje e strategji të lidhura me punësimin, infrastrukturën, arsimin dhe proceset elektorale.

Megjithë arritjet, studime tregojnë se lëvizja e aftësisë së kufizuar në Shqipëri është jo e bashkërenduar, pa kapacitete dhe pa një vizion gjithëpërfshirës, duke u fokusuar më së shumti në inisiativa të shkëputura, specifike për grupe të ndryshme të aftësisë së kufizuar (Handicap International 2004). Për më tepër, studime tregojnë për lidhje të dobëta të organizatave me qytetarët me aftësi të kufizuara, të cilët shprehen se ndihen të papërfaqësuar dhe nuk janë pjesë e këtyre organizatave (Caritas 2008).

Nevoja e këtij punimi është e lidhur me shumë faktorë. Së pari, ky studim i shtohet listës të studimeve të pakta në fushën e aftësisë së kufizuar në Shqipëri; së dyti, ai realizohet nën këndvështrimin e paradigmes së modelit social të aftësisë së kufizuar, duke u fokusuar jo vetëm tek individ, por më gjerë në ndërveprimin e tij me organizata e institucione përgjegjëse; së treti studimi evidenton një sërë problematikash që mbart përfshirja e personave me aftësi të kufizuara në politikëbërje në të gjitha nivelet e saj; së katërti, përmes tij evidentohen barrierat kryesore të të gjitha niveleve që pengojnë përfshirjen e individëve me aftësi të kufizuara; së pesti, studimi evidenton rëndësinë e përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara dhe organizatave të tyre në të gjitha fushat e jo vetëm në çështje specifike që i përkasin vetëm aftësisë së kufizuar; së gjashti, studimi evidenton rëndësinë e përfshirjes në të gjitha nivelet e politikëbërjes, nga të gjitha kategoritë e aftësisë së kufizuar; së shtati, ai thekson rëndësinë e marrjes në konsideratë të perspektivës gjinore gjatë proceseve politikëbërëse të fushës së aftësisë së kufizuar.

Rezultatet e këtij studimi mund të kenë ndikim në lëvizjen për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në Shqipëri. Modeli i përfshirjes, evidentuar përmes këtij

studimi, mund të sjellë përmirësimin e mëtejshëm të performancës së institucioneve qendrore dhe lokale në drejtim të masave që duhet të marrin për të rritur nivelin e përfshirjes në politikëbërje të personave me aftësi të kufizuara. Ai mund të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në lëvizjen e të drejtave të aftësisë së kufizuar, pasi orienton rritjen e nivelit të presionit përmes krijimit të koalicioneve e rrjeteve të gjera të avokatisë, ku organizatat e njerëzve me aftësi të kufizuara mund të kenë rol kryesor. Rezultatet e tij, mund të ndikojnë në rritjen e shkallës së përfaqësimit të individëve me aftësi të kufizuara, përmes shtimit të anëtarëve të organizatave apo koalicioneve, dhe anasjelltas vendosjes së procedurave të qarta për t'i mbajtur ato të informuar dhe marrë mendimin e tyre për çdo hap të procesit politikëbërës.

Rezultatet e tij, mund të ndikojnë gjithashtu edhe në demokratizimin e mëtejshëm të shoqërisë shqiptare në përgjithësi. Modeli i orientuar përmes këtij studimi tregon për rëndësinë e përfshirjes në politikëbërje të grupeve më të marginalizuara dhe më të varfëra të shoqërisë. Ai tregon se përfaqësime përmes organizatave qoftë këto avokatia apo qoftë me anëtarësi, nuk i bën këto grupe të ndihen qytetarë të barabartë dhe i vendos ato më tepër në rolin e përfituesit nga iniciativat e të tjerëve sesa në atë të qytetarit.

## **METODOLOGJIA**

Studimi u realizua përmes një metodologjie të kombinuar sasiore dhe cilësore. 874 pjesëmarrës u përfshinë në ofrimin e të dhënave sasiore, prej të cilëve 477 persona me aftësi të kufizuara, 397 prindër e familjarë të tyre nga disa rajone të vendit: Tirana, Durrësi, Shkodra, Elbasani, Fieri. Pjesëmarrësit u arritën përmes organizatave përfaqësuese të aftësisë së kufizuar, qendrave të shërbimeve dhe institucioneve lokale. Të gjitha kategoritë e aftësisë së kufizuar u përfaqësuan në studim. Po ashtu, përfaqësues të të dyja gjinive morën pjesë, me një përqindje pak më të lartë të meshkujve (57.9%). Pjesëmarrësit nga zonat rurale ishin më të paktë në numër se ato nga zonat urbane.

Instrumentat e përdorur për të mbledhur informacionin sasior, ishin pyetësorë të cilët përmbanin tre rubrika: pyetje demografike, pyetje të mbyllura dhe në fund, dy pyetje të hapura.

Të gjithë pjesëmarrësit morën pjesë vullnetarisht në studim. Të dhënat sasiore u përpunuan në SPSS (Versioni 17.00), ndërsa të dhënat cilësore u përpunuan në Excel sipas temave e nën-temave më të rëndësishme e të lidhura me pyetjet e studimit. Ky artikull synon t'i japë përgjigje pyetjeve të mëposhtme:

1. Si ndikojnë faktorët demografikë në përfshirjen në politikëbërje të personave me aftësi të kufizuara:

- a. Gjinia
- b. Kategoria e aftësisë së kufizuar
- c. Vendbanimi (qytet-fshat)

2. Si ndikon të qenit individ me aftësi të kufizuara apo familjar i tij në përfshirjen në politikëbërje?

## **REZULTATE E DISKUTIME**

*Ndikimi i gjinisë në përfshirjen në proceset politikëbërëse të individëve me aftësi të kufizuara dhe familjarëve të tyre*

Burrat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre, janë më të angazhuar në proceset politikëbërëse se gratë me aftësi të kufizuara. Jo vetëm në shoqërinë shqiptare,



por edhe në shoqëri më të zhvilluara, përfshirja e grave në politikëbërje është në nivele më të ulëta se ajo e burrave (Platforma e Pekinit për Veprim 1995). Për më tepër, gratë me aftësi të kufizuara vuajnë të qenit dyfish të diskriminuara, si rezultat i të qenit grua dhe të qenit me aftësi të kufizuara (Meekosha 1998; FSHDPAK 2009b). Kjo e kufizon aksesin e tyre në proceset politikëbërëse dhe i shtyn ato më fuqishëm drejt realizimit vetëm të roleve riprodiktive në familje dhe shoqëri. Në një shoqëri patriarkale siç është shoqëria shqiptare, pa dyshim që burrat kanë më tepër akses dhe liri për të qenë pjesë e proceseve politikëbërëse kur flitet për ta. Ata janë më të informuar për ndryshimet që po ndodhin në ligje e strategji që ndikojnë në jetën e tyre dhe janë më të përfshirë në takime kur diskutohen politika për ta.

Rezultatet e këtij studimi tregojnë për një përfshirje më të madhe të burrave me aftësi të kufizuara në të gjitha hallkat e procesit të bërjes së një politike në fushën e aftësisë së kufizuar. Kjo është evidente në disa aspekte. Më shumë burra (58.1%) se gra (56.5%) ishin informuar për ndryshime ligjore në fushën e aftësisë së kufizuar dhe më shumë burra se gra kishin marrë pjesë në takime ku ishin diskutuar politika të rëndësishme për ta. Nota mesatare me të cilën burrat vlerësuuan stadin final të përfshirjes në politikëbërje, ishte më e lartë në krahasim me atë të grave me aftësi të kufizuara (5.98 për burrat, 5.85 për gratë).

Varfëria është një faktor që shtyn si burrat ashtu edhe gratë me aftësi të kufizuara të jenë të interesuar të marrin informacion për përfitimet në para të aftësisë së kufizuar, por edhe të marrin pjesë më shumë në takime të organizuara në lidhje me diskutimin e politikave në lidhje me to. Rezultatet e studimit tregojnë për një diferencë të vogël në përfshirjen e burrave dhe grave me aftësi të kufizuara kur flitet për pagesat (1.7% për fazën e informimit dhe 0.7% për fazën e pjesëmarrjes në takime). Studimi tregon se gratë me aftësi të kufizuara kanë njohuri më të mira ligjore për ta dhe fëmijët e tyre (mesatarja statistikore 4.72 dhe deviacioni i standardit 1.993) në krahasim me burrat me aftësi të kufizuara (mesatarja statistikore 4.43 dhe deviacioni i standardit 2.160). Kjo mund të justifikohet me faktin se gratë janë në kërkim të vazhdueshëm të mundësive, të cilat mund t'i ndihmojnë ato të dalin nga gjendja në të cilën jetojnë. Nga ana tjetër, në të shumtën e rasteve në Shqipëri, janë nënat të cilat kthehen në kujdestare të fëmijës së tyre me aftësi të kufizuara, nuk kanë mundësi të punojnë apo të kenë jetën e tyre, e si rrjedhojë janë të lidhura vetëm me ndryshimet të cilat sadopak mund të ndikojnë në përmirësimin e situatës për fëmijët e tyre. Lehtësirat nga taksat lokale, ligjet që lidheshin me arsimin gjithëpërfshirës dhe nxitjen e punësimit, janë disa nga fushat ku gratë me aftësi të kufizuara kanë njohuri më të mira ligjore në krahasim me burrat. Kjo tregon se ato janë më kërkuese dhe më të interesuara për t'u shkolluar e punësuar vetë apo për fëmijët e tyre. Gratë me aftësi të kufizuara, duke qenë se kalojnë një kohë më të gjatë brenda shtëpisë, krahasuar me burrat me aftësi të kufizuara, janë me shumë në kontakt me informacionin mediatik. Gjithashtu, dhunimi i vazhdueshëm psikologjik edhe brenda familjes së tyre i shtyn gratë me aftësi të kufizuara të jenë më të interesuara për ndryshimet drejt një jetese të pavarur.

Burrat dhe gratë me aftësi të kufizuara dëshirojnë të jenë pjesë e proceseve politikëbërëse. Kjo tregohet në numrin e madh të grave e burrave me aftësi të kufizuara që klikuan këtë alternativë (86.6% gra dhe 85.9% burra). Burrat me aftësi të kufizuara e shohin më të errët gjendjen dhe klikojnë në një numër më të madh rreth barrierave të cilat pengojnë përfshirjen e tyre në proceset politikëbërëse. Si barrierat institucionale ashtu edhe ato që lidhen me përshtatshmërinë dhe me qëndrimet janë shënuar nga një numër më

i madh burrash me aftësi të kufizuara se sa gra me aftësi të kufizuara. Kjo për rrjedhojë të izolimit më të plotë të grave me aftësi të kufizuara brenda shtëpisë (është vetë familja që i izolon dhe i le ato të "padukshme", gjë që bën që ato të mos përballën drejtpërdrejt dhe të njohin barrierat fizike, institucionale dhe të komunikimit). Nga 21 barriera, 18 prej tyre burrat i vlerësoan më tepër. Rezultatet vërtetojnë se gratë shqiptare me aftësi të kufizuara megjithëse kanë më tepër njohuri ligjore në fushë, janë më pak të informuara dhe kanë akses më të limituar në procese të diskutimit të politikave në fushën e aftësisë së kufizuar.

### *Ndikimi i kategorisë së aftësisë së kufizuar në përfshirjen në procese politikëbërëse*

Përfshirja në politikëbërje e kategorive të ndryshme të aftësisë së kufizuar, është në nivele të ndryshme. Rezultatet e studimit tregojnë se kategoria e personave me aftësi të kufizuara mendore dhe autizëm, është kategoria që ka marrë më tepër informacion për ndryshimet ligjore, por që nga ana tjetër është përfshirë më pak në takime të diskutimit të politikave të fushës së aftësisë së kufizuar. Kategoria e personave me aftësi të kufizuara fizike (42%) dhe ata me probleme në shikim (39.1%), janë kategoritë që më shumë janë përfshirë në procese politikëbërëse të fushës së aftësisë së kufizuar. Po këto dy kategori të aftësisë së kufizuar më së shumti janë përfshirë në takime ku janë diskutuar pagesat e aftësisë së kufizuar. Ndërkohë në këtë pjesë të studimit vërtetohet edhe një herë se të gjitha kategoritë e aftësisë së kufizuar kanë marrë pjesë në takime ku janë diskutuar pagesat të cilat vijnë nga statuse të veçantë sipas kategorive të aftësisë së kufizuar. Pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuara intelektuale dhe autizëm janë kategoria e cila ka përfaqësimin më të ulët në krahasim me kategoritë e tjera në të gjitha fushat e diskutimit të politikave të arsimit, punësimit, përshtatshmërisë, shërbimeve sociale dhe shëndetësore.

Megjithëse kanë qenë më tepër prezent, kategoritë e aftësisë së kufizuar në lëvizje dhe në shikim, janë kategoritë më të pakënaqura dhe të cilat vlerësojnë më pak nivelin e përfshirjes në politikëbërje të personave me aftësi të kufizuara. Kjo tregon se ato janë kategori të cilat kanë një lëvizje më të fuqishme e si rrjedhim ligje dhe përfitime më të mëdha në krahasim me kategoritë e tjera të aftësisë së kufizuar. Gjithashtu, rezultatet e studimit tregojnë se njohuritë e personave me aftësi të kufizuara intelektuale, atyre me shëndet mendor, por edhe të invalidëve të punës janë njohuri të cilat janë vlerësuar me një notë jokaluese. Kjo vërteton më së miri statusin e ulët dhe diskriminues ligjor që sot kanë personat me aftësi të kufizuar intelektuale dhe ato me shëndet mendor. Për rastin e invalidëve të punës (3.17/10), mungesa e njohurive ligjore është më shumë e lidhur me mungesën e një alternative të lidhur me pagesat në kuiz, alternativë të cilën padyshim përfaqësuesit nga kjo kategori do ta vlerësonin drejt. Individë nga kategoria e personave me aftësi të kufizuara fizike dhe ato me probleme në shikim janë gjithashtu edhe njohës më të mirë të kuadrit ligjor nga i cili ato përfitojnë.

Diferencat në njohuri, informim, në mënyrat e komunikimit, përfshirje e mobilizim të kategorive të ndryshme të aftësisë së kufizuar kanë pasur ndikimin e tyre edhe në kuadrin ligjor e politik të fushës së aftësisë së kufizuar në Shqipëri. Lëvizja e të verbërve, invalidëve të punës dhe para e tetra plegjikëve ka qenë më e organizuar, më presuese dhe si rrjedhojë përfitimet e tyre janë shumë herë më të mëdha në krahasim me grupet e tjera. Lëvizja e prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara intelektuale, ka qenë ndërkohë më e pafuqishme, jo nën presionin e duhur, për të sjellë ndryshime pozitive ligjore në funksion të tyre. Duke qenë se personat me aftësi të kufizuara intelektuale nuk arrijnë të mbrojnë dhe përfaqësojnë vetveten, janë prindërit që e marrin këtë rol. Por

problemet e shumta familjare dhe prindërore, niveli i kufizuar i informacionit dhe kapaciteteve të tyre, presioni i vazhdueshëm psikologjik që sjell prania e aftësisë së kufizuar intelektuale në familje, si dhe prania e paragjyqimeve sociale shumë më të theksuara ndaj personave me aftësi të kufizuara mendore, bëjnë që prindërit të mos kenë kohën e duhur, angazhimin e duhur dhe këmbënguljen për të ndërtuar dhe finalizuar një proces të plotë e të suksesshem avokatie. Dhe më tej, ata jo vetëm nuk i bëjnë të "dukshëm" fëmijët e tyre (gjë që do të ndikonte në përsheptimin e zgjidhjeve), por i izolojnë më tej nga shoqëria shqiptare që shpesh i paragjykon e nuk ka vëmendjen e duhur ndaj tyre. Përfaqësues të institucioneve publike në shumë raste e cituan mungesën e mosbarazisë ligjore mes grupeve të aftësisë së kufizuar si një problem që duhet të adresohet.

*Ndikimi i vendbanimit në përfshirjen në politikëbërje të personave me aftësi të kufizuara dhe familjarëve të tyre*

Individët me aftësi të kufizuara banues në zonat rurale, janë më të izoluar, kanë më pak akses në informacion, në shërbime, e për më tepër janë më pak të përfshirë në procese politikëbërëse në krahasim me individët me aftësi të kufizuara, të cilët jetojnë pranë qendrave urbane. Rezultatet e studimit e vërtetuan këtë hipotezë. Së pari, personat me aftësi të kufizuara në fshat kanë më pak njohuri në ligjet dhe politikat që ndikojnë në jetën e tyre (mesatarja statistikore = 4.83 dhe deviacioni i standartit është 2.056 për qytetin dhe mesatarja statistikore = 4.57 dhe deviacioni i standartit është 1.789 për fshatin). Diferenca midis njohurive të individëve nga qyteti ndaj atyre që banojnë në fshat janë të dukshme në të gjitha ligjet e strategjitë.

Së dyti, më pak individë me aftësi të kufizuara nga fshati kanë marrë informacion për ndryshimet në politika dhe gati dy herë më pak se individët nga qyteti kanë marrë pjesë në procese politikëbërëse (15.2% dhe 30%). Në të gjitha fushat e takimeve pjesëmarrësit nga fshati janë në një numër më të vogël në krahasim me ato nga qyteti, të cilët rezultojnë më të interesuar në politika të lidhura me pagesat, arsimin, punësimin, përshtatshmërinë dhe shërbimet shëndetësore. Fusha e vetme e takimit në të cilën ka pasur më shumë prezent persona me aftësi të kufizuar nga fshati, është ajo e shërbimeve sociale. Kjo mund të shpjegohet me mungesën totale të shërbimeve në zonat rurale dhe me dëshirën dhe kërkesën në rritje të individëve me banim në fshat për to.

Së treti, pjesëmarrësit nga qyteti vlerësuan me nota më të larta nivelin e përfshirjes së tyre në takime të diskutimit të politikave në krahasim me ata nga fshati. Së katërti, pjesëmarrësit nga fshati gjykuan si më shumë problematike thujtë të gjitha barrierat alternative të cilat lidheshin me qëndrimet, me bashkëpunimin e ulët me pushtetin lokal, me nivelin e aksesit dhe largësinë nga vendi i takimit etj. Vlen të theksohet këtu se dyfishi i pjesëmarrësve nga fshati (62.8%) kanë humbur besimin se gjendja mund të ndryshojë, krahasuar me ato nga qyteti. Një nga faktorët mund të jetë edhe ritmi shumë i ulët ose inegzistent i ndryshimeve pozitive në përgjithësi në zonat rurale, krahasuar me ato urbane. Në dy nga fushat e lidhura me komunikimin e përshtatshëm përmes gjuhës së shenjave dhe asaj braille, pjesëma-rrësit nga zonat rurale vlerësuan më pak se ato nga zonat urbane. Ky fakt mund të jetë i lidhur më tepër me mungesën e njohurive dhe informacionit në drejtim të komunikimit të përshtatur.

*Ndikimi i të qenit person me aftësi të kufizuara apo familjar i tyre në përfshirjen në procese politikëbërëse*

Studimi tregoi se më shumë familjarë se individë me aftësi të kufizuara janë të përfshirë në proceset politikëbërëse të fushës së aftësisë së kufizuar në nivel qendror e lokal. Kjo shpjegohet me: a) më shumë familjarë (48.5%) se individë (35.9%) kanë marrë informacion për çështje të ndryshme të aftësisë së kufizuar, b) më shumë familjarë (29.5%) se individë (25.2%) kanë marrë pjesë në takime të diskutimit të politikave, c) më shumë familjarë (35.1%) se individë (34.9%) vlerësuan me një notë ngelëse (4) dhe kaluese të çalë (5) të qenët aktiv në takime dhe më shumë familjarë (38.4%) se persona (35.3%) vlerësuan me nota 4 e 5 konsultimin në vazhdimësi deri në draftin final, d) familjarët treguan të kenë njohuri ligjore më të mira (4.78/10 dhe 4.39/10) në shtatë prej fushave të cilat u kërkuar të vlerësohen, e) në 16 nga 21 barrierat alternative, perceptimi i familjarëve është më i pritur drejt negativitetit në krahasim me individët me aftësi të kufizuara. Barrierat në qëndrime dhe mungesën e aksesit, familjarët i vlerësojnë si më problematike në krahasim me individët.

Përfshirja më e madhe në procese politikëbërëse e familjarëve në krahasim me individët me aftësi të kufizuara mund të shpjegohet së pari me ekzistencën e barrierave fizike e të komunikimit, të cilat e vështirësojnë përfshirjen e individëve me aftësi të kufizuara, por edhe mund të kushtëzohet nga paragjykimet që ekzistojnë edhe brenda familjes ndaj kapaciteteve të personit me aftësi të kufizuara. Një studim i FSHDPAK (1998, p.18) tregon se familjet shqiptare preferojnë t'i quajnë 'të sëmurë' personat me aftësi të kufizuara mendore, duke u ofruar atyre kujdes brenda familjes. Nga të pasurit frikë nga diskriminimi dhe 'tallja', ata mbahen të mbyllur, duke i përjashtuar nga jeta normale. Kjo mënyrë pjesëmarrjeje dhe përfaqësimi shpesh orienton në zgjidhje në interes të familjes dhe jo të vetë personit me aftësi të kufizuara (Ekonomi 2002, p.12; FSHDPAK 2005).

## **PERFUNDIME E REKOMANDIME**

Rezultatet e këtij studimi treguan se megjithë dëshirën dhe përpjekjet për t'u përfshirë, modeli i përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në procese politikëbërëse në Shqipëri, është më shumë i orientuar drejt përjashtimit të tyre sesa përfshirjes. Studimi tregoi se personat me aftësi të kufizuar dhe familjarët e tyre, vazhdojnë të jenë të painformuar për ndryshimet ligjore e politike të cilat ndikojnë jetën e tyre. Interesi i tyre është i drejtuar nga ligjet që lidhen vetëm me pagesat dhe përfitimet në para, për të cilat ato mbahen të informuar si nga organizatat, në të cilat ato mund të jenë anëtarë, ashtu edhe nga institucionet lokale. Gjendja e vështirë ekonomike në të cilën jetojnë shumica e familjeve shqiptare që kanë anëtarë me aftësi të kufizuara, mungesa e njohurive të tyre për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, por edhe humbja e besimit për një ndryshim pozitiv, ndikojnë pa dyshim në pjesëmarrjen e ulët të individëve me aftësi të kufizuara dhe familjarëve të tyre në procese politikëbërëse në fusha të tjera me interes për to, përmendur arsimin, punësimin e formimin profesional, shërbimet alternative dhe aksesin në informacion, mjete e ambiente. Pengesat strukturore dhe ato të qëndrimeve të shoqërisë dhe institucioneve, padyshim që luajnë rolin e tyre në këtë proces.

Gratë me aftësi të kufizuara janë më të papërfshira në procese të bërjes së politikave të fushës së aftësisë së kufizuar. Ato janë më të padukshme e të izoluar, duke i atribuar rolin e liderit antarëve meshkuj të familjeve të tyre. Rezultatet e studimit tregojnë

për një përfshirje të niveleve të ulëta në politikëbërje të personave me aftësi të kufizuara të cilët banojnë në zonat rurale. Personat me aftësi të kufizuara intelektuale dhe ata me shëndet mendor, përfshirë edhe familjarët e tyre, janë kategoritë të cilat e ndjejnë veten më të papërfshirë dhe më të papërfillur. Studimi tregoi për një rol më aktiv të prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuar në procese politikëbërëse.

Rezultatet e këtij studimi, diktojnë rekomandime për organizatat e fushës së aftësisë së kufizuar dhe institucionet përgjegjëse të nivelit qendror e lokal, me qëllim përmirësimin e situatës së përfshirjes në politikëbërje të grupimit të individëve me aftësi të kufizuara.

*Rekomandohet që organizatat e fushës të:*

- Fuqizojnë kapacitetet në drejtim të të punuarit me pjesëmarrje.
- Fuqizojnë kapacitetet për realizimin e avokatisë së sukseshme.
- Rrisin bashkëpunimin, përmes krijimit të rrjetëzimeve e koalicioneve sa më të gjera për çështje me interes të përbashkët.
- Përmirësojnë performancën e tyre në drejtim të përfaqësimit sa më efektiv të zërit të çdo klienti apo anëtar të tyre.
- Bashkëpunojnë ngushtësisht me degët lokale të tyre dhe me institucionet lokale në nivel bashkie dhe komune për të mbajtur lidhjet e informuar njerëzit me aftësi të kufizuara në çdo zonë të vendit.
- Shtojnë presionin për eliminimin e të gjitha barrierave që pengojnë pjesëmarrjen e tyre.
- Bëjnë përpjekje për ta nxjerrë aftësinë e kufizuar nga korniza specifike, duke u bërë pjesë e tryezave ku diskutohen politika të rëndësisishme për të gjithë qytetarët shqiptarë.

*Rekomandohet që institucionet përgjegjëse të nivelit qendror e lokal të:*

- Përmirësojnë kuadrin ligjor për të nxitur dhe mundësuar pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në politikëbërje.
- Hartojnë rregullore e procedura me qëllim që të mundësojnë zbatimin e procesit.
- Planifikojnë në avancë të gjithë procesin dhe të parashikojnë buxhetet përkatëse.
- Fuqizojnë kapacitetet e tyre për të punuar me pjesëmarrje.
- Marrin masa për të eliminuar barrierat strukturore, të cilat pengojnë procesin e përfshirjes.

## **Referenca**

Caritas 2008, *Need assessment survey for people with disabilities in Shkodra, Laç & Fushë Kruja region*, Tirana, Albania: Caritas.

Commission of The European Communities 2009, Albania 2009 progress report, pare më 15 Prill 2010

[http://ec.europa.eu/delegations/albania/documents/eu\\_albania/2009\\_progress\\_report\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/delegations/albania/documents/eu_albania/2009_progress_report_en.pdf).

Drenofci, B 2010, 'Are people with disabilities included in the social welfare system?', *The Academic Thought*, vol. 2, no. 4, pp. 167-176.

- Ekonomi, M 2002, *Children and disability in Albania*: MONNE country analytical report, pare më 10 Qershor 2010, <[http://unicef.org/research/ESP/countryreports2002/alb\\_rep2002\\_eng.pdf](http://unicef.org/research/ESP/countryreports2002/alb_rep2002_eng.pdf)>
- EUCLID Network 2009, 'Third sector development in Albania: challenges and opportunities', Human Development Promotion Centre: Tirana.
- Flagler, M 2009, 'Consumers speak out', In *The implementation of the Action Plan of the National Strategy on People with Disabilities in 2008-2009*. Tirana, Albania: ADRF. pp. 151-172.
- FSHDPAK 1998, *Qëndrimi i opinionit publik për personat me aftësi të kufizuara*, Tiranë, Shqipëri: FSHDPAK.
- FSHDPAK 2005, *Analizë e kuadrit ligjor që garanton edukimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në kushtet e arsimit gjithëpërfshirës*, Tiranë, Shqipëri: FSHDPAK.
- FSHDPAK 2006, *Studim & vlerësim legjislacionit mbi aftësinë e kufizuar në Shqipëri*, Tiranë, Shqipëri: FSHDPAK.
- FSHDPAK 2008a, *Studim i kuadrit ligjor mbi vlerësimin e komisionimin e aftësisë së kufizuar në Shqipëri*, Tiranë, Shqipëri: FSHDPAK.
- FSHDPAK 2008b, *Paketë Ligjore për Aftësinë e Kufizuar në Shqipëri*, Tiranë, Shqipëri: FSHDPAK.
- FSHDPAK 2009a, *Paketë Ligjore për Aftësinë e Kufizuar në Shqipëri*, Tiranë, Shqipëri: FSHDPAK.
- FSHDPAK 2009b, *Gratë me aftësi të kufizuara në Shqipëri: Të përfshira apo të harruara*, Tiranë, Shqipëri: FSHDPAK.
- FSHDPAK 2010, *Për një jetë dinjitoze përmes punës: Vëzhgim mbi punësimin e personave me aftësi të kufizuara në pesë rajone të Shqipërisë*, Tiranë, Shqipëri: FSHDPAK.
- Handicap International 2004, *Beyond de-institutionalization: the unsteady transition towards an enabling system in South East Europe*, Handicap International, France.
- Meekosha, H 1998, 'Body battles: body, gender and disability', in T Shakespeare (ed.), *The disability reader*, Cassell, London, pp. 163-181.
- IDM& CIVICUS 2010, 'Civil society index for Albania: in search of citizens& impact', IDM: Tirana.
- USAID 2009, *NGO Sustainability Index for Central and Eastern Europe*, USAID.
- The United Nations 2005, *Fourth World Conference on Women: Action for Equality, Development and Peace*, Beijing, China - September 1995, pare më 14 shkurt 2011, <<http://www.un.org/womenwatch/daw/beijing/platform/plat1.htm>>

# **PUNËSIMI I GRAVE SIPAS KËNDVËSHTRIMIT HISTORIK.**

**Doreta Tartari ( Kuçi )**

Departamenti Sociologjisë, Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës

## **Përmbledhje**

Artikulli është një përpyetje për të sjellë tek lexuesi mënyrën se si ka evoluar punësimi i grave ndër shekuj.

Artikulli nëpërmjet këndvështrimit historik na jep një tablo të qartë të ecurisë graduale të këtij procesi duke filluar nga koha e gjuetarëve e deri në ditët e sotme.

Punësimi në përgjithësi dhe ai i grave në veçanti ka qenë dhe mbetet një ndër prioritetet kryesore për të ardhmen e vendit, si një faktor vendimtar për rritjen ekonomike, vendosjen e barazisë gjinore, uljen e varfërisë si dhe formimin e grave në një shoqëri demokratike.

Ky proces është i lidhur direkt me përkatësinë gjinore, kjo për vetë faktin se sot vihet re një rritje e propocionit të grave në forcat e punës si një nga tendencat më të rëndësishme të tregut të punës të kohëve të fundit.

Metoda e përdorur për shqyrtimin e çështjeve të trajtuara është metoda teorike pasi të dhënat janë mbledhur në bazë të studimeve dhe dokumentacioneve të deritanishme të kësaj fushe.

**Fjalët kyç:** Punësimi, Gratë, Përkatësia gjinore, Profesionet, Diferenca e roleve.

## **Abstract**

This article is an attempt to transmit to the reader the way that women employment has evolved through the centuries.

Through an historical perspective, this article offers a clear view of the gradual development of this process starting from the “hunters age” to the present days.

Employment in general, especially that of women, has been and still is one of the main priorities for the future of the country as an essential element in the economic development, in the establishment of gender equity, in the decline of poverty as well as in the women’s background in a democratic society.

This process is directly related to gender due to the fact that today we notice an increase in women proportion in labor forces as one of the most important tendencies in the present labor market.

The method used in the analysis of the issues treated in this article is the theoretical method due to the fact that the data was collected based on the studies and documents in this field.

**Kew Words:** employment, women, gender, professions, role differences.

## **1. Puna, një këndvështrim historik.**

Pabarazitë gjinore janë shumë të përhapura. Si format e paguara dhe ato forma të papaguara të punës gjithmonë kanë shfaqur modele pabarazie. Një nga problemet më kryesore që ka lidhje direkte me pabarazitë gjinore është shpërblimi. Duke injoruar

problemet e tjera në përlogaritjen e pagës si p.sh. aftësia, kualifikimet apo orët e punës, mund të themi që aspekt tjetër i fuqishëm në përcaktimin e pagës është dhe gjinia. Studimet pikërisht kanë treguar këtë dallim. Vetëm në vitin 2000 gratë kanë arritur të kenë 82% të rrogës së burrave për të njëjtën punë pasi përvoja e grave në punë është në rradhë të parë një proces interpretues që do të thotë se femrat me punën e tyre mund të ndryshojnë dhe zhvillojnë shoqërinë duke ulur pabarazitë gjinore.

Kontributet e Marksit, Weberit dhe Durkheimit në ekzaminimin e marrëdhënieve gjinore në punë, në tërësi nuk janë të përdorshme. Padyshim që të gjithë këto sociologë shfaqin idenë se pabarazitë gjinore kanë qenë prezente në çdo lloj formash shoqërore.

Ndarja e punës dhe përcaktimi i statusit të personave të rritur në shumë shoqëri kryhet duke marrë si kriter bazë përkatësinë gjinore (Nielson, 1978), por vetëm pak statuse siç është statusi i nënës dhe babait, lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me seksin. Megjithatë, historikisht stauet e nënës dhe babait kanë luajtur një rol shumë të rëndësishëm në krijimin e barazisë gjinore (Huber, 1976).

Në shoqëritë e hershme të gjuetarëve dhe mbledhësve të ushqimit nënat zotëronin shumë detyra. Varësia dhe përkujdesja për fëmijët u përkiste atyre dhe kjo i detyronte gratë të mbeteshin në të njëjtin vend për një kohë të gjatë. Megjithëse edhe gratë mund të merreshin me gjueti, burrat ishin gjuetarë që largoheshin nga zonat e banimit me ditë të tëra (Friedl, 1975). Disa antropologë diskutojnë mbi idenë se, duke qenë se gjuetia burimin më të rëndësishëm të sigurimit të ushqimit në këto shoqëri, rolet biologjike u lejuan meshkujve të monopolizonin rolet sociale më të vlerësuara nga ana kulturore.

Harris (1977) ka mbrojtur idenë se diferenca në rolet riprodhuese, ka krijuar diferenca edhe në sferën shoqërore, duke u lejuar burrave të dominonin edhe në fusha të rëndësishme sociale siç ishte fusha e luftës (Harris, 1977).

Autorë të tjerë mbrojnë idenë se ndarja e punës mes meshkujve dhe femrave nuk u shoqërua me pabarazi në shoqëritë e gjuetarëve dhe mbledhësve të ushqimit ose në shoqëri të tjera horikulturore. Në të gjitha shoqëritë statusi i të rriturve varet nga puna shoqërisht produktive. (Huber & Spitze, 1983). Në shoqëritë e hershme, e gjithë puna qoftë e meshkujve apo e femrave, kontribuonte në zhvillimin e komunitetit, kjo edhe për arsyen se familja nuk ishte e ndarë nga komuniteti. Puna “shtëpiake” e femrave ishte jo më pak shoqërisht produktive në krahasim me gjuetinë dhe luftimin, sfera këto të udhëhequra nga meshkujt.

Para periudhës së urbanizimit pjesa më e madhe e grave kryenin një punë të përveç kujdesit për fëmijët dhe punët e përditshme shtëpiake, si p.sh. punën në kopështin, kultivonin perimet për përdorim shtëpiak, kullosnin delet, prodhonin bukë etj. Përveç familjeve të pasura, detyrat që lidhen me punët e sotme të shtëpisë, pastrimi, rregullimi, fshirja, bërja e pazarit, etj. nuk ishin punët kryesore shtëpiake. Dhomat në shtëpitë paramoderne nuk kishin përdorim të veçantë dhe ishin pak të mobiluara. Në një shtëpi të zakonshme kishte pak për të pastruar e rregulluar. Gatimi dhe puna në makinën endëse ose tezgjah zinin të gjitha të njëjtën hapësirë (Tilly & Scott, 1978).

Në Amerikën e kolonizuar, familjet prodhonin më shumë se konsumonin dhe megjithëse meshkujt dhe femrat zakonisht bënin gjëra të ndryshme, femrat kishin role të rëndësishme prodhuese siç ishte endja e pëlhurave dhe krijimi i veshjeve, prodhimi i produkteve të tilla si sapuni apo qiriri, tregëtimi në shesh etj. Disa gra punonin si farkëtare, rrobaqepëse, tregëtare nëpër dyqane etj. dhe kur burrat e tyre vdisnin, shpesh ato zotëronin kontroll të plotë të biznesit familjar (Baxandall etj., 1976; Demos, 1970). Në Amerikën e kolonizuar, sikurse edhe në mjaft shoqëri të tjera jo amerikane, jeta familjare



dhe prodhimi i të mirave ishin të zhvilluara në të njëjtin vend, por ky rregullim ekologjik ndryshoi menjëherë pas Revolucionit Industrial (Cherlin, 1983; Tilly & Scott, 1978).

Me ngritjen e fabrikave, shtëpitë u bënë “sfera private”, të ndara dhe të izoluar nga “sfera publike” e punës së paguar. Ndryshimet ekologjike krijuan vështirësi të mëdha për gratë që të zotëronin njëkohësisht edhe statusin e bashkëshorteve dhe nënave edhe role të rëndësishme e të pushtetshme jashtë familjes (Sachs, 1983). Kjo sigurisht ndikoi ndarjen e punës brenda familjes.

## **2. Revolucion i industrial dhe ndryshimet në punësim.**

Teoricienë të ndryshëm nuk bien dakort se në ç’mënyrë përfituan gratë nga Revolucion i Industrial britanik (1760-1830).

Disa historianë më të fundit u fokusuan më së shumti në disavantazhet e punësimit të grave në këtë periudhë (Davidoff & Hall, : 1987). Megjithatë pavarësisht nga këto ndryshime, një gjë ishte e sigurt, që Revolucion i Industrial përbënte një epokë ndryshimesh në mënyrën e punësimit të grave. Sipas regjistrimit të përgjithshëm të asaj periudhe rezulton se numri i grave të punësuar në shërbimet shtëpiake zinte vendin e parë, më pas vinte punësimi në sektorin e prodhimit të tekstileve, rrobaqepësisë, agrikulturës etj. ndërsa sektorë të tillë si administrimi publik, forcat e armatosura, tregëtia e peshkimi zotëroheshin nga meshkujt (Mitchell, 1962: 60).

Revolucioni Industrial që mundësoi futjen në treg të makinerive të cilat viheshin në funksionim nga energjia e avullit të ujit, bëri të mundur që puna të mos organizohej më nëpër shtëpi, por nëpër fabrika.

Para Revolucionit Industrial, një pjesë e konsiderueshme e grave merrej me endjen e pëlhurave me dorë në kushtet e shtëpisë. Me zhvillimin e industrisë tekstile, mjaft femra u punësuan nëpër fabrika por mjaft të tjera nëpër zonat rurale mbetën të papuna si rezultat i konkurrencës që fabrikat i bënë endjes artizanale.

Në prag të Revolucionit Industrial gratë që punonin përdornin metoda të ndryshme për përkujdesjen ndaj fëmijëve. Ndonjëherë kujdesi ndaj fëmijëve dhe puna ishin të pajtueshme dhe nënat i merrnin me vete fëmijët në fushë apo dyqane ku punonin (Hopkinson, 1968). Zhvendosja e punës nëpër fabrika rriti vështirësitë e kombinimit të punës me kujdesin ndaj fëmijëve. Në shumë fabrika orari i punës ishte i ngurtë dhe gratë që pranonin të punonin, duhet të pranonin edhe orarin e punës 12 apo 13 orësh. Puna nëpër fabrika ishte shumë e disiplinuar, kështu gratë nuk kishin më mundësi të merrnin fëmijët me vete nëpër fabrika. Megjithatë, këto vështirësi nuk i pengonin nënat me fëmijë të vegjël të punësoheshin.

Nënat e shekullit të nëntëmbëdhjetë përdorën ndihmën e motrave më të mëdha, kushërinjve, fqinjve etj. për të siguruar kujdesin ndaj fëmijëve, ndërkohë që ato punonin.

Rritja e propocionit të grave në forcat e punës, përbën një nga tendencat më të rëndësishme në tregun e punës kohët e fundit kjo për vetë faktin se përqendrimi tek meshkujt, ka qënë kaq i zakonshëm (deri kohët e fundit) saqë rrallë mendohej se kërkonte një shpjegim. Ky nënvlerësim që shoqëria i ka bërë punës së femrave është produkt i nënvlerësimit të punës së femrave dhe në familje.

Ashtu si Goldthorpi (Goldthorpe) dhe Parkini argumentojnë se pozita e femrave varet nga pozita shoqërore e kryetarit të familjes. Natyrisht, argumenti i tyre vazhdon, qysh se koka e familjes – shtylla e familjes – është mashkull, pozita klasore e gruas përcaktohet nga klasa e partnerit të tyre. Kjo sillte dominim të meshkujve ndaj femrave,

pra nuk ishte e nevojshme që femrat të fitonin status në shoqëri me anë të punës. Por, nga ana tjetër, disa gra kanë një klasë shoqërore më të lartë sesa partnerët e tyre, por kjo nuk është rregull i përgjithshëm. Vlerësimi i Goldthorpit sugjeron se përcaktimi i pozitës klasore të femrës nga partneri i tyre (padyshim që gratë e palidhura mbajnë klasën e tyre) është një shfaqje, manifestim i diskriminimit seksual brenda shoqërisë.

Shpeshherë superioriteti i meshkujve shihet nga gratë si një strategji për të mbrojtur egon mashkullore, ndërkohë që për meshkujt ky superioritet nuk vihet re. Polert (Pollert;1981) sheh se femrat e një fabrike në Britani janë një shembull i mirë i asaj që sapo thamë. Ky shembull shfaq sesi femrat gjejnë siguri brenda punëve që kanë pagë më të ulët se ato të meshkujve. Kjo vjen pasi ato nuk duan të kërcënojnë egon e partnerëve të tyre. Një vetvlerësim kaq i ulët, shpeshherë forcon marrëdhëniet e dominimit të meshkujve ndaj femrave, dhe i bën femrat që ta perceptojnë punën (sidomos femrat e klasës puntore) si një ndërprerje ndërmjet shkollës dhe krijimit të familjes, apo si vend për të siguruar disa para plus dhe shoqëri sesa një karrierë. Shihet një prirje e femrave ku mbivlerësohet egoja e meshkujve dhe nënvlerësohet egoja e tyre. Ky mbivlerësim forcon akoma më shumë pabarazinë gjinore. Analizat e vajzave në shkolla mbështesin besimin se femrat në mënyrë të ndërgjegjshme ulin aftësitë e tyre për të mos kërcënuar egot e brishta të meshkujve (Sharpe, 1976; Horner, 1976) Gjithashtu studimi i Polertit shfaq se nëse femrat punojnë dhe nxjerrin më shumë, meshkujt do të ndjehen inferior dhe rezultati do të jetë se femrat do ta vuajnë më shumë këtë pasojë. Edhe pse papunësia e meshkujve ka lënë femrat të jenë burimi kryesor i të ardhurave, gratë akoma do të perceptojnë të ardhurat e tyre si ndihmuese, sesa si kryesore. Ka pak fakte që tregojnë se meshkujt do të aktivizohen në punët e shtëpisë edhe nëse ato janë papunë. Në Britani, 75% e grave merren me punët e shtëpisë (2001). Ndërsa meshkujt britanik harxhojnë 193 minuta në ditë duke u përfshirë në punë të paguar ndërsa femrat vetëm 75 minuta. Si rrjedhim, roga mesatare javore për meshkujt është 247 paund ndërsa për femrat 119 paund. Nëse ndodh e kundërta, meshkujt priren më tepër drejt vetvrasjes, alkolit, kanë atake kardiake, jetojnë ç vjet më pak. Meshkujt përbëjnë 80% e popullatës kriminale. Nga ana tjetër, femra sa më shumë të edukohet dhe sa më rrogë të mirë të ketë do të përfshihet në më pak punë shtëpiake sesa koleget e saj me edukim më të ulët dhe me rrogë më të ulët. Kjo nuk vjen pasi pasuria garanton teknologji shtëpiake –kjo nuk bën ndryshime në orët që i përkushtohemi shtëpisë; thjesht bën shtëpinë më të pastër – por sepse ato kanë një qëndrim më të hapur ndaj punëve të shtëpisë dhe krijojnë marrëveshje. Ndërsa femrat më pak të edukuara priren më shumë drejt punëve shtëpiake sepse meshkujt nuk rrijnë në shtëpi por në punë. Këtë mundësi nuk ja japin punëdhënësit e tyre, as sindikatat por partneret duke mbajtur përgjegjësitë shtëpiake. çështja shkon përtej punës së pabarabartë dhe përfshin rëndësinë e punës dhe familjes tek meshkujt dhe tek femrat. Shumë gra nuk kanë detyrime ndaj familjes, por jeta e tyre familjare garanton kuptimin kryesor të jetës. Si meshkujt dhe femrat e vlerësojnë familjen më shumë se punën. Por meshkujt nuk janë vënë përpara dilemës si të kombinojmë punën e paguar me përgjegjësitë shtëpiake. (Crehan; 1986).

Pozicioni i sindikatave në punësimin e femrave dhe arritjen e barazive nuk ka qënë shumë rezultativ gjatë kohërave. Sindikatat kanë pasur një praktikë tradicionale në përjashtimin e femrave duke e justifikuar këtë me vendet e pakëta të punësimit që ato kanë. Sindikatat edhe mbas Luftës së Dytë Botërore, shfaqnin diskriminimin ndaj femrave dhe grupeve minoritare. Ashtu sikurse dhe Kambell (Cambell) shprehet: "Për shumë femra, sindikatat mblidheshin në kohën e gabuar në vendin e gabuar dhe për gjërat

e gabuara. Ndërsa për shumë sindikalistë, femrat janë njerëzit e gabuar në vendin e gabuar, në kohën e gabuar që vazhdojnë po me të njëjta gjëra të gabuara." Por kushtet e punës u tjetërsuan, influenza e shteti ndryshoi duke përkrahur dhe femrat gjithashtu, si rrjedhojë kemi një rritje të femrave në vendet e punës (sidomos femrat e edukuara), kemi konkurrencë ndërmjet antarëve të sindikatave (sidomos kur punës manuale i ra rëndësia) dhe një brez feminist që krijon lëvizje politike dhe industriale nga femrat për femrat, të gjitha këto dhanë shtysat për veprimet feministe duke tërhequr dhe interesin e sindikatave. Padyshim, kemi pasur një mungesë interesi historik të sindikatave për femrat që ka shtyrë gjatë viteve këtë distancë me femrat puntore, urretje për to. Densiteti i sindikatave për femrat vetëm kohët e fundit ka filluar të afrohet me atë të meshkujve. Në vitin 1978 kishim 30% të femrave në sindikata ndërsa në një anketim më 1989, 39% e femrave puntore ishin pjesë e sindikatave. Një problem tjetër që ka të bëjë me femrat, dhe numrin e tyre të ulët në sindikata është se shumë femra përfshihen në punë me kohë të pjesshme. Sindikatat nuk kërkojnë antërarë me punë të pjesshme pasi ato janë të vështirë për tu kontaktuar dhe jo fort të angazhuar në lëvizjet sindikaliste. Për më tepër grupet më të mëdha sindikaliste janë pikërisht ato grupe që përfshijnë sektore pune ku meshkujt dominojnë (ndërtim; prodhim). Mund të themi se përfshirja e grave në sindikata është më e ulët se ajo e meshkujve. Shumë faktorë kanë të bëjnë me këtë përqindja si pozicioni i punës, oraret e punës dhe ndarja gjinore në punë.


### **3. Punësimi dhe përkatësia gjinore. Tendencat e fundit.**

Barazia mes grave dhe burrave në të gjitha sferat e jetës private dhe publike parashikohet edhe në legjislacion, siç është ligji nr.9970, datë 24.07.2008 "**Për barazinë gjinore në shoqëri**", i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2008. Synimi i këtij ligji është: a) të sigurojë mbrojtje efikase nga diskriminimi për shkak të gjinisë; b) të përcaktojë masa për garantimin e mundësive të barabarta ndërmjet grave e burrave, për të eliminuar diskriminimin me bazë gjinore; dhe c) të përcaktojë përgjegjësitë e autoriteteve shtetërore në të gjitha nivelet, për të hartuar dhe zbatuar aktet normative, si dhe politikat që mbështesin barazinë gjinore. Ligji për barazi gjinore kërkon që integrimi gjinor të jetë strategjia për arritjen e barazisë gjinore në shoqëri, nëpërmjet përfshirjes së perspektivës së secilës nga gjinitë në të gjitha proceset ligjvënëse, politikëbërëse, planifikuese, zbatuese e monitoruese. Ligji trajton edhe diskriminimin e ngacmimin dhe parashikon masa konkrete të përkohshme në postet politike dhe vendimmarrëse publike, për të garantuar të paktën 30% pjesëmarrje të gjinisë më pak të përfaqësuar. Ligji trajton barazinë gjinore dhe mbrojtjen nga diskriminimi në sektorët e arsimit, punësimit dhe mediave, dhe përmend shprehimisht nevojën e vlerësimit të punës së papaguar. Gjithashtu, ligji për barazinë gjinore parashikon mbledhjen e detyrueshme të statistikave, të ndara sipas gjinisë, nga të gjitha organet shtetërore dhe parashikon ngritjen e strukturave dhe mekanizmave institucionale për çuarjen përpara të barazisë gjinore.

Siç tregohet në figurën "Përqindja e stafit akademik femra/meshkuj në tre nivelet kryesore të sistemit arsimor", më 2009-'10, gratë përbënin përafërsisht 70% të stafit akademik në sistemin e arsimit të detyruar. Përqindja e femrave është më e lartë në nivelin e arsimit fillor (69.4%), reduktohet në nivelin e shkollës së mesme (60.6%) dhe është më e ulët në universitete (48.5%)<sup>47</sup>.


---

<sup>47</sup> Gra të dhe Burra të në Shqipëri, INSTAT 2009.




Burimi: MASH 2011

Siç tregohet në figurë “Përqindja e stafit akademik femra/meshkuj në tre nivelet kryesore të sistemit arsimor”, sistemi arsimor karakterizohet nga një përqindje më e lartë e femrave në staf. Megjithatë, përqindja e grave në pozicione vendimmarrëse ndjek modelin tradicional piramidial, ku stafi femëror zë vendin më të madh në pozicionet e ulëta dhe një ulje paralele në nivelet e larta menaxhuese. Siç tregohet në figurën “Përqindja e drejtuesve femra dhe meshkuj në sistemin arsimor shqiptar”, përqindja e grave drejtoresha nuk i tejkalon 30% në çdo nivel arsimor. Mungesa e grave në marrjen e vendimeve është në veçanti e dukshme në nivelin universitar, ku nuk ka asnjë drejtuese femër. Me sa duket, disa faktorë, përfshirë këtu pengesat sistematike dhe institucionale, stereotipat gjinorë dominues, dhe përgjegjësitë e papaguara të grave në ofrimin e përkujdesjeve, kufizojnë mundësitë e tyre të karrierës në sistemin arsimor, veçanërisht në nivelin universitar. Meqenëse mungesa e roleve, modeleve, përçon një mesazh negativ, stereotip gjinor për nxënësit dhe studentët, masa konkrete për të rritur përqindjen e grave në nivelet më të larta menaxhuese janë të nevojshme në harmoni me legjislacionin shqiptar, Vëzhgimet Përfundimtare të CEDAW.



#### 4. Tregu i punës në Shqipëri.

Gjatë periudhës 2007-2009 shkalla e përgjithshme e pjesëmarrjes në forcën e punës (pra, përqindja midis popullsisë ekonomisht aktive të moshës 15 deri në 64 vjeç dhe popullsisë në moshë pune) është ulur edhe për burrat edhe për gratë. Gjithsesi, ndërsa pjesëmarrja e meshkujve në tregun e punës mbeti pothuaj e qëndrueshme, pjesëmarrja e grave në tregun e punës ka rënë në mënyrë më drastike se pjesëmarrja e burrave dhe hendeuku përkatës gjinor u zgjerua nga 18.2% në vitin 2007 në 21.5% më 2009, duke nxjerrë në pah qasjen më të vogël të grave në tregun e punës, në raport me atë të burrave. Tërheqja e grave nga tregu i punës mund të jetë një tregues i mungesës së shpresës nga ana e tyre për të gjetur një punë të përshtatshme për shkak të krizës ekonomike. Në këtë rast, tërheqja gjithnjë në rritje e grave do të ishte vetëm e përkohshme dhe kjo prirje mund të prapësohet sapo zhvillimi ekonomik të rifillojë. Nga ana tjetër, fenomeni mund të ishte një reagim i qartë ndaj llojeve të punëve që mund të ekzistojnë për gratë në përgjithësi, duke treguar një problem strukturor të brendshëm të tregut të punës, Grupe të caktuara grash mund të dekurajohen nga pjesëmarrja në tregun e punës për shkak të numrit relativ të madh të punëve pak të kualifikuara në bujqësi dhe prodhim dhe shumëllojshmërisë së kufizuar të mundësive për punësim në të gjithë sektorët e tjerë. Hendeuku gjinor i dukshëm dhe në rritje në pjesëmarrjen në forcën e punës kërkon monitorim të kujdesshëm dhe zhvillimin e masave të përshtatshme të politikave të punës, me qëllim për t'u dhënë grave mundësi të barabarta në ekonomi.




Burimi: INSTAT, Anketa e Forcave të Punës, 2007, 2008, 2009

Sipas rezultateve të AFP-së, gjatë periudhës kohore 2007-2009, shkalla zyrtare e përgjithshme e papunësisë u rrit pak. Ndarja e të dhënave sipas seksit tregon se kjo vjen kryesisht për shkak të rritjes së papunësisë së femrave, nga 12.2% që ishte në vitin 2007, në 15.9% në vitin 2009. Gjatë së njëjtës periudhë shkalla e papunësisë së burrave ra nga 14.4% në 12.2%. Një prirje e ngjashme pasqyrohet nga statistikat për papunësinë afatgjatë gjatë së njëjtës periudhë, ku papunësia zyrtare e meshkujve ra me gati 2%, në ndryshim nga papunësia afatgjatë e grave, e cila u rrit prej 2%. Ndërsa në vitin 2007 shkalla e papunësisë së burrave ishte më e lartë se e grave, qysh nga ajo kohë prirjet tregojnë përkëqësimin e gjendjes së grave në tregun e punës, si nga pikëpamja e punësimit, ashtu edhe e papunësisë. Bujqësia mbetet sektori me pjesëmarrjen më të lartë

të grave; përqindja e grave ishte 60.4% në vitin 2007 dhe qysh atëherë është ulur vetëm pak (me 4% deri në vitin 2009). Punësimi i burrave në bujqësi është sa gjysma e punësimit të grave, me shifra që po ulen gradualisht gjatë viteve. Në vitin 2009 dy të tretat e të gjithë personave të regjistruar si “punëtorë të papaguar të familjes” në sektorin privat jo bujqësor ishin gra<sup>8</sup>.

Shifrat në sektorin privat jo bujqësor tregojnë një pamje që është pothuaj e kundërta e gjendjes së grave në bujqësi, me një dimension gjinor pothuaj të njëjtë. Sektori privat jo bujqësor punëson afërsisht dy herë më shumë burra se gra. Nga viti 2007 në vitin 2009 punësimi i burrave në sektorin privat jo bujqësor u rrit afërsisht me 15 për qind, si për gratë edhe për burrat.



#### Burimi INSTAT, Anketa e Forcave të Punës 2009

Të dhënat e punësimit në të gjithë sektorët tregojnë që gratë dhe vajzat dominojnë në tre sektorë. Në shëndetësi, në punë sociale dhe arsim gratë dhe vajzat zënë rreth 70% të të punësuarve në tërësi, dhe ato përbëjnë më shumë sesa gjysmën e të vetëpunësuarve në bujqësi. Përqindja e grave të punësuar është e lartë, gjithashtu, edhe në sektorin e financës dhe në tekstilë (shiko tabelën ”Struktura e punësimit sipas aktivitetit ekonomik dhe gjinisë”). Në të gjithë sektorët e tjerë burrat janë ata që mbizotërojnë punësimin, duke treguar qartë diversifikimin e tij. Punësimi i ndarë sipas grave/vajzave dhe burrave/djemve në tregun e punës mund të shikohet si një pasojë e mbizotërimit të stërvitjeve në arsimin dhe kanalizimin e vajzave dhe djemve në ndjekjen e kurseve dhe studimeve të ndjeshme nga ana gjinore.

<sup>8</sup> INSTAT 2009.

## Referencat

- Nielson, J. (1978). *Sex in society: Perspectives on stratification*. Bel-mont, CA: Wadsworth.
- Huber, J., & Spitze, G. (1983). *Sex Stratification: Children, housework and jobs*. New York: Academic Press.
- Friedl, E. (1975). *Men and women: An anthropologist's view*. New York: Holt, Rinehart & Winston.
- George, D., (1925). *London Life in the Eighteen-Centyry*, London: Kegan Paul, Trench, Trubner & Co., fq 208.
- Mitchell, B. R., (1962). *Abstrac of British Historical Statistics*, Cambridge: Cambridge University Press.
- Harris, M. (1997). *Cannibals and kings: the origins of cultures*. New York: Random House.
- Fisher, E. (1980). *Womans creation: Sexual evolution and the shaping of society*. New York: McGraw Hill.
- Lerner, G. (1986). *The creation of the patriarchy*. New York: Oxford.
- Davidoff, L. & Hall, C., (1987). *Family Fortunes: Man and Women of the English Middle Class, 1780-1850*, University of Chicago Press.
- Demos, J. (1986). *Past, present and personal: the family and the life course in American history*. New York: Basic Books.
- Cherlin, A. (1983). *Changing Family and household: Contemporary lessons from historical research*. *Annual Review of Sociology* 9,51-66.
- Tilly, L. A., & Scott, J. W. (1978). *Women work, and the family*. New York: Holt, Rinehart & Winston.
- INSTAT, Anketimi mbi Kushtet e Jeteses se Familjes, 2009.
- Raporti Kombëtar i Pozicionit të Grave dhe i Barazisë Gjinore në Shqipëri 2011.
- Grint, Keith, (2005). *The sociology of Work* (Sociologjia e Punës). Bot. III. Angli: Polity Press.

# **VLERËSIMI I NEVOJAVE NË TË MËSUAR TË FËMIJËVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA SI FAKTOR KYÇ PËR GJITHËPËRFSHIRJEN E TYRE NË SHKOLLAT E ZAKONSHME**

**Narbis Ballhysa**

Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

## **Përmbledhje**

Fëmijët me aftësi të kufizuara në Shqipëri janë ende një ndër grupet më të përjashtuara nga sistemi arsimor. Pas viteve '90 në vendin tonë vërehen përpjekje për krijimin e kuadrit të nevojshëm politik dhe ligjor në mbështetje të arsimit për fëmijët me aftësi të kufizuara si dhe ofrimin e modeleve të gjithëpërfshirjes së këtyre fëmijëve në shkollat e zakonshme. Megjithkëtë numri i paktë i fëmijëve me aftësi të kufizuara të përfshirë në shkollat e zakonshme tregon që ky proces gjatë zbatimit në praktikë përballlet me sfida.

Një ndër to është realizimi i vlerësimit fillestar të nevojave të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Ai përcaktohet si faktor kyç dhe me ndikim të drejtpërdrejtë në ecurinë pozitive të përfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollat e zakonshme. Në vendin tonë vlerësimi i nevojave të fëmijës me aftësi të kufizuara, megjithëse vlerësohet si hallkë e rëndësishme, ai ende nuk realizohet në parametra profesionale. Kjo ndikon ndjeshëm në mungesën e plotësisht të nevojave në të mësuar të fëmijës me aftësi të kufizuara në shkollat e zakonshme.

Artikulli, përmes të dhënave sasiore dhe cilësore të mbledhura nga mësues të cilët punojnë direkt me fëmijë me aftësi të kufizuara dhe drejtues të katër shkollave të zakonshme, si pjesë e një studimi të realizuar nga autorja si një rast studimor, për vlerësimin në thellësi të modelit gjithëpërfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollat e zakonshme, synon të ofrojë informacion për; rëndësinë e këtij procesi, mungesat me të cilat përballlet sistemi arsimor në vendin tonë si dhe nevojat për ndërhyrje për të lehtësuar zbatimin e tij në praktikë.

**Fjalët çelës:** gjithëpërfshirje, vlerësim i nevojave, nxënës me aftësi të kufizuara, shkollë e zakonshme, mësues

## **Abstract**

Children with disability in Albania continue to be one of the most segregated groups from the education system. After 90s in our country, efforts have been made to develop the necessary policies and legislation in order to support the education of children with disability, and to avail inclusive models to the regular schools. The minor number of children with disability attending the regular schools though indicates that inclusion is a challenging process.

One of the challenges is the realization of the initial assessment of educational needs of disabled children. It is defined as a key factor with a direct impact in the progress of the process of inclusion of disabled children in regular schools. Although in Albania the assessment of the educational needs of disabled children is considered as important, it is not yet realized to the necessary recognized and accepted standards and



professional requirements. The lack of the proper assessment influences in the fulfillment of the educational needs of children with disabilities in regular schools.

The article, through the analyses of the quantitative and qualitative data, collected from the teachers which work directly with pupils with disabilities and directors of four regular schools, as part of a study realized by the author as a “case study” for the deep evaluation of the model of inclusion of disabled children in regular schools, that aims to offer information on; the importance of the educational needs assessment process; the gaps and challenges faced by the educational system for its implementation and the necessary interventions for a better and professional implementation of the assessment process in practice.

**Key words:** inclusiveness, assessment of needs, children with disability, regular school, teacher

### Hyrje

Arsimi gjithëpërfshirës në përcaktimin e UNESCO-s (UNESCO, 2003) është vlerësuar si një proces që adreson dhe u përgjigjet nevojave të ndryshme të të gjithë nxënësve, përmes rritjes së pjesëmarrjes në të mësuar dhe reduktuar përjashtimin në të dhe përmes tij. Ai është i lidhur ngushtë me ndryshimet dhe përshtatjet në përmbajtjet e programeve mësimore, në qasjet pedagogjike, në strukturat dhe në strategjitë me qëllim plotësimin e nevojave specifike në të mësuar të fëmijëve (Sandkull, 2005).

Me qëllim që gjithëpërfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara të realizohet në praktikë, duhet të merret parasysh roli i një sërë faktorësh që drejtpërsëdrejti ndikojnë në efektivitetin e këtij procesi. Ato më së shumti varen nga qëndrimet dhe besimet e aktorëve kryesorë të përfshirë në të; fëmijë (Blandul 2010) mësues (Sharma & Moore, Sonawnae 2009; Hassan, Parveen dhe Riffat-un-Nisa 2010; Zambelli, Bonni 2004; Avramidis dhe Kalyva 2007), prindër (Wehbi 2006) , por edhe prej faktorëve që lidhen me qasjet pedagogjike në të mësuar (Nind , Wearmouth 2006; Avramidis, Bayliss, Burden 2002), me infrastrukturën mbështetëse në klasa (Leatherman dhe Niemeyer 2005), si dhe me drejtuesit e shkollave të zakonshme. Evidentimi i elementëve që ndikojnë pozitivisht në nxitjen e këtyre faktorëve merr rëndësi të veçantë në planifikimin e politikave mbështetëse për zbatimin në praktikë të arsimit gjithëpërfshirës.

Procesi i vlerësimit fillestar është një input i rëndësishëm në gjithëpërfshirje dhe shpeshherë suksesi për të nxitur qëndrueshmërinë (Peters, 2003). Ai është hallka e parë dhe ndër më kryesoret për të orientuar më tej procesin e plotësimit të nevojave të nxënësve me aftësi të kufizuara në klasat e zakonshme. Sipas Dixon, R. M. dhe Verenikina, I., (2007), identifikimi i nevojave të nxënësve me aftësi të kufizuara duhet bërë nga këndvështrimi i pikave të forta dhe jo të dobëta. Është më e nevojshme të përcaktohen elementët të cilët e bëjnë atë të pavarur, si dhe nevojat për mbështetje për të siguruar pavarësinë e tij. Vlerësimi ofron informacion për karakteristikat në të mësuar të fëmijës dhe ka për qëllim të drejtojë suksesin e fëmijës me aftësi të kufizuara përmes pjesëmarrjes në veprimtari. Oliver dhe Bowler, (1996, fq.158-159) termin “vlerësim” e shikojnë si të përshtatshëm për të përkufizuar një proces si të tërë në dallim nga termi “testim”, që kufizohet vetëm tek rezultati. Edhe këta autorë vënë theksin në atë se qëllimi i vlerësimit nuk është të diagnostikojë problemet, por të mundësojë të kuptuarin e thellë se si një nxënës mëson. Idealisht vlerësimi duhet të përqendrohet në pikat e forta dhe jo të

evidentojë ato të dobëtat tek një nxënës me aftësi të kufizuara. Vlerësimi është shumë kritik kur ai nisat nga diagnostikimi mjekësor, sepse në raste të tilla ai shërben për t' i etiketuar nxënësit. Diagnoza e fëmijës mund të jetë vetëm hapi i parë për të kuptuar nevojat e tij. Vlerësimi shumëplanësh është i rëndësishëm pasi përmes tij identifikohen edhe përshtatjet e nevojshme në programe, mjediset fizike dhe mjetet, asistencën në klasë për të cilat fëmija ka nevojë gjatë procesit mësimor. Rëndësia e mbarrëvajtjes së procesit të vlerësimit lidhet edhe me faktin se një vlerësim i duhur mund të krijojë një bazë të mirë për të gjykuar për progresin e nxënësit. Ai shërben për të ofruar informacion të nevojshëm për të lejuar mësuesit dhe prindërit të bëjnë zgjedhjet e duhura për metodat e mësimdhënies dhe menaxhimit të vështirësive në familje. E rëndësishme në procesin e vlerësimit çmohet edhe pjesëmarrja aktive e fëmijëve dhe e prindërve. Ata duhet të jenë pjesëmarrës dhe të kenë dijeni të plotë për këtë proces, si dhe të japin miratimin e tyre në përfundim për raportet, rezultatet dhe rekomandimet e vlerësimit (Oliver, Bowler, 1996, fq.160). Prindërit e nxënësve me aftësi të kufizuara shihen si lehtësues dhe bashkëpunëtorë në procesin e vlerësimit. Ato mund të ndihmojnë për të krijuar një klimë pozitive për vlerësimin, duke u shpjeguar fëmijëve nevojën e tij.

Është e rëndësishme të theksohet se vlerësimi që të ketë efekt, të jetë i rregullt dhe i vlefshëm duhet të jetë pjesë e sistemit të zhvillimit të shkollës, me fokus të fuqishëm për të ofruar informacion për nxënësit dhe mësuesit (UNESCO, 2005).

Ndonjëherë edhe kur shkollat kanë një protokoll vlerësimi të miratuar, janë kufizimet financiare, koha dhe kufizimet në personel që i pengojnë psikologët shkollorë dhe personelin tjetër profesionist të përdorin metoda dhe procedura shkencore në vlerësimet e tyre. Susan J.Peters, (2003) eidenton se krahas mbështetjes financiare për realizimin e vlerësimit si proces i një rëndësie të veçantë, është edhe trajnimi i profesionistëve që do ta kryejnë atë, pasi ky është një proces për të cilin nevojiten aftësi.

Gjithëpërfshirja duke u përkufizuar si një proces, ka pjesë të saj një sërë hallkash. Në funksion të arritjes së qëllimit final, atë të përfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollat e zakonshme, këto hallka duhet të ridimensionojnë funksionet e tyre, duke i përmirësuar ato të mëparshmet, por edhe duke i pasuruar me elementë të rinj.

E një rëndësie të veçantë dhe parakusht për ecurinë pozitive të procesit të përfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollat e zakonshme është vlerësimi i nevojave në të mësuar të këtyre fëmijëve.

Artikulli do të ofrojë një analizë të informacionit të mbledhur e të fokusuar në rëndësinë e procesit të vlerësimit, mungesat me të cilat përballet sistemi arsimor në vendin tonë si dhe nevojat për ndërhyrje për të lehtësuar zbatimin e tij në praktikë.

### **Metodologjia**

Studimi i procesit të vlerësimit të nevojave në të mësuar të fëmijëve me aftësi të kufizuara u mundësua si pjesë e një studimi të realizuar nga autorja si një rast studimor, për vlerësimin në thellësi të modelit gjithëpërfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollat e zakonshme. Për mbledhjen e të dhënave u përdor një metodologji e kombinuar, sasiore dhe cilësore. 50 mësues të cilët punonin direkt me fëmijë me aftësi të kufizuara në të dy ciklet shkollorë ( cikli i ulët dhe 9-vjeçar ) dhe katër drejtues të katër shkollave të zakonshme u përfshinë në ofrimin e informacionit për procesin e vlerësimit të nevojave të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Instrumentet e përdorura për të mbledhur informacionin sasior ishin pyetësorë që përmbanin një grup pyetjesh të mbyllura dhe gjysmë të mbyllura për çështje që lidheshin drejtpërsëdrejti me arsimin gjithëpërfshirës të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Për intervistat e thelluara me drejtues të shkollave të zakonshme u përdor një pyetësor me pyetje me të njëjtat tematika të arsimit gjithëpërfshirës për fëmijët me aftësi të kufizuara. Për të marrë informacion më të thelluar, për çështjet në fokus, me 6 mësues u organizua një takim fokus grupi. Pyetësorët e përdorur për takimin e fokus grupit përmbanin vetëm pyetje të hapura.

Të dhënat sasiore u hodhën dhe u përpunuan në programin SPSS (17.0), ndërsa të dhënat cilësore u përpunuan në programin Excel.

### **Rezultate e Diskutime**

Të dhënat e ofruara në këtë pjesë japin informacion për procesin e vlerësimit fillestar të nevojave të fëmijëve me aftësi të kufizuara për tu përfshirë në shkollat e zakonshme, mungesat dhe ndryshimet që duhet të realizohen për mbarrëvajtjen e këtij procesi.

#### *Mangësi në procesin e vlerësimit*

Nga të gjithë drejtuesit, mësuesit e psikologët e shkollave të zakonshme, në intervistat dhe fokus grupet e zhvilluara, u evidentua e një rëndësie të dorës së parë, nevoja për të patur një vlerësim shumë profesional të fëmijës, para se ai të pranohet në shkolla të zakonshme.

Megjithëse aktualisht vlerësimi kryhet pranë shkollave para fillimit të çdo viti shkollor, ai lë shumë për të dëshiruar në përcaktimin e saktë të aftësive në të nxënë të fëmijës me aftësi të kufizuara, i cili do të pranohet për herë të parë në shkollë. Kjo për arsye se ndonëse i kushtohet vëmendja e duhur, pjesëmarrësve, drejtuesve dhe kryesisht mësuesve (bazuar në kuadrin ligjor ata janë anëtarë të komisionit që bën vlerësimin e fëmijës me aftësi të kufizuara në shkolla) u mungojnë njohuritë për të përcaktuar nevojat specifike në të mësuar të fëmijës në varësi të aftësisë së kufizuar që ai ka. Mësuesit nuk kanë marrë kualifikimin e nevojshëm, gjatë periudhës së formimit të tyre universitar në drejtim të njohurive për nevojat e veçanta të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe punës individuale që nevojitet të bëhet me to. Në këtë kuptim, drejtuesit dhe mësuesit shprehen se vlerësimi i fëmijëve bëhet në bazë të:

- (1) njohurive të përftuara rishtas,
- (2) përvojës shumëvjeçare pedagogjike të mësuesve.

Nga mësuesit dhe drejtuesit e shkollave referohet se aktualisht nuk ka teste të unifikuara për vlerësimin fillestar të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Drejtuesit dhe mësuesit shprehen se kjo do të lehtësonte shumë orientimin e shpejtë dhe të saktë të plotësimit të nevojave specifike në të mësuar të këtyre fëmijëve.

Mësuesit në takimin e fokus-grupit shprehen se jo gjithmonë vlerësimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara bëhet në kohë dhe para çdo fillim viti.

Kjo ndodh, - shprehen ata -, për arsye se prindërit nuk pranojnë t'i referojnë si fëmijë me aftësi të kufizuara. Kjo vërehet në rastet kur: (a) mungojnë raportet mjekësore; (b) prindi nuk e referon raportin mjekësor ose (c) fëmija nuk ka ndjekur më parë kopshtin, duke munguar në këtë mënyrë raporti vlerësues i institucionit paraardhës.

Në të tilla raste mësuesit shprehen se gjenden të papërgatitur “...prindi e referon shumë vonë aftësinë e kufizuar të fëmijës së tij p.sh. kur ai ka epilepsi. Ndodh shpesh herë

*që gjendem e papërgatitur kur fëmija shfaq shenja të sëmundjes në klasë. Gjithashtu edhe në rastet kur fëmija ka probleme të caktuara përqëndrimi, hiperaktiviteti ose vështirësi në të nxënë. Disa muaj pasi shkolla ka filluar unë nis të vërej vështirësitë e fëmijës në të mësuar dhe mundohem të rendis specifika të punës që duhet të bëj me këtë fëmijë. Në këto raste vlerësoj si shumë të rëndësishëm vlerësimin paraprak që duhet t'i bëhet fëmijës para se ai të fillojë shkollën...” (mësues).*

*“...Vlerësimin e fëmijës e shikoj si shumë të rëndësishëm. Ne qartësohemi më vonë sesi duhet të punojmë me këta fëmijë. Prindërit duhet të jenë shumë bashkëpunëtorë...” (mësues).*

-Në disa raste mësuesit shprehen se që në fillim, puna me prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara përbën për ata një sfidë “...ata nuk duan ta pranojnë se fëmija e tyre ka një aftësi të kufizuar, ose me qartë, se me fëmijën duhet të punohet për një periudhë kohe në mënyrë të veçantë...” (mësues).

Për të gjitha këto arsye vlerësimi i nevojave të fëmijës me aftësi të kufizuara, megjithëse është hallkë e rëndësishme, ende nuk realizohet në parametrat profesionalë. Kjo ndikon ndjeshëm në mungesën e plotësimit të nevojave në të mësuar të fëmijës.

### Rëndësia e vlerësimit multiprofesional të nevojave në të mësuar të fëmijës me aftësi të kufizuara

Opinionet e dhëna për përmirësimin e procesit të vlerësimit konvergojnë të gjitha në një pikë, në krijimin e një grupi multidisiplinar për vlerësimin e nevojave në të mësuar të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Kjo shihet qartë në përgjigjet e dhëna prej mësuesve në pyetësorët sasiorë ku 74% e tyre (n=37) miratojnë idenë se vlerësimi fillestar duhet bërë nga një grup profesionistësh dhe japin mendimin e tyre për profesionistët, të cilët duhet të jenë pjesë e grupit multidisiplinar të vlerësimit. 62% e tyre (n=31) vlerësojnë se mësuesi duhet të jetë pjesë e grupit vlerësues, 58% e mësuesve (n=29) mendojnë se psikologu i zhvillimit duhet të marrë pjesë në vlerësim, 48% (n=24) e shikojnë punonjës social si profesionist në grupin vlerësues, 32% e mësuesve (n=16) mendojnë për pjesëmarrjen e mjekut në vlerësim dhe vetëm 30% e tyre (n=15) evidentojnë se i rëndësishëm në grupin vlerësues është edhe roli i logopedistit.

Nga opinionet del se mësuesit e shohin si më të rëndësishëm për të qenë pjesë e grupit multidisiplinar të vlerësimit, profesionistët e tillë si mësues, psikologë dhe punonjës social.

Rezultatet e studimit tregojnë se mësuesit, pavarësisht nga cikli ku ata japin mësim, shohin si të rëndësishëm grupin multidisiplinar për të vlerësuar nevojat e fëmijës në të mësuar. Për përfshirjen e specialistëve të tjerë, mësuesit e të dy cikleve variojnë në shifra të përafërta. Vlen për t'u theksuar se mësuesit e ciklit 9-vjeçar (n=18) vlerësojnë mësuesin si specialistin më të rëndësishëm për të qenë pjesë e grupit të vlerësimit, ndërsa 32% e mësuesve të ciklit fillor (n=16) vlerësojnë psikologun e zhvillimit si profesionistin më të rëndësishëm.

Edhe drejtuesit e shkollave janë të mendimit që duhet të krijohet një grup multidisiplinar me profesionistë të fushave të ndryshme, si me psikologë, mjekë, terapistë

të të folurit, mësues, punonjës socialë dhe përfaqësues të pushtetit për problemet e arsimit në nivel vendor. Ata gjykojnë se kjo strukturë kaq e rëndësishme shërben si pikënisje për garantimin e arsimit gjithëpërfshirës në të tërë kontekstin që ai ka, nëse ajo do të funksionojë në përputhje me të gjitha standartet që kjo hallkë e zinxhirit “*gjithëpërfshirje*” kërkon. Kjo, shprehen ata, edhe për faktin se prej hallkës së vlerësimit përcaktohet ecuria e të gjitha etapave të tjera të procesit të gjithëpërfshirjes në tërësi.

Të pyetur për rëndësinë e vlerësimit fillestar të nevojave në të mësuar të fëmijës me aftësi të kufizuara edhe mësuesit e shkollave të zakonshme e shikojnë atë si elementin kryesor në mbarëvajtjen e punës së tyre. Një vlerësim i drejtë dhe profesional i nevojave në të mësuar të fëmijëve, sipas opinionit të tyre, që mungon deri tani, u vjen në ndihmë për të:

1. formatuar saktë në funksion të tij (vlerësimit) PEI-t dhe punën individuale me nxënësit me aftësi të kufizuara, duke u orientuar drejt në nevojat që kanë këta fëmijë për t’u ndihmuar në shkollë;
2. identifikuar drejt nevojat e tyre për trajnime në vazhdimësi;
3. modeluar punën me prindërit e fëmijës në përputhje me nevojat specifike që ai ka;
4. për të ndihmuar në krijimin e një mjedisi sa më shoqëror për fëmijën me aftësi të kufizuara në shkollë, gjithmonë duke u nisur nga përshtatjet e nevojshme që mjedisi duhet të reflektojë përkundrejt nevojave të veçanta të fëmijës.

Mësuesit në fokus grup shprehen për nevojën e vlerësimit të fëmijëve nga një grup specialistësh. “...*Unë do të thoja që, përveç faktit që vlerësimi mungon, ai duhet të bëhet nga një grup profesionistësh, si psikologë, mjekë, mësues, terapistë sepse të gjithë këta do të japin një vlerësim të saktë për nevojat e fëmijës dhe shkallën e nxënies në të mësuar...*” (mësues).

Drejtues dhe mësues janë të mendimit se ndikim në efektivitetin e procesit të vlerësimit të nevojave ka përfshirja në këtë proces edhe e prindërve të nxënësve me aftësi të kufizuara. 78% e mësuesve (n=39) shprehen se pjesëmarrja e prindërve në procesin e vlerësimit është shumë e nevojshme. Prej tyre, 36% (n=18) janë mësues të ciklit fillor dhe 42% (n=21) mësues të ciklit 9-vjeçar. Sipas tyre, drejtues e mësues, prindërit duhet të kenë rol në informimin e komisionit për gjendjen e fëmijës dhe të familjes dhe në përfundim të procesit të vlerësimit të fëmijës atyre t’u merret opinioni nga profesionistët. Ata kërkojnë që ky rol në procesin e vlerësimit të jetë sa më aktiv dhe efikas, e parë kjo si në drejtim të referimit në kohë të rasteve pranë komisionit, por edhe të angazhimit të tyre në shkëmbimin e saktë të informacionit për fëmijën.

### **Përfundime e Rekomandime**

Që në nisje është e rëndësishme të theksohet se pranimi i nxënësve me aftësi të kufizuara në shkollat e zakonshme kalon përmes një procesi *vlerësimi fillestar* të rregullt, ashtu si edhe parashikohet në kuadrin ligjor përkatës. Aktualisht vlerësimi i nevojave të nxënësve me aftësi të kufizuara realizohet nga stafi pedagogjik i shkollës dhe psikologu i saj. Vendosja e psikologut në realizimin e këtij procesi, ka krijuar një klimë multiprofesionale për identifikimin e nevojave specifike që kanë në të mësuar nxënësit me aftësi të kufizuara.

Studimi evidentoi se modeli që po zbatohet ka pasuruar procesin e vlerësimit në drejtim të informacionit dhe dokumentacionit shtesë (raporte të hollësishme), që i ofrohen grupit vlerësues, pranë shkollës, për zhvillimin, ecurinë e fëmijës me aftësi të kufizuara

dhe për familjen e tij. Megjithatë studimi evidenton se ky vlerësim, në kuptimin që ai duhet t' i vijë në ndihmë sa më shumë mësuesve për hartimin e PEI-t, jo gjithmonë është i efektshëm. E parë në këndvështrimin e problematikës që mbart procesi i vlerësimit fillestar, studimi theksoi dy çështje të rëndësishme: *E para*, vlerësimi fillestar nuk kryhet ende nga një grup profesionistësh të fushave që lidhen me identifikimin e nevojave të nxënësve me aftësi të kufizuara dhe që ndikojnë drejtpërsëdrejti në procesin e të mësuarit të tij. Mungesa në përbërje të këtij grupi e profesionistëve të tillë si: psikologë zhvillimi, logopedistë, punonjës socialë, mjekë, ndikon drejtpërdrejt në mospërcaktimin e saktë të mbështetjes që duhet t' i ofrohet nxënësve me aftësi të kufizuara në shkollat e zakonshme, si në drejtim të përshtatjeve të programit mësimor ashtu edhe të të gjithë shërbimeve mbështetëse, që ai specifikisht ka nevojë për mbarëvajtje gjatë procesit mësimor. Vlerësimi fillestar i munguar nga një grup profesionistësh të specializuar në fushën e aftësisë së kufizuar është pengesë gjithashtu për të orientuar saktë institucionin arsimor në të cilin fëmija me aftësi të kufizuara duhet të arsimohet. *E dyta*, si çështje e evidentuar nga studimi, është se vlerësimi fillestar nuk bëhet gjithmonë në kohën e duhur, si p.sh. para se fëmija me aftësi të kufizuara të nisë shkollën, por disa kohë më vonë, kur fëmija është identifikuar si i tillë nga mësuesi si rezultat i shfaqjes së nevojave të caktuara apo edhe i simptomave të sëmundjes gjatë procesit mësimor. Në raste të tilla prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara nuk e pranojnë që në fillim se fëmija e tyre ka aftësi të kufizuara dhe se me të duhet të punohet në mënyrë të veçantë. Ata shpeshherë janë shumë të kufizuar për dhënien e informacionit të plotë e të dokumentuar që kanë për aftësinë e kufizuar të fëmijës së tyre. Kjo është një sfidë tjetër dhe shumë e vështirë me të cilën përballet procesi i gjithëpërfshirjes sepse lidhet me qëndrimet dhe mentalitetin e prindërve. Ndërtimi i marrëdhënieve përfshirëse, bashkëpunuese dhe këshilluese me prindërit e fëmijës me aftësi të kufizuara është i rëndësishëm për të mbështetur në kohë nevojat e fëmijës dhe për të rritur shanset e tij që të përfitojë nga përshtatjet e programit mësimor. Mësuesit janë ata që kanë rolin kryesor në krijimin e kësaj marrëdhënie dhe mbajtjen e saj në atë nivel që fëmija me aftësi të kufizuara të përfitojë sa më shumë. Për realizimin sa më të plotë të vlerësimit fillestar, riorganizimi i tij do të jetë një proces, që do të shtrojë për diskutim çështje që lidhen me përbërjen, funksionimin dhe pranë së cilës do të veprojë. Duke e theksuar vlerësimin fillestar si hallkën e parë dhe shumë të rëndësishme të procesit të gjithëpërfshirjes së nxënësve me aftësi të kufizuara në shkollat e zakonshme, nevojitet të krijohen të gjitha hapësirat e nevojshme ligjore dhe mbështetja e duhur financiare për të siguruar ecuri pozitive të këtij procesi.

Rezultatet e dala në përfundim të studimit evidentojnë më së pari nevojën për realizimin e vlerësimit fillestar multiprofesional të nevojave në të mësuar të fëmijëve me aftësi të kufizuara nga një me specialist i fushës përkatëse. Për t' i shërbyer këtij qëllimi shihet si domosdoshmëri ndërmarrja e një sërë ndryshimesh, që do të mundësojnë krijimin e premisave për realizimin e një procesi të plotë dhe shumëdimensional të nevojave në të mësuar të fëmijës me aftësi të kufizuara.

#### *Për këtë rekomandohet:*

1. Hartimi i kuadrit ligjor të nevojshëm për të mbështetur realizimin në praktikë të vlerësimit multiprofesional.

2. Marrja e masave në nivel vendor për ngritjen dhe funksionimin pranë DAR të një strukture me detyrë vlerësimin fillestar të nevojave në të mësuar të nxënësve me aftësi të kufizuara.

3. Përzgjedhja e specialistëve të fushave përkatëse në nivel vendor, për të qenë pjesë e grupit multidisiplinar të vlerësimit në strukturën e DAR.

4. Përfshirja në grupin multidisiplinar të vlerësimit të mësuesve me formim universitar për çështjet e edukimit special të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

5. Trajnimi i mësuesve dhe specialistëve të tjerë, të cilët do të jenë pjesë e grupit multidisiplinar të vlerësimit në nivel rajonal.

6. Akordimi i fondeve në nivel vendor për të siguruar mbështetjen finaciare për infrastrukturën e nevojshme në mbarëvajtje të strukturës së vlerësimit.

### Referenca

Avramidis, E., Bayliss, P., Burden, R., (2002). Inclusion in Action: An In-depth Case Study of an effective Inclusive Secondary School in the South-west of England. *International Journal of Inclusive Education* 6:143-163.

Blândul, V. C., (2010). International Approaches to Inclusion of Children with Special Educational Needs in Mainstream Education. *Problems of Education in the 21st Century* 21: 29-36.

Dixon, R. M., Verenikina, I., (2007). Towards Inclusive Schools: An Examination of Socio-cultural Theory and Inclusive Practices and Policy in New South Wales DET Schools, *Learning and Socio-cultural Theory: Exploring Modern Vygotskian Perspectives International Workshop 2007*, 1(1).

Leatherman, J. M., Niemeyer, J. A., (2005). Teachers' Attitudes toward Inclusion: Factor Influencing Classroom Practice. *Journal of Early Childhood Teacher Education* 26: 23-36.

Nind, M., and Wearmouth, J., (2006). Including children with Special Educational Needs in Mainstream Classrooms: Implications for Pedagogy from a Systematic Review. *Journal of Research in Special Educational Needs* 6: 116-124.

Oliver C. and Bowler F. R., 1996, Learning to Learn, Simon & Schuster.

Sandkull, O., (2005)—Strengthening Inclusive Education by Applying a Rights-based Approach to Education Programming. Paper presented at ISEC Conference, Glasgow.

Sharma, U., Moore, D., Sonawane, S., (2009). Attitudes and Concerns of Pre-Service Teachers Regarding Inclusion of Students with Disabilities into Regular Schools in Pune, India. *Asia-Pacific Journal of Teacher Education* 37:319-331.

UNESCO, 2003. Overcoming Exclusion through Inclusive Approaches in Education,

UNESCO 2005, Guidelines for inclusion: Ensuring Access to education for all.

Wehbi, S., (2006). The challenges of inclusive education in Lebanon. *Disability & Society* 21: 331-343.

# PSIKOLOGU SHKOLLOR: NJË PROFESIONIST I KUALIFIKUAR PËR TË KUPTUAR BULLIZMIN NË SHKOLLAT SHQIPTARE

**Silvana Loka**

Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme, Fakulteti i Shkencave Shoqërore  
Albanian University

## **Përmbledhje**

Studimi është një kërkim i integruar cilësor dhe sasior, i cili ka synuar të vlerësojë situatën aktuale të shërbimit psikologjik të ofruar në shkollat nëntë-vjeçare, në nivelin fillor të tyre, në kontekst të adresimit të bullizimit.

Metoda Delphi me psikologë shkollor në shkollat nëntëvjeçare në Tiranë, analiza e dokumentacionit lidhur me përvojat e tyre akademike dhe profesionale si dhe shqyrtimi sistematik i literaturës, ishin tre elementët përbërës të metodologjisë së këtij studimi. Niveli i ulët i njohurive lidhur me bullizmin dhe mungesa e udhëheqjes dhe supervizimit të specializuar në menaxhimin e rasteve të cilësuar si bullizëm ishin dy nga gjetjet kryesore të studimit. Sugjerime janë dhënë lidhur me ndërhyrjet më bashkëkohore të përpiluara për dedektimin dhe menaxhimin e bullizmit në shkolla. Rekomandime jepen gjithashtu për të përmirësuar integrimin e teorisë me përpjekje empirike për të realizuar zbatimin nga psikologët shkollorë të programeve pilot në këtë fushë.

**Fjalët kyçe:** Psikolog shkollor, bullizëm, teknika Delphi, përpunimi sistematik i literaturës.

## **Abstract**

The proposed study aims at answering the questions: a) can the context formed by the strategies for the Albanian school development is approximate to an anti-bullying approach? b) Is the Albanian school a community based school? c) Which of the anti-bullying approaches would presently be the most appropriate for an anti-bullying strategy in the Albanian school? Systematic literature review, content analysis to evaluate the compliance between national strategies on education with international strategies against bullying in schools, as well as semi-structured interviews to evaluate school functioning as community were the methods used for this study.

The study findings showed that the national strategies of education and child health in schools provide no orientation to prevent or reduce bullying. There is a lack of elements that would determine the functioning of the school as a community, finding that this would condition the modeling of the anti-bullying strategy in the future.

**Keywords:** 9-year schools, meta-analysis, semi-structured interviews, national strategy against bullying.

## **Hyrje**

Bullizmi është një çështje madhore me të cilën po përballët shkolla sot. Bullizëm janë sjelljet e përsëritura, të dëmshme dhe agresive ndërmjet personave që ndryshojnë në nivelin e tyre të fuqisë, të cilat mund të jenë si fizike edhe psikologjike. Ato përfshijnë



goditjet, rrahjet, ngacmimin verbal, gjestet fyese, përjashtimin ose thjesht presionin për t'u konformuar me ato që bullisti dëshiron apo thotë (Bentley & Li, (1995); Boulton & Underwood, (1992); Olweus, (1991); Veenstra et al., 2005). Bullizmi që dikur shihej si një sjellje e padëmshme, njihet tanimë si një sjellje e cila ka efekte afatgjata si për bullistin ashtu edhe për viktimën [Dedman, 2000 referuar në (Charlton, A.L, Vet-efikasiteti i perceptuar nga psikologët shkollorë në shkollat fillore, 2009, fq 8) ].

Sipas Ginter (2004), psikologët shkollorë janë “burimi më i madh” (p. 311) për t'u marrë me të gjitha tipet e dhunës që ndodhin në shkollë. Hermann dhe Finn (2002) i qëndruan idesë se psikologët shkollorë janë si nga pikëpamja etike edhe ajo ligjore përgjegjës për të siguruar që nxënësi të jetë i sigurt në shkollë.

Shumë studime janë fokusuar në mënyrat sesi psikologët shkollorë duhet t'i përgjigjen dhunës në shkollë [Dwyer, Osher & Warger, 1998; Futrell, 1996; Glasser, 2000; Hermann & Finn, 2002; Samples & Aber, 1998; Stevens, Lynn, & Glass, 2001, referuar në (Charlton, A.L, Vet-efikasiteti i perceptuar nga psikologët shkollorë në shkollat fillore, 2009, fq16) ]. Në përfundim të këtyre studimeve është arritur të kuptohet se tërësia e programeve të ndërhyrjes në adresë të bullizmit mund të ndërmerren nga psikologët shkollorë nëse ata zotërojnë njohjen e plotë të bullizmit si fenomen dhe aftësi të caktuara për ta menaxhuar atë. Të gjitha programet, si ato me bazë në shkollë, edhe ato që e trajtojnë shkollën si komunitet i njohin psikologut shkollor përgjegjësinë e të qenurit aktori kryesor në dedektimin dhe trajtimin e rasteve të bullizmit.

Ky studim u dizajnua për të mbushur boshllëkun e krijuar përsa i përket të kuptuarit të kompetencës së psikologëve shkollorë për të identifikuar dhe menaxhuar bullizmin në klasat 1-4 të shkollës nëntëvjeçare. Studimi u udhëhoq nga pyetjet: Deri në ç'masë e bëjnë psikologun shkollor (a) arsimimi, (b) vitet e përvojës në fushë, (c) trajnimet dhe (d) pjesëmarrja në aktivitete të zhvillimit profesional të aftë për të ofruar ndërhyrje efikase ndaj bullizmit? Si e vlerëson veten psikologu shkollor lidhur me kontributin që mund të japë në drejtim të reduktimit dhe parandalimit të bullizmit në shkollë?

## **Metodologjia**

### *Dizenjimi i kërkimit dhe metodat*

Ky u dizajnua si një studim i integruar cilësor dhe sasior. Edhe përpunimi i literaturës përfshiu konsultimin si të studimeve sasiore edhe atyre cilësore lidhur me studimin e kësaj çështje.

Përdorimi i përpunimit të literaturës shërbeu për përpilimin e pyetjeve në zanafillë të studimit, të cilat janë hulumtuar përmes teknikës Delphi. Teknika Delphi u përdor për të testuar vetëm një hipotezë të orientimit drejt bullizmit: kompetencën e psikologut shkollor për të ndërhyrë apo për ta parandaluar atë. Për këtë teknikë u përzgjedhën në studim 6 psikologë shkollorë të shkollave nëntëvjeçare të qytetit të Tiranës, si qyteti me popullsinë më të madhe dhe me numrin më të madh të psikologëve shkollorë. Gjithashtu kjo përzgjedhje mori në konsideratë edhe rritjen e vazhdueshme akademike dhe profesionale që psikologët shkollorë mund të kishin si rezultat i lehtësirave më të mëdha dhe mundësive më të shumta që ofron qyteti i Tiranës.

Teknika Delphi u përzgjedh si një metodë e cila “mund të përdoret kur nuk ka një njohje të plotë mbi problemin apo fenomenin [Adler & Ziglio, 1996; Delbeq et al., 1975

ref në (The Delphi Method for Graduate Students, Journal of Information Technology Education, Volume 6, 2007, fq 2)] .

Gjithashtu kjo metodë u përdor bazuar mbi tendencën që ajo ka për të arritur në konsensus, pasi një ndër pikënisjet e studimit ishte parashikimi për kualifikime të mëtejshme të psikologëve shkollorë në këtë çështje. Kujdes u bë në drejtim të mbajtjes nën kontroll të ndikimit që mund të kishte kjo karakteristikë në përmbushjen e besimit të studiuesit lidhur me nevojën për kualifikime të mëtejshme.

Kjo metodë u aplikua në dy raunde për shkak të homogenitetit të kampionit të studimit. ‘Raundi i parë’ i teknikës Delphi, i cili u zhvillua përmes pyetjeve të mbyllura i shërbeu fillimit të studimit përmes brainstorming. ‘Raundi i dytë’ u fokusua në çështje të lidhura drejtpërsëdrejti me pyetjet e kërkit.

Rezultatet e pyetësorëve online u analizuan përmes analizës cilësore të pëmbajtjes, për shkak të numrit të vogël të pjesëmarrësve. Në përfundim të përdorimit të kësaj metode u arrit identifikimi i nivelit të njohurive teorike dhe praktike të psikologëve shkollorë në drejtim të bullizmit në shkollë. Gjithashtu u nxorrën përfundime lidhur dhe me vlerësimin e tyre lidhur me këtë nivel njohurish dhe praktikash profesionale dhe ndikimin që kishte ky nivel në menaxhimin e bullizmit në shkollë.

#### *Përzgjedhja e kampionit*

Kampioni u përzgjedh bazuar mbi 4 kriteret e kampionimit të metodës Delphi sipas Adler & Ziglio (1996): a) njohuri dhe përvojë në çështjen në studim, b) aftësi dhe dëshirë për pjesëmarrje, c) kohë të mjaftueshme për pjesëmarrje dhe d) aftësi efikase të komunikimit. Numri i psikologëve shkollorë pjesëmarrës në këtë studim ishte 8, nga 42 psikologë shkollorë që përfshin ky shërbim në shkollë në të gjithë qytetin e Tiranës.

#### *Pika të dobëta të metodologjisë.*

Një ndër pikat e dobëta të këtij kërkimi ishte mungesa e një studimi pilot duke përdorur teknikën Delphi. Mungesa e këtij elementi në kërkimin e propozuar ndikoi në mungesën e një feedback-u për të ridizenjuar kërkimin në rast të përzgjedhjes jo të saktë të metodave kërkimore më të përshtatshme për të. Megjithatë mungesa e një studimi pilot nuk ndikoi identifikimin e problemit, dizenjimin e studimit dhe përzgjedhjen e kampionimit pasi studimi ishte një pjesë përbërëse e një studimi më të thelluar në drejtim të bullizmit në shkollat shqiptare. Të tjera studime janë bërë dhe do të bëhen në drejtim të zbulimit të faktorëve të përfshirë në lindjen e këtij fenomeni , ndikimin e mundshëm mbi të, parandalimin dhe menaxhimin e tij.

#### **Rezultatet**

Në ‘raundin e parë’ pyetjet e drejtuara pjesëmarrësve ishin të mbyllura. Ata synonin të mblidhnin informacion lidhur me: a) vitin e tyre të diplomimit, b) fushën në të cilën ishin diplomuar, c) vitet e përvojës si psikolog shkollor, d) kualifikime të marra përgjatë përvojës në punë dhe e) angazhime të tjera paralelisht me punën si psikolog shkollor. Në përfundim të ‘raundit të parë’ informacioni i mbledhur raportoi për psikologë dhe punonjës socialë të diplomuar pas vitit 2003 ( përveç një rasti, i diplomuar në vitin 2002), të cilët në pjesën më të madhe të kohës kryenin angazhimin si psikolog shkollor, angazhim i cili “iu linte shumë pak kohë edhe për gjërat e veta...”. Gjithsesi përgjigjet linin të kuptohej edhe prania e ndonjë angazhimi me kohë të pjesshme në punë të cilat iu ofroheshin në mënyrë të paplanifikuar.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, si metoda e tretë e përdorur në këtë kërkim, shërbimi psikologjik në shkolla ofrohet prej të diplomuarve në psikologji dhe punë sociale dhe shumë pak raste të diplomuar në filozofi dhe sociologji. Në dokumentacion nuk kishte pasqyrim të përditësuar të kualifikimeve të kohë pas kohshme të psikologëve shkollorë si dhe kishte mungesa në drejtim të raportimit (në cv-të e tyre) të angazhimeve të tjera jashtë orarit.

‘Raundi i dytë’ i teknikës Delphi u fokusua tek bullizmi dhe niveli me të cilin ai njihej si fenomen prej pjesëmarrësve në studim. Pyetjet e pyetësorit në raundin e dytë u drejtuan lidhur me a) përkufizimin e bullizmit, b) të paturit e rasteve të bullizmit në përvojën e tyre si psikolog shkollor, c) trajnimet e marra që lidhen me këtë fenomen, d) trajnime të tjera të cilave mund t’iu njihet një lidhje me fenomenin, e) praktika në menaxhimin e rasteve të bullizmit si dhe f) vlerësim të aftësive të tyre personale dhe profesionale për të menaxhuar raste të bullizmit. Në përfundim të ‘raundit të dytë’, përgjigjet raportuan për njohuri fillestare lidhur me bullizmin, përgjithësisht të marra nga literaturë në gjuhë të huaj e konsumuar për nevoja të rritjes profesionale apo për të gjetur zgjidhje të rasteve të caktuara. Gjithashtu përgjigjet e mbledhura referuan për shqetësim në raport me numrin në rritje të rasteve që sipas psikologëve shkollorë mund të klasifikoheshin si bullizëm. Trajnimet e marra përgjithësisht kishin ardhur nga Drejtoria Arsimore Rajonale, pas një testimi nevojash të psikologëve shkollorë. Pjesëmarrësit në kërkim raportuan për mospërputhje të tematikës së trajnimeve të marra me nevojat e deklaruara prej tyre. Ata nuk kishin marrë asnjë trajnim me fokus bullizmin, por kishin marrë një ose dy trajnime lidhur me menaxhimin e konfliktit, i cili është adresuar më shumë si marrëdhënie midis mësuesve dhe nxënësve. Përgjithësisht rastet e bullizmit ishin trajtuar duke i besuar intuitës së tyre. Në përfundim të pyetësorit, psikologët shkollor e vlerësuan veten të pafuqishëm teorikisht dhe nga ana praktike për të vlerësuar dhe menaxhuar rastet e bullizmit në shkollë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit i cili përfshiu edhe manuale që përdoren prej psikologëve shkollorë, nuk u konstatua asnjë element i trajtimit të dhunës së nxënësve ndaj nxënësve. Kryesisht dhuna e trajtuar në këto manuale ishte ajo midis mësuesve dhe nxënësve. Gjithashtu në dokumentacionin e shqyrtuar, rastet e bullizmit vetëm raportohen por nuk ndërhyhet apo monitorohet ecuria e tyre, përveçse në rastet kur nxënësit e përfshirë në bullizëm i referohen psikologut shkollor për çështje të tjera si mungesat në shkollë, apo shqetësimi që krijojnë në klasat kur zhvillohet ora mësimore.

## **Diskutime**

Çështjet kryesore të identifikuara në studim ishin a) mungesa e orëve mësimore në kurrikulën e formimit akademik të psikologëve shkollorë lidhur me bullizmin, b) mungesa e trajnimeve të specializuara lidhur me bullizmin në shkollë, c) shtimi i numrit të rasteve të vlerësuara si bullizëm nga psikologët në shkollë si dhe e) nivel i ulët i vet-perceptimit nga ana e psikologëve shkollorë si persona të aftë për të ndërhyrë në raste të bullizmit në shkollë.

A janë psikologët shkollorë kompetentë për të pikasur, trajtuar dhe parandaluar bullizmin në shkollë? Mungesa e njohurive në këtë fushë si dhe mungesa e trajnimeve lidhur me të janë dy elementë që e prekin kompetencën e psikologëve shkollorë, sidomos nëse merret në konsideratë fakti se këta profesionistë janë përgjegjës për sigurimin e një mjedisi të sigurtë për jetën e nxënësve.

A e ndikojnë angazhimet e tjera jashtë shkollës apo edhe përpjekjet personale të gjithësecilit prej psikologëve shkollorë për t'u rritur profesionalisht, për të rritur aftësinë e tyre për të menaxhuar bullizmin? Me gjithë nevojat për kualifikime të vazhdueshme dhe rritje profesionale të psikologut në shkollë, mungesa e trajnimeve të mirëfillta lidhur me bullizmin në shkollë do të bëjë që çështja e profesionalizmit në drejtim të reduktimit të këtij fenomeni në shkollë të vazhdojë të jetë e diskutueshme. Nga ana tjetër nuk mund të lihet jashtë vëmendjes edhe mungesa e një praktike të udhëhequr dhe të mbikqyrur nga autoritete dhe kërkues të mirëfilltë në këtë drejtim.

### **Rekomandime**

Studime të ndryshme kanë sugjeruar se nxënësit janë shpesh shumë dyshues në drejtim të të kërkuarit ndihmë për të administruar bullizmin (Rigby & Bagshaw, 2003; Unnever & Cornell, 2004). Nëse nxënësit nuk kërkojnë ndihmë tek mësuesit dhe psikologët, atëherë për këta të fundit do të jetë shumë e vështirë të marrin me mend se çfarë nuk po shkon siç duhet në jetën e nxënësve, viktimat të bullizmit. Sidoqoftë, psikologët shkollorë janë të vetmit që mund të mësojnë nxënësit se si të dëshmojnë një sjellje bulliste përkundrejt tyre dhe si të kërkojnë ndihmë nga më të rriturit.

Psikologët e shkollave kanë nevojë për njohuri, ndërgjegjësim dhe aftësi për të adresuar këtë sjellje që po merr përmasa të mëdha. Ata kanë nevojë të njohin prevalencën e bullizmit dhe pasojat e të gjitha llojeve të tij tek fëmijët. Ata gjithashtu kanë nevojë për aftësi për të ndërhyrë kur ndodhin incidente të bullizmit. Psikologët shkollorë kanë nevojë gjithashtu të kuptojnë, se ata duhet të bashkëpunojnë me prindërit, mësuesit dhe drejtuesit e shkollës për të ndërhyrë në mënyrë efikase. Roli si këshillues i psikologut shkollor e bën atë personin më të përshtatshëm për të koordinuar përpjekjet e grupeve të ndryshme të interesit.

Sidoqoftë, studime të ndryshme kanë treguar se psikologët shkollorë kanë nevojë të vazhdueshme për trajnime në këtë fushë, pasi edhe vetë kërkimet për këtë fenomen zbulojnë çdo herë horizonte të reja.

Programet e edukimit të psikologëve shkollorë duhet të përfshijnë parandalimin e bullizmit dhe menaxhimin e tij. Vetëm orë të konsiderueshme studimi dhe praktike për menaxhimin e këtij fenomeni mund të lehtësojnë menaxhimin e rasteve në shkollat ku ata punojnë.

Programet e trajnimit duhet të vlerësohen vazhdimisht për të siguruar që psikologët të mësojnë nga trajnimi i marrë dhe praktika e tyre e punës të pasqyrojë njohuritë e reja.

Bullizmi në shkollat shqiptare po kthehet në një çështje serioze. Psikologët shkollorë janë profesionistët e përshtatshëm që përmes trajnimit të duhur dhe praktikës në zhvillim të mund ta reduktojnë bullizmin në shkollë.

### **Referencat**

- Rigby, K. (2009), *New perspectives on bullying*. Jessica Kingsley Publisher.
- Lines, D. (2008), *The bullies: The rationale of bullying*. Jessica Kingsley Publishers London and Philadelphia.

- Skulmoski, G.J., Hartman, F., T., Krahn, J. (2007), *The Delphi Method for Graduate Research*. Journal of Information Technology Education, (6).
- Seifert, K. (2006) *How Children Become Violent: Why Disrupted Attachment Patterns Trigger Pathological Behavior*. Acanthus Publishing a division of The Ictus Group, LLC.
- Shure, M. B. (2005), *Thinking parent, thinking child*. McGraw-Hill.
- O'Moore, D & Minton, S. J (2004), *Dealing with Bullying in Schools*. Paul Chapman Publishing London · Thousand Oaks · New Delhi.
- Smith, P. K., Sharp, S. (2004), *School bullying: insights and perspectives*. Routledge 11 New Fetter Lane, London EC4P 4EE.
- Rigby, K. (2001), *Stop bullying in schools: A handbook for schools*. Acer Press.
- Staub, E. (2005), *The Psychology of Good and Evil: Why Children, Adults, and Groups Help and Harm Others*. Cambridge.
- Smith, P., Sharp S. (1994), *School bullying: insights and perspectives*. Routledge. London and New York.
- Fontaine, J. L. (1991), *Bullying: The child's View*. Calouste Gulbenkian Foundation.
- Denmark, F., Krauss, H., Wesner, R., Midlarsky, E., Gielen, U. (2005), *Violence in schools: Cross-national and cross-cultural perspectives*. Springer.
- Juvonen, J., Graham, S. (2001), *Peer harassment in school: The plight of the vulnerable and victimized*. The Guilford Press, New York, London.
- Borum, R., Verhaagen, D. (2006), *Assessing and managing the violence risk in juveniles*. The Guilford Press.

# DETYRA E SHTËPISË – MJET PËR PËRVETËSIMIN E GJUHËS SË HUAJ

Daniela Tamo

Departamenti i Gjuhës Angleze, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës

## Përmbledhje

Artikulli “Detyra e shtëpisë – mjet për përvetësimin e gjuhës së huaj” trajton një nga mënyrat e rëndësishme për zotërimin e gjuhës së huaj, siç është detyra e shtëpisë. Detyra e shtëpisë jepet nga mësuesi dhe kryhet nga nxënësi me një qëllim të përcaktuar mirë. Ajo synon të arrijë një apo disa objektiva dhe kontrollohet nga mësuesi apo nga vetë nxënësit. Detyra e shtëpisë ndihmon në rritjen e aftësisë së nxënësve për të thelluar njohuritë e marra, për të përsëritur dhe praktikuar shprehitë dhe aftësitë e fituara, për të përdorur burime të ndryshme informacioni etj. Nxënësit nga ana e tyre kanë mundësi të shprehen për përvojat e tyre personale, të lidhin dijet dhe njohuritë e fituara në klasë me përdorimin e gjuhës së huaj jashtë klase.

**Fjalët çelës:** detyrë shtëpie, mësimdhënie dhe mësimnxënie, shprehi, njohuri.

## Abstract

The article “Homework – a technique for the mastery of the foreign language” deals with a very important form serving to the mastery of a foreign language, like the homework. The homework given by the teacher and done by the student has a very well defined goal. It aims at reaching one or some goals and is checked by the teacher or by the students themselves. The homework helps to the increase of the students’ skill to deepen the acquired knowledge, to repeat and practise the skills, to use different sources of information, etc. On the other hand, the students themselves are given the chance to think and speak about their own experiences, to connect and interrelate the knowledge gained in the classroom with the use of the foreign language outside the classroom, etc.

**Key words:** homework, teaching and learning process, skills, knowledge.

## Hyrje

Gjuha në tërësi është një mjet shumë i rëndësishëm për komunikimin ndërmjet njerëzve. Ndërsa gjuha e huaj është një mjet komunikimi ndërmjet njerëzve që vijnë nga kultura të ndryshme. Ajo shërben për të rritur kontaktet midis kulturave, traditave, zakoneve të ndryshme dhe për të marrë e dhënë.

Qëllimi kryesor i mësimdhënies dhe mësimnxënies së gjuhës së huaj në shkollë është rritja e aftësisë komunikative të nxënësve, e aftësisë së tyre për të përdorur gjuhën e huaj në komunikimin me të tjerët. Sigurisht, nxënësit duhet të zhvillojnë aftësitë e tyre për të përdorur gjuhën e huaj në të gjitha format e mënyrat, me shkrim e me gojë. Ata duhet të zhvillojnë të katër aftësitë: të shkruarit, të dëgjuarit, të folurit dhe të lexuarit. Këtij qëllimi i shërben edhe mësimdhënia e mësimnxënia mbështetur në detyrën e shtëpisë.

### 1. Çfarë është detyra në tërësi, e detyra e shtëpisë në veçanti?

Shumë studiues kanë folur për përdorimin e detyrave në mësimdhënien dhe mësimnxënien e gjuhës së huaj. Koncepti detyrë është një element shumë i rëndësishëm në programin mësimor të çdo lënde, e po kështu edhe në programin mësimor të gjuhës së huaj. Po ashtu, ky koncept është i rëndësishëm edhe në procesin e vlerësimit të mësimnxënies, në klasë apo jashtë saj. Sipas Nunan (1989), mësimdhënia bazuar në detyra ka forcuar të mësuarit me qëllim komunikimin për të ndërvepruar në gjuhë të huaj, mundësitë që iu jepen nxënësve për t'u përqendruar jo vetëm në gjuhë, por në vetë procesin e të nxënësve, vetë përvojat personale të nxënësve si elemente që japin kontribut në procesin e të nxënësve, lidhjen e të mësuarit të gjuhës në klasë me përdorimin e gjuhës jashtë klase<sup>48</sup>.

Studiues të ndryshëm kanë dhënë përkufizime për termin “detyrë”. Kështu, Breen (1986) thotë që një detyrë është një plan i strukturuar për përgatitjen e mundësive për përmirësimin e njohurive dhe aftësive të detyrueshme në një gjuhë të re dhe përdorimin e saj gjatë komunikimit<sup>49</sup>. Prabhu (1987) thekson që një detyrë është një veprimtari që kërkon që nxënësit të arrijnë në një përfundim nga informacioni i dhënë përmes procesit të të menduarit dhe që i lejon mësuesit ta kontrollojnë dhe përmirësojnë këtë proces<sup>50</sup>. Nunan (1989) e përkufizon detyrën si një detyrë të dhënë në klasë dhe që bën që nxënësit të kuptojnë, të prodhojnë dhe të ndërveprojnë në gjuhën e huaj, ndërkohë që vëmendja e tyre përqendrohet më tepër tek kuptimi sesa tek forma<sup>51</sup>. Willis, J. (1996) e përkufizon detyrën si një veprimtari me një qëllim të caktuar dhe nëpërmjet të cilës nxënësit e përdorin gjuhën për të arritur një përfundim real<sup>52</sup>. Të gjitha këto përkufizime e të tjera e paraqesin detyrën si një plan pune, që i bën studentët ta shikojnë gjuhën në mënyrë pragmatike me qëllim që të arrijnë një përfundim. Detyra ka si qëllim të verë në përdorim gjuhën dhe të ketë ngjashmëri me mënyrën se si gjuha përdoret në jetën reale. Përkufizimet e mësipërme pavarësisht ndryshimeve vënë në dukje faktin që detyrat përfshijnë përdorimin e gjuhës për qëllime komunikative, në të cilën vëmendja e përdoruesit përqendrohet më shumë tek kuptimi sesa tek forma gramatikore. Sigurisht që kuptimi dhe forma janë të lidhura me njëra-tjetrën dhe gramatika shërben për të bërë të aftë përdoruesin e gjuhës të shprehë kuptime të ndryshme komunikative. Gjuha duhet të transferohet në veprimtaritë e jetës reale dhe kjo mund të realizohet duke kryer disa nga këto veprimtari në klasë dhe jashtë saj. Vetëm në këtë mënyrë gjuha e përdorur bëhet vërtet komunikative dhe nuk mbetet pasive.

Sipas Littlewood detyrat kanë disa karakteristika kryesore<sup>53</sup>. Detyrat janë veprimtari ku nxënësit punojnë për të arritur një objektiv të synuar. Objektivi mund të jetë i përcaktuar nga vetë nxënësit apo mësuesi. Detyrat mund të realizohen vetëm, apo më shpesh në bashkëpunim me nxënësit e tjerë apo ndonjëherë edhe në konkurrencë me të tjerët. Rezultati i detyrës mund të jetë diçka konkrete ose diçka jokonkrete.

---

<sup>48</sup> Nunan, D. Task based language teaching, f. 1.

<sup>49</sup> Van den Branden, K. Task – based language Education: From Theory to Practice, f. 14.

<sup>50</sup> Van den Branden, K. Task – based language Education: From Theory to Practice, f. 14.

<sup>51</sup> Van den Branden, K. Task – based language Education: From Theory to Practice, f. 14.

<sup>52</sup> Van den Branden, K. Task – based language Education: From Theory to Practice, f. 12.

<sup>53</sup> Littlewood, D. Task based learning of grammar, f. 2.

Edhe për detyrën e shtëpisë gjenden disa përkufizime në fjalorë dhe studiues të ndryshëm. Kështu, në *Compact Oxford English Dictionary of Current English* detyra e shtëpisë përkufizohet si detyrë shkolle që i kërkohet nxënësit ta bëjë në shtëpi. Tek *Merriam Webster's School Dictionary* i vitit 1994, detyra e shtëpisë përkufizohet: punë dhe veçanërisht mësim shkolle për t'u bërë në shtëpi. Tek *Webster's New World College Dictionary* detyra e shtëpisë shpjegohet si mësim për t'u studiuar ose punë shkolle për t'u bërë jashtë klase. Detyra e shtëpisë përkufizohet si detyra që u janë caktuar nxënësve nga mësuesi me qëllim që të kryhen jashtë orarit të shkollës<sup>54</sup>. Në të gjitha këto përkufizime ka një karakteristikë të përbashkët. Detyra e shtëpisë është një veprimtari e pavarur, e kryer jashtë klase, pa praninë e mësuesit. Ajo është detyrë që i'u ngarkohet nxënësve nga mësuesit për t'u bërë kryesisht jashtë klase. Quhet kështu si pasojë e faktit që shumica e nxënësve e bëjnë pjesën më të madhe të një pune të tillë në shtëpi.

Koha që nxënësi kalon në klasë dhe kryen një detyrë karakterizohet nga prania e mësuesit që e drejton dhe orienton nxënësin. Mësuesi paraqet materialin e ri dhe etapat dhe pastaj janë nxënësit që i përpunojnë materialet duke përdorur teknika të ndryshme interaktive. Ndërsa koha që kalohet duke bërë detyrat e shtëpisë është e strukturuar ndryshe. Ndërveprimi i nxënësit me veten dhe me materialin përbën karakteristikën kryesore. Kështu nxënësi punon në mënyrë të pavarur, duke formuluar dhe riformuluar hipotezat për materialin e ri sipas kohës së tij, me ritmin e tij dhe sipas mënyrës së tij të të mësuarit duke zhvilluar strategji për ta bërë më të lehtë të nxënësit. Është vetë nxënësi që e përcakton kohën se kur do ta kryejë detyrën e shtëpisë. Ka një lidhje dhe ndërvartësi të ngushtë midis detyrës në klasë dhe detyrës së shtëpisë. Kjo vartësi nuk është e rastësishme. Detyra e shtëpisë e merr nxitjen nga detyra në klasë dhe shërben për të përforcuar materialin apo aftësitë e prezantuara në klasë. Detyra e shtëpisë dhe detyra e klasës ndërtohen në mënyrë të tillë që të marrin nga njera-tjetra dhe të plotësojnë njëra-tjetrën.

Qëllimi i mësimdhënies dhe mësimnxënies së gjuhës së huaj bazuar në detyrën e shtëpisë është që nxënësve t'u mundësohet të studiojnë dhe eksperimentojnë me gjuhën e folur e të shkruar nëpërmjet veprimtarive që janë ndërtuar për ta angazhuar nxënësin në përdorimin autentik, praktik dhe funksional të gjuhës për qëllime komunikative dhe të dobishme dhe të përfshijë të katër aftësitë. Përvoja personale e nxënësve shërben si element që jep një kontribut shumë të madh në hartimin e detyrës së shtëpisë.

## **2. Qëndrimi tradicional dhe qëndrimi i ri ndaj detyrave të shtëpisë në gjuhën e huaj**

Në mënyrën tradicionale të mësimdhënies e mësimnxënies gjuha trajtohet si një objekt dhe nxënësve u kërkohet vetëm të mësojnë si nxënës. Prandaj edhe në qëndrimin tradicional ndaj detyrave të shtëpisë, nxënësi shihet nga mësuesi si një enë e zbrazët i cili e ndjen për detyrë të japë kontributin e tij për mbushjen e kësaj ene me sa më shumë material të jetë e mundur<sup>55</sup>. Pra sipas qasjes tradicionale, mësuesi është forca dominante në përcaktimin e detyrave të shtëpisë. Nxënësi zakonisht e bën detyrën më shumë për të kënaqur mësuesin ose për të mos u ndëshkuar sesa për të mësuar. Detyra bazohet në atë që mësuesi ndjen se është e rëndësishme për nxënësin dhe jo në atë që nxënësi dëshiron, i nevojitet apo pret të mësojë. Detyrat janë zakonisht me shkrim, shumë të strukturuar dhe

<sup>54</sup> Cooper, Harris and Valentine, J. C., : "Homework: a special issue".

<sup>55</sup> Murphy, J. and Decker, K. "Teachers' use of homework in high schools"



ngushtësisht të lidhura me tekstin. Qëllimi kryesor i tyre është praktikimi i gjuhës së huaj me anë të shkrimit duke e vënë theksin më shumë tek leksiku dhe strukturat gramatikore sesa tek të komunikuarit apo dëgjimi. Detyra konsiderohet si një punë individuale dhe bashkëpunimi në grup nuk inkurajohet. Përkundrazi, nëse nxënësit bashkëpunojnë, atëherë kjo mund të konsiderohet edhe si kopjim i detyrës. Qasja tradicionale vë më shumë theksin tek rezultati sesa tek procesi. Detyrat me orientim tek rezultati i shërbejnë mësuesit për të bërë një vlerësim të përgjithshëm të nxënësit dhe vlerësimi i nxënësit është i dokumentuar në çdo kohë. Përparësia e këtij qëndrimi është se nxënësi ka një ide të qartë për përparimin e tij në gjuhën e huaj sepse gjatë të gjithë kohës vlerësohet me notë dhe nota konsiderohet një tregues i rëndësishëm i përparimit të nxënësit. Por, nga ana tjetër kjo lloj qasje ndaj detyrave të shtëpisë ka rezultuar të ketë disa pika të dobëta. Kështu, duke qenë se detyra është e njëjtë dhe nuk përmban elemente krijimtarie, ajo nxit nxënësit të kopjojnë nga njeri- tjetri. Kështu, jo të gjithë nxënësit përfshihen në kryerjen e detyrave. Shumë shpesh, nxënësit i bëjnë detyrat vetëm për shkak të notës apo për të mos u ndëshkuar nga mësuesi, dhe jo për të përforcuar njohuritë dhe aftësitë e tyre në gjuhë.

Megjithëse qëndrimi tradicional vazhdon të jetë i pranishëm ende në orët e mësimdhënies dhe mësimnxënies së gjuhës së huaj, këto dekadat e fundit është formësuar një tjetër qëndrim ndaj detyrave, dhe detyrës së shtëpisë në veçanti. Kjo është një qasje e re që gjithnjë e më shumë po zëvendëson qasjen e vjetër dhe tradicionale. Ky qëndrim i ri lidhet me prirjet e reja për mësimin e gjuhës së huaj dhe qëllimin për përvetësimin e saj. Tashmë qëllimi kryesor për mësimin e gjuhës së huaj është qëllimi komunikativ. Nxënësit dhe të tjerët tashmë e mësojnë gjuhën e huaj kryesisht për qëllime komunikative. Kjo qasje e re vë theksin më shumë tek procesi i arritjes së qëllimit sesa tek rezultati. Pra, kjo qasje e re vë në dukje procesin përmes të cilit kalon nxënësi për të kryer detyrat e shtëpisë. Nën këtë prirje të re, detyra e shtëpisë nuk i shërben më vetëm të shkruarit, prandaj ajo nuk është vetëm një zgjidhje e ushtrimeve kryesisht të formës gramatikore. Gjuha e huaj trajtohet si mjet për komunikim dhe mësuesi me nxënësit funksionojnë kryesisht si përdorues gjuhe. Tashmë, nën këtë qasje të re, detyra e shtëpisë mund të marrë çdo lloj forme: atë të shkruarit, lexuarit, dëgjuarit dhe folurit. Ajo mund të marrë formën e të treguarit të nxënësit mbi një temë të caktuar apo që atij i pëlqen, formën e dëgjimit të folësve, të raportimit të vëzhgimeve, të një historie të shkruar fokusi i së cilës është i përcaktuar etj. Detyra mund të marrë formën ku puna, ndërveprimi dhe ndarja e mendimeve në grup është qëllimi kryesor i saj dhe matja apo vlerësimi apo rezultati as nuk merren në konsideratë<sup>56</sup>. Para se të jepet detyra e shtëpisë bëhet një punë paraprake përgatitore. Prezantohet tema dhe caktohet detyra. Pastaj vjen faza e zhvillimit të detyrës nëpërmjet veprimtarive të ndryshme mësimore, punës individuale, në dyshe apo në grup. Në këtë qasje të re, puna në grup është një nga teknikat që inkurajohet të përdoret dhe ka rezultuar të jetë një teknikë produktive dhe efikase për të nxitur të mësuarit përmes detyrave të klasës apo detyrave të shtëpisë. Bashkëpunimi në grup, duke qenë një teknikë interaktive e mësimnxënies i jep çdo nxënësi mundësi të ofrojë mendimet dhe idetë e tij, të diskutojë e debatojë, të bashkëpunojë me nxënësit e tjerë. Puna në grup bën që nxënësit me nivel të ndryshëm të aftësive të bashkëpunojnë dhe bashkëveprojnë me njëri- tjetrin, të përfitojnë dhe të mësojnë nga njëri- tjetri, krijon mundësi që nxënësit të hyjnë në marrëdhënie ndërpersonale me nxënës të tjerë, të kenë qëndrim pozitiv ndaj të mësuarit, të respektojnë njëri- tjetrin etj.

---

<sup>56</sup> Cooper, Harris M. The Battle over Homework.

Gjatë mësimdhënies dhe mësimnxënies bazuar në detyra shtëpie, mësuesi merr role të ndryshëm. Sipas Willis dhe Willis mësuesi është drejtues dhe organizator i diskutimeve, drejtues i punës në grup dhe punës në çift, lehtësues, motivues, këshillues, njohës i gjuhës etj. Qëndrimi pozitiv i mësuesit ndaj detyrave të shtëpisë e rrit vetëvlerësimin e nxënësve, si dhe u rrit vetëvlerësimin atyre që kanë perceptime të gabuara për veten.

Një rol shumë të rëndësishëm në përvetësimin e gjuhës së huaj bazuar në detyrat e shtëpisë luan edhe përzgjedhja e temave të detyrave. Detyrat e shtëpisë duhet të kenë kuptim për nxënësit si brenda ashtu edhe jashtë mjedisit të shkollës. Nxënësit janë më të motivuar kur merren me veprimtari që kanë për bazë njohuritë e tyre të mëparshme dhe që krijojnë lidhje të qarta midis asaj që ata janë duke mësuar dhe botës në të cilën jetojnë. Mund të përzgjidhen tema që gjenden në tekstet shkollore të nxënësve, tema që janë në tekste të lëndëve të tjera mësimore si histori, gjeografi, letërsi etj., tema që janë aktuale dhe me interes të madh për nxënësit, tema që zhvillohen shpesh nëpër biseda informale në kontekste shoqërore p. sh: në lokale, me familjen etj. Nxënësit dëshirojnë të jenë të aftë të flasin e diskutojnë me të tjerë për jetën jashtë klasës, ose t'u shkruajnë miqve e shokëve të huaj për vendin e tyre etj. Një mënyrë mjaft frytdhënëse për të rritur motivimin e nxënësve, për të kryer detyrat është që ata vetë të propozojnë e sugjerojnë temat e detyrave, ose të zgjedhin temat që pëlqejnë më shumë nga një listë temash që mësuesi ka përgatitur. Shumë mësues thonë që duke iu dhënë mundësinë nxënësve të zgjedhin vetë temat për detyrë shtëpie kanë rritur ndjeshëm interesimin dhe angazhimin e tyre.

Detyra e shtëpisë është pjesë përbërëse e procesit të të mësuarit. Ajo ka lidhje të drejtpërdrejtë me atë që shpjegohet atë ditë apo atë javë. Detyra e shtëpisë asnjëherë nuk prezanton koncepte, ide apo materiale të reja. Ajo nga natyra e saj është suplementare, plotësuese. Prandaj, detyra të mira shtëpie janë ato që e bëjnë nxënësin të praktikojë ato që ai i ka mësuar dhe që e ndihmojnë atë të shtojë njohuritë bazë që ka marrë. Ekspertë dhe studiues të ndryshëm sugjerojnë që nxënësi duhet të bëjë mesatarisht 2-3 orë në ditë detyra shtëpie<sup>57</sup>. Ata theksojnë se të kaluarit e më shumë kohe duke bërë detyrat e shtëpisë nuk do të thotë domosdoshmërisht që nxënësit do të kenë rezultate më të larta. Kur jepen detyra shtëpie, duhet të merren parasysh aftësitë e vetë nxënësve. Ka mësues që japin detyra shtëpie mbi bazën e aftësive të tyre dhe jo të nxënësve. Kjo mund të bëjë që nxënësit të mos jenë në gjendje ta kryejnë detyrën e shtëpisë dhe kështu të dyja palët përfundojnë të zhgënjyera dhe të mërzitura. Prandaj ekspertët sugjerojnë që detyrat e shtëpisë duhet të bazohen tek aftësitë dhe njohuritë e nxënësve<sup>58</sup>.

Detyra e shtëpisë duhet të hartohet dhe jepet për ta nxitur nxënësin të punojë më shumë për të mësuar gjuhën e huaj, dhe jo ta mërzisë atë. Është mirë të jepet si detyrë shtëpie një detyrë që nga njëra anë është sfiduese dhe nga ana tjetër e menaxhueshme nga nxënësit dhe që merr në konsideratë të gjitha nivelet e nxënësve. Detyra që duket e pamundur për t'u kryer çon me lehtësi në dekurajimin e nxënësve dhe në mungesën e angazhimit të tyre. Prandaj, detyra e shtëpisë duhet të ketë një qëllim të qartë, të ketë lidhje me jetën reale dhe të jetë sfiduese dhe e menaxhueshme nga nxënësit. Përvoja me detyrat e shtëpisë ka një ndikim domethënës jo vetëm në përparimin e nxënësve, por edhe në qëndrimet afatgjata të nxënësve ndaj të nxënit dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës. Ka

---

<sup>57</sup> Como, L. Homework is a complicated thing, f. 27-30.

<sup>58</sup> Paulu, N. Helping your students with homework: a guide for teachers.

disa parime që mësuesi duhet t'i mbajë parasysh. Kështu, mësuesi duhet të përdorë në mënyrë konstruktive atë çfarë nxënësi sjell me vete, qoftë nga përvoja e jetës, qoftë nga përvoja gjuhësore, për të zgjidhur problemet. Kur nxënësit i jepet një detyrë, duhet të merret parasysh që ai do të vërë në përdorim inteligjencën, imagjinatën, kreativitetin, intuitën, memorien, përqendrimin dhe aftësinë të gjykojë, diferencojë, përgjithësojë, ndërhyjë dhe të nxjerrë rezultate.<sup>59</sup> Mësuesi duhet të kalojë përgjegjësinë e të nxënësit nga mësuesi tek nxënësi. Kjo gjë kërkon që nxënësi të përfshihet në mënyrë aktive në procesin e të mësuarit, të vihet në qendër të tij duke u bërë i pavarur dhe në këtë mënyrë ndryshon edhe roli i mësuesit. Një mënyrë se si mësuesi mund të përdorë detyrën e shtëpisë për të ndihmuar të kalojë përgjegjësinë e të mësuarit nga mësuesi tek nxënësit është të zgjedhë veprimtari të cilat rrisin ndërgjegjësimin e nxënësit për gjuhën dhe kulturën. Me synim edukimin kulturor të nxënësve kërkohet që detyrat e dhëna të mos përqendrohen vetëm te njohuritë gjuhësore por edhe në ato kulturore. Kështu p. sh. nëse në një tekst nxënësit mësojnë për kështjellat e Anglisë dhe për historinë e tyre, pasi përvetësohet mësimi, fjalori dhe gramatika, nxënësve i'u caktohet detyrë shtëpie të përshkruajnë kështjella të caktuara në vendin e tyre. Mësuesi duhet të zhvillojë dhe forcojë vetëbesimin te nxënësi si një folës i pavarur i gjuhës. Kjo kërkon që të rritet vetëbesimi i nxënësit në aftësitë e tij për ta mësuar gjuhën. Zbulimi i modeleve dhe dhe praktikimi i tyre për t'u aftësuar në mënyrë produktive janë dy mënyra për të ndërtuar vetëbesimin e një nxënësi<sup>60</sup>. Duke e ndihmuar nxënësin të kapërcejë problemet e dala dhe të zbatojë njohuritë e marra, mësuesi në mënyrë domethënëse e përgatit nxënësin për të mësuar në mënyrë të pavarur. Mësuesi duhet të përgatisë nxënësin të kalojë nga e njohura tek e panjohura pa ndihmën e mësuesit<sup>61</sup>. Fjala kyçe në këtë koncept përsa i përket detyrave të shtëpisë është përgatitje<sup>62</sup>. Qëllimi është që një nxënës i aftë të mësojë vetë. Detyra e shtëpisë është një mundësi ideale për të realizuar një qëllim të tillë. Detyra e shtëpisë i jep mundësi nxënësit të bëjë lidhje e ndërlidhje, të formulojë dhe riformulojë hipoteza për gjuhën. Pasi nxënësi përpiket të gjejë rrugë të ndryshme për të zgjidhur problemin, mësuesi është i gatshëm ta ndihmojë nxënësin. Gjatë bërjes së detyrës së shtëpisë, nxënësi teorikisht mbështetet vetëm në forcat e tij, prandaj i duhet të përballlet vetë me problemet që i dalin. Pastaj, nxënësi bën krahasime, nxjerr përfundime dhe zgjidh problemet në një kohë që ka ende kohë të shkojë tek mësuesi dhe në klasë për t'i testuar përfundimet e veta. Kjo lejon që njohuritë të kontrollohen për saktësinë. Dhe kështu nxënësi e di nëse është duke i kanalizuar njohuritë e veta në drejtimin e duhur apo jo dhe mund të bëjë korrigjime nëse është e nevojshme përpara se gabimi të bëhet diçka e brendshme.

Detyra e shtëpisë iu shërben nevojave të ndryshme arsimore edukative. Ajo shërben për të ngulitur zakone studimi tek nxënësit, plotëson dhe përforcon punën e bërë në klasë dhe nxit iniciativën, pavarësinë dhe përgjegjësinë tek nxënësit. Në përvetësimin e gjuhës së huaj, detyra e shtëpisë shërben për të vazhduar e thelluar punën e bërë në klasë. Nuk mund të mendohet mësimi i gjuhës së huaj vetëm në orët e mësimit në klasë.

<sup>59</sup> Butler, Jocelyn A., Homework.

<sup>60</sup> Como, Lyn: Homework is a complicated thing, f. 27-39.

<sup>61</sup> Plumb David A. ESL/EFL Homework: Philosophical Considerations and their Application in ESL/EFL Homework Design.

<sup>62</sup> Doyle, W., "Effective Secondary Classroom Practices".

Dhënia e detyrave të shumëllojshme në gjuhën e huaj siguron vazhdimësi të të nxënit. Detyra e shtëpisë duhet të jetë një përvojë pozitive dhe nuk duhet të përdoret si ndëshkim.

Detyra e shtëpisë është një mundësi për nxënësit që të mësojnë dhe për prindërit që të përfshihen në arsimimin e fëmijëve të tyre. Interesimi dhe entuziazmi i prindërve ndikon pozitivisht tek nxënësi. Po ashtu i mëson nxënësit të kuptojnë që të mësuarit mund të jetë argëtues dhe ia vlen të përpiqesh. Detyra e shtëpisë i ndihmon nxënësit të përsërisin dhe praktikojnë ato që kanë mësuar, të bëhen gati për orën e ardhshme, të përdorin burime të tjera si biblioteka, interneti dhe burime të tjera referimi, të studiojnë lëndët më me thellësi, më shumë sesa u lejon koha në klasë etj.

Detyra e shtëpisë po ashtu afron prindërit dhe mësuesit. Prindërit që mbikëqyrin dhe punojnë me fëmijët e tyre për detyrat e shtëpisë mësojnë dhe dinë më shumë për shkollën dhe arsimimin e fëmijëve të tyre.

Detyra e shtëpisë është e rëndësishme edhe për mësuesit. Ajo i ndihmon ata të zbulojnë gabimet e mangësitë e nxënësve dhe t'i ndihmojnë këta të fundit që t'i korrigjojnë gabimet.

### **Përfundime**

Përdorimi i detyrave të shtëpisë është i rëndësishëm për përvetësimin e gjuhës së huaj, për krijimin e një atmosfere të këndshme në klasë ku mund të ndërthurren bashkëpunimi dhe konkurrenca ndërmjet nxënësve. Përmes detyrave të shtëpisë, nxënësit sjellin përvojat e tyre, shprehin mendimet dhe këndvështrimet e tyre dhe i krahasojnë ato me një temë të dhënë apo të caktuar nga mësuesi. Detyrat e shtëpisë nxisin tek nxënësit kënaqësinë, interesin, kuriozitetin, dëshirën dhe dashurinë për të mësuarit. Ato i motivojnë nxënësit për të mësuar më shumë me qëllim që të jenë të aftë të diskutojnë e debatojnë në situata të ndryshme, të ndihmojnë nxënësit e tjerë dhe të zgjidhin problemet përtej klasës, në jetën e përditshme. Ato mund të nxitin një dëshirë për të mësuarit që zgjat gjatë gjithë jetës.

Detyra e shtëpisë i ndihmon nxënësit të zhvillojnë zakone dhe qëndrime të mira. Ajo i mëson nxënësit të punojnë në mënyrë të pavarur, nxit disiplinimin dhe përgjegjësinë e përgjegjshmërinë e nxënësve.

### **Referencat**

- Butler, Jocelyn A. (1987), "Homework". Part of School Improvement Research Series by Northwest Regional Educational Laboratory, Portland, Oregon.
- Cooper, Harris M. (1994), *The Battle over Homework*. Thousand Oaks, Calif., Corwin Press.
- Cooper, Harris and Valentine, J. C. (2001), "Homework: a special issue", *Educational Psychologist*, no. 36.
- Corno, Lyn: "Homework is a complicated thing", in *Educational Researcher*, Vol. 25, no. 8, pp. 27-39.
- Doyle, W., (1985), "Effective Secondary Classroom Practices" in R. M. J. Kyle *Reaching for Excellence: an Effective Schools Sourcebook*, Washington, D. C., U. S. Government Printing Office.
- Littlewood, D. (2000), *Task based learning of grammar*. Hong Kong, English section, Curriculum Development Institute.

- Murphy, J. and Decker, K., (1989), *Teachers' use of homework in high schools*. Journal of Educational Research, 82, p. 261-269.
- Nunan, D. (2004), *Task based language teaching*. Cambridge: University Press.
- Paulu, N. (1998), *Helping your students with homework: a guide for teachers*. Washington D. C. U. S. Department of Education, Office of Educational Research.
- Plumb David A. *ESL/EFL Homework: Philosophical Considerations and their Application in ESL/EFL Homework Design*, 1981.
- Van den Branden, K. (2006), *Task – based language Education: From Theory to Practice*.
- Wahlberg, H. J. (1985), “Homework’s Powerful Effects on Learning”, *Educational Leadership*, Vol. 42, no. 7, pp. 76-79.
- Webster’s New World College Dictionary, 2010, Wiley Publishing, Inc., Ohio.
- Willis D. and Willis J. (2007), *Doing task based teaching*. Oxford University Press.

# **DIMENSIONI NDËRKULTUROR NË MËSIMDHËNIEN E GJUHËS SË HUAJ.**

**Edlira Xega**

Departamenti i Gjuhëve të Huaja, Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, Universiteti “Fan S. NOLI” Korçë.

## **Përmbledhja**

Ky punim konsiston në shfaqjen e dimensionit ndërkulturor në mësimdhënie e gjuhës së huaj. Në këtë artikull është parë edukimi ndërkulturor në shkollat nëntëvjeçare si një proces edukimi shoqëror i nxënësve. Gjithashtu në një studim gjatë orëve të gjuhës angleze është parë si shfaqet aspekti ndërkulturor në tekstet e “Express Publishing”, si dhe disa aktivitete ndërkulturore në klasë në përputhje me këtë dimension në programet e ciklit 9- vjeçar.

Edukimi ndërkulturor është sot një nga mjetet më të mira në dispozicion të mësuesit të gjuhës së huaj për t’i krijuar atij më shumë mundësi për një komunikim sa më të gjerë me shoqëritë shumëkulturore. Në këtë artikull janë parë gjithashtu edhe ndryshimet që pëson mësimnxënja tek nxënësit pas zhvillimit të këtyre aktiviteteve .

Në të gjithë punimin është vënë re se futja e aspektit kulturor së bashku me mënyrat sesi njerëzit kanë organizuar eksperiencën e tyre në mjedisin ku jetojnë, ndihmon në përvetësimin e gjuhës . Nxënësit ndihmohen t’i shohin proceset në shoqëri si një sistem lidhjesh shkak – pasojë, me sugjerime ,besime, koncepte dhe perceptime, me anë të të cilave shpjegojnë ngjarje dhe përmbushin qëllime. Pra nxënësit arrijnë ta përdorin gjuhën e huaj jo vetëm si një mjet për të komunikuar në vendin ku flitet kjo gjuhë, por edhe si vendosje të marrëveshjeve me njerëzit e kulturës së huaj.

**Fjalët kyce:** mesimdhënie e gjuhës së huaj, proces i edukimit ndërkulturor, aktivitet ndërkulturor, kompetencë gjuhësore, tekstet e “Express Publishing”, vlera sociokulturore.

## **Abstract**

This article presents the intercultural dimension of the foreign language teaching. Here is displayed the intercultural education in 9th grade school as a social educational proces of the students. In a study done during the classes of English language teaching, is seen how the intercultural is manifested in Express Publishing methods, and some intercultural activities in the English classes in accordance with the intercultural dimension of the programs of the 9th grades level as well.

Today the intercultural education is one of the best means in our disposal for creating possibilities from the multicultural societies. In this article are presented the changes that teaching undergoes after the use of intercultural activities in the classroom.

The whole article results in the fact that the teaching of culture helps in the acquisition of the foreign language, and in the ways how people have organised their own experience of the real world, in order to see it as a system of relations cause- result, with suggestions, beliefs, concepts, and perceptions , with whose help , they explain events and fulfill aims.

So the students use the foreign language not only as a mean of communication in the native country , but also as a mean for establishing relations with people of foreign cultures.

**Key words:** Foreign language teaching, the process of intercultural education, intercultural activity, language competence, Express publishing textbooks, socio- cultural values.

### **Hyrje:**

Duke u nisur nga eksperiencia ime disa vjeçare si mësuese e gjuhës së huaj si dhe nga rezultatet e kënaqshme që kam patur gjatë mësimit duke i vënë theksin aspektit kulturor në cikle të ndryshëm, më bënë të reflektoj mbi dimensionin ndërkulturor në mësimitin e anglishtes.

Futja e kulturës së huaj përmes gjuhës angleze ka rëndësinë e saj. Gjuha formon shoqërinë dhe formohet nga ajo. Gjatë aktit të të folurit ne shfaqim role kulturore dhe sociale që ndoshta nuk mund të vihen re. Mësimdhënia e gjuhës është e pandarë nga mësimdhënia e kulturës. Mësuesit e gjuhëve të huaja duhet të shkojnë përtej monitorimit të proceseve gjuhësore në klasë dhe të ndërgjegjësohen ndaj proceseve më komplekse të medimitit ndërkulturor. Kultura është themeli i komunikimit. Të mësuarit e një gjuhe të huaj bëhet brenda një kulture dhe kërkon që nxënësve t'u ofrohet mundësia për “ rritje individuale”. Objektivat e edukimit ndërkulturor janë globale. Këtu përmendim: rirforcimin e bazave të lidhjeve të përbashkëta jo vetëm midis shoqërive të ndryshme por edhe mes grupeve kulturore, si zgjidhjen e konflikteve në mënyrë paqësore, përpjekjen për të njohur diversitetet e ndryshme kulturore dhe për të gdhendur respekt ndaj tyre.

Përmes mësimdhënies së kulturës përmes gjuhës së huaj, nxënësit ndihmohen të kuptojnë që ndryshoret sociale si moshë, seksi, klasa sociale dhe vendi i banimit, influencojnë në mënyrat si njerëzit flasin si sillen e që sjelljet e tyre janë të kushtëzuara nga kultura. Ata ndërgjegjësohen në këtë mënyrë ndaj sjelljeve të të tjerëve në situata të caktuara , ndërgjegjësohen ndaj ngjyimeve kulturore të fjalëve dhe shprehjeve në kulturën e huaj. Ata zhvillojnë aftësitë e nevojshme për të bërë përgjithësime, për të pranuar kulturën e huaj, për të rritur kuriozitetin ndaj saj dhe të nxiten për të krijuar simpati dhe ndjeshmëri drejt njerëzve dhe vlerave të kulturës së huaj.

Për të arritur qëllimet përshtaten teknikat e duhura në aktivitetet që kanë të bëjnë me mësimdhënien e kulturës. Zgjedhja e kësaj varet nga faktorë të shumtë, si situata në të cilën gjuha shpjegohet, moshë dhe niveli i gjuhës i nxënësve dhe përgatitja e mësuesit për të shpjeguar elementet kulturore. Ndryshe nga gjuha e cila përvetësohet në moshën 5 vjeçare, përvetësimi i kulturës vazhdon gjatë gjithë jetës, me kalimin e individëve nga një grup social në një tjetër ose në grupe të reja sociale që kanë vlera e besime të ndryshme.

Duke u bazuar në atë çka thotë Kramsch ndërgjegjësimi ndërkulturor nuk është vetëm një aftësi por një grup aftësish dhe qëndrimesh dhe më mirë akoma, një kompetencë. Kjo kompetencë ndërkulturore komunikative është një përpjekje për të rritur ndërgjegjësimin e nxënësve të kulturës së tyre dhe duke bërë këtë gjë i ndihmon ata të interpretojnë dhe kuptojnë kulturat e tjera. Pra është një sërë praktikash që kërkojnë njohuri, aftësi dhe qëndrime.

Për më tepër, mësuesit e gjuhëve të huaja kanë përvojë të ndryshme, dhe në shumë raste mund jenë njohës të kulturave të ndryshme. Mësuesit janë ndërmjetësuesit unikë të lidhjeve kulturore.

Që mësimdhënia e kulturës të bëhet një pjesë e rëndësishme e një klase me gjuhë të huaj mësuesi duhet të vendosë qëllime të qarta dhe realiste. Mësuesi nuk është e thënë të jetë ekspert në njohuritë e një vendi të huaj, por ai duhet të dijë t'i ndihmojë nxënësit të pyesin dhe të interpretojnë .

## 1. Edukimi ndërkulturor- një proces edukimi social

### *Të rinjtë një burim thelbësor për edukimin ndërkulturor*

Të rinjtë janë qytetarët e ardhshëm të shoqërive tona ndërkulturore. Ata ndërtojnë një rrjet komunikimi të rëndësishëm drejt të rriturve dhe marrin iniciativë për ndryshime.

Në shkollë nxënësit mësojnë një kod kulturor, i cili duhet të ofrojë një hapje ndaj kulturave të tjera dhe mënyrave të tjera të jetesës. Gjithashtu edukimi ndërkulturor në shkollë është një përpjekje e rëndësishme hapjeje, dhe përshtatjeje programesh me realitetin e shoqërive shumëkulturore. Gjithmonë e me shumë shkolla e bazon punën e saj në parimin e barazisë për të gjithë. Aktualisht edukimi ndërkulturor kërkon që nxënësit të njohin e të respektojnë ndryshimet mes individëve.

Pra shkolla, sidomos përmes programeve mësimore ka një rol jashtëzakonisht të rëndësishëm, sepse i ndihmon nxënësit të merren me konfliktet duke i shmangur ato, duke nxjerrë në dritë interesat dhe duke kërkuar objektivat e përbashkëta.

Pra në një program shkollor është tepër e rëndësishme prezantimi i elementeve ndërkulturore , bazuar në:

- Rrëzimin e pikëpamjes etnocentrike të kulturës, ose idesë sipas së cilës është e mundur të përkufizohet një hierarki kulturash.
- Marrjen në konsideratë me gjithë objektivitetin dhe respektin e mundshëm, të karakteristikave të kulturave të ndryshme që bashkëjetojnë në një hapësirë specifike.
- Hapjen e vizionit të botës tek nxënësit.

Mësuesit duhet të jenë të përgatitur për të ndihmuar nxënësit të praktikojnë tolerancën aktive. Edukimi ndërkulturor i ndihmon të rinjtë dhe nxënësit të imagjinojnë botën e jashtme dhe ta kuptojnë këtë botë në të cilën jetojnë, të familjarizohen me realitetet e tjera, dhe ta kuptojnë ndryshimin pozitivisht, si edhe të inkurajojnë qëndrime, vlera, dhe sjellje pozitive. Mësimi i gjuhës së huaj zakonisht zhvillohet në një kontekst të paktën me dy kultura. Gjuha dhe kultura janë të pandara nga njëra-tjetra në mësimin e gjuhëve të huaja pasi duke mësuar gjuhën , nxënësi merr informacion kulturor dhe përvetëson mënyra të sjelluri , të ndryshme e të reja për të.

Nxënësit arrijnë të kuptojnë që zakonet tona, mënyrat tona të të menduarit, mënyrat tona të jetesës, nuk janë gjë tjetër vetëm përgjigje potenciale të botes që na rrethon. Ekzistojnë edhe realitete të tjera të cilat nuk janë as të këqija as më të mira por thjesht janë të ndryshme. Shoqëritë kanë nevojë për njëra- tjetrën, ato duhen njohur, ato duhet të përballen me ndryshimin, që të kuptojnë realitetet që janë ndryshe nga tonat.

Për të vendosur limitet në çdo aktivitet të edukimit ndërkulturor duhen pasur parasysh disa elemente:

- Konteksti në të cilin punohet. Motivimi i nxënësve varet nga vendi i aktivitetit.
- Njohjen që kanë me nxënësit si edhe lidhjet që ruajnë me ta.



- Niveli i pjesëmarrjes në aktivitete. Nëse nxënësit ndjehen të përfshirë në një aktivitet, rezultatet do të jenë më të mira, në krahasim me të qëndruarit pasiv.

Kompetenca ndërkulturore përfshin kompetencën komunikative dhe gjuhësore. Ajo përfshin njohuri mbi kulturën e komunitetit, historinë dhe traditat. Nxënësit duhet të kenë ngrohtësi, dhe empati kundrejt komunitetit, duhet të pranojnë ndryshimet etnike, duhet të kuptojnë vlerat e tyre dhe stereotipet. Ata duhen të jenë të aftë të diskutojnë çështjet kulturore në mënyrë të hapur.

Kur dy njerëz flasin me njëri-tjetrin, nuk shkëmbejnë vetëm informacion, por e shohin njëri-tjetrin si individ që i përket një grupi shoqëror të caktuar. Me fjalë të tjera, kur njerëzit janë duke folur me njëri-tjetrin, identitetet e tyre sociale janë pjesë e pashmangshme e ndërveprimit shoqëror midis tyre.

Në mësimdhënien e gjuhës së huaj, koncepti i “kompetencës komunikative” e merr këtë parasysh duke theksuar që nxënësit duhet të mësojnë jo vetëm kompetencën gramatikore por edhe njohuri mbi atë çka është gjuha e “duhur”.

“Dimensioni ndërkulturore” i gjuhës synon t’i zhvillojë nxënësit si folës ndërkulturore, që të jenë në gjendje që të angazhohen me identitete të shumta si dhe të shmangin stereotipet. Ai është i bazuar në perceptimin e bashkëbiseduesit si një individ, cilësitë e të cilit janë për t’u zbuluar.

Pra mësimdhënia e gjuhës me një dimension ndërkulturore vazhdon të ndihmojë nxënësit për të marrë kompetencën gjuhësore të nevojshme.

Por ajo gjithashtu zhvillon kompetencën e tyre ndërkulturore pra aftësinë e tyre për të siguruar një të kuptuar të përbashkët nga njerëz të identiteteve të ndryshme sociale, dhe aftësinë e tyre për të bashkëvepruar me njerëzit si qenie humane komplekse me identitete të shumta dhe me individualitetin e tyre.

Megjithatë, një folës ndërkulturore gjithashtu ka nevojë që të njihet dhe kuptohet nga perspektiva e personit tjetër, i cili ka aftësi, qëndrime dhe vlera të cilat janë vendimtare për mirëkuptimin dhe marrëdhëniet njerëzore ndërkulturore. Si pasojë, një mësues i mirë mund t’i ndihmojë nxënësit të ndërtojnë marrëdhënie midis kulturave të veta dhe të tjerëve, mund t’i ndihmojnë ata të shfaqin interes për “të tjerët”, dhe kultura e tyre të shihet nga perspektiva të ndryshme nga të tjerët. Kështu, zhvillimi i dimensionit kulturor në mësimin e gjuhës ka për qëllim t’i japë nxënësit si kompetenca ndërkulturore ashtu edhe kompetenca gjuhësore, për t’i përgatitur ata për bashkëveprim me persona të kulturave të tjera, për t’u mundësuar atyre që të kuptojnë dhe të pranojnë njerëzit nga kulturat e tjera si individë me të tjera këndvështrime, vlera dhe sjellje dhe t’i ndihmojë ata për të parë se një ndërveprim i tillë është përvojë pasurimi.

Por më e vështira është të vlerësohet nëse nxënësit kanë ndryshuar qëndrimet e tyre, dhe se si bëhen më tolerantë ndaj ndryshimeve dhe të panjohurës. Ky është një zhvillim moral dhe po ta vlerësojmë ne si mësues kurrë nuk do arrijmë të vlerësojmë sasinë e tolerancës kulturore. Nëse vlerësimi nuk është në formën e testeve dhe provimeve, por në lidhje me kompetencat e nxënësve, edhe një portofolio do të ishte zgjidhja më e mirë.

Kompetencat gjuhësore dhe kulturore në lidhje me çdo gjuhë e aftësojnë individin të zhvillojë një identitet më të pasur dhe me kompleks, një kapacitet më të rritur për mësim të mëtejshëm të gjuhëve të tjera dhe një hapje më të madhe drejt eksperiencave të reja kulturore.

## **2. Shfaqja e ndërkulturores në tekste. Aktivitete ndërkulturore në klasë në përputhje me dimensionin ndërkulturor të programeve ciklit 9- vjeçar si edhe aktivitete të tjera.**

Gjuhët e huaja ndihmojnë në dimensionet kroskurrikulare duke patur një ndikim të caktuar në identitet, në diversitetin kulturor në dimensionin global dhe në zhvillim. Një aspekt i identitetit dhe diversitetit kulturor është eksplorimi dhe vlerësimi i artit, letërsisë, muzikës të kulturave të ndryshme. Dhe kjo sillet më nga afër dhe më konkretisht tek tekstet e gjuhës angleze.

Programi i trajtuar në tekstet e gjuhës së huaj i aftëson studentet :

Të njohin multikulturat dhe diversitetin kulturor;

Të kenë fakte dhe njohuri sociale për vendin ku flitet gjuha;

Të njohin të tjerët duke qenë të ndërgjegjshëm për perspektiva të tjera në jetë;

Të tregojnë interes, respekt kundrejt vlerave, besimeve dhe perspektivave të komuniteteve të tjera;

Të shmangin paragjykimet dhe stereotipet;

Të observojnë ndryshime dhe ngjashmëri midis kultures mëmë dhe të huaj;

Këto karakteristika shfaqen qartë në tekstet e “Express Publishing” në të gjitha ciklet.

Është e rëndësishme dhënia e prioritetit çështjeve kulturore ashtu siç i jepet fokusimit në mësimin e gjuhës së huaj. Duhet njohur multikulturat si një realitet i botës ku jetojmë, duhet udhëhequr nxënësit për të treguar respekt dhe interes ndaj kulturave të tjera.

Është e rëndësishme së parë shfrytëzimi i materialeve për të eksploruar kulturën “e dytë” në klasat e gjuhës së huaj , konkretisht asaj angleze. Kohët e fundit janë futur në kurrikulën shqiptare tekste në programet e të cilave, gjuha dhe kultura janë të ndërthurura dhe kanë të njëjtën rëndësi. Përveç tyre mësuesve dhe nxënësve u janë ofruar site elektronike për mësimdhënien dhe mësimin e gjuhës angleze ku i gjejnë këto ndërthurje. Vlen të përmendim produktet globale të anglishtes nga Këshilli Britanik (GEP) për nxënës të grupmoshave të ndryshme:

<http://learnenglish.britishcouncil.org/> <http://learnenglishkids.britishcouncil.org/>

ku nxënës e studentë gjejnë lojra, tregime, aktivitete dëgjimi, aktivitete fjalori e gramatike, materiale videosh, teste etj. Si edhe siti tjetër për mësimdhënien e gjuhës angleze : [www.teachingenglish.org](http://www.teachingenglish.org), në të cilin krahas materialeve ndihmës për mësuesit ofrohet një varietet aktivitetesh kulturore për orët e mësimin.

Organizimi i aktiviteteve të ndryshëm kulturore e ndërkulturore rrit ndërgjegjësimin e nxënësve dhe zhvillon kuriozitetin e tyre drejt kulturës së huaj dhe kulturës së tyre dhe i ndihmon ata të bëjnë krahasime midis kulturave. Përveç kësaj ato pasurojnë eksperiencën e tyre dhe i ndërgjegjësojnë ata që edhe pse ka elemente kulturore që janë globalizuar, ka ende diversitet midis kulturave. Ky diversitet duhet kuptuar dhe respektuar dhe jo të nënvlefësohet.

### ***Aspekti ndërkulturor në tekste***

Zhvillimi i dimensionit ndërkulturor në mësimdhënien e gjuhës përfshin njohjen e këtyre qëllimeve nga mësuesit:

1. Dhënien e kompetencës ndërkulturore dhe gjuhësore nxënësve.

2. Përgatitjen e nxënësve për të ndërvepruar me popuj të kulturave të tjera .Aftësimin e tyre për të kuptuar dhe pranuar njerëz nga kultura të tjera si individë me perspektiva, vlera dhe sjellje të dallueshme.

3. Ndhimën që u japin nxënësve për të kuptuar që ndërveprime të tilla janë një ekperiencë e pasur duke parë lidhje midis kulturave.

4. Zhvillimi i një ndërgjegjësimi kulturor tek nxënësit si folës ndërkulturore dhe të jenë të aftë të angazhohen me kompleksitete dhe identitete të shumta për të shmangur stereotipet.

Këto pika duhen parë si qëllimet më të rëndësishme për ndërfutjen e një programi mësimor ndërkulturor në mësimdhënien e gjuhës; duke përfshirë këtu metodat e huaja tepër bashkëkohore që ingranojnë bukur njohuritë e gjuhës me kulturën .

Për të zhvilluar aftësitë ndërkulturore mund të fillohet nga tema në tekst dhe t'i inkurajojmë nxënësit të bëjnë pyetje të mëtijshme dhe të bëjnë krahasime mes kulturave..

Nga ana tjetër ushtrimet gramatikore në tekste mund t'i përforcojnë paragjykimet dhe stereotipet ose t'i sfidojnë ato.

Per shembull subjektet femërore mund të lidhen me aktivitete stereotipike femërore (Mary likes cooking; John likes football) përgjithësime të stereotipeve mund të inkurajojnë grupet ( The french like...; Germans are....' Older people...)

Tekstet duhen konsideruar si libra burimore më tepër se si libra shkollore dhe roli i tyre të jetë lehtësimi i procesit të mësimdhënies.Duhet ditur gjithashtu që informacioni kulturor nëpër tekste vjetërohet shpejt ndaj duhen gjetur të tjera burime si adresa elektronike , mjaft prej të cilave janë përmendur dhe më sipër, të cilat informojnë me të dhënat më të fundit në mënyrë që të integrohet dimensionin ndërkulturor në programin mësimor, ose revista, gazeta, CD, video, por gjatë transmetimit të këtyre materialeve autentike nxënësit duhet që të kuptojnë kontekstin dhe qëllimin.

Materiale nga origjina të ndryshme me perspektiva të ndryshme duhet të përdoren së bashku t'i aftësojnë nxënësit të krahasojnë dhe të analizojnë materialet në mënyrë kritike. Është më e rëndësishme që nxënësit të fitojnë më tepër aftësi analize sesa informacion faktik.

### **Aktivitete ndërkulturore gjatë mësimdhënies së gjuhës së huaj**

Temat në tekstet e “Express Publishing” janë krijuese, transmetojnë identitet kulturor dhe gjuhësor dhe vlera sociokulturore që janë universale si: tolerancë, këmbëngulje, kurajo. Në të gjitha orët e zhvillimit të gjuhës së huaj 3 plane janë të pandarë nga njeri- tjetri: social, lingustik dhe kulturor. Këto vërehen edhe gjatë orëve të projekteve.

Tregimet, loja me role, lojëra, information gaps, pyetësorë dhe vëzhgime, lojëra me hamëndje ose ritregime sjellin një metodë komunikative gjuhësore. Përfitimet që vijnë nga këto tekste kanë të bëjnë me përvetësimin e gjuhës si dhe me promovimin e kuptimit sociokulturor.

Më poshtë janë dhënë shembuj dhe veprimtari kulturore si dhe mënyrat si ato përvetësohen në mënyrë praktike nga nxënësit gjatë orës së mësimi, me anë të qëndrimeve të tyre, reagimeve, sjelljeve.

#### **• Access 1.- klasa e 5-të**

-“*Schools In England*”. Nxënësit krahasojnë shkollat në vendin e tyre dhe shkollat në Angli, duke parë të përbashkëtat e të veçantat si dhe pajisen me informacione.

-“ *Famous british people*” Nxënësit krahasojnë 5 njerëzit më të famshëm në vendin e tyre. Nxënësve u lihet për në shtëpi përgatitja e projektit mbi njerëz të famshëm

në Shqipëri, duke bërë krahasim të jetës shoqërore, politike, ekonomike me Britaninë, duke parë e krahasuar vlerat e personazheve të famshëm.

- “Scotland” Nxënësit njihen me kulturën e Skocisë dhe bëjnë krahasimin me kulturën shqiptare.

(fig. 1)



Fig. 1

### *Aktivitet jashtëkurrikular*

#### • **Java e gjuhës së huaj**

Ky aktivitet është zhvilluar me nxënësit e tre klasave të teta, si aktivitet kulturor në javën e gjuhës së huaj. Çdo klasë kërkon informacione mbi vendet anglishtfolëse, informacione mbi ushqimin, muzikën, vallëzimin historinë, monedhat, gjuhën zyrtare e të folur, turizmin, sportin, veshjet tradicionale. Nxënësit ndahen në grupe 6- 7 veta.

Hapi tjetër ishte të zgjidhej tipi i projektit. Nxënësit sollën video, dhe projekte në formën e roleve play. Disa nxënës sollën në klasë vizatime në letër për veshjet tradicionale të vendit që ata kanë zgjedhur, disa sollën receta, kuti me piktura me informacione brenda.

U vendosën flamuj dhe fjalë në dialekte të ndryshme të gjuhës angleze, formale dhe joformale, në klasa. Ishte një aktivitet shumë interesant, që e solli në mënyrë shumë interesante, gjuhën angleze në mjedisin shqiptar dhe krijoi një dimension ndërkulturor, me shkëmbim kulturash e informacione mbresëlënëse mes nxënësve e mësuesve.

#### • **Lojëra ndërkulturore/ Sporte**

Grupi: Adoleshentë- zhvilluar në klasën e 7 Access 3 dhe në klasën e 9 Click on  
Niveli: B1 deri në C1

Procedura:

1. Nxënësve u kërkohet të sjellin disa lojëra të ndryshme ose aktivitete sportive.
2. Nxënësit i referohen temës së tekstit ( *Snowbiking, Parker , Kitesurfing, ose edhe lojës “The crystal Quest”*) dhe pyetën nëse ekzistojnë në kulturën e tyre këto lloj sportesh dhe lojërash.
3. Ata kërkojnë në internet tek siti: <http://www.estcomp.ro/~cfg/games.html> . I përmbledhin gjetjet e tyre në një mini prezantim, ose ese reflektive.
4. Në internet ata provuan një lojë vizuale online.

Rezultatet ishin me të vërtetë surprizuese. Kishte shumë emocione, sidomos kur flasin për fëmijërinë e tyre të hershme. Kishte refleksione nga ana e nxënësve mbi universitetin dhe të veçantat duke krahasuar kulturat dhe çonin në konkluzione interesante.

• **Kujdes gafat kulturore (fig. 2)**

Është një orë mësimi të cilën e kam zhvilluar në klasën e XI ku zhvilloja anglishten si lëndë me zgjedhje, përkatësisht me librin: "Headway intermediate" temën me titull: "A world guide to good manners".

"Mind the Gaffe"- "kujdes gabimin" si mund të shmangim shkaktimin e ofendimeve kur udhëtojmë në një vend që ka kulturë tjetër nga e jona? 6 gafa: gjuha, sjellja, korrektësia politike, biseda, qëndrimet kulturore, dhe humori pa vend.

Përgatitja

Mblidhen disa shembuj gafash kulturore.

Fillimisht nxënësit prezantohen me stereotipin, duke u dhënë disa karakteristika të kombësive të ndryshme, që nxënësit të jenë në gjendje të japin mendimin e tyre në lidhje me figurat.




fig. 2

Lexohet pjesa dhe nxënësit shkruajnë 2-3 karakteristika për çdo kombësi.

Ndahen nxënësit në grupe dhe çdo grup përgatit 3 gafa për grupet e tjera. Nxënësit e tjerë korrigjojnë gafat sociale, bazuar në ato që kanë lexuar, duke bërë krahasimin dhe me vendin e tyre.

*Gafat:*

Në Gjermani, në Britaninë dhe në Hollandë ndalohet heqja e xhaketës dhe përveshja e mëngëve për të diskutuar për çështje biznesi.

Ngritja e këmbëve mbi tryezë në zyrat japoneze konsiderohet gafë, kurse në Amerikë është normale, dhe konsiderohet moment çlodhjeje.

Dhënia e dorës një Japonezi, nuk pritet, është gafë sociale

Shkelja e syrit në Pakistan është ofenduese.

Në Amerikë nuk bëhet muhabet derisa të kesh mbaruar së ngrëni hamburgerin.

Në Francë nuk mund të ulesh në një kafene pa u dhënë dorën të gjithëve që njeh.

### • **Gjuha e trupit ose komunikimi jo verbal**

Ky aktivitet është zhvilluar edhe në klasën e tetë tek Access 4, moduli 1a. (Fig. 3)

Nxënësit japin shembuj të gjuhës trupore në Shqipëri, dhe hamendësojnë nëse është e njëjtë me vendet e tjera; përqafimi në publik është i papranueshëm në Japoni; Japonezët mund të buzëqeshin kur janë konfuzë ose të inatosur. Qëllimi i këtij aktiviteti është t'i ndërgjegjësojë nxënësit për mënyrat e shumta të komunikimit dhe kuptimin e disa gjesteve në kultura të ndryshme. Për shembull: gjesti i figurës më poshtë është një shenjë e pranueshme në US me kuptimin “ok”, në Gjermani ose edhe në Shqipëri ka kuptim ofendues.



Fig. 3

Kontrollohet korrektësia gramatikore dhe leksikore. Nxënësit kontrollojnë njohuritë e tyre mbi kulturën britanike. Ky aktivitet është zhvilluar tek teksti “Access 4”, klasa 8

Ky aktivitet i ndihmoi nxënësit për t’u ndërgjegjësuar në shmangien konflikteve me kulturat e vendeve të tjera.

### • **Click on- klasa e 9-të**

Temat tek *Click on* për të zhvilluar aktivitete kulturore janë të shumta:

- *Types of holidays*- Nxënësit krahasojnë me kulturat e tjera, mënyrat si i kalojnë pushimet. Zgjerojnë njohuritë dhe ofrojnë eksperiencat e tyre mbi to.

- “*All aboard for a steam safari*”- ku nxënësit ofrojnë ide dhe mendime mbi temën, mësojnë dhe marrin njohuri mbi llojet e transporteve në vende të ndryshme.

### • **Kulturat e tjera**

Është një aktivitet i zhvilluar në disa cikle, klasat: 7, 8, 9

Aktiviteti bazohet në tema nga projektet e Këshillit Britanik, „Open cities“, realizuar në një prej orëve të lira në klasat e nënta.

### **Përgatitja**

Nxënësit i drejtojnë pyetjet njëri – tjetrit për të shkëmbyer njohuritë nga kulturat e tjera si më poshtë:

1. What foods from other countries have you tried? Which did you like?
2. Do you often see people wearing clothes from different cultures in the streets of your town? Do you know which countries they are from?
3. Do you ever listen to music from other cultures?
4. Do you ever watch films with subtitles?

5. What do you think about mixed marriages with people from different cultures? Does it encourage greater cultural understanding? etj  
Përgjigjet ishin interesante , kishte një dëshirë të madhe nga ana e nxënësve për njohjen dhe përfshirjen në biseda mbi kultura të vendeve të tjera.

### **Procedura**

Më pas u dorëzohen pyetjet e intervistës dhe nxënësit punojnë në çift. Ndihmohen vazhdimisht me fjalorin. Ka pasur edhe mosmarrëveshje me njëri-tjetrin..

Aktiviteti përfundon me një diskutim të përgjithshëm. Gjatë dy orëve në të cilat zhvillohet ky aktivitet vihet fokusi mbi fjalorin e ri dhe ndërgjegjësimin kulturor.

- Për të zbuluar më tepër rreth kulturave të tjera nxënësve u është dhënë edhe faqja e internetit , ku ka edhe projekte në të cilat përfshihen nxënësit.

Dy nga temat në të cilat janë zhvilluar aktivitete të ngjashëm janë: “*Music*” Access 3 dhe “*Traditional costumes of the British Isles*”, Access 4

Nxënësit dëgjojnë CD me pjesë muzike nga vende të ndryshme dhe kultura të ndryshme dhe e lidhin muzikën me kërcimet dhe kostumet tradicionale të vendeve të dhëna në tekst.

Ata japin mendimet e tyre mbi njohuritë e kulturave që kanë. Informacion shtesë gjendet tek siti i mëposhtëm: <http://worldmusic.nationalgeographic.com/>. Ky sit është shumë i gjerë sepse hap diskutime sidomos në klasat e 9-ta mbi kulturat e vendeve të ndryshme.

Tjetër variant është edhe përdorimi i pamjeve nga një faqe tjetër interneti, që janë përdorur me videoprojektor në klasë. Nxënësit shprehin mendimet e tyre nga cili vend janë pamjet dhe si lidhen me kulturat e ndryshme. Në këtë mënyrë krijohen orë argëtuese gjatë mësimdhënies së gjuhës angleze në klasë , ku merren mendime nga më të ndryshmet .Nxënësit ndajnë idetë dhe eksperiencat e tyre të udhëtimeve dhe njohjet e tyre me njerëz të kulturave të ndryshme.

Gjatë këtyre aktiviteteve nxënësit jo vetëm janë informuar, por dhe u janë krijuar mundësitë të shpalosin njohuritë e tyre përmes projekteve dhe aktiviteteve ndërkulturore, të mësojnë nga kultura angleze , ta pranojnë atë, vlerat e saj dhe ta ndërthurin me kulturën shqiptare në tema të ndryshme të jetës sociale, politike, historike, muzikore etj.

Nxënësit gradualisht ndërgjegjësohen nëpërmjet aktiviteteve kulturore që ofrojnë tekstet mësimore, konkretisht ato të “*Express publishing*”, si edhe aktivitetet e zhvilluara në orët e lira dhe projektet , që çdo kulturë prezanton aspekte pozitive, nga të cilat nxirren mësim dhe bëhen përpjekje për t’i përshtatur me kulturën tonë.

Nxënësit panë që lidhjet dhe ndërveprimet midis ndryshimeve kulturore të dy kulturave, janë pasuruese, jo vetë për individët , por edhe për gjithë shoqëritë. Ato mund të jenë gjithashtu burim i shumë kënaqësive. Çdo shoqëri ka diçka për të mësuar nga tjetra, dhe për t’i dhënë tjetrës. Gjithsesi duhet patur parasysh që qëndrimet dhe sjelljet duhet të ecin paralelisht me cilësitë e tjera si: bashkëpunimi, komunikimi, reflektimi kritik dhe organizimi.

Pas zhvillimit të aktiviteteve kulturore, tek shumë prej nxënësve u panë këto rezultate:

### *Njohuritë.*

- Zotërojnë normat esenciale dhe tabutë e kulturës së huaj (përshëndetjet , sjellje të ndryshme në sfera shoqërore dhe profesionale, rolet në familje, puna në grup, zgjidhja e problemeve,veshjet)
- Krahasojnë aspekte të rëndësishme të sjelljeve të dy kulturave.


### *Qëndrimet*

- Ndërveprojnë me anëtarë të kulturave të tjera.
- Mësojnë nga gjuha dhe kultura e tyre.
- Përballen me emocionet e kulturave të tjera.
- Marrin role të ndryshme në varësi të situatave të duhura (në familje, si vullnetar).
- Tregojnë interes në aspekte të reja kulturore (histori, traditë).
- Mundohen të kuptojnë ndryshimet në sjellje , vlera, qëndrime.

### *Aftësitë*

- Demonstrtojnë elasticitet kur ndërveprojnë me persona nga kultura e huaj.
- Dinë të përdorin strategjitë e duhura për të përshtatur kulturën e tyre me të huajën, në situata të caktuara, si dhe të gjejnë ndryshimet dhe të përbashkëtojnë mes dy – tre kulturave.

Si rezultat i gjithë këtyre aktiviteteve kulturore nëse e paraqesim me anë të një skeme të thjeshtë them se: 98% e nxënësve morën pjesë aktivisht në mësim. Ishin të interesuar dhe motivuar. Nxënësve u krijohet mundësi e larmishme për të kuptuar kulturat e tjera me larmishmërinë e temave që ofrojnë tekstet e “Express Publishing”.



### *Përfundimi*

Gjatë aktiviteteve ndërkulturore zhvilluar në klasat e gjuhës angleze, nxënësit u ndërgjegjësuam me idenë se stereotipet dhe paragjykimet bazohen në ndjenja më tepër sesa në mendime dhe duhen sfiduar. Vetë mësuesit ndikojnë tek nxënësit duke theksuar se sfidohen idetë dhe jo personi, nëse rezultati duhet të jetë pozitiv.

Edukimi ndërkulturore i ndihmon nxënësit të imagjinojnë botën e jashtme dhe ta kuptojnë botën në të cilën jetojnë, të familjarizohen me realitetet e tjera, dhe ta kuptojnë dhe pranojnë ndryshimin pozitivisht, si edhe të inkurajojnë qëndrime , vlera, dhe sjellje pozitive. Nxënësit arrijnë të kuptojnë që zakonet tona, mënyrat tona të të menduarit, mënyrat tona të jetesës, nuk janë gjë tjetër vetëm përgjigje të mundura të botës që na rrethon. Ekzistojnë realitete të tjera të cilat janë të ndryshme. Shoqëritë kanë nevojë për



njëra- tjetrën, ato duhen njohur , familjarizuar, të hapen drejt rreziqeve dhe të takohen me ndryshimin, që të kuptojnë realitetet që janë ndryshe nga tonat. Nxënësit gradualisht ndërgjegjësohen përmes aktiviteteve kulturore, që ofrojnë tekstet mësimore, konkretisht ato të “*Express Publishing*”, si edhe aktivitetet e zhvilluara në orët e lira dhe projektet, që çdo kulturë prezanton aspekte pozitive, nga të cilat nxirren mësim dhe mundohemi t’i përshtasim edhe në kulturën tonë, si edhe aspekte negative të cilat ne i kritikojmë.

Në klasa ndodh ndërveprim social dhe mësohet gjuhë e huaj. Mësimi i një gjuhe të huaj është një nga mënyrat më të mira për të përcaktuar identitetin kulturor. Nje orë e gjuhës angleze duhet të shërbejë si formim për nxënësit për të eksploruar dhe për të diskutuar kulturën e tyre, historinë dhe traditat. Është e vërtetë që këndvështrimi i një bote rrallë takon tjetrën. Duke krahasuar dy kultura nuk do të thotë që njëra është superiore dhe tjetra inferiore. Pa dyshim kulturat duhen respektuar.

Është e rëndësishme të dimë se si të jetojmë e ndërveprojmë në mënyrë krijuese me këto ndryshime nga kultura në kulturë, pra kjo ndryshueshmëri kulturore duhet parë si një dukuri që e pasuron kulturën tonë. Është i domosdoshëm respektimi i dinjitetit të çdo kulture. Kulturat bashkëjetojnë dhe ndikojnë tek njëra – tjetra. Ato pasurojnë njëra-tjetrën.

### Referencat

- A. Haloci, Sh. Delija, E. Tabaku, A .Sula *Didaktika e gjuheve te huaja*; Shblu, fq. 226
- Claire Kramsch. *Context and Culture in Language Teaching*. Fq. 238 Oxford University press
- M.Byram, B Gribkova, H.Starkey; *Developing the intercultural dimension in language teaching*, Council of Europe; fq.15; 34
- Byram, M. and Tost Planet, M. (eds.) 2001, *Identité sociale et dimension européenne*.
- Byram, M. and Zarate, G. *Definitions, objectives and assessment of sociocultural competence*. Strasbourg: Council of Europe 1997
- <http://www.elanguages.org/>
- <http://flickrriver.com/search/culture/>
- <http://wilderdom.com/games/MulticulturalExperientialActivities.html>
- Virginia Evans; Neil O’Sullivan, *Click on 3*; Express publishing 2008
- Virginia Evans, Jenny Dooley, *Access 4*; Express publishing 2008 fq 45
- Virginia Evans, Jenny Dooley, *Access 3*; Express publishing 2008 fq 107
- [www.teachingenglish.org](http://www.teachingenglish.org)

# NJË KËNDVËSHTRIM I RI I KORRIGJIMIT ME SHKRIM. ROLI I TIJ PËR NJË PËRVETËSIM MË TË MIRË TË GJUHËS FRËNGE.

**Pavlo Cicko**

Departamenti i Gjuhëve të Huaja, Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë,  
Universiteti “Fan S. NOLI” Korçë.

## **Përmbledhje**

Në këtë artikull trajtohet nga një këndvështrim i ri korrigjimi i gabimeve gjatë mësimit të gjuhës frënge për të huajt. Sipas kësaj pikëpamje kjo veprimtari mund të shndërrohet në një moment të rëndësishëm të të nxënës të përshtatur me ritmet dhe stilet e të mësuarit të nxënësve të ndryshëm.

Angazhimi i nxënësve për korrigjimin dhe përshtatjen e tij me ritmet dhe stilet e ndryshëm të të mësuarit, kërkon ndërjegjësimin e tyre se detyra apo testimi është plotësisht pjesë e të nxënës. Artikulli bazohet në një studim teorik mbi lidhjet midis modeleve të të nxënës dhe statusit të gabimit, mbi klasifikimin e gabimeve, mbi kriteret e vlerësimit dhe rolin e shënimeve të mësuesit mbi teste. Vëzhgimet e realizuara venë në dukje interesin e analizës së gabimeve të bëra nga nxënës gjatë të nxënës të tyre.

Korrigjimi sipas ritmeve të të mësuarit të çdo nxënës synon që të gjithë nxënës të përparojnë pavarësisht nga niveli i aftësisë që kanë.

**Fjalët çelës:** korrigjimi i gabimeve, kriteret e vlerësimit, analiza e gabimeve, roli i korrigjimit, strategjitë e të nxënës.

## **Abstract**

In this research paper one can find out the correction of the mistakes from a new point of view in the class teaching French for special purposes. According to this view point the activity may be turned to a very important moment of teaching, making it similar to the learning rythm and style of different students.

The cooperation with the students and young learners during the class time for the correction of the mistakes and making it similar to the rythmn and the style of the learners, require the students be conscious for the task they have and the test which should be completely part of their learning. The paper is based on a theoretical study dealing with the relations between the teaching models and the status error, the classification of the mistakes, the assessment criteria and the role of the teacher's notes picked up from the tests that he has realized during the whole period. The observations that have been realized by the teacher reflect the interest of the errors analysis done by the students and the learners during the time of their learning and teaching.

The correction according to the rythmn of the teaching and learning depends on every learner but it aims at progressing all the students in spite of their level and skills.

**Key words:** Correction of mistakes, the assessment criteria, the errors analysis, the correction role, learning and teaching strategies.

## Hyrje

Këndvështrimi i ri i korrigjimit me shkrim sipas orientimeve të Kuadrit Evropian për gjuhët synon ta shndërrojë këtë veprimtari të rëndësishme në një moment të të nxënës të përshtatur me ritmet dhe stilet e të mësuarit të nxënësve të ndryshëm.

Për të përmirësuar angazhimin e nxënësve në korrigjimin e punimeve të tyre dhe për ta përshtatur atë me ritmet dhe stilet e ndryshëm të të mësuarit, duhen ndërgjegjësuar nxënësit se një detyrë nuk vlerësohet vetëm për marrjen e një note, por ajo është plotësisht pjesë e të nxënës. Duke u nisur nga një studim teorik mbi lidhjet midis modeleve të të nxënës dhe statusit të gabimit, mbi klasifikimin e gabimeve, mbi kriteret e vlerësimit dhe rolin e shënimeve të mësuesit mbi testime, kemi realizuar disa vëzhgime të cilat venë në dukje interesin e analizës së gabimeve të bëra nga nxënësit gjatë të nxënës të tyre. Këto vëzhgime dhe kërkime të kryera në kuadrin e punimit tonë po i paraqesim më poshtë.

Nga përvoja jonë në mësimdhënien e gjuhës frënge kemi vënë re se gjatë vlerësimeve të punëve me shkrim ose testimeve të nxënësve përdoren forma korrigjimi të ndryshme si më poshtë:

- Mësuesi rimer çdo ushtrim në dërrasën e zezë dhe pyet nxënësit që kanë bërë gabime gjatë ushtrimeve.
- Mësuesi shpërndan fletoret duke komentuar gabimet me nxënësit që kanë gabuar ose që kanë zhvilluar mirë detyrën.
- Ai i pyet ata për ushtrimet në mënyrë që të sigurohet që nuk e kishin harruar detyrën e tyre, por i ishin kthyer përsëri për të riparë pjesët ose ushtrimet ku kishin gabuar.

Këto metoda korrigjimi nuk janë gjithmonë të përshtatshme, sepse kemi kuptuar që ajo që ndodh në klasë nuk iu intereson, as nuk i tërheq të gjithë nxënësit. Nxënësit që kanë dalë mirë në testim ose marrin pjesë në veprimtarinë e korrigjimit ose heshtin duke menduar “unë i di këto gjëra”. Ndryshe ndodh me të tjerët që nuk kanë përvetësuar rregullat kryesore gramatikore. Një pjesë e tyre mund të thotë me vete “sidoqoftë unë nuk do të jem kurrë i zoti t’i bëj të gjitha këto”. Për më tepër ne mendojmë se kur ora e korrigjimit kalon, pak nxënës mund t’i rikthehen çështjeve që nuk i kanë të qarta. Më tej kalohet në pjesët e tjera të mësimit dhe nxënësi që ka dalë keq në vlerësim nuk do të mund t’u rikthehet vështirësive të veta dhe të përpiqet që t’i kapërcejë ato.

Qëllimi i realizimit të korrigjimeve sipas ritmeve të të mësuarit të çdo nxënësi është që nxënësit me rezultate negative të mund të përparojnë pa u dekurajuar nga nota e marrë, ndërsa ata që kanë dalë me sukses ta shohin korrigjimin jo vetëm si një çast ku vetëm përsëriten përgjigjet e tyre të sakta. Qëllimi është që korrigjimi i një vlerësimi përfundimtar të bëhet një moment i të nxënës për çdo nxënës, pavarësisht nga nota dhe niveli i njohurive të tij.

### *1. Pikëpanjehet rreth korrigjimit*

- *Pikëpanjehet e mësuesve*

Pas një anketë të bërë me mësuesit del se në praktikën e mësimdhënies ka interes për korrigjimin e detyrave në klasë. Ky proces bëhet shpesh me të gjithë klasën ose pjesërisht duke ritrajtuar vetëm gabimet kryesore. Shumica e mësuesve kanë qëndrim

pozitiv ndaj gabimit. Kështu pjesa dërrmuese e mësuesve të anketuar ka shfaqur këto mendime rreth kësaj çështje: *Rëndësi ka shprehja e mendimeve/ korrigjimi të bëhet hap pas hapi/të ndërgjegjësohen nxënësit që t'i kuptojnë dhe të mësojnë si t'i korrigjojnë gabimet/ të stimulohen nxënësit për vetëkorrigjimin*. Por ka edhe mësues, ndonëse të pakët, që kanë qëndrim të ndryshëm për statusin e gabimit, duke e konceptuar atë si një pengesë gjatë të nxënës ose si një gabim i nxënësit. Për sa i takon vendit dhe rolit të korrigjimit të gabimeve, mendimet ishin : *Korrigjimi ndihmon nxënësin/Nxënësit mësojnë kur korrigjojnë/në shprehjen me gojë të mos ndërpriten nxënësit, të korrigjohen në fund/ të kemi kujdes nga gabimet e përsëritura/korrigjimi pa vend e frenon nxënësin*.

• *Pikëpamja e nxënësve.*

Sipas anketës së realizuar me nxënësit del se korrigjimi i detyrës është i dobishëm për të mësuar se çfarë duhet bërë për të marrë një notë të mirë si edhe për të kuptuar gabimet e veta. Shumë nxënës deklarojnë se ngrihen në dërrasë për të korrigjuar ushtrime ku kanë gabuar, por mjaft të tjerë thonë se nuk bëjnë asgjë gjatë korrigjimit të një testimi a pune me shkrim. Këto fakte venë në dukje rëndësinë që merr korrigjimi i individualizuar i gabimeve në mënyrë që t'u lejohet të gjithë nxënësve të angazhohen dhe të jenë aktivë gjatë korrigjimit.

Për më tepër, gjatë korrigjimit me të gjithë klasën, nxënësit pohojnë se i kuptojnë gabimet, por kjo mënyrë nuk i angazhon ata në korrigjim. Për këtë arsye ata do të ishin më të interesuar me një mënyrë tjetër korrigjimi, gjatë të cilës mund të rimerreshin më saktësisht gabimet e tyre dhe të ndreqeshin ato duke bërë ushtrime shtesë.

Së fundi, për nxënësit gabimi është më shpesh sinonim i dështimit ose pengesës që duhet kapërcyer. Kur flitet për gabimin, nxënësit kanë në mendje ndjenjën e dështimit, stresin, ankthin. Për këtë arsye është interesante që përpara se të mendojmë për procesin e ndreqjes ose shmangies të gabimeve, t'i përcaktojmë saktësisht ato. Mësuesit duhet të punojnë intensivisht për të thyer këto koncepte frenuese negative, së pari tek vetja e më pas tek nxënësit e tyre.

## 2. Lidhja e gabimit me modelet e të nxënës. Këndvështrim teorik.

Sipas J. P. Astolfi<sup>63</sup> çdo modeli të të nxënës i përgjigjet një status i veçantë i gabimit.

➤Kështu sipas modelit të transmetimit të njohurive ku nxënësi i grumbullon ato njëra pas tjetrës, gabimi ka status negativ.

Sipas këtij konceptimi, mësuesi e ka bërë punën e tij, por nxënësi nuk e ka përvetësuar, e ka mësuar keq çështjen apo mësimin ose nuk e ka përsëritur atë dhe gabimi ndodh për faj të tij. Puna e mësuesit konsiston atëherë në gjetjen dhe korrigjimin e gabimeve.

➤Në modelin behaviorist ku nxënësi duhet të kalojë nga një nivel njohurish tek një tjetër nëpërmjet etapave ndërmjetëse që shkojnë nga më e lehta tek më kompleksja, gabimi shihet si një anomali.

<sup>63</sup> A. J. Pierre, L'erreur, un outil pour enseigner, E. S. F. 2004

Sipas këtij modeli gjithçka është organizuar që nxënësi të shmangë gabimet duke reaguuar siç duhet në momentin e duhur. Kështu gabimet anashkalohen dhe mësuesi shpërblen suksesin e pjesshëm, duke e konsideruar gabimin si një dështim të mekanizmit. Por në këtë mënyrë nuk mund të dihet se çfarë ndodh në mendjen e nxënësit. Kështu kur ai mos të drejtohet më si më parë, nuk mund të konceptohet aspak autonomia e tij intelektuale. Edhe në këtë model statusi i gabimit është negativ, sepse gjithçka është organizuar për ta shmangur atë.

➤ Së fundi në modelin konstruktivist, gabimet nuk janë më as të dënueshme as dështime. Ato janë pengesa me të cilat ballafaqohet mendimi i nxënësit. Ato janë plotësisht pjesë përbërëse e të nxënës dhe tregojnë proceset konceptuale të nxënësit.

Cilado qoftë përgjigjja e nxënësit, gjëja e parë që duhet zbatuar është që kësaj përgjigjeje t'i jepet një kuptim dhe të kuptohet rruga intelektuale e nxënësit për të arritur tek kjo përgjigje.

Në këtë kuadër, gabimi nuk shikohet në mënyrë negative por në të kundërt ai konsiderohet si një njohuri. Këtu vihet theksi mbi veprimin e nxënësit dhe rëndësinë e proceseve “çekuilibër- riekulibrim” ku luajnë një rol kryesor konceptimet e nxënësit dhe shkëmbimet me nxënësit e tjerë.

Duke u nisur nga tri modelet e të nxënës dhe përcaktimi i gabimeve sipas tyre,

Astolfi i klasifikon gabimet në disa kategori:

a) gabime që shkaktohen nga kuptimi ose jo i kërkesave. Për arsye të mangësive në përvetësimin e leksikut nga nxënësit ose ngatërrimit të saj, fjalët e kërkesës të ushtrimit mund të mos jenë dhe aq të qarta për të gjithë nxënësit. Kështu mund të kemi kërkesën: transformoni shprehjet e mëposhtme dhe shprehni hipotezën duke ndërruar lidhëzën *si* me shprehjen lidhëzore *au cas où*.

b) gabime që vijnë si rezultat i zakoneve shkollore dhe i zbërthimit të gabuar të asaj çka pritet nga nxënësi.

c) gabim që dëshmon për konceptet alternative të nxënësit. Ky lloj gabimi ndodh gjatë gjithë periudhës së shkollimit. P. sh. nxënësit mund të kenë një mendim për vlerën e kohës së tashme të kushtores në frëngjisht përpara se mësuesi ta shpjegojë këtë temë gramatikore.

d) gabimi që lidhet me veprimet intelektuale. Këto veprime mund të duken të natyrshme ndërkohë që për nxënësin nuk janë veçse të disponueshme.

e) gabimet që kanë të bëjnë me rrugën e ndjekur. Ndërkohë që mësuesi pret një procedurë evidente, nxënësi përdor një tjetër dhe kjo është e vështirë për t'u kuptuar nga mësuesi.

f) gabimi që vjen për shkak të një mbingarkese njohëse.

g) gabimi që e ka origjinën e tij nga një disiplinë e ngjashme. Kështu shpesh konsiderohet se transferimi i njohurive nga gjuha amtare në gjuhën e huaj bëhet i natyrshëm, por në fakt nuk ndodh gjithmonë kështu me të gjithë nxënësit.

h) gabimi që shkaktohet nga vetë kompleksiteti i përmbajtjes së ushtrimit.

Pasi janë gjetur tipat e ndryshme të gabimeve të nxënësve fillon puna për trajtimin e tyre me anë të shënimeve mbi detyrën e tyre dhe kriteret e vlerësimit me synimin e realizimit të një korrigjimi të individualizuar.

### 3. Shënimet e detyrave dhe kriteret e vlerësimit.

#### 3.1. Shënimet.

Puna e mësuesit për trajtimin e gabimeve fillon me informimin e nxënësit për gabimet e bëra. J. Veslin vlerëson se shënimet mbi fletë nuk duhet të favorizojnë, por as të frenojnë qëndrimin e nxënësit që mësuesi do të dëshironte ta vëzhgonte. Fjalët e përdorura nga mësuesi duhet të jenë të lexueshme dhe të kuptueshme për nxënësin.

Kur mësuesi bën shënime, ai duhet t'i pranojë gabimet duke nënvizuar pika pozitive dhe arritje të sakta. Mësuesi duhet të zgjedhë midis gabimeve ato që janë prioritare për çdo nxënësi. Natyrisht nuk bëhet fjalë për të toleruar dhe anashkaluar gabime, por ato duhen zgjedhur në funksion të momentit, të vitit shkollor, të kompetencave dhe vështirësive të çdo nxënësi duke vënë theksin mbi objektin e punës për përmirësimin e gjendjes. Për më tepër, shënimet mbi fletën e nxënësit duhet të jenë një mjet komunikimi midis atij dhe mësuesit. Për këtë arsye mësuesi duhet t'i drejtohet nxënësit për ta motivuar, inkurajuar dhe për t'i dhënë këshilla si dhe për ta dalluar atë dhe punën e tij nga të tjerët. Të gjitha këto e çojnë mësuesin që ta konsiderojë punimin e nxënësit si një moment të veçantë të të nxënësit dhe një veprimtari komunikimi.

Në këtë mënyrë shënimet e mësuesit bëhen për nxënësin direktiva pune, sepse ato e lokalizojnë gabimin në mënyrë të qartë, saktësojnë natyrën e tij dhe orientojnë korrigjimin. Ato e nxitin nxënësin që të dallojë dhe gjejë gabimet e veta dhe pastaj të vetëkorrigjohet dhe vetëvlerësohet. Por që të arrihet kjo duhet që kriteret e vlerësimit të përcaktohen më përpara nga mësuesi dhe që ato të jenë të qarta për nxënësit. Gjatë shënimeve në fletë mësuesi mund t'i tregojë për çdo gabim nxënësit një nga kriteret.

#### 3.2. Kriteret e vlerësimit.

Një shënim është formues për nxënësin kur i tregohet se procedura që ai ka ndjekur është e drejtë, e gabuar ose ndërmjet të dyjave. Për shembull: ke përdorur gabim kushtoren pas lidhëzës *à condition que* ! Për këtë arsye duhet që mësuesi të vendosë përpara vlerësimit kriteret që do t'i lejojnë të përcaktojë nëse zgjidhja e ushtrimit është e saktë, e gabuar ose midis të dyjave dhe t'i transmetojë tek nxënësit.

Një mënyrë për të vendosur kriteret do të ishte transformimi i çdo gabimi në një kriter. Shembull : duke u nisur nga përdorimi i gabuar i *conditionnel présent*, në vend të *imparfait*, vendoset si kriter vlerësimi përdorimi i qartë dhe i saktë i tyre gjatë shprehjes së kushtit.

Një metodë e dytë do të ishte të niseshim nga kërkesa e ushtrimit që do të kishte për të realizuar nxënësi. Nëse atij do t'i kërkohej një ushtrim që synonte shprehjen e lirë, atëherë vlerësimi i gabimeve gramatikore do të kalonte në plan të dytë, duke i mëshuar më shumë pasurisë të fjalorit, saktësisë në shprehje etj. Mund të ketë dhe kriteret e tjera, por e rëndësishme është që ato t'u shpjegohen mirë nxënësve. Për më tepër nuk duhet t'u tregohen nxënësve vetëm kriteret e suksesi, sepse kjo gjë nuk do t'i ndihmonte ata të dinë se çfarë duhet të bëjnë. Sidoqoftë, është e rëndësishme që kriteret t'i shërbejnë nxënësit dhe që të kenë kuptim për të. Ne mund të përpunojmë lista kriteresh ose mund t'i ndihmojmë nxënësit që t'i zbulojnë vetë kriteret duke vëzhguar punimet dhe detyrat e nxënësve të tjerë.

Gjithë kjo punë e lejon nxënësin të ndërgjegjësohet se ajo që po bën është një situatë e të nxënësit dhe se aty ai mund të gjejë problemet që shtrohen për zgjidhje. Kjo është për të një përvojë krejt e ndryshme nga korrigjimi i thjeshtë.

Në këtë mënyrë, korrigjimi do të jetë më i individualizuar për çdo nxënës i cili do të vlerësojë ndryshe punën e tij. Duke mos qenë një objekt që nuk do të na shërbejë më tej, korrigjimi nuk do të jetë përfundimi i punës të nxënësit, por do të pasojë veprimtaritë e kaluara dhe do të jetë një trampolinë për veprimtaritë e ardhshme deri sa të shpjerë nxënësin drejt vetëvlerësimit.

Si përfundim do të thoshim se me këtë mënyrë të konceptuari të gjërave, shënimet e mësuesit do të informojnë nga njëra anë nxënësin mbi arritjet e tij dhe nga ana tjetër mbi mënyrën e tij të të vepruarit. Le të shohim më poshtë disa procedura për të ndrequr gabimet pas vlerësimit të tyre.

#### *4. Praktika korrigjimi*

Në këto rreshta do të përshkruajmë disa rrugë të ndreqjes së gabimeve të propozuara në rastin e konstruktivizmit, ose e thënë ndryshe, kur gabimi lidhet me konceptimet e nxënësit. Në këto raste nxënësi duhet ndihmuar dhe nxitur që të ndërgjegjësohet për kontraditën në rrugën midis pyetjes dhe përgjigjes. Pikërisht kjo është gjëja më e vështirë për mësuesin, të shkaktojë tek nxënësi një konflikt të brendshëm i cili do ta çojë atë në ndërtimin e një konceptimi të ri.

##### *4.1. Organizimi i bisedës shpjeguese.*

Biseda shpjeguese është një metodë e parë për të krijuar konfliktin e mësipërm. Qëllimi i saj është të nxitë nxënësin të ndërgjegjësohet për proceset që ka përdorur për të zhvilluar ushtrimin e dhënë. Gjatë saj ai do të kuptojë kontraditat e veta. Vështirësia për mësuesin është që ta lejojë nxënësin të flasë pa u përpjekur që ai t'i tregojë përgjigjen e saktë, sepse përndryshe ky i fundit veçse do të luante rolin duke thënë atë që mësuesi do të donte të dëgjonte dhe dizekuilibri nuk do të ndodhte. Në temën e shprehjes së kushtit kjo bisedë mund të përqëndrohet tek rregullat e përdorimit të lidhëzave. Kështu nxënësit mund t'i pyesim: Përse keni përdorur pas lidhëzës **si** foljen në mënyrën lidhore? A mund të përdorim me këtë lidhëzë mënyra të tjera të foljes përveç dëftores për të shprehur një kusht? Në cilën pjesë të fjalisë, në atë kryesore apo në atë të varur, përdoret mënyra kushtore në shprehjen e hipotezës? etj.

##### *4.2. Organizimi i "konflikteve" njohëse.*

Këtu bëhet fjalë për të krijuar ndërveprime midis nxënësve ku secili të shpjegojë arsyet e zgjedhjes së një forme të caktuar nga ai, t'i ballafaqojë me ato që kanë zgjedhur të tjerët dhe të argumentojë përse zgjedhja e tij është e drejtë. Por që kjo të realizohet në çastin e korrigjimit të vlerësimit të individualizuar, duhet që grupet e nxënësve të ndërtohen në mënyrë homogjene.

Leximet e detyrës ose testimit duhet të venë në dukje rolin kryesor të analizës së gabimeve të bëra nga vetë nxënësi si edhe efikasitetin dhe karakterin individual të korrigjimit. Është me rëndësi themelore që nxënësi të mund të njohë kriteret përpara një vlerësimi, në mënyrë që, në momentin e korrigjimit, të mund të bëjë më mirë lidhjen midis gabimeve të veta dhe përgjigjeve të sakta.

Së fundi, është me rëndësi që nxënësi të mund të shpjegojë gjatë një ballafaqimi me nxënës të tjerë, arsyet për të cilat ai mendon se përgjigja e tij është e saktë, duke krahasuar njohuritë e tij me të tjerët dhe duke i vënë ato në pikëpyetje nëse duhet.

### 4.3. Eksperimentimi

#### ➤ *Puna me gabimet. Analiza apriori.*

Në fillim bëhet një punë paraprake me nxënësit për tipat e ndryshëm të gabimeve, në mënyrë që të individualizohet sa më shumë korrigjimi. Pas kësaj pune çdo nxënës do të marrë kopjen e tij të detyrës pasi ajo të jetë korrigjuar nga mësuesi. Duke u nisur nga gabimi i bërë, ai do të përpiket ta analizojë atë. Në fazën e parë, ai do të përpiket të kuptojë dhe më pas të shpjegojë arsyetimin e vet, për të arritur tek përgjigja që ka dhënë duke gjetur se në çfarë kategorie mund të klasifikohet gabimi i tij (mosnjohje e zgjedhimit të foljes; ngatërrim i mbaresave midis kohës *imparfait* dhe *conditionnel présent*; ngatërrim i kuptimit ose vlerave të përdorimit të lidhëzave; mospërvetësim i rregullave të bashkëveprimit të lidhëzave me foljet etj). Në fazën e dytë ai do të mendojë për rrugën që duhej ndjekur për të arritur tek përgjigja e saktë duke vënë në pah gabimet që ka bërë gjatë arsytimit të parë.

Pra duke analizuar në këtë mënyrë gabimet e tij, duke pasur parasysh listën që do të ketë formuluar me të tjerët, nxënësi do të mund që jo vetëm të jetë në gjendje t'i korrigjojë ato, por edhe të rikrijojë koncepte të reja dhe sidomos të arrijë një korrigjim sa më të përshtatshëm me vështirësitë dhe pengesat e tij.

#### ➤ *Organizimi.*

Gjatë seancës mësimore që i paraprin dhënies së rezultateve të punës me shkrim, punohet me tipat e ndryshëm të gabimeve duke u nisur nga shembujt që mësuesi kishte nxjerrë nga fletët e testeve.

Pastaj çdo nxënës merr në dorë detyrën e vet me shënime dhe korrigjime “të paplota” nga mësuesi. Kjo do të thotë që ishte vënë shënimi ose shenja “mirë ose shumë mirë” për përgjigjet e sakta, ndërsa për gabimet e bëra sinjalizimi do të ishte vetëm me një nëvizim ose me shënimin “përgjigje jo e plotë”, “përgjigje e gabuar” ose thjesht G=gabim. Kjo nënkuptonte që nxënësi vetë duhet të përpiquej të gjente zgjidhjen e saktë për çdo shembull të gabuar.

Në një moment më pas secili nga nxënësit do të shënonte në një fletë të veçantë arritjet dhe gabimet e tij. Në të njëjtën fletë ai do të ndërtonte tre kolona për secilën fjalë dhe atje ku ka gabuar do të shënonte :

- në kolonën e parë përgjigjen e dhënë;
- në të dytën korrigjimin e saj ;
- në të tretën tipin e gabimit që kishte bërë duke u nisur nga klasifikimi i bërë më përpara.

Në fund nxënësi do të përpiquej të shpjegonte se përse përgjigja e tij nuk ishte e saktë.

#### ➤ *Përshkrimi dhe zhvillimi.*

Puna e parë që ka të bëjë me përpunimin e listës së tipave të ndryshëm të gabimeve bëhet duke e ndarë klasën në dy grupe. Fillohet duke i pyetur studentët se cili



mund të jetë shkak i një gabimi në shprehjen e kushtit dhe të hipotezës në frëngjisht. Ata përmendën disa shkaqe si :

- keqkuptimi i kërkesës të ushtrimit;
- mospërvetësimi i zgjedhimit të foljeve, sidomos të atyre të parregullta në mënyrën kushtore;
- ngatërrimi i zgjedhimit të foljeve në kushtore me kohën e ardhme të dëftores meqënëse janë shumë të ngjashme;
- ngatërrimi i vlerave të përdorimit të lidhëzave;

Studentët përdorën shprehje si: “ Kjo temë është shumë e vështirë. Nuk na kujtohet. Këto i kemi harruar dhe në shqip” etj. Por ata nuk kishin propozime ose mendime të tjera. Atëherë propozohen shembuj të tjerë me gabime të bëra nga ata vetë për të ilustruar tipe gabimesh që ata mund t’i kishin bërë pa arritur që t’i shpjegojnë pse pa gjetur dot origjinën. Ishte një punë e vështirë për studentët. Më pas u dhanë punimet e korrigjuara dhe u shpjegua mënyrën e korrigjimit. Për studentët me më shumë vështirësi kjo lloj veprimtarie është realizuar gjatë një seance pune të veçantë për analizën e gabimeve. Kështu, për t’i ndërgjegjësuar për format e gabuara organizuam me grupin që dallonte me vështirësi kushtoren nga e pakryera e dëftores ushtrimin gojor të mëposhtëm: Ata duhet të formulonin hipoteza me strukturën *si+imparfait + conditionnel présent*, në fjalitë ku qëllimisht ishte zgjedhur e njëjta folje që do të përdorej në të dy format. Studentët u ndamë në grupe dyshe. I pari do të vendoste foljet në formën e duhur; tjetri do të dëgjonte dhe korrigjonte shokun sipas modelit të korrigjuar që ka marrë nga mësuesi. Pas një etape të parë ata do të ndërronin rolet.

Qëllimi i kësaj veprimtarie ishte të automatizoheshin elementet e përdorimit të *imparfait + conditionnel présent* në shprehjen e hipotezës dhe njëkohësisht të korrigjoheshin disa gabime. Po paraqesim disa shembuj të dhënë: 1. *Si mon frère(ne pas être) informaticien, / (être) journaliste.* 2. *Si vous (vouloir) assister à cette reception, / (vouloir)-vous bien nous le faire savoir?* 3. *Si on (dire) toujours ce que l’on pense, / on (dire) souvent des choses désagréables.*

#### ➤ *Analizë: lidhja me problematikën.*

Puna e parë për përpunimin e tipave të ndryshme të gabimeve i ndihmoi studentët të analizonin një gabim konkret, megjithëse ata kishin vështirësi në përdorimin për këtë qëllim të fletës së tyre. Por nuk duhet të çuditemi për këtë sepse duhet punuar me listën e gabimeve sa herë që një gabim ndodh. Vështirësia më e madhe për një nxënës është që të karakterizojë një gabim të vetin.

Në fakt puna e dytë e studentëve kur korrigjimi bëhej për gabimet konkrete të secilit u zhvillua me interes prej tyre. Ata ishin të interesuar për analizën dhe shpjegimin e gabimeve të tyre. Megjithëse disa nuk arritën realisht të analizonin gabimet e tyre por thjesht vetëm i përshkruan, kjo veprimtari ngjalli interes. Duke e shpjeguar arsyetimin që të çon tek përgjigjja e gabuar, ata mund të kuptojnë më mirë nocionin ose temën gramatikore që nuk e kishin përvetësuar. Ky korrigjim i individualizuar i’u dha mundësi studentëve të reflektojnë mbi statusin “formues” të gabimit, sepse gjatë kësaj veprimtarie theksi u vu edhe mbi arritjet e tyre megjithëse vlerësimi me notë mund të ishte jo i mirë. Megjithëse të gjithë nuk arrijnë akoma të analizojnë në mënyrë të saktë gabimet dhe të gjejnë origjinën e tyre, na duket interesant fakti që ata arritën të shprehen për këtë problem. Gjatë eksperimentimit të dytë u synua që të vazhdohej puna reflektuese mbi

statusin e gabimit e cila ishte filluar nga studentët në fazën e parë, por me synimin për të punuar gjithashtu mbi kriteret e vlerësimit.

##### 5. *Ekspërimëtimi i dytë. Puna mbi kriteret e vlerësimit dhe mbi gabimet.*

###### *a. Analiza apriori.*

Puna e bërë gjatë eksperimentit të parë u vazhduar në një formë tjetër gjatë korrigjimit të detyrës së ardhshme. Për këtë u përpoqëm të ndërtojmë punën rreth kriterëve të vlerësimit përpara kryerjes së testimit.

Duke marrë pikënisjen nga ushtrime të zhvilluara në klasë studentët do të përpunonin një tabelë me kompetencat që duhen zotëruar në shprehjen e hipotezës në frëngjisht. Me përcaktimin e njohurive që duhen përvetësuar dhe aftësive që ata duhet të zotërojnë për këtë temë të rëndësishme, ata do të përcaktojnë dhe metodat e të nxënës. Tabela e kompetencave do të ketë dy funksione në momente të ndryshme të të nxënës: në fillim ajo do t'u shërbejë atyre për të theksuar qartë çështjet kryesore që do të përvetësojnë gjatë orëve, ndërsa më vonë ajo do të jetë një reference gjatë korrigjimit. Nëse kompetenca do të zotërohet, ata do të shprehin saktë marrëdhënien sintaksore të hipotezës në komunikim; në të kundërt, ata do të dinë me saktësi se në ç'pikë duhet të punojnë për ta realizuar atë pa gabime. Përpunimi i tabelës në fjalë duhet bërë sa më shumë që të jetë e mundur nga vetë studentët, sepse duke njohur vetë kompetencat që duhet të fitojnë, ata do t'i zotërojnë më mirë. Kështu në tabelën që studentët, ndërtuan në lidhje me kompetencat që ata zotëronin për shprehjen e kushtit dhe të hipotezës në frëngjisht ishin:

- ✓ Përvetësimi i zgjedhimit të foljeve në kushtore.
- ✓ Përvetësimi i mirë i kohëve të ndryshme të mënyrës dëftore si *imparfait*, *plus-que-parfait*, etj.
- ✓ Përvetësimi i saktë i kuptimit dhe përdorimit të lidhëzave që shërbejnë për të ndërtuar shprehjen e kushtit në frëngjisht.
- ✓ Përvetësimi i rregullave të bashkëveprimit të lidhëzave me foljet.
- ✓ Dallimi i qartë i mbaresave të kohës së pakryer të dëftores, nga ato të kohës së tashme të kushtores, në mënyrë që mos ngatërrohen.
- ✓ Konceptimi i qartë i hipotezës të realizueshme apo të përealizueshme duke e parë këtë fenomen të lidhur ngushtë me kohët e foljeve por dhe kryesisht me kuptimin e fjalisë.
- ✓ Dallimi i qartë i mbaresave të kohës së ardhme të dëftores, nga ato të kohës së tashme të kushtores, në mënyrë që mos ngatërrohen.

Pas plotësimit individual të tabelës nga çdo nxënës u hartua tabela përmbledhëse e cila kishte si kampion studimi një grup prej tridhjetë studentësh.

***Tabelë sintetike e kompetencave të zotëruara nga studentët në shprehjen e kushtit dhe hipotezës.***

| <b><i>Kompetenca që zotërohet nga nxënësit</i></b>                           | <b><i>Shkalla e zotërimit të kompetencës sipas numrit të nxënësve.</i></b> |                           |                    |                          |
|------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------|---------------------------|--------------------|--------------------------|
|                                                                              | <b><i>Dobët</i></b>                                                        | <b><i>Mjaftueshëm</i></b> | <b><i>Mirë</i></b> | <b><i>Shumë mirë</i></b> |
| Njihet dhe përdoret kushtorja e tashme dhe e shkuar e foljeve                | 3                                                                          | 7                         | 15                 | 5                        |
| Njihet dhe përdoret koha e pakryer e dëftores                                | 3                                                                          | 5                         | 10                 | 12                       |
| Njihet dhe përdoret më se e kryera e dëftores                                | 2                                                                          | 10                        | 11                 | 7                        |
| Njihet dhe përdoret e kryera e dëftores                                      | 4                                                                          | 7                         | 9                  | 10                       |
| Zotërohet kuptimi i lidhëzave nënrenditëse hipotetike                        | 5                                                                          | 9                         | 10                 | 6                        |
| Dallohet kushtorja nga e ardhmja e dëftores                                  | 3                                                                          | 9                         | 12                 | 6                        |
| Dallohen mbaresat e të pakryerës nga ato të të tashmes të kushtores          | 4                                                                          | 10                        | 11                 | 5                        |
| Njihen rregullat e bashkëveprimit të lidhëzave me kohën dhe mënyrën e foljes | 4                                                                          | 10                        | 9                  | 7                        |
| Bëhet dallimi në përdorimin e kushtores së tashme dhe të shkuar të foljeve   | 3                                                                          | 8                         | 11                 | 8                        |

Gjatë korrigjimit secili do të kryejë analizën e gabimeve duke u udhëhequr nga tabela e kompetencave që ka plotësuar. Kështu ai do të kuptojë nëse i zotëron realisht ato ose do të përpiqet të shpjegojë se përse përgjigja e tij është e pasaktë. Në këtë mënyrë korrigjimi do të jetë i individualizuar dhe çdo student do të përparojë gjatë të nxënës duke u interesuar për shkakun e gabimeve të veta.

#### ***b. Organizimi***

Gjatë orëve të mësimi që i paraprinë testimit, studentëve iu paraqit puna që ata duhet të bënin për ta përgatitur. Ata duhet të ishin të aftë t'i përgjigjeshin pyetjes: Çfarë mbani mend nga përdorimi dhe vlerat e mënyrës kushtore? Çfarë duhet të dini rreth funksioneve të kohëve dhe mënyrave të foljes në shprehjen e hipotezës? Ç'lidhje ekziston midis lidhëzave të ndryshme dhe mënyrës së foljes së fjalisë së varur dhe asaj kryesore ?

Nëse ata nuk janë në gjendje t'u përgjigjen këtyre pyetjeve u tërhiqet vëmendja për çështjet e paqarta.

Gjatë përvojës së dytë të eksperimentit për analizën e gabimeve u vu re një zhvillim pozitiv tek nxënësit. Ata e kishin kuptuar se nuk duhet të mjaftohemi me përshkrimin e gabimeve, por të shkohet më tej duke u përpjekur të shpjegohet arsytimi i tyre dhe dobësitë e tij. Ata filluan të ndërgjegjësohen që nuk duhet të përqëndrohen më vetëm mbi gabimet “ ku ata nuk kanë marrë pikë në vlerësim”, por të përpiqen të kuptojnë përse kanë gabuar gjatë arsytimit të tyre në mënyrë që të mos e përsëritin më të njëjtin gabim në të ardhmen.

Pas këtyre dy përvojave ku studentët u përballën vetëm me gabimet e tyre mund të zbatohet dhe një mënyrë tjetër korrigjimi, ai me grupe, i cili u lejon nxënësve të diskutojnë me njëri-tjetrin për gabimet e bëra. Kjo formë ka rëndësinë e vet, sepse në grup nxënësit mund të shkëmbejnë mendime mbi të njëjtën fjalë ose formë të gabuar duke ballafaquar shpjegimet e tyre.

Për të ruajtur gjithmonë karakteristikat e korrigjimit të individualizuar duhet që grupet të jenë homogjene duke mbledhur në një grup nxënësit që kanë patur të njëjtat vështirësi në të njëjtat ushtrime të detyrës mbi shprehjen e hipotezës. Duke patur parasysht numrin e ushtrimeve të dhëna p. sh. pesë, mund të formohen po aq grupe me nxënës. Mund të zbatohet dhe praktika e vendosjes tek grupi i parë i nxënësve që kanë më shumë vështirësi dhe tek grupi i fundit i atyre që shfaqin më pak vështirësi se ata të grupeve paraardhëse. Kështu ne vendosëm në grupin e parë nxënësit që kishin më shumë vështirësi në përdorimin e saktë të kushtores së tashme të foljeve të parregullta. Pasi mësuesi korrigjon detyrat, ndërton grupe me studentë që kanë gabuar tek i njëjti ushtrim duke iu kërkuar të gjejnë gabimet e bëra, t'i korrigjojnë dhe më pas t'i analizojnë.

Puna me grupe homogjene për të njëjtën zgjedhje të saktë të formave foljore, do t'i lejojë ata të ballafaqojnë shpjegimet dhe analizat e tyre. Ajo do t'u krijojë mundësi studentëve në vështirësi për një çështje, të dëgjonin një përgjigje të saktë nga të tjerët, sepse mësuesi nuk mund të luajë rolin e bashkëbiseduesit për një veprimtari me të gjithë. Secili nga grupet do të përqëndrohet vetëm në një ushtrim duke gjetur gabimet, duke i analizuar dhe shpjeguar ato dhe duke propozuar më pas një variant të vetin të saktë. Kështu për një nga grupet me studentë më të dobët se të tjerët u dha si detyrë korrigjimi i ushtrimit ku nxënësit duhet vetëm të gjenin dhe rrethonin përgjigjen e saktë pa dhënë ndonjë argument për të.

Një student nga secili grup do të paraqesë korrigjimin e bërë dhe do të vejë në dukje gabimet. Kjo formë do të gjallërojë klasën, sepse çdo grup do të vlerësohet për analizën dhe punën e bërë. Gjatë kësaj veprimtarie roli i mësuesit është të udhëheqë pa ndërhyrë duke i lënë ata të shkëmbejnë sa më shumë mendime për të bindur njëri-tjetrin. Kjo formë pune është pozitive për të nxënësit e studentëve.

### **Përfundime**

Me sa pamë më sipër duket qartë se korrigjimi pas vlerësimit të punëve me shkrim duhet të jetë sa më i përshtatur me nivelin dhe veçoritë e studentëve, në mënyrë që ata të përparojnë në të nxënësit e tyre. Për këtë arsye analiza e gabimeve dhe e origjinës së tyre nga vetë ata është themelore, por ajo ende ngelet një punë e vështirë për të. Kjo metodë pune duhet praktikuar sa më herët duke synuar që analiza të arrijë të bëhet plotësisht nga ata vetë. Fitimi i refleksive nga ana e studentëve, për të ngritur pyetje sa herë që shfaqet një gabim, është një punë mjaft e vështirë. Megjithatë është e rëndësishme

që ata të kuptojnë interesin e shpjegimit prej tyre të gabimeve gjatë rrugës së të nxënit dhe të ndërgjegjësohen se ato nuk janë të dënueshme, por janë tregues të gjendjes së të nxënit të tyre dhe njëkohësisht mjete për të ecur përpara.

Hulumtimi dhe paraqitja e qëndrimeve të ndryshme të mësuesve dhe nxënësve ndaj problemeve që lidhen me mësimdhënien e shprehjes së kushtit janë sintezë e vlerësimit të përgjigjeve të pyetësorëve të realizuar me një popullsi të gjërë të nxënësve, studentëve dhe mësuesve të gjuhës frënge.

## **Referencat**

Tagliante. Ch. La classe de langue, Paris, CLE International, 1994.

Germain. C. Evolution de l'enseignement des langues. 5000 ans d'histoire. CLE International, Paris, 1993.

Jamet. Ch. Contrastivité et enseignement du français langue étrangère en France. Thèse de doctorat, Université Lumière, Lyon 2, 2000.

Corbellari. M. L'histoire de l'éducation de nouvelles acquisitions. Paris, CLE international, 2001.

Kuadri i Përbashkët Evropian i Referencave për Gjuhët, 2006.

Larry. M. M. L'interprétation de l'erreur, CLE International, 2003.

Pendaux. M. Les activités d'apprentissage en langue étrangère. Hachette, 1996.

Lamy. A. Mes rendez-vous avec la faute. F. D. M, n 185, 1984.

**KUMTESA NGA SESIONI SHKENCOR**  
**“MIHAL GRAMENO DHE KONTRIBUTI I TIJ SI NJË NDËR**  
**PUBLICISTËT E PARË TË GAZETARISË SHQIPTARE”**



# MIHAL GRAMENO DHE KONTRIBUTI I TIJ, SI NJË NDËR PUBLICISËT E PARË TË GAZETARISË SHQIPTARE

Dion Tushi

Departamenti i gjuhës dhe i letërsisë, Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, Universiteti  
“Fan S. Noli” Korce

## Përmbledhje

Mihal Grameno nëpërmjet penës së tij dha një kontribut tepër të çmuar edhe në publicistikë. Periodikët e themeluar dhe të drejtuar prej tij, si tribuna të mendimit qytetar korçar, kanë luajtur një rol të madh në emancipimin e gazetarisë të sapokrijaur në gjuhën shqipe në Shqipëri.

Në faqet e kësaj gazete prej M. Gramenos, u pasqyruan me realizëm dhe profesionalizëm ngjarje të rëndësishme kulturore dhe patriotike, si Kongresi i Manastirit, ku në mënyrë të detajuar jepen objektivat dhe arritjet e tij, si dhe delegatët e Korçës, Kongresi i Dibrës, rrethanat në të cilat u thirr ai etj. Por mbi të gjitha, në publicistikën e Gramenos, një vend të rëndësishëm zë kultura dhe sidomos letërsia. Dy gazetatat e tij mund t’ju shërbejnë akoma studiuesve të letërsisë si burime të rëndësishme për hulumtimin e zhvillimeve letrare në Periudhën e Pavarësisë, por po ashtu edhe historianëve.

**Fjalë çelës:** Mihal Grameno, gazeta “Lidhja Orthodhokse”, “Koha”.

## Abstract

Mihal Grameno through his pen gave a priceless contribution in journalism. Periodicals founded and run by him, as tribune opinion Korça citizen, have played a major role in the emancipation of journalism in Albania.

In the pages of this newspaper of M. Grameno was covered with realism and professionalism important cultural and patriotic events, such as the Congress of Monastir, where details are given objectives and achievements, as well as delegates of Korca, Debar Congress, the circumstances in which he was called, etc. Two of his papers can serve even scholarly literature as important sources for researching literary developments in the Period of Independence, but also historians.

**Key words:** Mihal Grameno newspapers, Orthodox League, Time.

Mihal Grameno nëpërmjet penës së tij dha një kontribut tepër të çmuar edhe në publicistikë. Periodikët e themeluar dhe të drejtuar prej tij, si tribuna të mendimit qytetar korçar, kanë luajtur një rol të madh në emancipimin e gazetarisë të sapokrijaur në gjuhën shqipe në Shqipëri.

Kështu, mbas reformave që ndodhën në Perandorinë Osmane dhe shpalljes së Hyrjetit në vitin 1908, patriotët shqiptarë u përpoqën ta shfrytëzonin në dobi të çështjes shqiptare, çdo liri dhe të drejtë që buronte prej kushtetutës së re të Xhonturqve. Në këtë



kohë, për vetë kushtet dhe rrethanat sociale, ndërgjegjësimi me idetë shqiptariste, kërkonte një infrastrukturë të posaçme, ku sigurisht një rol kryesor do të luante edhe shtypi. Pikërisht, këtë periudhë lirie relative shfrytëzoi edhe M. Grameno, për të krijuar në Mars të vitit 1909, një ndër gazetatat e para në Korçë dhe në Shqipëri në gjuhën shqipe, të përdyjavshmen politike, fetare dhe letrare “Lidhja Orthodhokse”, që së bashku me gazetën “Korça” të drejtuar nga Sami bej Pojani, dalë dhe kjo pothuajse në të njëjtën kohë, në Dhjetor 1908, i kanë shërbyer ndërgjegjësimit kombëtar nëpërmjet informimit, të korçarëve patriotë brenda dhe jashtë atdheut.

Në një qytet si Korça, ku publicistika kishte filluar të lëvrohej me sukses që nga fundi i shekullit të XIX – të, pavarësisht gjuhës së këtyre periodikëve, kujtojmë këtu revistën e karakterit filologjik “Pellazgos” të filologut dhe shkrimtarit Kostandin Skënderi, me një klasë qytetare të emancipuar për kohën, me lice, arsim të mesëm, të konsoliduar qysh në vitet dyzet të shekullit të XIX – të, dhe me një grup të zgjeruar intelektualësh dhe biznesmenësh të studiuar jashtë, prezantimi i një periodiku, aq më tepër në gjuhën shqipe, përbënte për botuesin një sfidë intelektuale, e cila duhej që të përballohej denjësisht.

Për hir të së vërtetës, duhet thënë se duke patur parasysh të gjitha numrat e “Lidhjes Orthodhokse”, deri në fund të vitit 1910 dhe më pas gazetën “Koha” që vjen për të zëvendësuar këtë të fundit, deri në vitin 1926, mund të themi se M. Grameno dhe më pas i vëllai i tij Koço Grameno, që qysh prej Nëntorit të vitit 1920 mori drejtimin e gazetës, e përballouan me shumë profesionalizëm dhe përkushtim këtë sfidë. Kështu ai nxorri një gazetë të denjë për Korçën dhe e vendosi veten në rradhën e parë të pionerëve të gazetarisë cilësore shqiptare.

Që në numrin e parë të “Lidhjes Orthodhokse”, të bën përshtypje alfabeti i përdorur Latino - Cirilik, tepër i thjeshtë dhe i suksesshëm për kohën, i cili as sot nuk krijon vështirësi për lexuesit. Gjuha e qëmtuar, bazuar në dialektin tosk, në të folurën e Korçës, është tepër shprehëse e lakuar dhe e përdorur mjeshtërisht, ku toni i publicistit të formuar vendoset tërësisht në sfondin e stilit të shkrimtarit, duke i dhënë shpesh gjuhës ngjyra të veçanta stilistike.

Në këtë periodik, të bëjnë përshtypje artikujt e karakterit politik, të cilat tregojnë se Gramenoja më tepër se një gazetar ka qenë një analist i mirëorientuar në një plan ndërkombëtar, këta artikuj, së bashku me artikujt e karakterit shoqëror, religjioz dhe letrar, janë sot burime të rëndësishme të mirëfillta për historinë e shoqërisë, arsimin, kulturës, gazetarisë dhe religjionit të qytetit të Korçës dhe vendit në përgjithësi.

Në planin politik, kjo gazetë shfaqet si përkrhëse e politikës së ndryshimeve të Perandorisë, ajo në vijën e saj është përgjithësisht pro politikës Otomane në vend, të ndjekur prej xhonturqve. (LO 1909: 2) Në artikujt politikë, përshkruhet aktiviteti politik

në dobi të çështjes së zgjimit kombëtar dhe ruajtjes e kultivimit të gjuhës, i partive dhe deputetëve të Korçës dhe zonave të tjera të Shqipërisë, të cilët merrnin pjesë në parlamentin turk. Sipas artikujve të kësaj gazete, autoritete të lartë të Portës, me origjinë e ndërgjegje kombëtare, organizohen dhe kërkojnë gjithmonë e më tepër të drejta për vendin, duke theksuar pothuajse në të gjitha rastet, detyrimet që Porta e Lartë ju ka shqiptarëve për mbështetjen që ata i kanë dhënë historikisht përgjatë shumë shekujve. Fjalimet në parlamentin turk, të personaliteteve të tillë si Hasan Prishtina Bajo Topullit Dervish Hima, Abdyl Hypi (LO 1909 31 korrik) etj dhe mënyra e komentimit nga Grameno, të lënë të kuptosh, se tashme klasa e re nacionaliste shqiptare që po shfaqej, shpresonte se Perandoria turke do ta kompensonte ndihmën që ata i kishin dhënë Perandorisë Otomane, nëpërmjet lirive dhe mbrojtjes që kjo e fundit do tu bënte sidomos ndaj shovinizmit fqinj.

Nëse kjo ishte linja e ndjekur nga Grameno në pasqyrimin e politikës së jashtme, ku një vend të rëndësishëm zinin gjithashtu dhe komentet e shtypit perëndimor, austriak, italian dhe atij amerikan, për çështjen shqiptare në përgjithësi, të cilat pasqyroheshin me një korrektesë të lartë përkthimi si tek “Lidhja Orthodhokse”, po ashtu edhe tek “Koha”, materiali religjioz i servirur në gazetatat e tij, ishte gjithnjë në funksion të idesë së shqiptarizmit, shkëputjes nga varësia e politikës së Megaloidhesë, që propogandohej edhe nëpërmjet religjionit, dhe që për hir të së vërtetës, kishte mbështetës të shumtë në shtresën e borgjezisë së lartë korçare.

Në krye të gazetës “Lidhjes Orthodhokse”, në krah të djathtë të saj ishte vendosur sentenca e Gramenos, se “cili nuk do fenë nuk do as atdhenë”, e cila mund të themi se ka shërbyer si devizë e botuesit. Kështu, këtu motivi patriotik i “Varrit të pagëzimit”, shprehet nëpërmjet propogandimit të gjithçkaje që ka të bëjë me një kishë kombëtare në shërbim të emancipimit kombëtar. Një rubrikë e rëndësishme në këtë kontekst ka qenë edhe pasqyrimi i aktivitetit liturgjik dhe botues të Fan Nolit dhe klerikëve të tjerë shqiptarë në diasporë.

I ndërgjegjshëm për rolin që feja luante në ndërgjegjen e bashkëqytetarëve të tij, Gramenoja, kapërceu kuadrin e religjionit tradicional orthodhoks, duke përshkruar në gazetën e tij, aktivitetet e shkollës shqipe protestante të vashave, apo aktivitet e ndryshme të shkollave të komunitetit myslyman, gjithmonë në kuadër të çështjes kombëtare. Kemi parasysh këtu paqsyrimin e grevës së nxënësve të Idadies (Gjimnazit myslyman) të Korçës, kundër vendimit të brendshëm që u mor atje, për të hequr alfabetin latino – cirilik dhe për të futur atë me gërma arabe, ku nga nxënësit u vu në dijeni Vilajeti dhe inspektori i arsimit në Manastir. Nga gazeta mësojmë se në këtë lëvizje përkrah nxënësve ishin edhe shumë mësues të këtij institucioni, midis të cilëve edhe Mihal Grameno dhe Nisi Themeli, (L O9 1909Shkurt: 4) që jepnin mësim në këtë shkollë. Do të jetë kjo lëvizje, ajo e cila do ti paraprinte Mitingut të Shkronjave, që do të organizohej pak më vonë po në qytetin e Korçës. Apo pasqyrimi i aktiviteteve të shoqërisë protestante “Ylli i

Mëngjezit”, kryesuar nga mësuesja Parashqevi Qiriazi, si dhe komentimi i aktiviteteteve tek “Lidhja Orthodhokse” në ditën e lutjeve për studentët, organizuar në shkollën shqipe protestante të vashave, nga komisioni kristian protestant i përfaqësuar nga zonja Kenedi, në 2 Shkurt të vitit 1912. (Koha, , 24 Mars: 4)

Në faqet e kësaj gazete prej M. Gramenos, u pasqyruan me realizëm dhe profesionalizëm ngjarje të rëndësishme kulturore dhe patriotike, si Kongresi i Manastirit, ku në mënyrë të detajuar jepen objektivat dhe arritjet e tij, si dhe delegatët e Korçës, Kongresi i Dibrës, rrethanat në të cilat u thirr ai, ku theksohet se pa praninë e delegatit nga Korça Abdyl Ypi, ky eveniment nuk do të kishte asnjë përfundim, apo edhe Mitingu i Shkronjave.

Por mbi të gjitha, në publicistikën e Gramenos, një vend të rëndësishëm zë kultura dhe sidomos letërsia. Dy gazetat e tij mund t’ju shërbejnë akoma studiuesve të letërsisë si burime të rëndësishme për hulumtimin e zhvillimeve letrare në Periudhën e Pavarësisë, por po ashtu edhe historianëve,

Në këto gazeta, gjejmë të botuara disa tregime pak të njohura të M Gramenos, prej të cilave mund të përmendim rrëfenjën “Gazetari Shqiptar”, “Lesharta”, “Tregimi i Kërshëndellave”, “Kujtime nga Burgu” (L O, 1909 Korrik; Koha 1912, qershor) etj, tepër interesante për nga mënyra e kompozicionit, ku motivet patriotike dhe lirike që mbart në vetvete kjo gjini, shprehen nëpërmjet stilit romantiko sentimental, karakteristike për prozën e tij. (H L Sh, 1983: 464)

Gjithashtu krahas tregimeve të lëvruara prej Gramenos, faqja letrare e “Lidhjes Orthodhokse” dhe “Kohës”, ka patur edhe përkthime nga letërsia e huaj evropiane, të bëra nga përkthyes korçarë, prej të cilave përmedim tragjeditë e Shekspir, apo pjesë nga letërsia franceze, bile dhe kritikë letrare anglze bashkëkohore, si bie fjala në lidhje me veprën e Tolstoj, të përkthyer këto përkatësisht nga Loni Progri, Nestor Frashëri dhe Grigor Cilka.

Informacionet që marrim nga këto gazeta, janë një tregues i shkallës së lartë të qytetarisë në Korçë dhe shërbejnë siç e theksuam më lart edhe si burime për hulumtuesit.

Jashtë gazetave të Gramenos, nuk mbeti pa u përfshirë as albanologjia, sidomos teza e prejardhjes pellazgjike të gjuhës shqipe, aq dominuese në këtë periudhë, e përsëritur me forcë prej atdhetarëve patriotë. Kështu, ai boton artikuj me përmbledhje nga vepra studimore “Mbi prejardhjen e Shqiptarëve” të Kristo Dakos, si dhe përmbledhje nga teoria e prejardhjes së gjuhës shqipe, të helenistit dhe albanologut të njohur gjerman Max Muller. Tepër interesante gjithashtu janë të dhënat që jepen në këto gazeta, mbi intelektualët korçarë dhe kontributin e tyre në fushën e përkthimit, si bie fjala komentimi që i bëhet punës përkthimore të intelektualit Nikolla Zografi, i cili sipas informacionit që

na jepet, kishte përkthyer në gjuhën shqipe që nga mesi i shekullit të XIX – të, Ungjinjtë dhe liturgjitë që këndoheshin në Mitropolinë e Korçës, si dhe fakte të tjera të rëndësishme të kësaj natyre

Tepër interesant është dhe informacioni që marrim për krijimin e shkollës së parë shqipe të natës në Korçë, prej mësuesit patriot Dhimitër Berati, në vitin 1910. Në faqet e gazetës “Lidhja Orthodhokse”, shfaqet për herë të parë edhe emri i studiuesit të palodhur korçar Ilo Mitkë Qafzezi, si përkthyes dhe si vjershëtor, me një përkthim të një poeme bizantine për Shën Marinë, si dhe me një krijim origjinal të frymëzuar nga arrdhja e Vitit të Ri.

Nga sa u tha, arrihet në konkluzionin se Gramenoja ka meritën e themelimit të publicistikës shqiptare në qytetin e Korçës, dhe konsiderohet me të drejtë si një nga kontribuesit më të zellshëm dhe më të talentuar të gazetarisë shqiptare në fillimet e saj. Do të ishte kjo traditë e krijuar prej tij, që do shërbente si bazë për daljen e gazetave dhe revistave të tjera cilësore në qytetin e Korçës, prej të cilave përmendim Kalendarin e Korçës (1910 – 1930) të Mihal Xoxit dhe Jani Kremos, Xgjimin (1913 – 1914) dhe më pas Adriatikun (1916 – 1917) të Dhorit Kotit, Rilindjen e Pandi Frashërit (1920 – 1935), Gaztën e Korçës (1916 – 1939) e Vangjelit dhe Gorguzit, Shqiptarin e Amerikës, që filloi të botohet në Korçë mbas ndalimit të futjes së gazetës “Dielli”, si dhe revistën prestigjioze letrare “Bota e Re” të G. Evangjelit. Në të cilat do të shkruanin pothuajse pa përjashtim të gjithë ata që më pas do të konsideroheshin si intelektualët më në zë të vendit. Po të kemi parasysh këtu dhe gazetat e huaja dhe ato shqiptare që dilnin jashtë vendit, në të cilat korçarët kanë qenë të abonuar, kuptohet lehtësisht se kemi të bëjmë me një qytet kozmopolit edhe përse i përket shtypit dhe informacionit të qytetarëve.

Produkt dhe faktor i këtij qytetërimi ka qenë pa dyshim edhe Mihal Gramenoja, kontributi i të cilit, në fushën e publicistikës konsiderohet tepër i çmuar dhe origjinal.

## **Referencat**

Historia e Letërsisë Shqiptare, 1983, Tiranë.

Koha, 1911 – 1924.

Lidhja Orthodhokse, 1909 – 1910.

# VEÇORITË SINTAKSORE TË NDËRTIMEVE GJUHËSORE NË PROZËN E GRAMENOS

Elona (Biba) Çeçe

Departamenti i gjuhës dhe i letërsisë, Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, Universiteti  
“Fan S. Noli” Korçë

## Përmbledhje

Vepra e shkrimtarit dhe publicistit Mihal Grameno, përfaqëson tiparet e variantit letrar të toskërishtes të dhjetëvjeçarit të parë të shek. XX. Përmes analizës të hollësishme, konstatojmë këto veçori sintaksore të veprës: njësimin e normës në fushën e *rendit të fjalëve*; *pozicionin e grupit emëror*, në lidhje me kallëzuesin; prirjen drejt përcaktimit të normës për *përshtatjen në kohë të foljeve në periudha*, e cila përbën një nga mjetet kryesore për ndërtimin e periudhave; mbizotërimin e normës për përdorimin më të shpeshtë të *ndërtimeve veprorë*; përdorimin e drejtë të kundrinorit pas foljes; *përdorimin e lidhore*s së foljes në vend të trajtës “me punue”, infinitivit të gegërishtes, i cili, rrallë u përdor si një mjet për afrimin në shkrim të dialekteve

Këto tipare dëshmojnë se këtij shkrimtari dhe publicisti i takon një meritë e veçantë në zhvillimin e variantit letrar të toskërishtes, që do të shërbente si varianti themelor për Gjuhën standarde shqipe.

**Fjalë kyçe:** grup emëror; trajta mënyrore dhe kohore, variant letrar.

## Abstract

The work of Mihal Grameno, writer and publicist, is representative of the linguistic features of the literary variety of the Tosk dialect during the first decade of the twentieth century. The syntactic features of Grameno's writings, that have been identified through a detailed analysis of his works, are: the unity of linguistic norm as related to word order, the position of the noun phrase relative to the predicate, the attempt to define a standard for the agreement of the tenses of verbs in compound sentences - one of the most important ways of building them up; the predominance of the norm for a more frequent use of active voice structures, the correct use of the object after the verb, the use of the subjunctive form of the verb instead of the Geg infinitive (“*me punue*”) - the latter was rarely used as a means of closing the gap between the written varieties of the two dialects.

These characteristics of Grameno's writings clearly show that he deserves a prominent place in the history of the attempts to develop a literary variety for the Tosk dialect, which would later serve as the basis for Standard Albanian.

**Key words:** noun phrase, tense and mood forms, literary variant.

Në “Historinë e gjuhës letrare shqipe”, kur flitet për prirjet e zhvillimit të strukturës sintaksore të shqipes, janë përcaktuar disa veçori themelore të kësaj strukture që lidhen: me rendin e fjalëve në fjali, dhe të pjesëve në periudhë; me format e zgjedhimit të foljeve që mbizotërojnë në periudha, si dhe me pozicionin e gjymtyrëve që shprehin marrëdhënie objektore dhe rrethanore.

Këto tipare nuk janë trajtuar për variantet letrare, e aq me tepër në veprakonkrete. Kur flitet për veçoritë e gjuhës në dhjetëvjetëshin e parë të shek. XX thuhet se botimet letrare në toskërishte kishin një përhapje më të gjerë, si brenda dhe jashtë vendit, krahasuar me gegërishten. Është fakt që në këtë vepër nuk përmendet kontributi i Gramenos, ndërkohë që prej penës së tij shqipja paraqitet me një variant letrar të konsoliduar.

Në këtë kumtesë janë marrë në shqyrtim veçoritë sintaksore, sepse kur paraqitet e njësuar struktura sintaksore e një gjuhe, “kështjella e sintaksës” thotë Kadareja te “Ftesë në studio”, ajo gjuhë dëshmon një zhvillim të qëndrueshëm. Dhe vepra e Gramenos e vërteton më së miri këtë fakt.

Gjatë analizës së prozës të Gramenos, me qëllim që të zbulonim veçoritë sintaksore, konstatuam:

1. Njësimin e normës në fushën e rendit të fjalëve. Dhe konkretisht pozicionin e grupit emëror, në lidhje me kallëzuesin.

**“Shtëpia e zezë”**, siç e quanin qytetarët ishte një shtëpi e madhe, **ndërtuar me gurë dhe rrethuar më gjithë anët ime avlli** edhe fortësia edhe ishte mbanë qytetit pranë kroit të Abdi beut.

**Një grua e re edhe e bukur**, që dukesh fare mirë në dritare të flagëvet, **me leshrat e lëshuar edhe të pakrehura, me sy të zgurdulluar, veshur me rrobën e natës** *si ç’ishte ngritur me tmerr nga gjumi*, zgjate duar, duke lutur njerëzinë t’i shpëtojnë të vetmin djalë që kishte, i cili flinte në katin e dytë, meqënëqë ajo nuk munte nga flagët e zjarrit ta shpëtonjë!

Siç duket edhe nga shembujt e mësipërm, përgjithësisht, ky grup emëror, kur është në funksion të gjymtyrës kryesore, (subjektit) vendoset para kallëzuesit. Vendoset pas në rastin kur ka funksionin e një gjymtyre të dytë, por s’mungojnë as rastet kur për efekte stilistike kemi rend të ansjelltë, p.sh.: **Manushaqesë** e më shumë **të gjorit kajmekam**, i cili pandehte se iu sosnë **mëkatat**.

Megjithëse shqipja është një gjuhë me rend kryesisht të lirë, në prozën e Gramenos ekziston një rregull edhe për rendin e pjesëve nëperiudha. Psh.: “Katunde edhe qytete shkretoheshin dhe njerëzia mërgoheshin në vende të huaj, duke lënë shtëpitë, plaçkat e gjithë ç’kishin edhe vështroin vetëm si e si të shpëtojnë nga rreziku shpirtin e tyre.”.

Shpesh hasen fjali që fillojnë me lidhëza kundërshtore, përmbyllëse e shkakore.

Gjithashtu, këtu do të përfshijmë edhe rastet e thyerjes së rendit në një fjali, pjesët e së cilës kanë kryesisht raporte barazie, por edhe raporte varësie. Në këtë rast, mendojmë se kjo dukuri nuk ndodh aq për faktin se fraza e tij është e gjatë, sesa për faktin se Gramenoi e vlerëson këtë thyerje si një mjet stilistik. Hasen fjali që fillojnë me lidhëza kundërshtore, përmbyllëse, e shkakore.

**Po** njerëzia gjithë mbetnë të shurdhër në blegërimet e në lutjet e kësaj gruaje, mënjanë nga frika e zjarrit që nuk muntnin t'afroheshin, më tjetër anë nga tmerri që, vështronin njerëz në atë shtëpi, të cilën e dinin të pandenjtur edhe të shkretuar.

**Andaj** vështronin vetëm që të mos zgjatet zjarri më tjetër shtëpi, duke lënë të brençmit në duart e Perëndisë!

**E** neve duallmë përjashta dhe shikuam zjarrin gjersa u doq dhe u gremis shtëpia me gjith sa ishin. **Se** në jetë nuk paska brengë më të madhe se e dashurisë që të tretë më këmbë edhe të thëthin gjakun si gjarpëri.

## **2. Prirja drejt përcaktimit të normës për përshtatjen në kohë të foljeve në periudha, kur dihet se bashkelidhja e trajtave mënyrore dhe kohore është një nga mjetet kryesore për strukturimin e periudhave**

Dukesh fatbardhës pas fytyrës edhe fort i kënaqur kësaj jete, se buzët i *nëngeshnë* me të arrirë në krua *tagjenjë* tani të math e të bukur.

Pas pak kohë *mblodhi* mjaft Shokë edhe gjesdiste mi gjithë anët e Toskërisë, jo që *t'u bënë* dëme e të liga njerëzisë e udhëtarëve, si të tjerët hajdutë që ishin ata më të poshtërit kusarë, po për të mprojtur edhe për të ndihurë të dobëtët edhe të vobekëvet, që ishin nën fuqi të të mbëdhenjëve, të cilët kërkonin *t'u rjepën* edhe lëkurën e trupit. Me këto të sjella *fitoi* në pak kohë dashurinë e popullit, se njerëzia *zunë të rrojte* të qetë, duke mos u drojtur nga të mbëdhenjtë, të cilët tani *dridheshin* nga tmerri i Arslanit edhe *s'guxonin të rjepin* si më parë popullin, po kërkonin fshehtazi humbjen e këti hajduti, që emri i *kishte arrirë* gjer në Konstandinopojë!

Hajdutët të gjithë si edhe Zëmbaku *mbetnë* të habitur për këtë ngjarje që s'e *kuptonin*; po Arslani, si erdhi në vete, duke puthur Zëmbakun e duke qarë si një foshnje që do *t'i vritësh* përpara syvet të ti, i *lajmëron* që ay është i biri, se hajmalinë ja *kish varur* vetë pa ikur, edhe e *njihte* pas një shënimi që kishte në faqe të djathtë.

Në fjalitë e bashkërenditura bashkëlidhja e trajtave kohore tregon njëkohësi veprimesh në të tashmen, në të shkuarën dhe në të ardhmen. Skemat që shfaqen janë e tashme + e tashme: e pakryer + e pakryer; më se e kryer + e pakryer. Në fjalitë e përbëra kohore bashkëlidhja është i vetmi mjet që tregon njëkohësi ose jonjëkohësi.

## **3. Mbizotërimi i normës për përdorimin më të shpeshtë të ndërtimeve veprare**

Ky tipar lidhet me stilin tregimtar të Gramenos, ku ligjërata e drejtë dhe zhdrejtë gërshetohen natyrshëm. Gjithashtu, ky tipar kushtëzon edhe mbizotërimin e marrëdhënieve objektore.

Qytetarët *ndenjë* të gjithë pranë zjarrit gjer më të gdhirë, për të ruajtur mos *kërcenjë* nonjë shkëndijë afër, edhe *pyesnin* njëri-tjatrën në *dinte* gjësendi që kur *rronin* njerës në këtë shtëpi po asnjë prej syresh nuk e *dinte* ç’ njerës *rronin*, që kur *kishin* ardhur në atë shtëpi, edhe sa ishin.

Andaj, me gjithë helmin që *ndjenin* për ata që u bën therorë të zjarrit, *gëzoheshin* më tjetër anë se zjarri i vuri funt asaj shtëpie së zezë, që *kishte shuar* kaqe njerës, edhe të cilën e *nëmëronin* si shkakun e gjithë të ligave që *ngjisinin* në qytet!

#### 4. Përdorimin i drejtë i kundrinorit pas foljes

Sot, sipas normës sintaksore, këshillohet që të përdoret folja para kundrinorit.

Ky përdorim në mënyrë të njëtrajtshme shfaqet te Gramenoja, si p.sh.:

Perëndia *u falte fatbardhësi e jetë* të gjatë, po, sa gjallë e me nder, të punoni edhe *të doni të drejtën e të mirën* e Shqipërisë, edhe rrofshi e qofshi dhe nderofshi **“Oxhakun”**.

Rastet me emra foljorë si p.sh.: Pas *të ikurit të Zëmbakut*, të cilit që tani e tutje do t’i themi edhe Rexhep,

kajmekami ndë një brengë të madhe kërkonte të mbetej vetëm..., janë të rrallë, prandaj edhe në këtë aspekt mund të themi që kemi një tipar të konsoliduar.

5. Një tipar tjetër që vepron edhe sot në gjuhën standarde është **përdorimi i pjesëzës mohuese *mos* para një foljeje në mënyrën lidhore**, e cila vendoset midis pjesëzës gramatikore dhe foljes.

Maloja forcon zemrën edhe, si puth Rexhepkën, i cili s’i ndaheshe nga krahët, puth edhe Vahidenë, duke e forcuar me fjalë që për së shpejti do të kthehet edhe **të *mos* ndahet** kurrë, merr armët edhe shkon!

#### 6. Në prozën e Gramenos vërehet përdorimi i elementeve të toskërishtes letrare

Një tipar tjetër themelor është mungesa e infinitivit të gegërishtes, i cili u përdor si një element gjuhësor me synimin që të afroheshin dy dialektet dhe të krijohet një variant i përbashkët, p.sh. mund të përmendim, për këtë rast, prozën e H. Ali Korçës. (Qëndrimi për afrimin në shkrim të dialekteve filloi me K. Kristoforidhin, te “Dhjata e Re”, por shfaqet edhe te rilindas të tjerë e mw pas përqafohet nga gjuhëtarët e “Shkollës të Elbasanit”, si: A.Xhuvani, S. Shuteriqi, K.Cipo, M. Domi, L. Dodbiba.) Ky fakt ka një ndikim të drejtpërdrejtë në strukturën sintaksore. Ai është zëvendësuar me formën e shtjelluar foljore dhe konkretisht me mënyrën lidhore, që siç dihet është një dukuri jo vetëm e shqipes, por edhe e gjuhëve të tjera të rajonit tonë. Nga shembujt e përzgjedhur është e qartë se këto ndërtime me lidhore funksionojnë si periudha.

Por për fat të keq, iku edhe Rexhepi që *të ndjekë* hajdutët, Manushaqja vërtet e gëzuar për këtë ngjarje të bukur, po tani rrinte hequrë, mënjanë, duke mos kuxuar *të afrohet*. Në rastet kur nevojitet të shprehet rrethana qëllimore, përdoret forma me për të që ndryshe, nga gjuhëtarët quhet edhe paskajorja e dytë e shqipes., me *për të*.



**Në përfundim, përsëritja në mënyrë të rregullt e të gjitha këtyre veçorive të sipërpërmendura, nuk mund të jetë një rastësi, prandaj** mund të themi që në vepër nuk shfaqet vetëm vizioni i atdhetarit, i shkrimtarit, publicistit, por edhe vizioni i njohësit të mirë gjuhës. Vepra dëshmon që shqipja e tij ishte një gjuhë, që funksiononte sipas normave. Prandaj, një meritë e veçantë në zhvillimin e variantit letrar të toskërishtes, që më vonë do të shërbente si një nga variantet themelore për gjuhën standarde shqipe, i takon, edhe Mihal Gramenos.

### **Referencat**

**Haxhi A, Topalli T,** (1998) *Historia e gjuhës së shkruar*, Shkodër.

**Kastrati J,** (1980) *Historia e gramatologjisë shqiptare*, Tiranë.

**Lloshi Xh,** (1987) *Njohuri për stilistikën*, Tiranë,

**Myzyri H,** (1987) *Mësonjtorja e parë shqipe e Korcës*, Tiranë.

**Osmani T,** (1999) *Udha e shkronjave*, Tiranë.

**Raka F,** (1997) *Hitoria e shqipes letrare*, Prishtinë.

**Raka F,** (2004) *Normëzimi i shqipes ndër shekuj*, Prishtinë.

**Samara M,** ( 2005) *Histori e gjuhës letrare shqipe*, Tiranë.

# FRYMA PATRIOTIKE NË PUBLICISTIKËN E MIHAL GRAMENOS

**Pavlo Cicko**

Departamenti i Gjuhëve të Huaja, Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, Universiteti "Fan S. Noli" Korçë

## **Përmbledhje**

Në publicistikën e Mihal Gramenos dallohen qartë shqetësimet e shkrimtarit patriot për edukimin e bashkëkombasve të vet me dashurinë për atdheun dhe demaskimin e qëllimeve shoviniste të fqinjëve ndaj Shqipërisë. Vetë tematika e trajtuar dëshmon për frymën e lartë patriotike kombëtare të publicistikës së tij. Kështu spikatin: ideja se kryengritja e armatosur do të ishte rruga e vetme për fitimin e autonomisë së atdheut; besimi i autorit në luftën e drejtë për liri të çetave të kryengritësve shqiptarë; pasqyrimi me ngjyra të gjalla i portreteve dhe figurave të shquara të luftëtarëve të lirisë; shqetësimi i autorit për zhvillimin e shkollës dhe arsimit në gjuhën shqipe. mbrojtja e zjarhtë e njësisit të alfabetit shqip kundër pengesave që qeveria turke sajonte.

**Fjalët çelës:** Lëvizja popullore, autonomia e atdheut, lufta e drejtë për liri, shkolla dhe gjuha shqipe.

## **Abstract**

The journalistic writings of Mihal Grameno are marked by the the writer's concerns for the education of his fellows with the love for his country and by the exposing of the neighbors' chauvinistic goals against Albania. The thematic content of such writings is an indication of its high nationalistic spirit. There are of great importance the ideas that the armed uprising would result as the final and only way towards the autonomy; the author's belief in the fair cause of the Albanian insurrectionists; the vivid description of the outstanding portraits of the freedom rebels; the author's concern for the school and education development in Albanian; the fierce support towards the unity of the Albanian alphabet in an hazarding climate presented by the Turkish government.

**Key words:** popular outbreak, country's autonomy, the fair cause of the war, the Albanian school and language

## **Hyrje**

Publicistika e M. Gramenos është pjesë e publicistikës shqiptare të Rilindjes Kombëtare. Si e tillë ajo jetoi me shqetësimet e problemet e saj dhe u përpoq të realizojë misionin e edukimit të njerëzve me dashurinë për atdheun nëpërmjet tematikës të larmishme dhe demaskimit të qëllimeve shoviniste të fqinjëve si edhe të fuqive të mëdha ndaj Shqipërisë. I edukuar në një familje patriotike korçare me ndjenjat e fuqishme atdhedashëse Grameno do të bëhet shpejt një luftëtar i pushkës dhe penës në lëvizjen kombëtare shqiptare. Kontakti që pati me patriotët shqiparë në Rumani e formoi plotësisht karakterin e tij

patriotik. Gjatë qëndrimit atje ai lidhet ngushtë me shoqërinë Drita dhe Nikolla Naçon për të cilin do të shkruajë më vonë : “ ...Gjith shërbimin tim të vogël, mbi altarin e atdheut, ja detyroj mësonjësit tim Nikoll Naços, i cili është një nga patriotët e mëdhenj”<sup>64</sup>. Atje ai u formua me karakterin përparimtar dhe demokratik të shkollës dhe pedagogëve të shquar rumunnë. Që në shkrimet e tij të para dallohen interesat patriotike hde ideja e luftës për lirinë e atdheut. Talenti i tij në publicistikë është tashmë një vlerë e spikatur e publicistikës të kohës. Ai boton që prej vitit 1905 me inicialet etij M.G ose me disa pseodonime si Nomegra, Plasaraku, Fshikull e Dhjako, tek disa Gazeta si “Drita” e SH.Kolonjës, “Albania” e F.Konicës, “ Kombi”, Korça”, “Dielli” e Bostonit, “Albania” e Nju –Jorkut, si dhe tek “ Koha” dhe “Lidhja ortodokse” të cilat i drejtoi vetë. Grameno mendonte se shtypi si një armë e fuqishme“... arin atje ku pushka dhe topi s’arrin e s’qëllon dot”<sup>65</sup>. Pas kushtetutës xhonturke në 1908 ai vendos ti kushtohet gazetarisë. Fillimisht bëhet redaktor i gazetës “Korça” dhe më vonë në 1909 boton gazetën e tij “Lidhja orthodhokse”, që bëhet një tribunë e mendimit kombëtar. Por karakteri antiosman i shkrimeve dhe veprimtaria e gramanos në shoqëritë patriotike bëri që qeveritarët turq ta mbyllin gazetën dhe ta burgosin atë. Falë punës së palodhur trajtimit të problemeve të rëndësishme për vendin dhe popullin si edhe talentit të Mihalit, shkrimet e tij lexoheshin me interes nga lexuesit. Popullariteti që fitoi ishte dhe shkak që qarqe të caktuara greke dhe italiane të përpiqeshin ta përdornin për me interesa e tyre shoviniste. Por patrioti korçar nuk i pranoi kurrë ofertat e tyre të pandershme.

### **Tematika patriotike e shkrimeve publicistike të Mihal Gramenos.**

Në shkrimet e veta publicistike Gramenoja do të pasqyrojë problemet kryesore të Rilindjes kombëtare shqiptare.

Do të sjellim disa tematika të caktuara që dëshmojnë për frymën ë lartë patriotike kombëtare të publicistikës së tij . Ai propagandon idenë se kryengritja e armatosur do të ishte rruga e vetme për fitimin e autonomisë dhe të shkëputjes së plotë nga sundimi turk otoman.

Tek skica Gazetari shqiptar, botuar në numrin eparë të gazetës “Korça”, ai pasqyron figurën tipike të gazetarit patriot të atyre viteve, që nuk mposhtet nga vështirësitë ekonomike por i shërben i vendosur lirisë së atdheut të vet. Ky shkrim mund të vlerësohet si shprehje e kredos së tij dhe e betimit se energjitë e veta do t’ia kushtonte idealit të çlirimit kombëtar. Atdhetari i flaktë përdorte shpesh dhe një qëndrim dinak duke botuar në fillimet e gazetave disa artikuj që në dukje mbështesnin reformat e Turqisë ndaj Shqipërisë, por këto i bënte që të siguronte vazhdimësinë e botimit dhe të punës të tij për

<sup>64</sup> M. Grameno, Patriotët e mëdhenj, “Koha”, 1916, 3 shkurt, f 1. Cituar nga Th. Gjika tek M. Gramenoja Publicist Demokrat, Akademia e Shkencave e RPSSH, Tiranë, 1980, f20.

<sup>6565</sup> Reporteri, Mbledhja e përgjithshme, “Koha”, 1915, 28 janar, f2.

të demaskuar dhe luftuar më me forcëpërpjekjet shoviniste greke dhe për të siguruar më shumë liri nga pushteti turk.

Gjatë periudhës 1909-1912 bien në sy artikuj si “Moti 1909 qysh na le, Thirja e Komitetit shqiptar, Rreziku në portë, Kryengritja shqiptare, Tre burra shqiptarë, Të hyrit e kryengritësve shqiptarë në Korçë, etj . Aty gjejmë të mishërohet besimi i autorit në luftën e drejtë për liri të çetave të kryengritësve shqiptarë. Me zgjuars ai shpesh e fshifte qëndrimin e vet duke shënuar në gazetë shprehjen” marrë nga shtypi i huaj etj. Por psa botimit të artikullit Thirja e Komitetit shqiptar, ai burgoset për herë të dytë në korrik 1911. Mihal Grameno e shihte lëvizjen çlirimtare nga Turqia si një lëvizje të gjerë popullore. Kështu tek shkrimi “Mbi trazimet e Shqipërisë” , ai do të shprehej se luftëtarët e lirisë do jepnin “edhe të fundit pikë të gjakut për të fituar autonominë e plotë të Shqipërisë.” “Koha”, 1911, 10|23 korrik, f.1. <sup>66</sup>

Pasqyrimi me ngjyra të gjalla i disa portreteve të figurave të shquara të luftëtarëve të lirisë të çetës së Cerçiz Topullit, është një pjesë tjetër e rëndësishme e tematikës së shkrimeve të tij. Nëpërmjet këtyre figurave lexuesit emocionohen dhe ndejnë dashuri për figurën e luftëtarit , bëmat dhe trimëritë e tyre. Shkrimet tingëllojnë si një kushtrim për t’iu bashkuar luftës në male. Ata ai i portretizon me realizëm duke pasqyruar trimërinë, vendosmërinë dhe vetmohimin për çështjen e atdheut por dhe nga ana tjetër humanizmin dhe arsyen që na bën të kutojmë se nuk kemi të bëjmë thjesht me rebelë apo me anarkistë, ashtu siç do ti pëlqente ti quante pushteti i kalbur turk, për hesap të interesave të veta. Grameno jep me ngjyra të gjalla karakterin e këtyre luftëtarëve, ndjenjat njerëzore dhe veprimet e tyre luftarake. Bie në sy fakti se figurat qëndrore të shkrimeve me portrete janë njerëzit e varfër të popullit, ata që mbështesnin me çdo gjë luftën e çetave për liri.

Ai skicon gjithashtu edhe figurat të shquara të grave shqiptare duke i vlerësuar ato dhe veprën e tyre për lëvizjen kombëtare dhe çlirimin e atdheut. Përmendim këtu shkrimet “Arbëreshat”, “Foleja shqipëtare” dhe “Ylli i mëngjezit”.

Në 1927 ai boton “Kryengritja shqiptare “ një libër me kujtime nga jeta e tij në çetë, i cili ka vlerë dokumentare por edhe letrare. Grameno do të përsërisë këtu edhe njëherë idenë e tij se lufta dhe sakrificat e njerëzve të thjeshtë do të shpëtonin Shqipërinë. Ai thekson se “....kjo opingë është shtylla dhe shpresa e kombit shqiptar”<sup>67</sup>

Në artikuj të tjerë vemë re shqetësimin e autorit për zhvillimin e shkollës dhe arsimit në gjuhën shqipe. Gjatë pasqyrimin të veprimtarisë së shkollave të Korçës, Kolonjës, Negovanit dhe të Normales së Elbasanit , ai shpreh shqetësimin për fatin dhe

---

<sup>66</sup> Th. Gjika, M. Gramanoja Publicist Demokrat, Akademia e Shkencave e RPSSH, Tiranë, 1980, f.48.

<sup>67</sup> M.Grameno, Shpresa, “Koha” 1912, 30 janar |12 shkurt, f.2.

mbarëvajtjen e tyre. Natyrisht e lidhur ngushtë me çështjen e gjuhës është dhe ajo e alfabetit shqip. Grameno bëhet një nga organizatorët dhe frymëzuesit e mitingut për shkronjat shqipe që ishte një protestë efuqishme kundër përpjekjeve të qeverisë turke për të futur alfabetin arab. Ai shkruan një reportazh me titull “Mitingu i shkronjave shqipe”, në të cilin përshkruan patriotizmin e madh të popullit korçar. Në artikuj të tjerë të shkruar gjatë kësaj kohe si “Arsimi në Shqipëri”, etj, Grameno do të mbrojë me zjarr njësimin e alfabetit shqip kundër pengesave që qeveria turke sajonte. Tek artikuj të tjerë spikat tema e satirizimit dhe goditjes që ai ju bënte qeveritarëve të lartë turq. Tek Një vërë në ujët U bë dritë dhe Reformat ose mirësitë(1912), dallohet ironia e thellë dhe tallja ndaj rendit të kalbur të asaj qeveri dhe masave antipopullore që ajo ndiqte. Kështu në “koha ‘ ai shkruan : “... u ngopmë me këto komodira edhe duhet që .....qeveritarët tanë të kuptojnë që nuk shkojnë paskëtaj programet e shkruarë në karta, por duhet me punë!”<sup>68</sup>

Në shkrimet e Gramenos të viteve 1905-1912 dallohet dhe tema e luftës që ai bën kundër shovinizmit dhe propagandës antishqiptare të shteteve fqinje. Me anën e tyre synohej të zgjohej ndërgjegjja kombëtare tek bashkëkombasit në mënyrë që të mos gënjejeshin nga propaganda e mësipërme. Ai boton shkrime ku luftohen qëllimet e mbrapshta të klerit e një pjese të shtypit por dhe të qeverisë greke. Tribunë e kësaj lufte bëhet gazeta “Lidhja orthodhokse”. Një tipar nga më të spikaturit që ka të bëjë me qëndrimin e tij ndaj fesë, është fakti se ai si shumë patriotë të tjerë mëndjendritur nuk e lidhi çështjen shqiptare me interesat e fesë. Për të si edhe për të gjithë rilindësit e tjerë motoja ishte “Feja e shqiptarit është shqiptaria”. Në shumë artikuj të tjerë si *Derman i Llasos*, *Ujku qimen e ndrron* etj, autori fshikullon veprimet çnjerëzore të disa klerikëve që nuk pranonin të varosnin njerëz nga familjet patriote. Ai mbrojtë interesat patriotike por kurrë nuk shfaqti ndjenja shoviniste në shkrimet ku luftonte propagandën e shteteve fqinje që donin ta paraqitnin vilajetin e Janinës si “qëndrën e helenizms” dhe vilajetin e Kosovës si “Serbi e vjetër”. Ai theksonte se ata: “...duhet ta dinë që vetëm atëhere kur të mos mbetet këmbë shqiptari mund të na zaptojnë atdhenë armikët tonë”.<sup>69</sup>

Një temë tjetër për të cilën Gramano shkroi në publicistikën e tij ishte dhe ajo që lidhej me futjen e gjuhës shqipe si gjuhë e liturgjisë kishtare duke zëvendësuar greqishten. Kjo përpjekje do të ishte një hap shumë i rëndësishëm për formimin e kishës autoqefale shqiptare, gjë për të cilën luftonin rilindasit shqiptarë. Për këtë qëllim ai ishte një nga autorë të kërkesës të shoqërisë “Shpresa” Të shqiptarëve të Rumanisë dëguar patriarkut të Stambollit, që në 1903, për futjen e gjuhës shqipe në shërbesat e kishës shiptare.

---

<sup>68</sup> M.Grameno, U bë dritë, “Koha”, 1912, 7/10 qershor, f.1.

<sup>69</sup> M.Grameno, Çakajtë, ‘Koha”, 1912, 13/26 shtator, f.1.

Në rrethanat e dobësimit të sundimit turk në shtetet ballkanike dhe të luftës për dëbimin e Turqisë në tetor 1912, Grameno shkon në Vlorë dhe që nga kjo kohë nuk e vazhdon më botimin e gazetës “Koha”. Ndërsa në periudhën 1913-1920, ai shkruan përsëri artikuj që lidhen me luftën kundër politikës grabitqare pushtuese të fuqive ndërluftuese të luftës së parë botërore, fuqi që e shndëruan Shqipërinë në një shesh beteje. Në artikujt, replikat dhe pamfletet e shumta ai demaskon çdo qëndrim dhe veprim antishqiptar të qeverive të mëdha.

Pas pushtimit të Vlorës artikujt e tij ndaj politikës italiane janë një mbrojtje e shkëlqyer e interesave kombëtare dhe një përpjekje për ti hapur sytë popullit që mos të mashtrohej nga propaganda se gjoja ushtria italiane do të qëndronte vetëm përkohësisht aty. Disa prej artikujve të tij demaskues ishin: *Karnavalet italiane, Politika italiane në Shqipëri, Duam politikë të qëruar, Italia dhe Shqipëria*. Vlen të përmendet këtu fakti se shkrimtari patriot kishte qartësinë dhe largapamësinë që të dallonte dhe ndante politikën shoviniste dhe qeverinë nga populli i cili siç shkruante Grameno “... jo vetëm që është kundra, po edhe e dënon ashpërsisht një veprim të tillë nga ana e qeverisë italiane”<sup>70</sup>

Por ndërsa ndaj Italisë dhe Austro-hungarisë ai mbajti një qëndrim të prerë kundërshtues, ai miratoi politikën e Francës, i nisur mesa duket dhe nga shpallja e Krahinës autonome të Korçës. Largpamësia e tij për mbrojtjen e çështjes kombëtare shqiptare u shfaq dhe me faktin e botimit të tre numrave të gazetës “Koha” në frëngjisht dhe në anglisht. Me këtë botim ai e bëri të qartë për të gjithë opinionin ndërkombëtar të vërtetën e popullit të vet dhe luftën e tij për çështjen kombëtare. Rreptësia e shkrimeve të tij dallohet edhe në luftën kundër shovinizmit serb. Për të mbështetja në armët dhe luftën e popullit do të ishte e vetmja rrugë e fitores. Kështu në *Letër nga Italia* ai shkruan: “Besimi ynë duhet të jetë ndër neve duke u përpjekur me gjithë fuqinë të përfitojmë nga rrjedhjet dhe interesat diplomatike jo duke varur shpresën në të huajt.”<sup>71</sup> Vlerat e veçanta të publicistikës së Gramenos lidhen gjithashtu me faktin se ai arriti të përshkruajë portrete patriotësh në shkrime si *Muço Qulli, Patriotët e mëdhenj, Atdhetarët e urtë, Të pavdekshmit, Burrat*, etj. Në këto shkrime ravijëzohet ideja se shtresa të ulta, vegjëlia ishin bazë e lëvizjes patriotike shqiptare.

Në vitet 1915-1919 Ai boton gazetën Koha në SHBA, nëpërmjet të cilës politikën shoviniste të shteteve pjesëmarrës në luftë ndaj vendit tonë.

Në përfundim mund të themi se Grameno e përsosi gjatë viteve publicistikën e tij duke shfaqur në shkrimet, pamfletet dhe fejtinet cilësi më të mira si në idetë përparimtare ashtu dhe në formën artistike.

---

<sup>70</sup> M.Grameno, Politika italiane në Shqipëri, “Koha”, 1915, 16 shtator, f.1.

<sup>71</sup> M.Grameno, Letër nga Italia, ‘Koha’, 1916, 17 gusht, f.2.

## **Referencat**

M. Grameno, Patriotët e mëdhenj, “Koha”, 1916, 3 shkurt, f.1. Cituar nga Th. Gjika tek M. Gramenoja Publicist Demokrat, Akademia e Shkencave e RPSSH, Tiranë, 1980, f20.

Reporteri, Mbledhja e përgjithshme, “Koha”, 1915, 28 janar, f2.

Th. Gjika, M. Gramanoja Publicist Demokrat, Akademia e Shkencave e RPSSH, Tiranë, 1980, f.48.

M.Grameno, Shpresa, “Koha” 1912, 30 janar|12 shkurt, f.2.

M.Grameno, U bë dritë, “Koha”, 1912, 7/10 qershor, f.1.

M.Grameno, Çakajtë, ‘Koha’, 1912, 13/26 shtator, f.1.

M.Grameno, Politika italiane në Shqipëri, “Koha”, 1915, 16 shtator, f.1.

M.Grameno, Letër nga Italia, ‘Koha’, 1916, 17 gusht, f.2.

# VEPRIMTARIA PATRIOTIKE E MIHAL GRAMENOS NË VITET 1909-1912

**Bashkim Jahollari, Aleksandra Piluri**

Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, Universiteti “Fan S. Noli” Korçë

## **Përmbledhje**

Periodha 3 vjeçare, 1909-1912 për Mihal Gramenon është mbushur me veprimtari patriotike dhe prodhimtari letrare e publicistike. Kjo veprimtari u zhvillua në qytetin e Korçës ku Mihal Grameno bashkëpunoi me shumë atdhetarë të tjerë dhe u bë ndër drejtuesit kryesorë të shoqërive patriotike të krijuara në këtë qytet. Veçohet këtu veprimtaria për problemet arsimore e zhvilluar në rradhët e shoqërisë shkollore “Përparimi”.

Mihal Grameno kuptoi drejt se problemi themelor në këto vite ishte përcaktimi i një alfabeti të vetëm për gjuhën shqipe. Prandaj ai ishte delegate edhe në kongresin e Manastirit, që diskutoi për këtë problem.

Veprimtari patriotike e Gramenos ra në sy të autoriteteve turke, të cilat në korrik 1911 e burgosën atë. Por edhe në këtë situatë ai mbrojti me forcë idenë “ se nuk do të hiqte dorë nga lufta për çlirimin kombëtar.

**Fjalët çelës:** veprimtari patriotike, prodhimtari letrare e publicistike, veprimtaria për problemet arsimore

## **Abstract**

The three-year period, 1909-1912 is full of patriotic events and rich in literal and journalistic publication for Mihal Grameno. This activity occurred in the city of Korça where Mihal Grameno cooperated with many other Albanian patriots. He also became one of the main leaders of several patriotic organizations established in this city. What should be emphasized here is the activity about education problems which was held by the scholar organization “Përparimi.”

Mihal Grameno understood that the most crucial problem of that time was the establishment of a unique alphabet for the Albanian language. As a result, he was one of the representatives in the Congress of Manastir who discussed about this problem.

The patriotic commitment of Grameno was soon noticed by the Turkish authorities, which in July 1911 imprisoned him. But even though he found himself in this situation, he never gave up the idea of always struggling and never quitting the attempts for the national liberation.

**Key words:** patriotic, publication, education, alphabet, liberation



Jeta e Mihal Gramenos është një nga jetët më të pasura për sa i përket aktivitetit patriotik, letrar e publicistik.

Me veprimtari të ngjeshur patriotike e prodhimtari letrare e publicistike është e mbushur edhe periudha 3-vjeçare 1909-1912, të cilën kemi bërë objekt të kësaj kumtese. Ne do të flasim këtu vetëm për veprimtarinë patriotike të Mihal Gramenos, pa u ndalur në krijimtarinë letrare (novelat "Varri i Pagezimit" dhe "E puthura", që ai shkroi dhe botoi më 1909, vëllimi poetik "Këngëtore shqipe-Plagët", që botoi më 1912) dhe as për krijimtarinë e tij publicistike të këtyre viteve. Këto mund t'i përmendim vetëm të lidhura me veprimtarinë patriotike të kësaj periudhe.

Mbas fitores së revolucionit Xhonturk (Korrik 1908) Mihal Gramenoja, duke menduar se puna patriotike brenda në atdhe do të ishte më e frutshme dhe më e dobishme se ajo që mund të zhvillonte në kolonitë jashtë atdheut, vendosi të qëndronte në qytetin e tij të lindjes.

Këtu ai u lidh me patriotë si: Orhan Pojani, Vani Kosturi, Thoma Avrami, Pandeli Cale, Themistokli Gërmenji, Vangjel Gjika, Goni Katundi, Hasan Bitincka, Loni Logori, Hil Mosi (që kish ardhur nga Shkodra), etj.

Duke shfrytëzuar ato pak të drejta që u njohu kushtetuta xhonturke popujve jo turq të Perandorisë, Gramenoja së bashku me patriotët e tjere korçarë iu fut punës për forcimin e mëtejshëm të ndërgjegjes kombëtare të popullit, gjallërimit të aktivitetit kulturor e politik si dhe të lëvizjes së armatosur për të siguruar autonominë territoriale administrative, këtë hap të parë për të arritur në lirinë e plotë të atdheut.

Në "Klubi i Diturisë shqip" që u formua në Korçë, ai do të ishte një nga anëtarët më aktivë, ndërkohë që do të zgjidhej në kryesi ose në pleqësi të shoqërive "Lidhja Ortodokse", "Përparimi" dhe "Banda e Lirisë", ku do të luante rol të ndjeshëm me pjekurinë e tij politike dhe me guximin e vet.

Ai do të ndihmonte patriotin Sami Pojani për të nxjerrë në dhjetor 1908 gazetën "Korça", kurse pas disa muajsh do të nxirrte vetë një organ patriotik, gazetën "Lidhja Ortodokse" e cila u bë tribuna e mendimit dhe e aktivitetit të shoqërisë me të njëjtin emër. Gramenoja si drejtor i këtij organi dhe si nënkryetar i shoqërisë "Lidhja Ortodokse" zhvilloi një luftë të hapët me gjithë kundërshtarët e gjuhës Shqipe, që nuk lejonin futjen e saj as në kishë e as në shkollë.

Edhe në shoqërinë muzikore "Banda e Lirisë", të formuar në Korçë, Mihal luante një rol të rëndësishëm. Si anëtar i pleqësisë të kësaj shoqërie ai kontribuoi fuqimisht që shoqëria ta kryente më së miri rolin e saj, duke përhapur këngët patriotike në masat e gjera të popullsisë. Shoqëria mori pjesë në manifestime të ndryshme, në festa, në vënien në skenë të dramës "Besa" të Sami Frashërit, ku Gramenoja luajti rolin e Vahidesë. Ishte koha kur rolet e femrave në skenat tona i luanin ende burrat.

Aktivitetin e vet patriotik Mihal Gramenoja e zgjeroi më tepër në rradhët e shoqërisë shkollore "Përparimi" që u formua në Korçë në shtator 1909, duke zbatuar vendimin e Kongresit të Elbasanit. Si sekretar i kësaj shoqërie ai punoi pa u lodhur për të afirmuar të drejtën e zhvillimit të arsimit në gjuhën shqipe. Shoqëria shkollore

"Përparimi" kishte si qëllim çeljen e shkollave në gjuhën amtare, botimin e librave, broshurave e teksteve shqip si dhe të kujdesej për mbarëvajtjen e punës në shkollën normale të Elbasanit. Kjo shoqëri u përpoq të çelte shkolla shqipe jo vetëm në krahinën e Korçës, por edhe në krahinat e tjera të Shqipërisë. Për këtë qëllim ajo u kërkoi të gjitha klubeve ndihmë morale dhe materiale. Në radhët e kësaj shoqërie, Gramenoja bëri përpjekje të mëdha për të vënë në jetë edhe vendimin tjetër të Kongresit të Elbasanit ku thuhej: "Shqiptarët, kudo do të përpiqen me sa mundet të fusin gjuhën shqipe në shkollat e huaja që janë në Shqipëri". Udhëheqja e shoqërisë, në përputhje me këtë vendim, kërkoi nga autoritetet qeveritare që gjuha shqipe të mësohej me shkrim e këndim në gjithë shkollat e huaja të vilajeteve shqiptare. Në sajë të këmbënguljes së shoqërisë u lejua që gjuha shqipe të mësohej në shkollat turke të disa qyteteve, midis tyre edhe në Korçë. Mësuesi që filloi ta jepte mësimin e gjuhës shqipe në gjimnazin turk të Korçës ishte vetë patrioti Mihal Grameno. Ai gjatë orës së mësimin u mësonte nxënësve veç rregullave gramatikore dhe pjesë nga "Historia e Skënderbeut" të Naimit, gjë që bëri ta largonin nga shkolla, pa i paguar as rrogën e atyre muajve.

Grameno, me anëtarët e tjerë të shoqërisë "Përparimi" mori pjesë në protestat e zhvilluara kundër politikës së xhonturqve, të cilët në bashkëpunim me klerin fanatik mysliman filluan të përhapnin abetaret e Arif Hiqmetit, ku përdorej alfabeti arab për shkrimin e gjuhës shqipe. Kjo përpjekje djallëzore ndeshi në rezistencën e vendosur të nxënësve dhe mësuesve patriotë korçarë. (Gramenoja u ngrit me forcë kundër përdorimit të këtij alfabeti. Ai theksonte se duhej shkullur kjo "gozhdë e Nastradinit").

Duke kuptuar drejt faktin se zgjidhja e problemit të alfabetit kishte jo vetëm rëndësi arsimore, por në radhë të parë rëndësi politike e kombëtare. Gramenoja mbrojtë idenë se gjuha jonë duhet të shkruhej vetëm mbi bazën e alfabetit latin të Stambollit. Në Kongresin e Manastirit, të zhvilluar në nëntor 1908, për problemin e unifikimit të alfabetit, ai kishte marrë pjesë si përfaqësues i shoqërisë "Banda e Lirisë" të Korçës. Dhe tani në zbatim të vendimit të këtij kongresi u bë një nga nxitësit kryesorë për zhvillimin e mitingut të shkronjave shqipe në Korçë, më 27 shkurt 1910, ku populli i kësaj krahine, me frymë të lartë patriotike protestoi kundër përpjekjeve të xhonturqve, për përhapjen e shkrimit të gjuhës shqipe me alfabetin arab.

Të shqetësuar nga aktiviteti i Mihal Gramenos, autoritetet turke vepruan. Ato e gjobitën dhe e nxorën në gjyq disa herë. Në qershor të vitit 1910 me vendim të gjyqit ushtarak të Dibrës atë e burgosën dhe njëkohësisht ia mbyllën gazetën "Lidhja Orthodoxe". Masat e marra nga pushtuesit turq nuk e mposhtën patriotin. Ai hodhi poshtë edhe premtimet e bëra nga qeveria turke për shpërblime të majme, në qoftë se do të ndërpriste veprimtarinë e vet. Por ai do ta forconte këtë veprimtari në faqet e gazetës së re "Koha" që filloi ta botonte më 14 shkurt të vitit 1911.

Në këtë periudhë gjendja në Shqipëri sa vinte bëhej më e nderë. Kryengritja e vitit 1910 u shtyp nga forcat turke. Në jug të vendit patriotët mendonin të krijonin çeta të armatosura që të solidarizoheshin me kryengritësit e veriut. Në krahinën e Korçës, këtë shkëndijë e mbanin ndezur Themistokli Gërmenji, Mihal Gramenoja, Spiro Ballkameni,

Haki Mborja, Vangjel Gjika dhe patriotët të tjerë. Në mars- prill të vitit 1911, Mihali shkoi në Stamboll ku u takua me patriotët Dervish Hima, Hil Mosi, Nexhip Draga, Hasan Prishtina, etj, të cilët ishin të vendosur në luftën e tyre për çlirimin e Shqipërisë. Ata e caktuan Mihal Gramenon si përfaqësues të Korçës në Komitetin kryengritës të Toskërisë. Kur u kthye në atdhe ai filloi nga puna me sukses. Duke vënë në jetë porositë e marra nga shokët e Stambollit në mesin e vitit 1911 në Korçë, me nxitjen e tij, u organizua Komiteti i Fshehtë i Toskërisë, për të ndihmuar luftën e armatosur. Në komitet bënë pjesë shumë patriotë si Vangjel Gjika, Goni Katundi, Nepsi Kerenxhi, Haki Mborja, etj.

Më 16 qershor të këtij viti çeta e parë e komitetit doli malit. Pas një jave rradhët e saj u shtuan me shumë korçarë të tjerë. Filloi krijimi edhe i çetave të tjera patriotike. Mihal Gramenoja e përkrahu fuqimisht organizimin dhe zhvillimin e kësaj lëvizjeje të armatosur. Ai iu dhuroi luftëtarëve të lirisë rrobat dhe armët e tij, me të cilat kishte luftuar kundër pushtuesve turq në çetën e Çerçiz Topullit. Edhe kjo ishte shprehje e përkrahjes që i jepte ai luftës së armatosur kundër pushtuesit.

Por, qeveria osmane për të mos lejuar përhapjen e kryengritjes në Jug të Shqipërisë, në korrik 1911 dërgoi në Korçë forca të shumta ushtarake, duke arrestuar aktivistet kryesore të saj, midis të cilëve edhe Mihal Gramenon, si dhe rrethuan në befasi, në Orman Çiflig, çetat e Spiro Ballkamenit dhe të Qamil Panaritit. U burgosen rreth 40 patriotë që ishin shpirti i lëvizjes kombëtare jo vetëm në Korçë, por edhe në vise të tjera përreth.

Themistokliu, Mihali e patriotët e tjerë që ndodheshin në burgun e Korçës nuk hoqën dorë për asnjë çast nga plani i kryengritjes së armatosur. Qeveria turke përpigje që me mashtrime dhe kercenime t'i largonte ata nga rruga e tyre. Ajo dërgoi në burg dhe dy përfaqësues të saj, të cilët për të mashtruar patriotët deklaruan se qeveria do t'i njihte kërkesat e popullit shqiptar. Por patriotet nuk ranë në kurthin e qeverisë turke. Në emër të patriotëve të burgosur Mihal Gramenoja iu përgjigj të dërguarve të qeverisë: "ne nuk heqim dore nga lufta për çlirimin kombëtar".

Viti 1912 ishte periudha kur në vendin tonë ndodhën lëvizje të mëdha. Vala e kryengritjes ndihej kudo. Vete zhvillimi i ngjarjeve hodhi poshtë propagandën turke se "Lëvizja e armatosur shqiptare ishte thjesht një turbullirë çetash". Në faqet e gazetës "Koha", Mihali trajtoi probleme të rëndësishme që shtroheshin lidhur me luftën e armatosur. Numri i luftëtarëve rritej vazhdimisht. Midis shumë patriotëve, edhe Mihali, në shtator 1912 u regjistrua vullnetar që të luftonte për lirinë e Shqipërisë.

Shpallja e pavarësisë edhe për të ishte gëzim i madh. I thirrur nga Vlora ai me disa shokë nisët për atje, ku arriti më 3 dhjetor 1912. Në Vlorë u vu në shërbim të qeverisë së Ismail Qemalit dhe punoi me vendosmëri për zbatimin e programit të saj.

Duke parë veprimtarinë e Mihal Gramenos në vitet 1909-1912, arrijmë në përfundimin se ai u udhëhoq nga mendimi që lëvizja kombëtare shqiptare ishte një lëvizje e gjerë e çlirimtare, një lëvizje që s'mund ta mposhte as demagogjia dhe as forca e armeve të armikut. Në këtë periudhë të rëndësishme për çështjen e pavarësisë kombëtare Mihal Gramenoja dha një kontribut të ndjeshëm për gjallërimin e lëvizjes patriotike në

trevën e Korçës në të gjitha aspektet e saj, si lëvizje kulturore, politike, letrare, gazetareske dhe mbi të gjitha si një lëvizje e armatosur, çka ishte aspekti kryesor i saj.

### **Referencat**

Trako Pirro “Mihal Grameno”, Tiranë 1974

“Histori e Shqipërisë” vëll. II, Tiranë 1984

Butka Uran “Gjeniu I kombit”, Tiranë 2000

Gogo Iliaz “Punëtorë të shquar të shkollës shqipe ”, Tiranë 2001

Gjika Thanas “Mihal Grameno, jeta dhe vepra”, Durrës 2012

VITI XVII I BOTIMIT, Nr. 23, 2012

BULETINI SHKENCOR

SCIENCE BULLETIN

(seria e shkencave shoqërore)  
(social science series)